


PRONËSI NDËRKOMBËTARE APO LOKALE?

ZHVILLIMI I SEKTORIT TË SIGURISË
NË KOSOVËN E PAS-PAVARËSISË

DR. FLORIAN QEHAJA



PRONËSI NDËRKOMBËTARE APO LOKALE?
ZHVILLIMI I SEKTORIT TË SIGURISË NË KOSOVËN E PAS-PAVARËSISË



PRONËSI NDËRKOMBËTARE APO LOKALE?

**ZHVILLIMI I SEKTORIT TË SIGURISË
NË KOSOVËN E PAS-PAVARËSISË**

DR. FLORIAN QEHAJA

Verzioni origjinal i këtij libri është në gjuhën angleze.

Botimi i librit në gjuhën shqipe u mundësua nga
Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga autori dhe publikuesi i parë i këtij teksti
– Universiteti i Lublanës. Të drejtat e pronësisë intelektuale mbrohen nga Ligji Nr.
04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta dhe Ligji Nr. 05/L-047 për
Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat
e Përafërta. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme
elektronike apo të transmetohet në çfarëdo forme apo mjete elektronik, mekanik apo
tjetër, pa lejen paraprake të botuesit.

Birit tim, Fron Qehaja

PËR AUTORIN

Florian Qehaja është aktualisht Drejtor Ekzekutiv i Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), organizatë udhëheqëse për çështje të sigurisë në Kosovë dhe në Ballkanin Perëndimor. Ai ka punuar si konsulent ndërkombëtar në çështje të sigurisë dhe ka bashkëpunuar me organizata të njohura qeveritare dhe joqeveritare ndërkombëtare. Z. Qehaja po ashtu është një opinionist që ofron analiza në mediat lokale dhe ndërkombëtare në fushën e gjerë të sigurisë dhe politikës së jashtme. Aktualisht është udhëheqës i ekipit të mbështetjes bilaterale të Ministrisë Norvegjeze të Mbrojtjes (CIDS) në Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës, duke e këshilluar Ministrinë për çështjet e menaxhimit dhe integritetit të burimeve njerëzore.

Z. Qehaja është autor i disa publikimeve shkencore dhe të politikave në fushën e sigurisë. Ai ka kryer post-doktoratë në Universitetin Kolumbia (në Institutin Saltzman për Studime të Luftës dhe Paqes) si bursist i programit Fulbright. Ai mban titullin doktor i shkencës në studime të sigurisë nga Fakulteti i Shkencave Shoqërore të Universitetit të Lubjanës. Për më tepër, ai ka diplomuar në Universitetin e Sussex (në Mbretërinë e Bashkuar) në Studimet Bashkëkohore Evropiane (MA) si fitues i grantit OSI/Chevening, ndërsa diplomën Bachelor në Drejtësi e ka marrë në Universitetin e Prishtinës.

Ai është i martuar dhe ka një djalë.

TABELA E PËRMBAJTJES

Mirënjohje	xiii
Parathënie	xv
Lista e shkurtesave	xvii
HYRJE	XIX
Struktura e librit	xxvii
KAPITULLI I 1: ZBËRTHIMI I PRONËSISË LOKALE	1
Themelet dhe përkufizimi i pronësisë lokale	1
Pronësia lokale në diskursin e politikave	5
Kush janë vendorët?	10
Ligjshmëria, legjitimiteti dhe pronësia lokale	14
Vetëvendosja	15
Legjitimiteti	20
Kritikat për pronësinë lokale	23
Teoria e shtetndërtimit	26
Ndërtimi i paqes liberale	30
Besimi	37
Reforma e Sektorit të Sigurisë	39
RSS dhe pronësia lokale: Si përputhen këto dy koncepte?	45
RSS dhe zhvillimi	47
KAPITULLI II: KONTEKSTI I ZHVILLIMIT TË SEKTORIT TË SIGURISË NË KOSOVË	51
Karakteristikat kyçe politike dhe të sigurisë	52
Mungesa e pronësisë lokale dhe autoriteti i kompetencave të rezervuara (1999-2004)	54
Mbështetja komplekse dhe implikimet për zhvillimin e sektorit të sigurisë	60
Pika e kthesës: Fillimi i dorëzimit të përgjegjësive (2004 - 2008)	64

KAPITULLI III: SEKTORI I SIGURISË NËN OMBRELLËN E BASHKËSISË NDËRKOMBËTARE	69
Dilemat e mëdha.....	69
Dilema e varësisë	76
Bashkëpunimi i pabarabartë dhe dilema e besimit	78
Vendorët nuk u besojnë ndërkombëtarëve	79
Bashkësia ndërkombëtare nuk u beson vendorëve.....	83
Stabiliteti i ekzagjuar.....	88
Stabiliteti i ekzagjuar në raport me zhvillimin institucional.....	90
Stabiliteti i ekzagjuar në raport me kërcënimet e sigurisë	98
Perceptimi publik për pronësinë lokale	102
Perceptimi për rolin e përgjithshëm të bashkësisë ndërkombëtare.....	102
Perceptimi për kapacitetet lokale dhe tërheqjen e misioneve ndërkombëtare	108
Analiza multivariate e perceptimeve	113
KAPITULLI IV: PROBLEMET E ZHVILLIMIT TË SEKTORIT TË SIGURISË NË TRE SHEMBUJ.....	119
Hartimi i strategjisë së sigurisë së Kosovës (2009-2011)	119
Siguria në bashkësi nga lartë - poshtë	127
Tejprioritizimi i incidenteve me motive etnike.....	135
KAPITULLI V: PËRMBLEDHJE MBI PRONËSINË LOKALE NË MJEDISËT E PAS PAVARËSISË.....	141
Rishikimi i pronësisë lokale	143
Analogjia ndërmjet pronësisë lokale dhe vetëvendosjes.....	145
Rëndësia e legjitimitetit në pronësinë lokale	147
Ulja e varësisë ndaj bashkësia ndërkombëtare.....	148
Strategjia e qartë dalëse	149
Aftësia për të rezistuar	150
Implikimet e ekzagjerimit të “politikës së lartë”	152
Promovimi i besimit	154
Zvogëlimi i modeleve të imponuara nga jashtë	156

PËRFUNDIMET	159
Sintetizimi i sfidave të pronësisë lokale	160
Perspektiva e ardhshme e teorizimit të pronësisë lokale dhe ri-përkufizimit të rolit të bashkësisë ndërkombëtare	164
REFERENCAT	171

MIRËNJOHJE

Nuk mund ta marrë me mend t'ia atribuoj vetëm vetes përfundimin e këtij libri. Ndhimja e një numri personash dhe disa institucioneve ka qenë shumë e rëndësishme në faza të ndryshme të hulumtimit tim. Meqë libri bazohet në masë të madhe në temën e doktoratës, më duhet të shpreh mirënjohjen time për Departamentin e Mbrojtjes në Fakultetin e Shkencave Shoqërore të Universitetit të Lubjanës ku kam ndjekur studimet e doktoratës. Po ashtu kam përfituar shumë edhe nga mundësitë dhe përkrahja që kam marrë nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS). Përveç kësaj, kam pasur dy mundësi të jashtëzakonshme të mobilitetit kërkimor dhe hulumtues në Institutin Norvegjez për Çështje Ndërkombëtare (NUPI) dhe në Universitetin e Gracit. Derisa periudha e mbledhjes së të dhënave ka kërkuar që unë të jem i pranishëm në mënyrë proaktive në Kosovë, unë kam përfituar edhe nga periudhat e udhëtimeve zyrtare dhe profesionale (si në Nepal, Palestinë, etj.). Veçanërisht, pjesëmarrja e shpeshtë dhe kontributi në konferenca prestigjioze akademike dhe të politikave shënuan një vlerë të shtuar në punën time.

Janë një numër njerëzish të cilëve u detyrohem shumë dhe të cilët kanë kontribuar shumë në përfundimin e këtij libri. Një falënderim shumë i veçantë shkon për babain tim, Gjeneral Ramadan Qehajën i cili ishte frymëzuesi kryesor në rrugëtimin tim profesional e shkencor. Bagazhi i tij i gjerë profesional në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë përbënte shtytjen bazë në ngritjen time profesionale. Në mënyrë të veçantë falënderoj nënën time Nazmien për këshillat dhe investimet gjatë gjithë jetës dhe gruan time Vjosën për durimin e madh dhe përkrahjen morale në të gjitha fazat e shkrimit të këtij libri.

Biri im, Froni, më ka frymëzuar që të përfundoj këtë libër. Ai padyshim do më frymëzojë që të zgjerojë punën time kërkimore dhe të publikojë librin e ardhshëm.

Florian Qehaja

PARATHËNIE

Ky libër është një hap më tej në zhvillimin e konceptit të pronësisë lokale, duke e larguar atë nga niveli i politikave drejt nivelit akademik përmes aplikimit të rastit empirik të Kosovës. Për ta bërë këtë janë aplikuar tre perspektiva: perspektiva e parë është ajo teorike, që analizon pronësinë lokale në bazë të teorisë së shtet-ndërtimit dhe konceptit të reformës së sektorit të sigurisë (RSS); perspektiva e dytë zbrëthen njohuritë ekzistuese për pronësinë lokale; dhe perspektiva e tretë është ajo empirike, që e trajton rastin e Kosovës për shkak të rëndësisë që ka rreth dilemës mbi pronësinë lokale.

Pronësia lokale është vënë përballë RSS-së sepse koncepti saj, ndonëse në nivel të politikave, ka rrjedhur nga RSS. Sidoqoftë, kufizimi i konceptit vetëm në RSS është i pamjaftueshëm për analizën e saj shkencore duke marrë parasysh teoritë e tjera relevante, siç është teoria e shtet-ndërtimit. Së këndejmi, ky hulumtim i ka dhënë prioritet teorisë së shtet-ndërtimit përmes testimit të pronësisë lokale në kuadër të normave siç janë besimi dhe legjitimiteti. Në mënyrë të veçantë, pronësia lokale është analizuar në kontekstin e ligjshmërisë, ku vetëvendosja paraqet njërin prej parimeve më të përshtatshme. Libri e kontekstualizon pronësinë lokale brenda kornizës së marrëdhënieve ndërmjet bashkësisë ndërkombëtare dhe aktorëve lokalë në Kosovë duke përcaktuar këtë marrëdhënie në kontekst të njëjës ndërkombëtarë - vendorë. Prandaj, ky hulumtim nuk ishte në gjendje të ekzaminojë ndarazi rolin e aktorëve në procesin e zhvillimit të sektorit të sigurisë. Këto marrëdhënie komplekse paraqesin një dobësi që pengon zbatimin e pronësisë lokale. Komponenti i përgjithshëm ishte kontekstualizimi i “politikës së lartë” dhe implikimet e saj në zbatueshmërinë dhe respektimin e pronësisë lokale.

Bashkësia ndërkombëtare është gjetur të jetë obsesive lidhur me përgjegjësinë e saj në siguri - e fokusuar më shumë në një stabilitet të tepruar - duke e pasur këtë si vëllën e vet thelbësore. Kjo e ka rrezikuar

përfshirjen e vendorëve në procesin e shtet-ndërtimit deri në atë masë sa e tjetërsoi popullsinë dhe profesionistët lokalë. Ky libër ka përdorur shembuj konkret empirikë për të sqaruar shkallën e ndërhyrjes ndërkombëtare në sektorin e sigurisë së Kosovës. Fillimisht, pjesa empirike e librit i sqaron në aspektin kontekstual elementet kyçe që shënojnë intervenimin e bashkësisë ndërkombëtare në dëm të pronësisë lokale. Kjo ka qenë tepër e pranishme gjatë periudhës së administrimit ndërkombëtar të Kosovës, nga viti 1999 deri në 2008. Kapitulli tjetër e identifikon marrëdhënien e tendosur ndërmjet bashkësisë ndërkombëtare dhe aktorëve lokalë rreth një numri vendimesh në periudhën pas pavarësisë. Këtu, referencë e veçantë i është kushtuar krijimit të forcave të armatosura dhe nivelit të mosbesimit të identifikuar, si përmes matjeve cilësore ashtu edhe atyre sasiore. Analiza futet edhe më thellë duke shqyrtuar tri raste specifike që e sfidojnë pronësinë lokale në Kosovë: procesi i hartimit të strategjisë së sigurisë; krijimi “nga lart poshtë” i këshillave për siguri në bashkësi; dhe tejproritizimi i incidenteve ndëretnike.

Rasti i Kosovës ka dëshmuar të jetë shumë i rëndësishëm në ekzaminimin e shkallës së përfshirjes ndërkombëtare. Roli tepër i madh i bashkësisë ndërkombëtare, e cila nuk ka një strategji të qartë dalëse, ka bërë që politikat e imponuara nga jashtë të refuzohen nga faktorët lokalë, duke mos gjetur aplikim në kontekstin e Kosovës. Ky nivel i përfshirjes së bashkësisë ndërkombëtare e ka ndarë politikën e sigurisë prej realitetit lokal, duke e çuar atë në fragmentim dhe qëndrueshmëri të kufizuar.

Ky libër është bazuar në masë të madhe në disertacionin e doktoratës të mbrojtur me 14 shkurt 2016 në Fakultetin e Shkencave Shoqërore (Departamenti i Mbrojtjes), në Universitetin e Lubjanës. Për më tepër, libri pasqyron mbi dhjetë vite përvojë të autorit në hulumtimin dhe monitorimin e sektorit të sigurisë në Kosovë.

LISTA E SHKURTESAVE

ASK	Agjencia e Statistikave e Kosovës
B e H	Bosnja e Hercegovina
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
BPV	Bruto Prodhimi Vendor
ÇÇR	Çmobilizim, Çarmatim dhe Ri-integrim
DCAF	Qendra e Gjenevës për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura
DFID	Departamenti i Mbretërisë së Bashkuar për Zhvillim Ndërkombëtar
EPLO	Zyra Ndërlidhëse Evropiane për Ndërtimin e Paqes
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë
EUPT	Ekipi Planifikues i Bashkimit Evropian
EVSB	Ekipet Vepruese për Siguri në Bashkësi
FAK	Forcat e Armatosura të Kosovës
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
FSK	Forca e Sigurisë së Kosovës
GJND	Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë
HRW	Human Rights Watch
ICG	Grupi Ndërkombëtar i Krizave
ICISS	Komisioni Ndërkombëtar mbi Ndërhyrjen dhe Sovranitetin Shtetëror
ICO	Zyra Civile Ndërkombëtare
KAZH	Komiteti për Asistencë Zhvillimore
KFOR	Prania Ushtarake Ndërkombëtare në Kosovë
KIPRED	Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave
KKSB	Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi
KLSP	Komitetet Lokale për Siguri Publike
KSKB	Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara
KSS	Këshilli i Sigurisë së Kosovës

KTV	Kohavizioni
MB	Mbretëria e Bashkuar
MFSK	Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës
MMA	Monitorimi, Mentorimi dhe Këshillimi
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior
NUPI	Instituti Norvegjez për Çështje Ndërkombëtare
OECD	Organizata për Bashkëpunimin dhe Zhvillim Ekonomik
OHR	Zyra e Përfaqësuesit të Lartë
OJQ	Organizatat Joqeveritare
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PEMI	Krimet Potencialisht të Motivuar Etnikisht
PK	Policia e Kosovës
PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
QKSS	Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë
RSS	Reforma e Sektorit të Sigurisë
RSSB	Rishikimi i Sektorit të Sigurisë së Brendshme
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
SHPK	Shërbimi Policor i Kosovës
SSK	Strategjia e Sigurisë Kombëtare
TMK	Trupat Mbrojtëse të Kosovës
UÇK	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

HYRJE

Që nga përfundimi i konfliktit në vitin 1999, Kosova zyrtarisht ishte nën administrimin e bashkësisë ndërkombëtare¹ nën ombrellën e Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) dhe pranisë ushtarake ndërkombëtare (KFOR). Autoriteti i këtyre misioneve është bërë pjesë e të drejtës ndërkombëtare me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (RKSB) (OKB, 1999). Përveç këtyre dy misioneve, ishte edhe “një armatë e tërë punëtorësh ndërkombëtarë” në organizata qeveritare dhe joqeveritare (OJQ), të cilit ishin bashkuar me qëllim të rindërtimit dhe zhvillimit të Kosovës. Edhe pse pushteti i bashkësisë ndërkombëtare në mënyrë të kuptueshme ishte shumë i madh në periudhën e menjëhershme të pas konfliktit, ka pasur një trajektore e cila e ka shënuar ndryshimin e ndikimit dhe mandatit të misioneve ndërkombëtare. Megjithatë, në disa sektorë ky ndryshim nuk ka ndodhur në mënyrë koherente dhe duke i marrë parasysh rrethanat e reja.

Ky moment i ri u krijua në kohën kur Kosova e shpalli pavarësinë e saj me 17 shkurt 2008. Shtetësia e Kosovës - si një projekt i mbështetur ndërkombëtarisht - u njoh shpejt nga disa fuqi ndërkombëtare. Megjithatë, konsolidimi i shtetësisë së Kosovës u ballafaqua me sfida të vështira, të cilat e komplikuan procesin e shtet-ndërtimit: veçanërisht krahasuar me shtetet e tjera të ish-Jugosllavisë të cilat kishin kaluar nëpër procesin e secesionit (Surroi, 2014; Weller, 2009). Këto sfida ishin të jashtme, dhe që përcaktoheshin nga interesat e ndryshme që kishte bashkësia ndërkombëtare në Kosovë. Rrjedhimisht, nga perspektiva e marrëdhënieve ndërkombëtare, formësimi i shtetësisë së Kosovës u pengua nga vështirësitë e jashtme politike. Këto probleme

1 Libri i referohet nocionit “bashkësi ndërkombëtare” sepse ai nënkupton një subjekt politik ndërkombëtar. Ai përfshin misionet ndërkombëtare në terren, komunitetin e donatorëve ndërkombëtarë, dhe individët ndërkombëtar me ndikim. Së këndejmi, nocioni ‘bashkësi ndërkombëtare’ nënkupton më së miri gamën e gjerë të aktorëve ndërkombëtarë në fushat në të cilat është i fokusuar ky hulumtim.

përfshinin kërcënimin e Rusisë me veto në Këshillin e Sigurimit të OKB-së dhe rolin e Serbisë si “elefanti në dhomë” përmes refuzimit të saj që të njohë pavarësinë e Kosovës. Kjo situatë veç sa e rriti kompleksitetin e rolit dhe pranisë së bashkësisë ndërkombëtare, të cilës si rezultat, dhe siç me të drejtë e identifikon Richard Caplan, i mungonte një strategji e qartë dalëse, duke e arsyetuar praninë e tyre në terren në bazë të “politikës së lartë” (Caplan, 2012, f. 4). Me fjalë të tjera “politika e lartë” nënkuptonte se sfidat e jashtme politike me të cilat përballlej Kosova ishin arsye më të mëdha se sa elementet e procesit të shtet-ndërtimit.

Dilema primare për bashkësinë ndërkombëtare kishte të bënte me sektorin e sigurisë. Ky sektor ka rëndësi të madhe, sepse e përmban fuqinë detyruese dhe shtyllat e shtetësisë (Buzan, 1991; Fukuyama, 2004; Weber, 1958). Si pasojë, pronësia mbi planifikimin, menaxhimin dhe kontrollin e sektorit të sigurisë paraqiste një pikëpyetje për Kosovën në periudhën pas pavarësisë. Nuk ishin vërejtur ndryshime të mëdha në mes të periudhës së pas konfliktit dhe asaj të pas pavarësisë në diskursin dhe mandatin e misioneve ndërkombëtare ndaj sektorit të sigurisë. Për shembull, diskursi e vinte vazhdimisht theksin në dilemat politike dhe rajonale - siç ishte reagimi i Serbisë - para politikës dhe kërkesave të brendshme. Në fakt, e para dukej se mbizotëronte ndaj kësaj të dytës (Surroi, 2014). Një ish-zyrtar i lartë i bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë në mënyrë cinike sugjeronte se nëse Ministri i Punëve të Jashtme në Serbi do të deklaronte se “do të shembet qielli në Kosovë” atëherë reagimi i bashkësisë ndërkombëtare do të bazohej në atë deklaratë (F. Harris, intervistë personale, 2 maj, 2014).

Si rezultat, në të gjitha nivelet e zhvillimit të sektorit të sigurisë është vërejtur një ambiguitet politik dhe ndërhyrje e tepruar e bashkësisë ndërkombëtare. Referenca në çështje që krejtësisht kishin të bënin me sigurinë - ose mbrojtjen edhe ishte dobësuar edhe konsiderohej si autoritet ekskluziv i bashkësisë ndërkombëtare. Në shpjegimin e këtij fenomeni, një aktivist politik nga Prishtina kishte deklaruar se “qeverisja ndërkombëtare e ka imponuar një diskurs të zhveshur nga fjalët “mbrojtje” (*ang. ‘defence’*) madje edhe “mbrojtje [në kuptimin e ruajtjes]” (*ang. ‘protection’*), ku mbetet vetëm “siguria” sepse ushtria është

shndërruar në polici, dhe sundimi i ligjit është revokuar nga sunduesit e ligjit, i ndarë nga idetë e drejtësisë” (Kurti, 2011, f. 92).

Rrjedhimisht, këto politika kanë çuar në reagimin e palëve dhe aktorëve lokalë, deri në atë masë sa që kornizat e politikave lokale për krijimin e forcave të armatosura mbizotëruan më vonë në raport me modelin e forcës së sigurisë së imponuar nga jashtë. Për më tepër, bashkësia ndërkombëtare theksonte nevojën që në mënyrë artificiale të ruhet stabiliteti dhe siguria, përkundër asaj se kjo pasqyrore një stabilitet të obsesionuar e ekzagjeruar i cili manifestonte mungesën e besimit në mes të bashkësisë ndërkombëtare dhe vendorëve. Edhe në Kosovën e pas pavarësisë, kërkesat e brendshme nga poshtë-lartë vazhdimisht kishin mbetur nën hije të qasjeve standarde nga lart-poshtë të bashkësisë ndërkombëtare. Një ndërhyrje e tillë në zhvillimin e sektorit të sigurisë e ka shkëputur politikën e sigurisë nga realiteti lokal, duke siguruar fragmentim dhe qëndrueshmëri të kufizuar të saj. Kjo reflektohet, për shembull, nga qasja e Strategjisë Kombëtare të Sigurisë (SKS) të imponuar nga jashtë, ku dominimi artificial i politikave ndëretnike dhe i sigurisë në bashkësi “nga lart-poshtë” shënon rastin më shqetësues, ndonëse jo të vetmin, në procesin e zhvillimit të sektorit të sigurisë në Kosovë.

Pozita vartëse e kërkesave vendore nën agjendën e imponuar nga jashtë ka rezultuar në bashkëpunim të pabarabartë (Hansen, 2008; Reich, 2006; Richmond, 2012) ndërmjet bashkësisë ndërkombëtare dhe qeverisë e faktorëve lokalë. Kjo pasojë jo vetëm që është identifikuar në qarqet akademike (Mac Gintz, 2007; Paris dhe Sisk, 2009; Richmond, 2012) por edhe është konfirmuar nga të intervistuarit gjatë grumbullimit të të dhënave. Po ashtu, dhe në kuptim më të gjerë, mungesa e përfshirjes së faktorëve lokalë në formë të përfaqësuesve të qeverisë ose të shoqërisë civile manifeston një ndër prerogativët kyç për sigurimin e pronësisë lokale. Nëse synimet fillestare të misionit ndërkombëtar bazoheshin në arritjen e qëllimeve pozitive, rezultatet mund të sigurohen vetëm nëse faktorët lokalë marrin pjesë aktive dhe udhëheqin proceset e zhvillimit. Në Kosovë nuk ka ndodhur kështu.

Libri nuk e përkrah ndonjë ide radikale që synon të sfidojë themelet e pranisë së bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë. Nga pikëpamja

strategjike, prania ndërkombëtare ia ka dal që të ndal luftën dhe ka ndihmuar në tranzicionin e një shoqërie post-autoritare dhe të pas konfliktit në një shoqëri demokratike dhe të tregut të lirë. Në këtë mënyrë, Kosova pati mundësi tu kthehet aspiratave të saj për t'iu bashkuar familjes së saj gjeografike dhe kulturore - Evropës. Për më tepër, ky libër e portretizon në mënyrë pozitive perceptimin e qytetarëve të Kosovës për rolin e bashkësisë ndërkombëtare: shumica e kosovarëve (61.9%) e konsiderojnë rolin e bashkësisë ndërkombëtare të rëndësishëm, veçanërisht në periudhën menjëherë pas konfliktit. Megjithatë, ajo çka sfidon ky libër janë “veprimet taktike” të bashkësisë ndërkombëtare, të cilat i ‘ushqejnë’ strategjitë prapa shumë shtyllave të shtet-ndërtimit, veçanërisht në sektorin e sigurisë. Me fjalë të tjera, shkalla në të cilën vendorët janë të përfshirë në procesin e zhvillimit është shumë me rëndësi për krijimin dhe mbajtjen e një strategjie të mirë.

Natyrisht, do të ishte naive që të synohej pronësia lokale në periudhën menjëherë pas konfliktit në të cilën kapacitetet në dispozicion janë shumë të kufizuara për adresimin e detyrave themelore të rendit publik pas konfliktit. Kjo çështje pasqyron një argument i cili mbështetet prej fillimit e deri në fund të librit. Megjithatë, pronësia do të mund të arsyetohej pasi aktorët lokalë të kenë fituar nivelin e duhur të përvojës. Në anën tjetër, nuk mund të thuhet se jeta në Kosovë ka filluar në vitin 1999 - duhet të merren parasysh edhe përvojat e mëhershme, përfshirë edhe ato të drejtuara nga elita gjatë viteve 1970-ta dhe 1980-ta (Surroi, 2014). Përvojat e mëhershme të kosovarëve dhe, çka është më e rëndësishme, 9 vitet e administrimit ndërkombëtar në Kosovë (1999-2008), së bashku rezultuan me një rritje të pjekurisë, duke kontribuar në shtimin e thirrjeve për një sektor të sigurisë në pronësi lokale. Derisa nevoja për një përfshirje të bashkësisë ndërkombëtare arsyetohet, kjo prani ndërkombëtare nuk mundet pafundësisht të zëvendësojë kapacitetet lokale (Donais, 2012b). Bashkësia ndërkombëtare mund të zëvendësojë kapacitetet lokale vetëm përkohësisht, deri sa të vërej potencialin për rritjen e pjekurisë vendore që kosovarët e kanë treguar që nga fillimi i shtetësisë.

Në të vërtetë, sfidat e ndikimeve të jashtme ndaj shtetësisë pasqyronin vetëm një element të problemeve. Faza fillestare e shtet-ndërtimit

është penguar edhe si rezultat i faktorëve të brendshëm, siç janë: zhvillimi i dobët ekonomik, vështirësitë në zbatimin e sundimit të ligjit, korrupsioni dhe krimi i organizuar i krijuar nga elita politike lokale. Të gjitha këto probleme pasqyrojnë enigma të mëdha, të cilat ndikojnë në mënyrë të njëjtë në proceset e shtet-ndërtimit. Secila çështje tregon ndërlikueshmërinë e proceseve të shtetndërtimit në Kosovë. Sidoqoftë, synimi i këtij libri është që të fokusohet vetëm në një drejtim të procesit të shtet-ndërtimit, në veprimet e bashkësisë ndërkombëtare. Kjo i referohet drejtpërdrejt fushës primare të hulumtimit - pronësisë lokale.

Koncepti i pronësisë lokale është ekzaminuar dhe komentuar në mënyrë kritike përgjatë tërë librit. Pronësia lokale është një prej frazave më të shpeshta politike të përdorura në mjediset e post-konfliktive si nga profesionistët ndërkombëtarë ashtu edhe nga aktorët lokalë. Nëse e përmbledhim përkufizimin ekzistues, pronësia lokale tregon shkallën në të cilën faktorët lokalë dhe përfaqësuesit e zgjedhur të një vendi të caktuar ushtrojnë të drejtën e pronësisë në proceset e zhvillimit dhe shtet-ndërtimit (Donais, 2009). Supozimi mbizotërues i pronësisë lokale ka argumentuar në favor të asaj që “aktorët lokalë të vihen në plan të parë dhe të udhëheqin proceset e reformës...si dhe që roli primar t’i jepet përfshirjes së shoqërisë civile në hartimin e politikave dhe në zhvillim” (Donais, 2012a, p. 12). Një përkufizim më i gjerë i referohet të drejtës ligjore dhe politike të aktorëve lokalë që të kenë autoritetin përfundimtar që në mënyrë të pavarur të vendosin për proceset e shtet-ndërtimit në një territor ose rajon të caktuar. Në aspektin ligjor, është e drejtë e qytetarëve në një territor apo shtet të caktuar të zgjedhin formën e tyre të qeverisjes, e cila njihet edhe si e drejtë e vetëvendosjes. Për më tepër, ajo përshkruan argumentet politike me të cilat e arsyeton nevojën për tu dëgjuar “zëri” i vendorëve në proceset e shtyra nga jashtë, duke përfshirë edhe normat kyçe që favorizojnë të drejtën e njerëzve e cila rrjedh nga legjitimiteti. Në përgjithësi, pronësia lokale nuk është vetëm e drejtë por edhe shërben si koncept shumë i rëndësishëm dhe si kornizë që u jep faktorëve lokalë autoritetin që të udhëheqin dhe të jenë pronarë të proceseve të zhvillimit të sektorit të sigurisë.

Sidoqoftë, përkufizimet ekzistuese janë paraqitur në kuptim të ngushtë në nivel të politikave dhe avokimit. Pronësia lokale nuk duhet të paraqes vetëm kornizën e politikave por ajo mund të përdoret edhe si vegël që i shërben bashkëpunimit ndërmjet bashkësisë ndërkombëtare - qoftë me misionet e mandatuara nga OKB ose me komunitetin e donatorëve - në njërin anë, dhe aktorët lokalë - qoftë me përfaqësuesit e qeverisë dhe shoqërinë civile, në anën tjetër. Rrjedhimisht, pronësia lokale nuk mund të ekzaminohet vetëm nga perspektiva e politikave: në vend të kësaj, niveli akademik ofron fleksibilitet për zbrërthimin e pronësisë lokale nga perspektiva të ndryshme, përfshirë ato teorike dhe empirike.

Rëndësia e këtij libri mund të përshkruhet përmes metodave të ndryshme të ekzaminimit në të cilat pronësia lokale shikohet përtej kornizës së politikave dhe asaj teknike. Edhe pse kontributi nga të tjerët e ka shqyrtuar pronësinë lokale kryesisht rreth dimensioneve teknike, është e drejtë të thuhet se ky koncept duket të mos jetë hulumtuar përtej nivelit të politikave (Martin dhe Wilson, 2008). Si rezultat, kam ardhur në përfundim se kontributi i deritanishëm ka bërë vetëm hapa të kufizuar drejt zhvillimit të një kuptimi dhe sqarimi të pronësisë lokale që është në gjendje të bind aktorët e rëndësishëm të politikave për zbatueshmërinë dhe dobinë e këtij termi në të gjitha mjediset e pas konfliktit.

Ky libër ka bërë një hap përpara që të sjell konceptin evolues të pronësisë lokale nga niveli i politikave në nivelin akademik. Ai nuk është fokusuar vetëm në ekzaminimin e pronësisë lokale në tërë dimensionin e marrëdhënieve ndërmjet faktorëve ndërkombëtarë dhe aktorëve lokalë: ai po ashtu e ka trajtuar edhe përfshirjen e shoqërisë civile në bërjen e politikave për të përmbushur nocionet e një sektori gjithëpërfshirës të sigurisë. Ky fokus shtesë, përmes përfshirjes së një analize të shoqërisë civile, shërben si një vlerë e shtuar në origjinalitetin e këtij libri. Ai bazohet në supozimin se përfituesit përkatës janë qytetarët e vendit dhe jo vetëm profesionistë (Martin dhe Wilson, 2008) ose aktorët politikë në terren. Kështu, përveç pronësisë shtetërore, krahas rolit të bashkësisë ndërkombëtare, ky hulumtim po ashtu vlerëson edhe rolin e aktorëve të shoqërisë civile në zhvillimin e sektorit të sigurisë.

Si rezultat përfundimtar, unë ia kam dal të zërthej konceptin ekzistues të pronësisë lokale dhe të aplikojë të gjitha kompleksitetet e saj në studimin e Kosovës. Bashkë me konceptin plotësisht të zërthyer të pronësisë lokale, rasti i Kosovës duket të jetë mjaft sfidues dhe kompleks për të testuar pronësinë lokale. Ai paraqet një rëndësi empirike specifike e cila dallon nga njohuritë ekzistuese të pasqyruara në rastet e tjera. Unë kam ardhur në përfundime duke aplikuar një hulumtim të shume strategjive i cili mundësojë diversifikimin e metodave të mbledhjes së të dhënave. Metodologjia përfshinte një kombinim të hulumtimit cilësorë si dhe matjes sasiore; ku e para nënkuptonte një fushë më të gjerë metodologjike. Unë i kam mbledhur të dhënat gjatë periudhës prej janarit 2014 deri në janar 2015. Kam zhvilluar 21 intervista kokë-më-kokë me palët e interesit; është bërë një anketë vetëm për qëllime të hulumtimit, duke nxjerr një mostër kombëtare që e përfaqëson popullsinë e Kosovës të moshës mbi 18 vjeçare, që përfshinte 1,101 familje; dy grupe të fokusit; analiza të përmbajtjes dhe teksteve si dhe vrojtim me pjesëmarrje dhe pa pjesëmarrje.

Në përgjithësi, besoj se libri do të arrijë qëllimin që të kuptohen kompleksitetet e pronësisë lokale në mjediset e pas pavarësisë. Kontributi i dhënë nga studiuesit e tjerë në këtë fushë ka qenë kryesisht i orientuar drejt politikave e rrallë është identifikuar ndonjë kontribut akademik. Studimet e deritashme kanë aplikuar një fokus teknik duke shqyrtuar në mënyrë të izoluar politikat e donatorëve dhe reformën e sektorit të sigurisë në rastet studimore specifike. Prandaj, rastet që janë zhvilluar deri më sot u përjasin atyre vendeve që gëzojnë njohje të plotë ndërkombëtare si shtete dhe marrëdhëniet e tyre me bashkësinë ndërkombëtare janë zhvilluar në rrethana të ndryshme politike. Për shembull, Nathan ka shpjeguar pronësinë lokale në proceset e RSS-së në Afrikën Jugore (Nathan 2007); MacGinty ka dhënë një kontribut në zërthimin e këtij koncepti në rastin e Libanit (MacGinty 2007); Albrecht dhe Jackson kanë kontribuar në rastin e Sierra Leones (Albrecht dhe Jackson 2014); Lemay-Hebert është fokusuar kryesisht në rastin e Timorit Lindor (Lemay-Hebert 2011; Lemay-Hebert 2012), kontributi nga Friedrich dhe Luethold në Palestinë (Friedrich, R., dhe Luethold, A, 2008) dhe rastet të tjera eventuale të kontributeve në rastet studimore. Për më tepër, Richmond dhe Donais kanë kontribuar shumë në zërthimin e marrëdhënieve ndërmjet aktorëve ndërkombëtarë.

bëtarë dhe vendorë bazuar në teorinë liberale të ndërtimit të paqes dhe duke ndjekur shembujt e disa rasteve studimore (Richmond, 2009; Richmond, 2012; Donais 2012a). Megjithatë, të gjitha këto kontribute janë fokusuar vetëm në një dimension të pronësisë lokale: ose nënkuptonin vlerësimin e rolit të komunitetit të donatorëve (Nathan 2007) ose kishin për qëllim të zbërthejnë marrëdhëniet ndërmjet bashkësisë ndërkombëtare dhe aktorëve lokalë përtej kornizave politike, shoqërore dhe antropologjike (Donais 2009; Richmond 2012).

Në të vërtetë, në këtë libër unë e kam zbërthyer konceptin e pronësisë lokale dhe i kam aplikuar të gjitha kompleksitetet e saj në studimin e Kosovës. Bashkë me konceptin e ekzaminuar plotësisht të pronësisë lokale, rasti i Kosovës duket të jetë mjaft sfidues dhe kompleks për të analizuar pronësinë lokale. Ai paraqet rëndësi empirike specifike e cila dallon nga njohuria ekzistuese e pasqyruar në rastet e tjera. Si rezultat, përveç kontributit të përgjithshëm për shkencën, unë besoj se ky libër do të plotësojë një pjesë të neglizhuar në bibliotekën deri më sot të kufizuar për çështjet e sektorit të sigurisë në Kosovë. Në këtë fazë, janë disa burime që kanë të bëjnë me sektorin e sigurisë në Kosovë, por ka mungesë të një projekti të vetëm hulumtues i cili elaboron në detaje procesin e vërtetë të ndërtimit të institucioneve të sigurisë. Për shembull, Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë ka nxjerrë disa raporte të hulumtimeve sasiore që matin nivelin e besimit të publikut në sektorin e sigurisë (shih UNDP 2011; UNDP 2012), në bazë të mostrave të stratifikuara që kryesisht tregojnë nivelin e besimit që ndjehet në raport me institucionet e sigurisë në Kosovë. Janë disa raporte të nxjerra nga Grupi Ndërkombëtar i Krizave (ICG) që analizojnë situatën e sigurisë në përgjithësi dhe që fokusohen në pjesën veriore të Kosovës (shih ICG 2007; ICG 2008; ICG 2012; ICG 2013). Përveç këtyre, janë edhe disa artikuj të shkruar nga ekspertë dhe akademikë lokalë me qëllim të vlerësimit të performancës së institucioneve të sigurisë dhe të gjendjes së sigurisë në përgjithësi (shih R. Qehaja 2004; Gashi dhe Hidri 2008; Skendaj 2014) por që kanë mbuluar vetëm çështje shumë specifike dhe kryesisht të orientuara drejt politikave. Janë edhe disa publikime të bëra në revista ndërkombëtare nga akademikë dhe profesionistë ndërkombëtarë të cilat, edhe pse të shumta në numër, vetëm disa merren me specifikën e çështjeve të sigurisë në Kosovë (shih Chomsky 2002; Pettifer 2003;

Welch 2006; Weller 2009; Lemay-Hebert 2012). Rrjedhimisht, ky libër pritet që të shërbejë në tejkalimin e një numri mangësish të ndryshme në njohuritë ekzistuese mbi pronësinë lokale në sektorin e sigurisë, si dhe korpusit të kufizuar të njohurive mbi këtë sektor në Kosovë.

STRUKTURA E LIBRIT

Kapitulli 1 shërben si kornizë konceptuale e librit. Ai fokusohet në zbrërthimin e bazës konceptuale të pronësisë lokale duke sjellë konceptin nga niveli i politikave në atë akademik. Në fillim të këtij kapitulli përkufizohet pronësia lokale si term. Para diskutimit të pronësisë lokale në kontekstin akademik, një seksion specifik i është dedikuar zbrërthimit të termit në bazë të njohurisë ekzistuese të politikave. Ligjshmëria dhe legjitimiteti përbëjnë dy aspektet për të cilat është zbrërthyer fillimisht pronësia lokale, duke shënuar dy fushat si një pikë hyrëse në diskutimin e vërtetë mbi pronësinë lokale. Sa i përket teorisë, baza e parë teorike e merr parasysh teorinë e shtet-ndërtimit, në të cilën është elaboruar pronësia lokale në kuadër të ndërtimit liberal të paqes dhe dilemave të besimit. Dimensionin e dytë ishte reforma e sektorit të sigurisë (RSS), nga e cila ka buruar pronësia lokale. Ky kapitull po ashtu ka përmbledhur kritikën ekzistuese të pronësisë lokale.

Kapitulli 3 shënon fillimin e diskutimit mbi dimensionin empirik, por nga një perspektivë kontekstuale. Këtu, janë disa referenca historike në disa prej zhvillimeve kyçe në të cilat fokusi primar është vënë në periudhën pas konfliktit. Kapitulli është ndarë në dy periudha të administrimit ndërkombëtar të Kosovës: periudhën 1999-2004 dhe periudhën 2004-2008. Këtu, jam fokusuar në rolin e bashkësisë ndërkombëtare gjatë këtyre periudhave si dhe në proceset kyçe politike dhe shoqërore. Disa tipare të rëndësishme të kësaj pjese u kanë shërbyer përpjekjeve në pjesën empirike, me fokus në periudhën prej vitit 2008 deri në 2013.

Kapitulli 4 bën fjalë për thelbin e lidhjes ndërkombëtarë-vendorë. Këtu, kam zbrërthyer rolin e përgjithshëm të bashkësisë ndërkombëtare në procesin e RSS-së duke u fokusuar në dilemën e madhe të stabilitetit të ekzagjeruar e obsesiv. Kapitulli reflekton mbi një numër rastesh empirike që sqarojnë marrëdhënien e pabarabartë ndërmjet

aktorëve ndërkombëtarë dhe lokalë, kryesisht në proceset e sigurisë dhe mbrojtjes. Analiza cilësore është kombinuar me të dhëna sasiore. Pjesa e fundit e këtij kapitulli i interpreton perceptimet e qytetarëve përmes në numri variacionesh.

Kapitulli 5 e sqaron pronësinë lokale përmes sfondit të tri rasteve që e kanë nxitur këtë argumentim: rasti i parë ka të bëjë me ndërhyrjen e bashkësisë ndërkombëtare në procesin e hartimit të SSK-së, rasti i dytë paraqet një shembull të rebusit të mekanizmave të sigurisë në bashkësi, dhe rasti i tretë reflekton mbi dilemën e stërtheksuar të konfliktit ndëretnik. Këto raste demonstronjë gjetjet kryesore empirike në kontekstin e bashkëpunimit ndërmjet bashkësisë ndërkombëtare dhe aktorëve lokalë.

Kapitulli 6 përfundon në formë të mësimëve të nxjerra. Këtu qëllimi im ishte që të përmbledh implikimet e studimit tim empirik për rajonet e tjera. Këto implikime kanë si synim bashkësinë ndërkombëtare dhe qeveritë kryesore donatore që synojnë të përfshihen në procesin e zhvillimit të sektorit të sigurisë në të ardhmen. Megjithatë, implikimet nuk janë të menduara vetëm për kornizën politike por edhe për të pasuruar përkufizimin ekzistues të pronësisë lokale, ndonëse në mënyrë të kufizuar.

KAPITULLI I

ZBËRTHIMI I PRONËSISË LOKALE

Kjo pjesë paraqet gurthemelin e këtij libri. Ajo paraqet intervenimin kryesor teorik përmes zbërthimit të pronësisë lokale. Pjesa e parë fokusohet në konceptin e pronësisë lokale, duke filluar nga përkufizimi gjuhësor para se të thellohet në përkufizim më të përgjithshëm. Për më tepër, kjo analizë pasqyron evoluimin e pronësisë lokale në nivel të politikave duke nënvizuar dominimin e pronësisë lokale në nivelin konceptual dhe akademik. Intervenimi i parë shënon ekzaminimin e nocioneve “pronësi” dhe “lokale”. Pas kësaj, pronësia lokale përforcohet përmes të kuptuarit ligjor i cili bazohet në parimin ekzistues të vetëvendosjes dhe normave në të cilat legjitimiteti zë hapësirë të veçantë.

Pjesa e dytë shqyrton njohurinë teorike ekzistuese mbi shtetndërtimin. Kjo pjesë shqyrton një varg paradigماش që e përshtatin përpjekjen e shtetndërtimit drejt konceptit të pronësisë lokale. Këtu, dominimi matet duke e krahasuar me teorinë liberale të ndërtimit të paqes në kontekstin e shtetndërtimit, në të cilin dilemat dalin në shesh përmes pronësisë lokale. Marrëdhënia ndërmjet vendorëve dhe bashkësisë ndërkombëtare analizohet në norma të shtetndërtimit, siç është besimi. Pjesa e fundit ofron një diskutim për RSS-në, nga e cila buron dilema e pronësisë lokale.

THEMELET DHE PËRKUFIZIMI I PRONËSISË LOKALE

Elementet themelore të pronësisë, si term, rrjedhin kryesisht nga burimet juridike. Sipas fjalorëve juridik, pronësia është e drejtë juridike në të cilën pronari ushtron kontrollin përfundimtar dhe të drejtën mbi pronën (Fjalori, 2013). Nga këndvështrimi ligjor, ka një dallim ndërmjet “të drejtës për të pasur në pronësi” dhe “të drejtës për të

poseduar”. Përderisa e drejta për të poseduar nënkupton të drejtën për të përdorur një pronë të caktuar, ajo, megjithatë, nuk e bën “poseduesin” pronar të ligjshëm. Kështu, poseduesi mund të gëzojë të mirën e të banuarit në pronë, ndërsa pronari e gëzon të drejtën e titullit ligjor mbi pronën dhe përfitimet nga prona me transferimin e lirë të asaj që e ka në pronësi (Bendix dhe Stanley, 2008). Ky dallim i qartë ndërmjet posedimit dhe pronësisë mund të vërehet në kategoritë e të Drejtës Romake, të cilat janë zbatuar më vonë në të Drejtën Kontinentale. Ngjashëm, kështu është rasti edhe me modelin Anglosakson, i cili njihet “marrëdhënien ligjore ndërmjet një personi dhe një objekti” (Britanica, 2014).

Hulumtimi i pronësisë përmes prejardhjes së saj në fjalorin juridik ofron njohuri të rëndësishme themelore që do të ndihmojnë hulumtimin e pronësisë lokale dhe fokusin primar të këtij libri. Kjo më së miri theksohet në vet përkufizimin e “pronësisë” në gjuhën angleze, i cili kryesisht tregon dimensionin juridik. Për më tepër, dhe ngjashëm, kështu ndodh edhe kur ky përkufizim përkthehet gërmë për gërmë në shumicën e gjuhëve lokale.² Të kuptuarit e dimensionit juridik të pronësisë lokale nuk është qëllimi kryesor i këtij libri, megjithatë, dhe siç do të argumentohet në vazhdim, pronësia lokale tregon disa tipare juridike dhe normative.

Për dallim nga nocioni i përkufizuar mirë i pronësisë në fjalorët juridikë, pronësia lokale nuk është e përkufizuar në mënyrë të kuptueshme në fjalor. Ajo është e përbërë nga dy fjalë, dhe të dyja së bashku krijojnë një kuptim të caktuar. Sipas fjalorit në internet, pronësia lokale “është mënyrë përfshirjes së bashkësisë (komunitetit) në të cilën banorët lokalë mund të kenë në pronësi aksione dhe të kenë përfitime nga zhvillimet lokale” (Fjalori, 2014). Ky është një përkufizim i pamjaftueshëm që i ofron lexuesit vetëm idenë bazike të pronësisë lokale.

Qëllimi primar i këtij libri është që të ekzaminojë *pronësinë lokale* si parim që zbatohet në marrëdhëniet ndërkombëtare, në siguri dhe në studimet e zhvillimit. Edhe pse koncepti duket të jetë i pranishëm në dokumentet e politikave, ai ka rrjedhur nga diskursi me shkrim

2 Për shembull, kur përkthehet shprehja angleze “local ownership” në gjuhën shqipe i bie “pronësia lokale.” Ky term ofron një interpretim juridik.

dhe me gojë i cili ishte i drejtuar kah vendet në zhvillim që gëzonin mbështetjen e donatorëve ndërkombëtar, kryesisht në mjedise të pas konfliktit dhe pas-autoritare. Ajo po ashtu vë në shënjestër vendet që kanë qenë subjekt i vendosjes së administratave ndërkombëtare civile dhe ushtarake në bazë të Kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara (OKB, 1948). Kuptimi i drejtpërdrejtë i pronësisë lokale (në këto kontekste) sugjeron se reforma e politikave dhe institucioneve të sigurisë duhet të hartohet, menaxhohet dhe zbatohet nga aktorë lokalë e jo nga aktorë të jashtëm (Nathan, 2008). Madje, synimi primar i pronësisë lokale ka qenë që të përcaktohet roli i bashkësisë ndërkombëtare në gjithë këto mjedise, veçanërisht gjatë komunikimit dhe bashkëpunimit me homologët lokalë. Thënë ndryshe, dilema kritike (mbi pronësinë lokale) përbëhet nga marrëdhënia ndërmjet bashkësisë ndërkombëtare (qoftë ajo prani ndërkombëtare civile dhe/ose ushtarake, komunitet i donatorëve ose tjetër) dhe aktorëve lokalë (kuptohet si pranues). Kjo marrëdhënie pasqyron thelbin e konceptit të pronësisë lokale, i cili mund të përfshihet në kontekst të njëjës ndërkombëtarë-vendorë. Si rezultat, libri do të analizojë këtë bashkëpunim në bazë të këtij kuptimi.

Për të zbërthyer më tej konceptin bashkëkohor të pronësisë lokale, është me rëndësi thelbësore që të identifikohen agjentët primarë. Në fakt, janë dy agjentë kryesorë të pronësisë lokale: nyja ndërkombëtarë-vendorë dhe mjediset e pas-konfliktit/ pas pavarësisë. Së pari, pronësia lokale trajton marrëdhënien ndërmjet aktorëve ndërkombëtarë dhe aktorëve lokalë në një mjedis të post-konfliktit ose post-pavarësisë. Aktorët ndërkombëtarë përfshijnë një gamë të gjerë të palëve të interesit, të cilët veprojnë në emër të “ndërkombëtarëve” siç janë misionet ndërkombëtare, agjencitë donatore, aktorët ndërkombëtarë qeveritarë dhe joqeveritarë, dhe aktorët e jashtëm shtetërorë dhe jo-shtetërorë. Ky grup i gjerë i aktorëve ndërkombëtarë mund të përfshihet në kuadër të nocionit të një *bashkësie ndërkombëtare*. Në anën tjetër, aktorët lokalë nënkuptojnë të gjithë aktorët që përbëhen nga përfaqësuesit e vendit të synuar, siç janë institucionet shtetërore, OJQ-të dhe qytetarët. Kështu, këtij përkufizimi gjithëpërfshirës të aktorëve lokalë mund t'i referohemi si *lokalët (vendorët)*. Së dyti, pronësia lokale e ka një synim specifik, dhe ajo është analizuar mjaft në vendet e post-konfliktit ose të post-pavarësisë. Ka një varg vendesh ku mund

të analizohet pronësia lokale si marrëdhënie ndërmjet bashkësisë ndërkombëtare dhe vendorëve, siç janë Afganistani, Etiopia, Guatemala, Liberia, Sierra Leone, Timori Lindor, Bosnja e Hercegovina (B e H), Kosova, Palestina, Afrika e Jugut, Nepali, Libia. Pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, këto vende kanë kaluar nëpër njëfarë tranzicioni dhe janë përballur me probleme të njohjes ndërkombëtare ose të konfliktit të brendshëm. Edhe pse formati i pranisë dhe intervenimit ndërkombëtar në këto raste janë të ndryshme; në praktikë, siç do të sqarohet më vonë, qasja ndaj këtyre vendeve nuk dallon aq shumë.

Sidoqoftë, “nga perspektiva përkufizuese dhe operacionale, pronësia lokale mbetet edhe elastike edhe e pakapshme” (Richmond, 2012, f. 354). Megjithatë, ka raste të rralla kur ky koncept është shqyrtuar në qarqet akademike. Si rezultat, kontributi i dhënë deri më sot nga studiuesit ka qenë jopërfundimtar. Përpjekjet e deritanishme akademike nuk kanë qenë në gjendje të japin një kuptim të qartë se çka është pronësia lokale. Oliver Richmond, për shembull, përpiqet të thjeshtësojë përkufizimin si “...marrëdhëniet ndërmjet aktorëve të jashtëm dhe të brendshëm mbi institucionin politik, ligjor, social, zhvillimor dhe të sigurisë i cili importohet ose ndërtohet dhe bazohet në aspektin lokal” (Richmond, 2012, f. 359). Në anën tjetër, dhe ngjashëm me Richmondin, Timothy Donais e përkufizon pronësinë lokale si “...procesin deri ku aktorët lokalë ushtrojnë kontrollin ose ndikimin mbi fillimin, dizajnin dhe zbatimin e procesit të reformës” (Donais, 2009, f. 118). “Shkalla” në të cilën janë të përfshirë aktorët ndërkombëtarë përbën arsyetimin për ekzaminimin e pronësisë lokale. Kjo ndodh për arsye se pronësia lokale nuk është objekt statik; nuk mund të matet përfshirja e bashkësisë ndërkombëtare në terma të “po” dhe “jo”. E as që mund të matet marrëdhënia ndërmjet bashkësisë ndërkombëtare dhe vendorëve sipas kategorive statike. Kështu, pronësia lokale duhet të analizohet në bazë të performancës së bashkësisë ndërkombëtare në vendet e post-konfliktit dhe post-pavarësisë dhe përmes marrëdhënieve të saj me bashkësinë lokale.

Duke pasur parasysh përkufizimin jo të plotë akademik të pronësisë lokale, pyetja kryesore që ngrihet në këtë libër është: çka në të vërtetë nënkuptojmë me pronësi lokale? Derisa pyetja është shtruar në mënyrë të thjeshtë, nuk pritët se do të jepet një përgjigje të thjeshtë.

Kështu, ajo kërkon një ekzaminim më sistematik në kontekstin e vendeve të post-konfliktit dhe/ose post-pavarësisë. Një përkufizim më i gjerë do të nxirret nga pjesët në vazhdim; megjithatë, korniza imediate e pronësisë lokale përfshin një përkufizim në të cilin aktorët lokalë (në kuptimin e gjerë) e kanë autoritetin përfundimtar për të vendosur në mënyrë të pavarur për proceset e shtetndërtimit në një territor ose rajon të caktuar. Kjo është një e drejtë e cila paraqet argumentet ligjore, politike dhe morale. Në aspektin ligjor, është e drejtë e qytetarëve në një territor apo shtet të vendosin për formën e tyre të qeverisjes, e cila njihet edhe si e drejtë për vetëvendosje. Për më tepër, ajo paraqet argumentet politike me të cilat e arsyeton nevojën për tu dëgjuar “zëri” i vendorëve në proceset e drejtuara nga jashtë, dhe po ashtu përfshin normat kyçe që favorizojnë të drejtën e njerëzve e cila rrjedh nga legjitimiteti. Përkufizimi i pronësisë lokale zbërthehet më tej në pjesët në vazhdim.

PRONËSIA LOKALE NË DISKURSION E POLITIKAVE

Tani më është e qartë se pronësia lokale përfundimisht buron nga diskursi me shkrim dhe me gojë i bashkësisë ndërkombëtare. Ajo është pjesë e korpusit të përgjithshëm të fjalorit të përdorur nga organizatat ndërkombëtare në mjediset pas-konfliktit ose pas pavarësisë. Pronësia lokale ka qenë e pranishme krahas shumë fjalëve kyçe (në modë) përfshirë fjalët “stabilitet”, “demokraci”, “ndërtim i paqes”, “bërje e paqes”, “pajtim”. Edhe fjalët sinonime të pronësisë lokale janë bërë pjesë se diskursit të organizatave ndërkombëtare: për shembull, Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB) është e prirë të përdor termin “pronësi kombëtare”, përderisa Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) e përdor termin “pronësi e vendit”. Përkundër një grumbull të larmishëm të fjalëve kyçe, asnjë prej tyre nuk e ka sqaruar sa duhet përmasën e “lokale” dhe “pronësi”.

Pronësia lokale filloi të përmendet më shpesh kah fundi i viteve 1990ta. Ajo u zhvillua për tu bërë pjesë të pandashme e dokumenteve të politikave në fillim të shekullit XXI dhe që nga atëherë e ka ruajtur këtë pozitë. Është me rëndësi të identifikohet dhe vlerësohet shkalla në të cilën është dhënë prioritet pronësisë lokale nga organizatat ndërkombëtare për një numër arsyes: Së pari, organizatat

ndërkombëtare janë aktorët primarë në lidhjen ndërkombëtarë-vendorë; së dyti, duhet të analizohet se si organizatat ndërkombëtare e paraqesin pronësinë lokale brenda kornizës së politikave për të pasur një pasqyrë të saktë dhe; së treti, vënia në hartë do t'i ndihmojë këtij libri të identifikojë se cilat organizata e kanë përqafuar konceptin e pronësisë lokale për të vlerësuar në mënyrë kritike zbatimin e tij në terren, veçanërisht në rastin e Kosovës.

Është vështirë të identifikohet se cila organizatë ndërkombëtare e ka përdorur së pari nocionin “pronësi lokale”. Mund të ketë dokumente të hershme që e theksojnë nevojën për një përfshirje më të madhe lokale dhe të drejtën e “përfituesve”. Edhe pse një prej dokumenteve të para ku përmendet pronësia lokale është një dokument i hartuar dhe publikuar nga Banka Botërore (BB) në vitin 1995 i titulluar “Forcimi i efektivitetit të ndihmës: Mësimet për donatorët”, i cili vlerësonte performancën e përgjithshme të ndihmës ndërkombëtare për zhvillim në periudhën menjëherë pas Luftës së Ftohtë. Dokumenti e bënte të qartë nevojën për të promovuar pronësinë lokale në kuadër të ndihmës ndërkombëtare (BB, 1995). BB në mënyrë të hapur i ftoi qeveritë donatore dhe komunitetin e gjerë donatorë që të respektojnë përfaqësuesit lokalë dhe të adresojnë kufizimet (e vendorëve) (Richmond, 2012, f. 366). Një institucion tjetër financiar - Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) - po ashtu e mori parasysh parimin e pronësisë lokale. Megjithatë, krahasuar me BB-në, pronësia lokale në FMN sigurohet vetëm pasi vendi pranues të respektojë kushtet e FMN-së - të njohura edhe si “kushtëzime”. Kështu, FMN-ja e njeh pronësinë lokale (përfshirjen e popullsisë lokale) vetëm nëse pranohet gjerësisht kushtëzimi i saj (Khan dhe Sharma, 2001). Sidoqoftë, asnjë prej dokumenteve fillestare të FMN-së nuk e kishin synim parësor që të respektojnë pronësinë lokale.

Përfundimisht, koncepti është inkorporuar gradualisht në kornizat e politikave të agjencive individuale donatore qeveritare. Mbretëria e Bashkuar, për shembull, e ka përqafuar pronësinë lokale në vitin 1997, duke e deklaruar zotimin e saj për pronësi lokale në një dokument të Departamentit të Mbretërisë së Bashkuar për Ndihmë Ndërkombëtare (DFID) për uljen e varfërisë dhe ndihmën për zhvillim (DFID, 1997). DFID u bën thirrje përpjekjeve diplomatike dhe programeve për zhvillim që të sigurojnë një reagim ndërkombëtar “në bazë të pronësisë

kombëtare” (DFID, 1997, f. 53). Ky hap po ashtu është pasuar nga agjencitë e tjera qeveritare me ndikim dhe me prani të fuqishme në të gjitha ato mjedise.

Në fakt, ishte diku fundi i viteve 90ta dhe fillimi i viteve 2000 kur pronësia lokale u bë pjesë e qëllimeve dhe objektivave të organizatave ndërkombëtare. Në mënyrë të veçantë ky ishte rasti me OECD - një organizatë qëllimi i të cilës është që të promovojë politikat që përmirësojnë mirëqenien ekonomike dhe sociale të njerëzve gjithandej botës (OECD, 2014). OECD, mes një vargu të gjerë çështjesh, po ashtu i këshillon qeveritë donatore se si të shpërndajnë më mirë ndihmën për zhvillim në mjediset post-konfliktit. Për këtë qëllim, në vitin 1996 u bë deklarata e parë e cila e adresonte çështjen e pronësisë lokale në komunitetin zhvillimor. Më vonë, në vitin 2005 “Deklarata e Parisit për Efektivitetin e Ndhimës” haptazi u bëri thirrje vendeve që të forcojnë kapacitetin e tyre për të ushtruar mandatin duke e respektuar pronësinë lokale (OECD, 2006). Pronësia lokale u bë elementi kryesor i Raportit të Komitetit të OECD-së për Ndhimë në Zhvillim (DAC) për Reformën e Sektorit të Sigurisë dhe Qeverisjen. Raporti nuk është dokument detyrues, por u rekomandon fuqishëm aktorëve që të ndryshojnë qasjen e tyre dhe në radhë të parë të marrin parasysh kontekstin dhe ekspertizën lokale në proceset e RSS-së. Raporti DAC i OECD-së vlerëson në mënyrë kritike rolin e agjencive ndërkombëtare në vendet post-konfliktit dhe nënvizon përparësinë krahasuese të vendeve ku ka pasur përfshirje lokale në proceset e tyre të RSS-së (OECD, 2007)

Derisa organizatat ekonomike ndërkombëtare (siç janë FMN, BB dhe OECD) synonin të adresonin pronësinë lokale në kuadër të komunitetit të donatorëve, po ashtu ishte me rëndësi (nëse jo edhe më e rëndësishme) që koncepti i pronësisë lokale të përqafohej edhe nga organizatat e tjera ndërkombëtare që operonin në mjediset e post-konfliktit ose post-pavarësisë. Sigurisht se ka shume organizata të ndryshme ndërkombëtare me mandat për të qeverisur dhe për të ofruar mbështetje. Një interpretim i gjerë i Kartës së OKB-së përkufizon këto organizata si organizata të sigurisë së përbashkët siç janë OKB, BE, Unioni Afrikan, ose organizata të vetëmbrojtjes së përbashkët siç është NATO (Simma, 1999).

OKB ka filluar të përdor pronësinë lokale si pjesë të zhvillimit të paradigmes së saj të “Përgjegjësisë që të mbrojë”, e cila është lansuar në një raport special në vitin 2001. OKB në përgjithësi i referohet kësaj paradigme si përgjegjësia e botës për të siguruar që të drejtat e njeriut të mos shkelen në mënyrë sistematike nga aktorë shtetërorë dhe joshtetërorë. Për këtë qëllim, raporti ofron opsione për rolin e bashkësisë ndërkombëtare në mjediset pas konfliktit, të cilat respektojnë plotësisht të drejtat e popullatës lokale (OKB, 2001). Objektivat e “Përgjegjësisë që të mbrojë” u mishëruan më tej në dy dokumentet të tjera të rëndësishme të OKB-së, siç janë Paneli i Nivelit të Lartë të OKB-së dhe Agjenda e Paqes e OKB-së. Pronësia lokale gradualisht u bë pjesë e diskursit të përgjithshëm të zyrtarëve më të lartë të OKB-së. Ish-Sekretari i përgjithshëm i OKB-së Kofi Anan, për shembull, vazhdimisht i është referuar nevojës për pronësi lokale dhe për “qeverisje pjesëmarrëse”. Ngjashëm, Lackdar Brahimi, zyrtar i lartë i OKB-së, ka theksuar nevojën që organizatat ndërkombëtare të respektojnë pronësinë lokale në shkallën më të lartë të mundshme. Brahimi sugjeron se pronësia lokale nuk synon të ndryshojë konstelacionin nga shqetësimet e huaja në mbizotërimin e shqetësimeve lokale, por thërret fuqishëm (bashkësinë ndërkombëtare) për të shmangur arrogancën, për të treguar përulesë dhe respekt të mirëfilltë për popullsinë lokale (Brahimi, 2007).

Sidoqoftë, përkufizimi i OKB-së dhe respekti për pronësinë lokale është subjekt i kritikës. Richmond beson se OKB-ja e lidh pronësinë lokale me pronësinë kombëtare në mënyrë mjaft dykuptimëshe dhe e shpreh problemin e veçantë lidhur me përkufizimin e “pronësisë kombëtare”. Ai thekson se “përkufizimi i OKB-së (i pronësisë lokale) përpiket të kapërcejë të kuptuarit elitar dhe kombëtar të pronësisë, dhe kufizohet nga kultura e saj burokratike e angazhimit me po ato elita përmes vënies së shtetit në qendër: dhe sepse pjesëtarët më të marginalizuar të shoqërisë, në bazë të identitetit, racës ose klasës, nuk janë fokus i pronësisë lokale” (Richmond, 2012, f. 366). Përkufizimi e vendos OKB-në në mesin e atyre organizatave ndërkombëtare që në aspektin ndërkombëtar e anashkalojnë kuptimin gjithëpërfshirës të pronësisë lokale në territoret e administruara ose që ndikohen nga OKB-ja.

Në anën tjetër, Bashkimi Evropian (BE) e ka një varg dokumentesh të politikave që rregullojnë rolin e saj si një “fuqi globale në rritje”. Për këtë qëllim, Strategjia e Sigurisë e BE-së, derisa paraqet zotimin për BE-në që të ushtrojë pushtetin e saj me një zë të vetëm, nuk i referohet marrëdhënieve karshi “pranuesve” ose aktorëve lokalë në terren. Dokumenti paraqet një objektiv të qartë sipas të cilit “BE do të mendoj globalisht e veprojë lokalisht” (BE, 2003, f. 6) duke mos e zbrërthyer se si ajo “vepron lokalisht”. Përveç kësaj, Parlamenti Evropian e ka miratuar një rezolutë për perspektivën e zhvillimit të BE-së. Këtu, rezoluta në mënyrë të qartë i referohet pronësisë lokale si “me rëndësi thelbësore për stabilitetin afatgjatë” (BE, 2008a). BE e sheh integrimin si standardizim lokal me norma të jashtme, si harmonizim dhe transformim lokal sipas një loje rajonale e cila është themeluar që një kohë të gjatë (Richmond, 2012). Kjo qasje nënkupton adoptimin e vlerave që vijnë nga hemisfera perëndimore. Problemi qëndron në atë se a i merr parasysh BE-ja vlerat lokale, përfshirë edhe ato që jo domosdoshmërisht u janë përshtatur vlerave perëndimore, në performancën e vet në terren. Kjo qasje mund të vlerësohet përmes një numri instrumentesh të aplikuara nga BE, siç janë misionet, marrëdhëniet dypalëshe me vende të caktuara dhe ndihma për zhvillim.

Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior (NATO) duket se nuk e përfshin pronësinë lokale në dokumentet strategjike të saj. Koncepti i saj i ri strategjik e njeh rolin e autoriteteve lokale në luftimin e terrorizmit dhe në ballafaqimin me sfidat e tjera të sigurisë. Sidoqoftë, dokumenti nuk i referohet bashkëpunimit me aktorët lokalë (NATO, 2010a). Dokumenti i NATO-s i vitit 2020 ka ofruar një kornizë gjithëpërfshirëse të vizionit të ri strategjik të organizatës në vendet dhe territoret ku ajo është e pranishme. Ndonëse ka një referencë për vendorët, dokumenti nuk e njeh konceptin e pronësisë lokale, ndërsa i referohet vetëm autoriteteve lokale, që kuptohen si qeveri (NATO, 2010). Si rezultat, ajo nuk e njeh konceptin e vendorëve në kuptimin e gjerë. Krahasuar me BE-në, roli i NATO-s mund të vlerësohet në bazë të misioneve të saj në terren (nëse ka ndonjë) dhe përmes marrëdhënieve politike me këto vende. Në të vërtetë, NATO-ja nuk e ofron komponentin e ndihmës në zhvillim me përjashtim të asistencës që u jep vendeve në reformën dhe përmirësimin e forcave të armatosura.

Në përgjithësi, referenca ekzistuese në pronësinë lokale nga organizatat ndërkombëtare duhet të shihet me skepticizëm. Një sugjerim më i elaboruar është dhënë se referenca në vendorët dhe në pjesëmarrjen e tyre përdoret nga donatorët dhe organizatat ndërkombëtare kryesisht për të siguruar rrjedhat e financimit dhe marrëdhënien të mira me qeveritë donatore (Richmond, 2012). Këtu, duket se referenca e shpeshtë në “vendorët” ka pasur për qëllim paraqitjen e një pseudo-realitetit në qarqet ndërkombëtare, pa u kërkuar ndonjë elaborim i mëtejshëm. Çka është më me rëndësi, ka një mospërputhje ndërmjet referencës me shkrim ndaj pronësisë lokale dhe zbatimit të saj praktik në mjediset pas konfliktit.

KUSH JANË VENDORËT?

Për të zbërthyer më tej pronësinë lokale, duhet të nxirren tiparet kryesore të asaj se çka e përbën “vendoren” (lokalen). Nga këndvështrimi i përgjithshëm, vendorët duhet të jenë përfaqësues të vendeve pas konfliktit ose pas pavarësisë dhe përfitues të mbështetjes së bashkësisë ndërkombëtare në procesin e shtetndërtimit. Sa i përket qeverisjes lokale, termi mund të jetë çorientues - ai po ashtu nënkupton përfaqësuesit e një bashkësie në një rajon ose komunë të caktuar. Nga perspektiva e përgjithshme, termi do të bënte një ndarje parimore ndërmjet “neve - ndërkombëtarëve” dhe “atyre - vendorëve”. Si pasojë, në mënyrë që të shmanget keqkuptimi dhe ndarja e ndërkombëtarëve nga vendorët, disa autorë kanë shkruar më tej duke thënë se nuk ka asgjë lokale në një botë të globalizuar dhe rrjetëzuar (MacGinty dhe Richmond, 2013). Megjithatë, unë e pranoj termin ‘lokal’ apo “vendor” ashtu si është paraqitur, dhe si është eksploruar në mënyrë që të studiohen marrëdhënien ndërmjet bashkësisë ndërkombëtare dhe vendorëve duke u përmbajtur nga çfarëdo paragjykimi që mund të vjen rezultat i (keq)interpretimit të tij të ngushtë.

Robert MacGinty dhe Oliver Richmond kanë hulumtuar në thellësi nocionin ‘lokal’ në kontekstin e lidhjes ndërkombëtarë-vendorë. Sipas tyre, me “vendor kuptohet një varg i agentëve me bazë lokale të pranishëm në një mjedis të konfliktit ose post-konfliktit, disa prej të cilëve kanë për qëllim të identifikojnë dhe krijojnë proceset e nevojshme për paqe, ndoshta me ose pa ndihmën e bashkësisë ndërkombëtare, dhe të

strukturuar në aso mënyre në të cilën përputhet legjitimiteti në terma lokalë dhe ndërkombëtarë” (MacGinty dhe Richmond, 2013, f. 769). Ata e elaboruan këtë më tej duke theksuar se “duke pasur parasysh kompleksitetin dhe përfshirjen e shumëllojshme të agjentëve në kontekste të caktuara termi lokal ka kuptim elastik” (MacGinty dhe Richmond, 2013, f. 770). Termi “përfshirje e shumëllojshme e agjentëve” pasqyron të kuptuarit gjithëpërfshirës të termit lokal, i cili duhet të ekzaminohet. Në të vërtetë, përfshirja e të gjithë aktorëve nga radhët e ndryshme të bashkësive përbën përfaqësimin legjitim. Secili rast përbën kontekstin e vet; megjithatë, në shumicën e vendeve, termi lokale nënkupton një numër aktorësh. Për shembull, *aktorët shtetëror* - që nënkupton elitat nga të gjitha dimensionet e sektorit publik siç është Qeveria, Kuvendi, Komunat, Presidenca, Agjencitë Shtetërore dhe Partitë Politike; *shoqëria civile* - që nënkupton OJQ-të, udhëheqësit e fshatrave, udhëheqësit fisnor, media, universitetet dhe qytetarët. Po ashtu, diaspora (nëse është e madhe) paraqet një dimension të rëndësishëm të përbërësve më të gjerë të vendorëve (Mobekk, 2010).

Fushëveprimi i termit lokal mund të zgjerohet më tutje varësisht nga vendi apo rajoni; megjithatë, identifikimi këtu pasqyron madhësinë tipike të “lokalëve” në shumicën e mjedisëve. Megjithatë, ky fushëveprim i llojllojshëm nuk mund të krahasohet me situatat e tjera të post-konfliktit të pas Luftës së Dytë Botërore. Shoqëria civile perëndimore shihet si kontrast nga rajonet e tjera siç është Lindja. Vendet perëndimore e përkufizojnë shoqërinë civile kryesisht në bazë të OJQ-ve, shoqatave dhe qytetarëve, derisa, për shembull, në Afganistan komponent kyç të shoqërisë civile janë udhëheqësit fisnor ose të fshatrave. Kjo ka çuar në krijimin e një nocioni artificial të shoqërisë civile i cili nuk ka promovuar vëllimin e madh të bashkësive në mjediset e post-konfliktit ose post-pavarësisë (Richmond, 2009b). Richmond argumenton se tendenca për të realizuar projekte kulturore e me këtë - “të promovojë krijimin e OJQ-ve si kërpuhat” - me siguri do të përkufizohet në “romantizimin e lokales” (Richmond, 2009, f. 152). Romantizimi këtu paraqet një projekt të fundit të “intervenuesve” ndërkombëtarë që duan të transformojnë sjelljet e individëve në shoqëritë e synuara deri në atë shkallë që të jenë krejtësisht në përputhje me sugjerimet dhe udhëzimet e bashkësisë ndërkombëtare. Në mënyrë të ngjashme, Fukuyama beson se shoqëria civile

(në një proces të shtetndërtimit) e lindur nga jashtë “mund të degjenerojë në grupe përfituese të interesit qëllimi i të cilave nuk është llogaridhënia më e madhe por rritja e fushëveprimit të subvencioneve të qeverisë” (Fukuyama, 2004, f. 41). Si pasojë, tendencat për të shikuar shoqërinë civile vetëm përmes perspektivës së OJQ-ve mund të jetë çorientuese dhe pasqyrojnë konsideratë të dobët për kontekstin.

Prandaj, problemi mbetet mbi atë se kush i përbën vendorët në secilën prej mjediseve të post-konfliktit. Përveç domosdos së distancimit të përkufizimit të shoqërisë civile vetëm në kondita të OJQ-ve, po ashtu është e domosdoshme për ta larguar perceptimin dominues të elitave ndërkombëtare për vendorët. Ky është problemi i dytë që mund të përshkruhet në kontekstin e njëjës ndërkombëtarë-vendorë. Vërtet, pronësia e shtyrë vetëm nga elitat në fund të fundit nuk mund të përfaqësojë pronësinë lokale për një varg arsyesh. Së pari, ajo nuk mund të legjitimohet mjaftueshëm në vendet ku demokracia është në fazat e hershme ose ku përballlet me probleme. Për shembull, tendenca për të parë zgjedhjet në mënyrë të njëjtë në këto vende kur krahasohen me vendet në zhvillim është problematike, për shkak të nevojës për një periudhë të konsiderueshme të praktikës demokratike në mënyrë që të krijohet tradita e zgjedhjeve. Së dyti, ajo nuk përfaqëson në mënyrë gjithëpërfshirëse qëndrimet e të gjitha bashkësive dhe përfaqësuesve. Ky argument është i pranishëm në rastet që kanë sisteme të dobëta zgjedhore, ku demokracia pjesëmarrëse mund të forcojë legjitimitetin sa i përket zhvillimit të një projekti demokratik për të mirën e shoqërisë. Së treti, ajo nuk mund të përfaqësojë në mënyrë të drejtpërdrejtë interesat e bashkësive të marginalizuara dhe të pakicave.

Duke i përcjell shembujt e bashkësisë ndërkombëtare, ku komunikimi i saj me vendorët është më i madh në nivelin më të lartë, kapja e elitës ishte një nocion që paraqiste sjelljen e aktorëve ndërkombëtarë në përpjekje për të ndërvepruar vetëm me nivelet më të larta të qeverisë (Hansen, 2008). Komuniteti i donatorëve ndërkombëtarë shpesh i ka preferuar elitat lokale që kanë disa kredenciale specifike perëndimore, siç janë zotërimi i mirë i gjuhës angleze, dhe përdorimi i shprehjeve të zakonshme të donatorëve si “tregjet”, “reforma” dhe “shoqëria civile” (Caparini, 2010; Narten, 2009). Në këtë mënyrë, bashkësia ndërkombëtare është e prirë “të punojë me aktorët që tashmë janë mësuar të

punojnë me të huajt, të cilët më së shpeshti i përkasin elitës së shkolluar mirë” (Hellmüller, 2012, p. 239). Zakonisht, grupet e elitës kombëtare dhe zyrtarët qeveritarë luajnë rol të rëndësishëm në “importimin dhe zbatimin e strategjive të jashtme zhvillimore”, veçanërisht në rastet kur ato u shërbejnë interesave të vet atyre (Everett, 1997, f. 139).

Në anën tjetër, kur synojnë të arrijnë pëlqim të rëndësishëm politik, donatorët ndërkombëtarë janë të prirë të jenë selektiv me kapjen e elitës së tyre. Në disa kontekste të pas luftës, për shembull, ka pasur një tendencë që të flitet vetëm me elitën që përfaqësonte krahun e luftës, sepse ata supozohej se e kishin pushtetin e tyre detyrues, e kështu janë faktorë potencial që mund të dëmtojnë sigurinë dhe stabilitetin. Për hir të qëllimeve përfundimtare dhe siç është paraqitur në mandatet e tyre fillestare, bashkësia ndërkombëtare është pajtuar me pjesë të përzgjedhura të elitave duke “plotësuar kërkesat burokratike” (ticking the box) në arritjen e qëllimeve të caktuara.

Disa autorë argumentojnë me ngulm në favor të bashkëpunimit të drejtuar nga elitat, duke pasur në mendje praktikat në Perëndim ku procesi i shtetndërtimit udhëhiqet nga elitat. Megjithatë, procesi i shtetndërtimit në Perëndim më shumë e pasqyron shtetndërtimin westfalian, i cili dallon shumë nga shtetndërtimi bashkëkohor. Bota e globalizuar kërkon një përfshirje më të gjerë të aktorëve në të gjitha proceset. Për më tepër, procesi i shtetndërtimit do të përdoret në masë të madhe për të siguruar një proces më legjitim, i cili përfshin një numër më të madh përfaqësuesish të bashkësive. Përveç kësaj, dinamika e procesit të menjëhershëm të shtetndërtimit është shumë e rëndësishme, sepse parimet kryesore të legjitimitetit duhet të rrënohen që në fillim.

Donais është përpjekur të zbërthejë modelet e bashkësisë ndërkombëtare në ato që janë të prira të shikojnë vendorët vetëm përmes perspektivës së elitave- të përfshirë në “qasjen minimaliste” - dhe ato që merrnin parasysh një përbërje më të gjerë me përfshirje të gjerë të shoqërisë civile - e njohur si “qasje maksimaliste” (Donais, 2008b, f. 8) Problemi qëndron në atë se ka më shumë agjentë të bashkësisë ndërkombëtare që janë të gatshëm të aplikojnë qasjen minimaliste thjeshtë sepse është më e lehtë. Edhe ajo “i plotëson kushtet burokra-

tike” (ticks the box) të përfshirjes së vendorëve si pjesë e diskursit të shpesh të mbi pronësinë lokale. Ka pasur raste kur përfaqësuesit e bashkësisë ndërkombëtare kanë pranuar injorimin e qëllimshëm të përfaqësuesve të gjerë lokalë meqë ajo kërkon më shumë përpjekje dhe kohë (Wilén & Chapaux, 2011).

Megjithatë, janë vetëm pak që e marrin parasysh qasjen maksimaliste, ndonëse në mënyrë selektive. Çka është më brengosëse, në punën e përditshme, bashkësia ndërkombëtare është e prirë të “subjektivizojë” popullatën lokale në kategori statike si viktima, luftëtarë, përfitues - emërtime që paraqesin një pamje njëdimensionale (MacGinty, 2011). Ka një tendencë që të përfshihen përfaqësuesit e shoqërisë civile nga OJQ-të e krijuara nga ndërkombëtarët. Shoqëria civile e nivelit bazë dhe grupet e presionit nga zonat rurale rrallë ftohen. Bashkësia ndërkombëtare e mban fuqinë e financimit, e cila i mban gjallë aktivitetet e OJQ-ve dhe kështu i përmbush nevojat e të jashtëmëve në mënyrë më adekuate (Mobekk, 2010; Reich, 2006). Bashkësia ndërkombëtare duhet të përfshijë të gjithë përfaqësuesit e vërtetë të shoqërisë civile, që flasin në emër të ndonjë bashkësie të caktuar dhe të qytetarëve të tyre. As pronësia e elitës e as e qytetarëve nuk do të mbizotërojnë ndarazi pa i bërë bashkë të dy qasjet, nga lart-poshtë dhe nga poshtë-lartë. Siç ka theksuar Roland Paris “shtetndërtimi nuk kufizohet në qasjen ‘nga lart-poshtë’ e as vetëm ‘nga poshtë-lartë’ (Paris dhe Sisk, 2007, f. 15).

LIGJSHMËRIA, LEGJITIMITETI DHE PRONËSIA LOKALE

Kur përkthehet në gjuhët lokale, pronësia nuk duket se ka vetëm kuptim juridik. Ajo po ashtu nënkupton dimensionin normativ në nyjen ndërkombëtarë-vendorë i cili është thelbësor për konceptin e pronësisë lokale. Janë dy fusha të vrojtimit akademik që kontribuojnë më tej në zbërthimin konceptual të pronësisë lokale: Bazën juridike të aplikuar përmes konceptit të vetëqeverisjes dhe bazën normative që aplikohet kryesisht përmes normës ndërkombëtare të legjitimitetit. Edhe pse ka dallim ndërmjet ligjshmërisë dhe legjitimitetit, të dyja janë elemente të njëjta thelbësore që duhet të ekzaminohen pasi që përplotësojnë njëra-tjetrën.

VETËVENDOSJA

Korrelacioni juridik i pronësisë lokale me të drejtën ndërkombëtare është prekur vetëm shkurtimisht nga autorët, duke lënë një boshllëk tjetër në korpusin pak të studiuar të pronësisë lokale. Megjithatë, nuk është pritur që shkencëtarët politik dhe zhvillimor të japin kontribut në dimensionin juridik, duke e pasur parasysh se kjo kërkon një interpretim juridik të parimeve dhe normave. Studiuesit kompetent - juristët ndërkombëtarë - duket se nuk e kanë hulumtuar interpretimin e pronësisë lokale. Është e kuptueshme, edhe pse mungesa e interpretimit ligjor të pronësisë lokale nuk e ulë domosdo rëndësinë e pronësisë lokale, ai do të forconte edhe më shumë kornizën ekzistuese, duke avokuar për një marrëdhënie më të barabartë në lidhjen ndërkombëtarë-vendorë.

Parimi primar ligjor që i mbështet themelet e pronësisë lokale është parimi i *vetëvendosjes*. Ky parim i referohet të drejtës së njerëzve që të vendosin vet për fatin politik dhe ekonomik pa imponim ose ndërhyrje nga jashtë. Ideja kryesore e saj është politike: ajo i referohet të drejtës së njerëzve në vetëvendosje në mjedise komplekse. Themelet e vetëqeverisjes janë të mishëruara në Kartën e OKB-së. Neni 1.2 i Kartës së OKB-së është i qartë kur thekson se "...marrëdhëniet miqësore mes kombeve bazohen në respektimin e parimit të të drejtave të barabarta dhe të vetëvendosjes së popujve..." (OKB, neni 1.2).³ Parimi i vetëvendosje përforcohet në nenin 55 të Kartës së OKB-së. Fillimisht, vetëvendosja është aplikuar për një parim ligjor thelbësor në zgjidhjen e kontesteve rreth territoreve koloniale. Ai u bënte thirrje vendeve kolonialiste që të respektojnë të drejtën e njerëzve (në këto territore) që të vendosin vet lirisht për fatin e tyre. Kjo çoi në miratimin e Rezolutave të Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1514 dhe 1654, të cilat bënë thirrje për tu dhënë pavarësinë vendeve dhe popujve të kolonizuar; duke stimuluar de-kolonizimin (OKB, 1960, 1961). Vetëvendosja kohëve të fundit u mishërua në Konventën Ndërkombëtare për

3 Pa hyrë në detaje të mëtejshme të bazave të saj, vetëvendosja ishte e pranishme në diskursin politik në fillim të shekullit XX, ku u argumentua e drejta e kombeve për shkaputje nga mbretëritë e atëhershme. Vetëvendosja për herë të parë në mënyrë eksplicite u përmend në Katërmbëdhjetë Pikat e famshme të Presidentit të SH-BA-së, Woodrow Wilson (1918) i cili synonte të mbështeste të drejtën e kombeve të vogla për vetëvendosje.

të Drejtat Civile dhe Politike dhe Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (OKB, 1976a, 1976b) si e drejtë individuale. Të dy konventat janë përfaquar nga legjislacionet e brendshme të vendeve demokratike.

Për më tepër, parimi i vetëvendosjes mund të gjendet në vendimet e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJND). Ajo përforcon këtë parim në një numër rastesh në favor të saj [vetëvendosjes], duke sjell përfundime për të drejtën e njerëzve që të vendosin dhe qeverisin vet shoqërinë e tyre. Në Opinionin Këshillues (1971) për praninë e Afrikës së Jugut në Namibi, opinioni ju referua të drejtës së Namibianëve për vetëvendosje, e cila në atë kohë u konstatua se pengohej nga prania e paligjshme e Afrikës së Jugut (GJND, 1970). E drejta për vetëvendosje është përfshirë edhe në dy opinione të tjera këshilluese të GJND-së: njëri për Saharën Perëndimore (1975), i cili në mënyrë të veçantë i referohet “parimit të vetëvendosjes përmes shprehjes së lirë dhe të mirëfilltë të vullnetit të popullit” (GJND, 1975) dhe tjetri për Timorin Lindor (1995), që i jep të drejtë banorëve të Timorit Lindor në vetëvendosje (GJND, 1995). Në vitin 2001, ky parim u bë një ndër elementet primare të doktrinës së “përgjegjësisë që të mbrojë”, e cila argumentonte në favor të intervenimit ndërkombëtar në rastet kur ka shkelje të rënda të të drejtave të njeriut në një vend ose territor të caktuar (ICISS, 2001). Ky parim është i pranishëm edhe në një numër të dokumenteve të tjera të politikave të organizatave ndërkombëtare dhe qeverive donatore.

Megjithatë, gjatë ekzaminimit të dokumenteve ligjore ekzistuese dhe të drejtës zakonore, parimi i vetëvendosjes u interpretua si e drejtë e popujve për të vendosur për besimin e tyre politik, përfshirë edhe pavarësinë e tyre nga sundimi i jashtëm. Kjo mund të përmbledhet në vetëvendosje ndërkombëtare. Në kontekstin e konceptit të pronësisë lokale, vetëvendosja do të interpretohet në mënyrë më të gjerë. Kjo sigurisht paraqet të drejtën e popujve për të vendosur lirshëm se çka është në interesin më të mirë të tyre. Siç thotë Ralph Wilde, “popujt kanë të drejtë të jenë të lirë nga kontrolli i huaj duke u mbështetur në të drejtën e tyre në autonomi” (Wilde, 2012, f.261). Kjo është përkufizuar më shumë si vetëvendosje e brendshme (Daniel, 2008; Weller, 2009). Vetëvendosja e brendshme mund të futet në konceptin

e pronësisë lokale si e drejtë e popullit që të vendos vet për proceset zhvillimore dhe të shtetndërtimit. Vetëvendosja e brendshme i merr parasysh rastet në mjediset post-konfliktit ose post-pavarësisë, ku bashkësia ndërkombëtare ushtron një mandat të gjerë deri aty sa të administrojë një territor ose vend. Marc Weller zbërthen kuptimin e vetëvendosjes nga një e drejtë individuale në një të drejtë në të cilën thirren pjesëtarët e grupeve ose popullsive të caktuara, në të cilën ata kanë të drejtë të vendosin dhe qeverisin brenda një territori (Weller, 2009).

Në fakt, ka argumente të fuqishme që sqarojnë përputhshmërinë ndërmjet konceptit të pronësisë lokale dhe parimit të vetëvendosjes. Një interpretim më i gjerë i konceptit të vetëvendosjes bashkon komponentët e ngjashëm të vetëvendosjes dhe pronësisë lokale, si e drejta e vendorëve dhe bashkëpunimi me shtetet e jashtme dhe/ose bashkësinë ndërkombëtare. Këta janë agjentët kryesorë të të dy koncepteve. Problemi është se pronësia lokale nuk përmendet në mënyrë eksplicite në asnjë dokument ligjor, ndërsa vetëvendosja përmendet. Megjithatë, pronësia lokale rrjedh si pjesë e kornizës së re të përfshirjes së bashkësisë ndërkombëtare, përderisa vetëvendosja është e mishëruar në kartën e OKB-së për shkak të përvojës ndërkombëtare me kolonializmin. Për këtë qëllim, Richmond propozon që harmonia ndërmjet pronësisë lokale dhe vetëqeverisjes në mënyrë të qëllimshme nuk është analizuar nga bashkësia ndërkombëtare, dhe vetëm pjesërisht nga akademikët, sepse vetëvendosja është si një jehonë e epokës së kaluar të kolonializmit (Richmond, 2012). Prandaj, një pjesë e bashkësisë ndërkombëtare me të kaluar kolonialiste përpiqet të shmang këtë përsëritje. Madje, vetëqeverisja është shmangur me qëllim nga bashkësia ndërkombëtare në mënyrë që të zbrapsen debatet potenciale mbi mospërputhjet ndërmjet parimeve ligjore. Për shembull, vetëvendosja është e mishëruar në kartën e OKB-së, dhe veprimet e saj të vërteta në terren në shumicën e rasteve i shmangen zbatimit të këtij parimi themelor.

Bashkë me bazat e forta ligjore, vetëvendosja mes tjerash nënkupton komponentin moral dhe ligjor përmes të cilit bashkësia ndërkombëtare nuk do të tejkalojë kufijtë e mbështetjes dhe intervenimit të jashtëm. Edhe pronësia lokale edhe vetëvendosja me të drejtë mund

të përkufizohen si një fuqi morale e krijuar, e cila pasqyron një varg të gjerë të elementeve që mbështesin të drejtën e aktorëve lokalë që të përcaktojnë fatin e tyre (Shinoda, 2008). Përcaktimi i besimit të njerëzve i ka rrënjët në parimin e vetëvendosjes. Kështu, ka një bifurkacion të parimeve të pronësisë lokale dhe vetëvendosjes. Kjo e ngrit këtë të fundit deri në nivel të doktrinës - përndryshe, e përcaktuar si “doktrina e pronësisë lokale” (Shinoda, 2008, f. 95).

Vetëvendosja, ngjashëm me pronësinë lokale, argumenton për respektim të vendorëve dhe të drejtave të tyre ligjore. Laurie Nathan ka treguar se administratorët ndërkombëtarë dhe donatorët shpesh e arsyetojnë mungesën e pronësisë lokale bazuar në atë se aktorëve lokalë u mungon legjitimiteti ose kapaciteti (Nathan, 2008). Për të sqaruar dimensionin normativ të vetëvendosjes, Wilde ka ofruar disa shembuj gjatë shpërbërjes së kolonializmit në të cilin, përkundër kapacitetit të kufizuar, e drejta në vetëvendosje ishte konvertuar në të drejtën në vetë-administrim (Wilde, 2012). Kështu, vetëvendosja zërthehet në një autoritet (qeveri), i cili do të drejtohet dhe menaxhohet nga vendorët. Kjo i kufizon politikat e një administrate ndërkombëtare, e cila duhet të pranojë autoritetin e vetëqeverisjes (Zaum, 2006).

Në rastet e shtetndërtimit bashkëkohor, vetë-administrimi lehtë mund të sfidohet nga prania fizike dhe ndikimi virtual i bashkësisë ndërkombëtare, në formë të përfshirjes së donatorëve ose misioneve ndërkombëtare. Siç është arsyetuar më herët, mjetet tradicionale të shtetndërtimit nuk mund të përdoren më. Si rezultat, e drejta në vetëvendosje dhe pronësia lokale në qeverisje duhet të konsiderohen si shumë komplekse. Kështu kompleksitetet e vetëqeverisjes bashkëkohore është vështirë të përshkruhen përmes parimeve të pronësisë lokale.

Sidoqoftë, bashkësia ndërkombëtare do të mund të argumentonte kundër pronësisë lokale kur merret parasysh se e drejta e vetëvendosjes kërkohet atëherë kur të arrihet matura e popullsisë lokale. Përdërisa Wilde ka theksuar se deklaratat se vendorët nuk janë “gati” nuk paraqet argument të mjaftueshëm kundër të drejtës së tyre në vetëvendosje (Wilde, 2012, f. 261), pezullimi i përkohshëm i vetëvendosjes dhe pronësisë lokale është i domosdoshëm para se të arrihet matura.

Kjo përfshin rastet ku vendorët përkohësisht nuk janë në gjendje të ushtrojnë autoritetin, para një date të mëvonshme kur vendorëve u jepen të drejtat e tyre të plota. Megjithatë, ushtrimi i të drejtës normative në vetëvendosje mund të shtyhet vetëm në rast se ka qëllime të qarta nga bashkësia ndërkombëtare që emërtohen si “strategji dalëse” (Caplan, 2012, f. 4). Strategjitë dalëse janë orientime të politikave të bashkësisë ndërkombëtare të përshkruara si “largim gradual” nga mjediset e post-konfliktit dhe post-pavarësisë. Kjo politikë parashikon institucione shtetërore të vetqëndrueshme “që mund t’i mbijetojnë tërheqjes së intervenimit të jashtëm” (Fukuyama, 2004, f. 136). Këto mund të mos jenë të lidhura me dimensionin ligjor por mund të marrin parasysh respektimin e vetëvendosjes duke parë ndryshimin e rrethanave. Këto orientime të politikave - pezullimi i të drejtës së vetëvendosjes dhe pronësisë lokale, kërkojnë ndërgjegjësim për të mos përdorur arsyetimet në favor të vazhdimit të pranisë dhe intervenimit ndërkombëtar. Megjithatë, një politikë e tillë mund të shkoj gabim, siç sugjerohet nga Richard Caplan, sepse ajo mund të tjetërsojë popullatën lokale (Caplan, 2012). Kjo e përforcon mungesën e legjitimitetit dhe ka pasoja për bazën ligjore në bazë të cilave janë mandatuar këto administrata.

Në anën tjetër, ka kundër argumente që nuk e mbështesin harmonizimin ndërmjet vetëvendosjes dhe pronësisë lokale. Argumenti i parë i referohet kontekstit të themelit të parimit të vetëvendosjes. Sipas Matthew Saul, fakti se e drejta e vetëvendosjes ishte përpiluar në bazë të dhënies së të drejtës populjve që të zgjedhin besimin e tyre, të lirë nga ndikimi kolonial, sinjalizon një kontekst tjetër nga përfshirja e bashkësisë ndërkombëtare në mjediset e post-konfliktit (Saul, 2011). Sipas Saulit, shumica e administratave ndërkombëtare kanë bazë të fortë ligjore që buron nga Kapitulli VII i Kartës së OKB-së, ku atyre u jepet autoriteti. Sidoqoftë, Sauli ofron vetëm një interpretim të ngushtë të parimit të vetëvendosjes dhe i mungon një studim në kuptimin e pronësisë lokale. Pronësia lokale thirret në të drejtën legjitime të populjve “që të thonë fjalën e vet” në mjediset e post-konfliktit, megjithëse në baza të përcaktuara ligjore të administratave ndërkombëtare.

LEGJITIMITETI

Ndryshe nga vetëvendosja si bazë e fortë ligjore për pronësinë lokale, *legjitimiteti* është normë e fortë e cila mëton të jetë e pranishme kur ka pranim të popullarizuar për një autoritet, të zgjedhur nga populli. Në demokracitë me institucione me përvojë dhe të bazuara në vlera, matja konvencionale e legjitimitetit bëhet nga perspektiva e zgjedhjeve ku fituesit krijojnë sundimin e shumicës në një vend. Kështu, shumica që përfaqëson dhe sundon një vend të caktuar konsiderohet të jetë elementi primar i legjitimitetit në një mjedis demokratik. Kjo konsiderohet të jetë perspektivë pluraliste. Sidoqoftë, në vendet me një rol dhe prani shumë me ndikim të bashkësisë ndërkombëtare, legjitimiteti nuk mund të matet vetëm nga perspektiva e zgjedhjeve. Kjo për shkak se bashkësia ndërkombëtare nuk zgjidhet [me votë] nga qytetarët dhe vjen ose si rezultat i një mandati të dhënë nga organizatat e përbashkëta ndërkombëtare të sigurisë - që do të thotë OKB (Kapitulli VII) - ose ka ndonjë ftesë të veçantë që qeveria i ka dërguar bashkësisë ndërkombëtare për të ofruar mbështetje. Në këto rrethana, ndonëse ka bazë ligjore për praninë e aktorëve ndërkombëtarë, megjithatë ekziston dilema mbi shkallën në të cilën bashkësia ndërkombëtare konsiderohet legjitime nga qytetarët në një vend të synuar. Kriza e legjitimitetit për bashkësinë ndërkombëtare ka implikime morale, meqë pritet të jetë “e mirë” pasi që është krijuar për hir të “qëllimeve të mira” (Bain, 2006).

Një numër i madh i autorëve kanë kontribuar në debatin akademik për legjitimitetin. Sidoqoftë, legjitimiteti që duam ta ekzaminojmë këtu është i ngushtë dhe kompleks, meqë ai fokusohet në mjediset e post-konfliktit dhe post-pavarësisë. Sipas Dominik Zaum, edhe pse legjitimiteti i qeverive i ka rrënjët në demokraci, “bashkësia ndërkombëtare (në mjediset e post-konfliktit) ia mohon të drejtën e mbikqyrjes popullit gjatë qeverisjes së tyre” (Zaum, 2006, f. 456). Zaum konstaton se legjitimiteti është element shumë i rëndësishëm në vendet post-konfliktit, në të cilat populli ka të drejtë të thotë fjalën e vet dhe respektohet. Edhe pse ai konsideron se autoriteti i jepet bashkësisë ndërkombëtare (nga ana e autoriteteve vendore) në mënyrë të pranueshme ligjore, një autoritet i tillë nuk mund të jetë absolut dhe duhet të mbahet përgjegjës (Zaum, 2006). Një tendencë për autoritet

absolut në disa perspektiva ka provokuar reagim të akademikëve dhe aktorëve të pavarur mbi rolin e bashkësisë ndërkombëtare. Në të vërtetë, është e vështirë të matet autoriteti absolut në shkencat sociale; megjithatë, autorët që kritikojnë këtë lloj të autoritetit është dashur të hulumtojnë rastet në terren për të ofruar të dhëna empirike.

Për më tepër, legjitimiteti në mjedisin e post-konfliktit ose të post-pavarësisë mund të ekzaminohet përmes përdorimit (të tepruar) të fuqisë së bashkësisë ndërkombëtare, në njërin anë, dhe aftësisë së vendorëve për të kundërshtuar këto argumente, në anën tjetër. Në të vërtetë, kjo e fundit është mjaft e rëndësishme sepse nëse mund të paraqitet një argument kundërshtues, atëherë ai legjitimitet është në krizë. William Bain në mënyrë të veçantë ekzaminon atë që ai e përkufizon si “autoritet për të rezistuar” (Bain, 2006, f. 537). “Autoriteti për të rezistuar” mund të shihet lehtë në rastin kur vendorët (si në perspektivën maksimaliste ashtu edhe në atë minimaliste) janë në pozitë tu thonë “jo” disa veprimeve të caktuara të ndërmarra nga bashkësia ndërkombëtare. Kjo është me rëndësi veçanërisht nëse ato veprime nuk janë harmonizuar në përputhje me vullnetin popullor të shumicës së qytetarëve dhe interesave të asaj shoqërie. T’i thuhet “jo” pranisë ndërkombëtare është më e komplikuar se sa, për shembull, t’i thuhet “jo” qeverisë. Në demokracitë normale, “jo”-ja për qeverinë mund të konvertohet në dështim të partive në pushtet për të fituar zgjedhjet dhe për të përcaktuar partinë qeverisëse. Megjithatë, bashkësia ndërkombëtare nuk mund të sfidohet në mënyrë “demokratike” sepse ata nuk janë përfaqësues të popullit. Aftësia për të rezistuar po ashtu shihet si pika më e dobët e përfaqësimit lokal në një mjedis të post-konfliktit. Dominik Zaum thekson se “ideja se bashkësia ndërkombëtare bën përpjekje të mëdha për të gjetur një qëndrim të shëndoshë për aq sa ajo varet nga diskursi i aftësisë që në një mënyrë ose tjetrën nënkupton inferioritetin e njerëzve që ajo synon të ndihmojë” (Bain, 2009, f. 154). Si rezultat, përdorimi i panevojshëm i autoritetit aplikohet vetëm përmes autoritetit ligjor që u është dhënë aktorëve ndërkombëtarë derisa autoriteti legjitim është i diskutueshëm në rastet kur vendimet dhe veprimet janë në kundërshtim me interesat e shoqërisë.

Vërtetë, para se të ekzistojë “autoriteti për të rezistuar”, duhet të ketë autoritet lokal. Në marrëdhëniet ndërkombëtare, autoriteti lokal nuk

mund të krijohet natyrshëm: Ky është më shumë një ndërtim gradual shoqëror (Bain, 2009; Lincoln, 1995). Edhe pas gjurmës për ekzistimin nominal të autoritetit, zbatueshmëria e tij mund të jetë e suksesshme vetëm “kur të jetë në gjendje të vë obligime efektive” (Hopgood, 2009, f. 232). Është e drejtë të thuhet se autoriteti i vendorëve nënkupton jo vetëm elementet normative por edhe materiale siç janë kredibiliteti dhe legjitimiteti. Me pozicionim të dobët të shteteve në krijim e sipër, është vështirë të pritet që autoriteti lokal të jetë i konsolidura dhe i pranuar në mënyrë që të krijojë rezistencë ndaj autoritetit ndërkombëtar. Autoriteti dobësohet edhe më shumë nëse ka probleme endemike të qeverisjes në radhët e vendorëve, shumica e të cilëve i referohen korrupsionit dhe krimit të organizuar (Di Lellio, 2009).

Pasojat e veprimeve (jolegjitime) të bashkësisë ndërkombëtare ndaj autoritetit të pamjaftueshëm lokal kërkojnë një formë të veçantë të llogaridhënies së bashkësisë ndërkombëtare. Ligji për organizatat ndërkombëtare në përgjithësi e përcakton se organizatat ndërkombëtare veprojnë sipas kushteve të së drejtës ndërkombëtare, si dhe të drejtës vendore të shteteve ku ato operojnë dhe sipas rregulloreve të tyre të brendshme. Këtu qëndron llogaridhënia e cila shtrihet drejt legjitimitetit të saj. Për t’iu referuar sërish analogjisë në vijim, përderisa një qeveri e zgjedhur i jep llogari Parlamentit, agjencive të pavarura dhe shoqërisë civile, ekziston një enigmë në të cilën është e paqartë se kujt i jep llogari bashkësia ndërkombëtare. Praktikisht, këtu vijmë te rasti me Kosovën, kur gjatë administrimit ndërkombëtar të OKB-së nuk i jepej llogari organeve mbikëqyrëse lokale siç ishte Avokati i Popullit. Në mënyrë të ngjashme, dhe në periudhën pas pavarësisë - Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit (EULEX) - për të shmangur autoritetin e Avokatit të Popullit mbi stafin e tij, krijoi një Panel të Veçantë për të Drejtat e Njeriut të përbërë nga gjyqtarë të EULEX-it (Muharremi, Qehaja, Vrajolli dhe Perteshi, 2010). Si rezultat, përfundimi i Richmond për lidhjen ndërmjet pronësisë lokale dhe llogaridhënies ndërkombëtare është i saktë. Sa më pak që të ketë autoritet dhe pronësi lokale, aq më e madhe do jetë nevoja për llogaridhënie ndërkombëtare (Richmond, 2012).

Legjitimiteti i kontestuar i administratës ndërkombëtare mund të zëvendësohet pjesërisht me ndonjë formë të pëlqimit nga njerëzit. Pël-

qimi në përgjithësi paraqet burim dhe mjet të fuqishëm për paraqitjen e obligimeve politike, e me këtë, autoritetit politik (Zaum, 2006). Mund të ofrohet në një varg formash, edhe pse elementi kryesor në matjen e kredibilitetit të bashkësisë ndërkombëtare është përmes shkallës së mbështetjes publike që ata e marrin. Ky pëlqim, megjithatë, duhet të ofrohet në mënyrë të plotë. Në disa raste, kurdo që pëlqimi është paraqitur si burim i autoritetit për administratën ndërkombëtare, ka qenë pëlqimi i shtetit e jo pëlqimi i qytetarëve të shtetit (Zaum, 2006). Ky faktor e thëllon edhe më shumë krizën e legjitimitetit me të cilën përballen misionet ndërkombëtare.

KRITIKAT PËR PRONËSINË LOKALE

Literatura e kufizuar mbi pronësinë lokale përfshin një numër autorësh të cilët nuk pajtohen me parimet themelore të pronësisë lokale dhe drejtojnë kritika për mënyrën në të cilën arsyetohet ky koncept. Edhe pse burimet që e sfidojnë rëndësinë e pronësisë lokale janë të kufizuara, këto vlerësime janë të mjaftueshme për të vlerësuar në mënyrë kritike kontributin ekzistues të pronësisë lokale. Insistimi i debateve ndërkombëtare në përkufizimin e pronësisë lokale do të sigurojë që aktorët e shumtë të kenë hapësirë që të ofrojnë një përkufizim që i përgjigjet të kuptuarit dhe kontekstit të tyre. Si pasojë, përkufizimi më i rëndësishëm, më i vërtetë dhe më domethënës i pronësisë lokale qëndron në perceptimet e ndryshme të palëve të interesit.

Argumentet ekzistuese për pronësinë lokale janë problematike si në aspektin teorik ashtu edhe atë praktik. Martin dhe Wilson i janë qasur në mënyrë kritike konceptit të definuar nga burimet e politikave dhe ato akademike. Këtu dallohen dy probleme kryesore me përkufizimin ekzistues të pronësisë lokale; i pari, koncepti nuk i përgjigjet në mënyrë të qartë pyetjes se kush e përbën 'lokalen', dhe së dyti, ai fokusohet në pronësinë mbi procesin e reformës, e jo në pronësinë mbi ofrimin e sigurisë (Martin dhe Wilson, 2008). Sigurisht, fushëveprimi i përfshirjes lokale vazhdon të kontestohet në pikëpamjen e kontribuesve. Siç u sqarua më lartë, vendorët nuk shikohen në mënyrë të tërësishme, dhe deri diku, me qëllim anashkalohen. Sa i përket argumentit të dytë, proceset e reformave e sqarojnë në mënyrë të saktë se koncepti rrjedh nga niveli i politikave, që domethënë, nga komuniteti ndërkombëtar

për zhvillim. Si rezultat, ky koncept kryesisht është i pranishëm në dokumentet e politikave duke e mbajtur artificialisht rëndësinë e tij në nivelin normativ (Ambro, 2006). Në terma të thjeshtë, pronësia lokale nuk shkon përtej diskursit normativ mbi rëndësinë e pronësisë lokale në qarqet zhvillimore dhe të politikave. Pra, me të drejtë argumentohet se pronësia lokale arsyetohet në mënyrë jokohërente dhe nuk mund të mbizotërojë në aspektin konceptual për shkak të mungesës së vëzhgueshmërisë së saj dhe synimeve që ndryshojnë (Narten, 2009). Për më tepër, koncepti i pronësisë lokale nuk e sqaron se a synon të avokojë për përfshirjen e vendorëve në planin e një procesi të caktuar ose a e promovon ai vetëm fazën e zbatimit (Hellmüller, 2012). Ky argument më të drejtë e ka identifikuar mbizotërimin e kontributit teknik drejt këtij koncepti më shumë se zhvillimin akademik të tij.

Një prej sfidave kryesore të konceptit është nxjerr nga ajo në çka mbështetet pronësia lokale. Përderisa një prej agentëve kryesorë të konceptit është paraparë të jenë vendorët (domethënë përfituesit dhe shoqëria civile në kuptimin gjithëpërfshirës), koncepti është udhëhequr vetëm nga komuniteti ndërkombëtar për zhvillim. Sa për ironi, janë këto të dyja që duke futur këtë koncept në diskurs në mënyrë që të heqin “marrëdhënien e pabarabartë” në nyjen ndërkombëtarë-vendorë, nuk respektojnë zbatimin e saj konceptual në praktikë. Për të na përkujtuar argumentin e Richmondit dhe Fukuyamës, duket se synimi (i bashkësisë ndërkombëtare) ka qenë që të fus këtë koncept në diskurs në mënyrë që të binden qeveritë donatore mbi atë se si duhet të zbatojnë këtë koncept në praktikë. Hannah Reich e ka përkufizuar këtë si “marrëdhënie patron - klient” (Reich, 2006, f. 22), që nënkupton se diskursi mbi këtë koncept ishte më shumë i fokusuar në bindjen e qeverive donatore mbi atë se çfarë produkte donatorët (patronët) do tu ofrojnë vendorëve (klientëve). Për qëllime të zërthimit të mëtejshëm, pronësia lokale, për shembull, nuk argumenton për përfshirjen e vendorëve dhe avokon një qasje nga poshtë-lart, ndërsa koncepti zbatohet nga aktorët e jashtëm dhe donatorët përmes qasjes nga lart-poshtë. Si pasojë, koncepti mbetet në margjinën të “kornizës logjike” (logframe) dhe brenda kategorisë së fjalëve të shpeshta të përdorura nga komuniteti i donatorëve. Kjo e ka bërë kundërtënë kontributin e konceptit (Bendix dhe Stanley, 2003). Aktualisht, pronësia lokale paraqet pjesëmarrjen e jo

posedimin, autonominë, legjitimitetin ose pëlqimin lokal, pjesërisht për shkak të pabarazive mes ndërkombëtarëve dhe vendorëve (Reich, 2006; Richmond, 2012). Kjo kritikë e paraqet mungesën e kontributit nga përfituesit (vendorët) në këtë koncept. Pa përfshirjen e agjentëve përfitues në zhvillimin e këtij koncepti, pronësia lokale mbetet e pas-tudiuar dhe e bën ndryshimin të paqëndrueshëm.

Një argument tjetër integral ka të bëj me kohën kur duhet të ndodh pronësia lokale. Disa autorë e identifikojnë një ndarje në mes të periudhave menjëherë pas konfliktit dhe periudhave të mëvonshme kur pjekuria është më e arsyetuar. Në të vërtetë, është sureale të pritët një përfshirje më e gjerë e vendorëve gjatë periudhës menjëherë pas konfliktit. Annika Hansen, për shembull, derisa avokon për një marrëdhënie më të barabartë në nyjen ndërkombëtarë-vendorë, insiston se përfshirja e shoqërisë më të gjerë civile në një periudhë menjëherë pas konfliktit është jorealiste. Ajo argumenton se praktika e dobët dhe hapësira e kufizuar politike për aktivizëm social mund të jenë të dëmshme për përpjekjet për rindërtim pas konfliktit (Hansen, 2008). Po ashtu me të drejtë argumentohet se pronësia lokale është më komplekse në disa kontekste se në të tjerat, dhe veçanërisht është vështirë të zbatohet në kontekstin e luftës dhe periudhën menjëherë pas luftës (Joseph, 2007; Nathan, 2008). Për shembull, në disa mjedisë, është e vështirë që bashkësia ndërkombëtare të identifikojë se cilat elita në të vërtetë përfaqësojnë nevojat dhe interesat e vendorëve. Si rezultat, është gabim që të gjitha mjediset pas konfliktit dhe pas pavarësisë të futen në një “paketë”. Në mënyrë të ngjashme, pronësia lokale kritikohet meqë supozohet se vendet e synuara paraqesin raste të kapaciteteve të dobëta dhe mungesës së ekspertizës, duke e bërë pronësinë shumë të vështirë (Mobekk, 2010).

Argumentet ligjore po ashtu janë përpjekur të sfidojnë konceptin e pronësisë lokale. Këto e interpretojnë në mënyrë të ngushtë fushëveprimin ligjor të bashkësisë ndërkombëtare, i cili në të shumtën e rasteve, është i mandatuar nga OKB-ja. Sipas kësaj kritike, vendosja e bashkësisë ndërkombëtare [në një vend] dhe përkrahja që ofron ajo nën ombrellën e “ruajtjes së paqes dhe stabilitetit” sugjeron se paqja dhe siguria do të mbizotërojnë në çfarëdo thirrje për pronësi lokale. Ajo argumenton më tej se disa situata e favorizojnë një opinion më të

gjerë ndërkombëtar e brengosen më pak për vetëvendosje dhe pronësi lokale (Saul, 2011). Sipas Mathew Saul, administrata ndërkombëtare pasqyron “vizionin solidarist” të shoqërisë ndërkombëtare dhe i ka rrënjët në ofrimin e mbështetjes për më të dobët. Kjo nuk duhet të mbetet në hije të konceptit pluralist (Saul, 2011, f. 174), i cili avokon për “zërin” tradicional të vendorëve në vendimet që mund të përfshihen në kuadër të pronësisë lokale.

TEORIA E SHTETNDËRTIMIT

Teoria e shtetndërtimit paraqet një prej kornizave më të rëndësishme teorike në shkencat politike dhe në marrëdhëniet ndërkombëtare. Teoria e shtetndërtimit u paraqit në shekullin XVII përmes “Paqes së Westfalisë”, ku bashkësitë në Evropën Perëndimore njohën kufijtë dhe sovranitetin e njëra-tjetres. Me referencë në shtetndërtimin konvencional, zhargoni akademik bashkëkohor vazhdon të ndjek nocionet e “shtetit westfalian”.

Max Weber është pionier në dhënien e kontributit për teorinë e shtetndërtimit klasik. Argumenti i tij kryesor është se “shteti është i përbërë nga bashkësia njerëzore e cila me sukses e merr monopolin e përdorimit të forcës në një territor të caktuar” (Weber, 1958, f. 95). Janë katër elemente që përmenden shpesh për të përkufizuar shtetin në mënyrë konvencionale: njerëzit, territori, qeveria dhe sovraniteti. Një teori e tillë klasike e ka definuar procesin e shtetndërtimit nga perspektiva perëndimore dhe nga përvoja në procesin e krijimit të kombeve. Po ashtu, koncepti i shtetit ka qenë shumë i pranishëm gjatë shekullit XX, veçanërisht gjatë Luftës së Ftohtë. Në këtë kontekst të Luftës së Ftohtë, Barry Buzan ka theksuar se shteti përbëhet nga individët e lidhur bashkë në një njësi politike kolektive (Buzan, 1991). Ky mendim shkon më tej, pasi që “baza fizike e shtetit përfshin popullsinë dhe territorin e vet, përfshirë të gjitha resurset natyrore dhe pasuritë e krijuara nga njeriu të cilat gjenden brenda kufijve të tij” (Buzan, 1991, f. 90). Shteti modern në Evropë kërkon ushtri të mëdha të mandatuara për ushtrimin e autoritetit mbi territorin e vet (Fukuyama, 2004).

Fundi i Luftës së Ftohtë ka parë fillimin e një “cikli” të ri të shtetndërtimit. Kjo paraqitje e shteteve të reja kontribuoj më tej në evoluimin e teorisë

së shtetndërtimit, duke shënuar një largim nga konvencionalja drejt jokonvencionale. Natyra e shtetndërtimit ka ndryshuar në mënyrë drastike, veçanërisht gjatë krijimit të shteteve të reja jashtë Evropës Perëndimore, në Evropën Lindore dhe Juglindore si dhe në rajonet e tjera të botës. Argumentet vesfaliene për shtetndërtimin mbetën në dimensionin konceptual, edhe pse në esencë nuk janë përjashtuar krejtësisht. Për shembull, Francis Fukuyama, një kontribuues i shquar në teorinë e shtetndërtimit, ende është i mendimit se shtetndërtimi (në shekullin XXI) kërkon monopolin Weberian të dhunës legjitime mbi një territor të përcaktuar. Ai vazhdoi së argumentuari se shtetet i mbajnë nën kontroll mjetet detyruese përmes strukturave siç janë ushtria dhe policia (Fukuyama, 2005), dhe shtoi se “me fjalë të tjera, esenca e shtetësisë është zbatimi [i detyrueshëm]: mundësia themelore për të dërguar dikë me uniformë dhe me armë që të detyrojë njerëzit të respektojnë ligjin e shtetit” (Fukuyama, 2004, f. 7).

Sidoqoftë, natyra e shtetndërtimit ka ndryshuar, veçanërisht në vendet me prani ose rol të konsiderueshëm të bashkësisë ndërkombëtare. Prandaj, ajo çka po ekzaminojmë ne është shtetndërtimi në kuadër të ndërtimit të paqes dhe shkalla e ndikimit që ka bashkësia ndërkombëtare në thelbin e shtetësisë - sektorin e sigurisë. “Shkalla” e përfshirjes ndërkombëtare duhet të shihet në kontekstin e asaj që mund të përcaktohet si “marrëdhënie e pabarabartë” (Hansen, 2008; Reich, 2006). Kjo marrëdhënie e pabarabartë gjendet në mes të bashkësisë ndërkombëtare, në cilësinë e administratorit ose mbështetësit, dhe vendorëve; përmes rolit të tyre si “përfitues” në një shtet në krijim e sipër (Hansen, 2008, f. 40). “Marrëdhënia e pabarabartë” mbështetet nga një numër argumentesh që nënvizojnë varësinë e këtyre vendeve nga ndihma e jashtme, rrethanat e vështira politike dhe funksionimi i kufizuar ose mos-funksionimi total i sundimit të ligjit. Për të përkujtuar dilemën e legjitimitetit, bashkëpunimi i pabarabartë po ashtu gjendet edhe në autoritetin e pamjaftueshëm të vendorëve (Bain, 2009; Hopgood, 2009). “Marrëdhënia e pabarabartë” në procesin e shtetndërtimit po ashtu shikohet edhe nga perspektiva sociologjike dhe antropologjike, ku konsiderohet e drejtë të supozohet se thelbi i kësaj marrëdhënie përbëhet nga një mentalitet “ne” dhe “ata” - ku “ne” nënkupton më të fortit dhe “ata” nënkupton më të dobëtit. Disa autorë shkojnë më tej duke përcaktuar këtë bashkëpunim të pabarabartë

si “marrëdhënie patron-klient” (Reich, 2006, f. 4; Richmond, 2012, f. 354). Edhe pse ndarja ndërmjet “Lindjes” dhe “Perëndimit” është tejkualuar, akoma ka mbetur dikotomia ndërmjet “neve” dhe “atyre”. Edward Said e elaboron këtë argument kur thekson se dikotomia “ne” dhe “ata” shoqërohet me konotacione ksenofobike, në të cilën kultura e “jonë” është superiore ndaj kulturës së “atyre” (Said, 1994). Said vazhdon të mbaj këtë qëndrim radikal, kur e trajton qasjen e fuqive të mëdha ndaj shteteve më të vogla dhe më të dobëta. Megjithatë, mendimeve të tij mbi marrëdhënien kulturore dhe antropologjike ndërmjet perëndimorëve, në njërën anë, dhe lindorëve, në anën tjetër, duhet tu kushtohet vëmendje e veçantë.

Në të vërtetë, ka një bashkëveprim ndërmjet teorisë së shtetndërtimit dhe antropologjisë në kontekstin e pronësisë lokale. Sipas Fergusonit, një ndër dallimet kryesore ndërmjet antropologëve dhe studiuesve të marrëdhënieve ndërkombëtare është se këta të fundit janë të prirë të përdorin kombin-shtet “si kornizë analitike themelore”, ndërsa antropologët e propozojnë idenë se kombi-shtet përfaqëson një prej shumë formave të organizimit shoqëror (Fergusson, 2009, f. 182). Ky theks në kombet-shtet është drejtpërdrejt e lidhur me supozimet rreth asaj se sa në mënyrë të veçantë duhet të organizohen vendet. Si rregull, supozimet e tilla në fakt mund tua pamundësojnë studiuesve që të kuptojnë një çështje të caktuar në kornizën e saj dhe nga intervenimi përkatës në një situatë të caktuar. Kështu, ndërtuesit e shtetit duket se i qasen një çështjeje të caktuar “nga lartë”, ndërsa antropologët fillojnë “nga poshtë”, duke u angazhuar me njerëzit në terren e jo me institucionet ose elitat politike. Për më tepër, antropologët janë të prirë të fokusohen në një kontekst të veçantë dhe të kuptojnë se si rastet specifike lokale janë të mishëruara në kontekstin më të gjerë global. Çka është më e rëndësishmja, disiplina e merr parasysh edhe bashkëveprimin dinamik ndërmjet dy sferave kështu që ato analizohen si një tërësi. Për bashkëpunimin ndërmjet “ndërkombëtarëve” dhe “vënderëve”, kjo nënkupton se ne duhet të fokusohemi në atë se si aktorët e ndryshëm hyjnë në marrëdhënie shoqërore me njëri tjetrin (Fergusson, 2009) dhe të ekzaminojmë ndërveprimin brenda një rrjeti më të gjerë dinamik të raporteve të fuqisë. Për të kuptuar këtë të fundit, studiuesit duhet të shikojnë përtej asaj që është “etnografisht e dukshme” (Farmer, 2004, f. 307).

Në fakt, si nga perspektiva e shtetndërtimit ashtu edhe ajo antropologjike, është argumentuar se nyja ndërkombëtarë-vendorë pasqyron një pabarazi të thellë, të përkufizuar nga pozita vartëse e vendorëve në procesin e shtetndërtimit. Kështu, Hansen kishte të drejtë kur deklaroi se “agjenda normative e angazhimit ndërkombëtar pas konfliktit mund të jetë në kundërshtim me dëshirën për tu mundësuar autoriteteve vendore dhe popullsisë të vendosin për fatin e tyre” (Hansen, 2008, f. 40). Megjithatë, ka një mospërputhje ndërmjet fuqisë së njerëzve e marrjes së pronësisë nga ta në një anë dhe fuqisë së aktorëve të jashtëm në anën tjetër. Shtetet dhe bashkësitë që janë subjekt i përkrahjes së madhe ndërkombëtare varen nga përkrahja e jashtme. Ato ose janë të dobëta në arsyetimin e kërkesave të tyre legjitime ose nuk mund të kundërshtojnë përkrahjen ndërkombëtare për shkak të rrethanave të dobëta politike dhe ekonomike. Kështu, kjo gjendje është analogjike me “marrëdhëniet asimetrike” të aktorëve ndërkombëtarë dhe lokalë (Reich, 2006, f. 14). Marrëdhënia e ka mishëruar ndarjen e rreptë ndërmjet Veriut dhe Jugut, ku përfaqësuesit e këtij të fundit paraqesin vlera të caktuara dhe janë me demokraci të stabilizuara që u japin atyre një përparësi krahasuese. Për këtë qëllim, David Chandler na përkujton neve marrëdhënien e pabarabartë ndërmjet atyre që ai i quan shtete perëndimore dhe shteteve jo-perëndimore si përfitues. Për më tepër, brenda këtij përkufizimi Chandler e konsideron emërtimin “shtete jo-perëndimore” si më të pranueshëm. Për shembull, në rastet e Kosovës si dhe të Bosnjës e Hercegovinës, të dy kontekstet janë parë si jashtë perëndimit, por jo edhe jashtë Evropës. Chandler më tej argumenton se shtetet jo-perëndimore janë në një pozitë që e bën të vështirë tu rezistojnë pranisë ndërkombëtare dhe mbështetjes së jashtme për reformat institucionale dhe për ndërtimin e kapaciteteve (Chandler, 2013).

Si rezultat, teoria e shtetndërtimit mund të ekzaminohet duke e kuptuar mirë ndërtimin liberal të paqes. Ky ndërtim liberal i paqes pasqyron një formë të nuancuar të shtetndërtimit, në të cilin bashkësia ndërkombëtare ka investuar në bërjen e paqes ose përmes pranisë së saj si mision paqëruajtës ose përmes formave më gjithëpërfshirëse të përkrahjes së donatorëve në vendet e post-konfliktit. Sërish, dilema e besimit vazhdon të jetë e rëndësishme dhe ekzaminon lidhjen mes

ndërkombëtarëve dhe vendorëve në mjediset pas pavarësisë. Këto të dyja do të trajtohen ndarazi në pjesën në vazhdim.

NDËRTIMI I PAQES LIBERALE

Pronësia lokale diskutohet gjerësisht në kuadër të ndërtimit liberal të paqes në shtetet e reja të krijuara. Ajo është bërë pjesë e pandashme e shtetësisë që nga përfundimi i Luftës së Ftohtë. Ndërtimi i paqes liberale rrjedh nga paqja liberale, e cila promovon idenë se disa shoqëri dhe shtete të caktuara janë më paqësore, si në çështjet e brendshme ashtu edhe në marrëdhëniet e tyre ndërkombëtare (Newman, Paris dhe Richmond, 2009). Teoricienët klasik dhe bashkëkohor liberalë besojnë se vendet demokratike dhe liberale rrallë bëjnë luftëra kundër njëra tjetrës (Paris, 2006). Për të parandaluar keqpërdorimin e pushtetit për interesa personale dhe individuale që mund të dëmtojnë paqen dhe lirinë, liberalët klasikë argumentojnë në favor të kufizimit të kompetencave të qeverisë (Paris, 2006). Preokupim kryesor i ndërtimit të paqes liberale është paqja dhe mirëqenia, dhe argumenton se ka një përvojë të suksesshme në dhënien fund të dhunës në mjediset pas konfliktit ose pas pavarësisë (Selby, 2013).

Për më tepër, ndërtimi i paqes liberale prioritetizojnë individin mbi format e tjera të organizimit shoqëror dhe i jep peshë të veçantë tregut si motor i ndryshimit shoqëror dhe si garantues kundër konfliktit (Mac Ginty, 2007). Ai po ashtu e merr parasysh shtetndërtimin si politikë vendimtare për komunitetin global, bazuar në besimin e përbashkët se shtetet në krijim e sipër ose shtetet ekzistuese të dobëta paraqesin burim të jostabilitetit global (Fukuyama, 2004). Si rezultat, fushëveprimi për diskutimin e pronësisë lokale në ndërtimin të paqes liberale është i gjerë, dhe përfshin edhe elementet e teorisë mbi demokracinë dhe demokratizimin, në përgjithësi. Megjithatë, aspektet më të gjëra të paqes liberale nuk janë në fokus të këtij libri. Libri synon të përshkruaj dhe ekzaminojë ndërtimin e paqes liberale vetëm brenda fushës së veprimit të pronësisë lokale, dhe periferisë së saj të menjëhershme. Derisa lexuesi mund të hutohet nga vargu i burimeve në teorinë e paqes liberale, ato që fokusohen në ndërtimin e paqes dhe në rolin e bashkësisë ndërkombëtare paraqesin rëndësi të veçantë për konceptin e pronësisë lokale. Rëndësia e tij nuk bazohet në fokusin e saj të

ndërlidhur por më e rëndësishme, ai tregon qasjen e përgjithshme dhe të standardizuar të bashkësisë ndërkombëtare.

Përderisa qëllimet e ndërtimit të paqes liberale duartrokiten gjerësisht, ekziston një numër i kritikave në kuadër të qasjes së saj në kontekstin e pas konfliktit dhe pas pavarësisë. Kritikata kryesisht kanë në shënjestër implikimin e kornizës së ndërtimit të paqes liberale në parimet e pronësisë lokale. Në fakt, korniza ekzistuese e ndërtimit të paqes liberale paraqet kundërthënie themelore me parimin e pronësisë lokale. Mac Ginty, për shembull, e shikon paqen liberale si formë dominuese e ndërtimit të paqes e cila pasqyron interesat praktike dhe ideologjike të veriut global (Mac Ginty, 20120) për shkak të ndikimit të kufizuar të jo-perëndimorëve në konceptin dhe substancës së saj. Ai thekson se “paqja liberale është softueri që e vë në lëvizje harduerin e shumë organizatave ndërkombëtare, shteteve dhe organizatave ndërkombëtare joqeveritare” (Mac Ginty, 2010, f. 396). Kështu, paqja liberale përfaqëson një kornizë të standardizuar për bashkësinë ndërkombëtare në të cilin të gjitha shoqëritë, përfshirë edhe shoqëritë pas konfliktit, pavarësisht se a i përkasin vendeve jo-perëndimore, duhet të përqafojnë vlerat liberale dhe neo-liberale. Në këtë kontekst, është interesante të theksohet se organizatat kryesore ndërkombëtare të përfshira - domethënë, OKB, NATO, FMN dhe Banka Botërore - janë shumë të përkushtuara për demokracinë. Programet e përshtatjes strukturore të bazuar në ideologjitë perëndimore vazhdojnë të luajnë “rolet më të rëndësishme në ndërtimin e paqes” (Paris, 1997, f. 62). Megjithatë, Parisi ka deklaruar se këto përpjekje pasqyrojnë qëllimin e kamotshëm të fuqive të mëdha “për t’i dhënë frymë perëndimore periferisë” (Paris, 2002, f. 651).

Gjatë argumentimit për paqen liberale si mjet kritik i bashkësisë ndërkombëtare, Mac Ginty ka theksuar se paqja liberale është “gjëja më e mirë e mundshme” (Mac Ginty, 2010, f. 399), që nënkupton se asnjë prej intervenimeve dhe përkrahjes deri më sot nuk kanë pasqyruar modele alternative në përputhje me rrethanat e ndryshme. Bashkësia ndërkombëtare shpesh argumenton se kjo qasje e standardizuar paraqet shprehjen e një njohurie të “akumuluar” shkencore dhe praktikave më të mira të Perëndimit (de Coning, 2013). Mund të pajtohem me argumentin se paqja liberale mund të jetë “gjëja më e mirë

e mundshme” për momentin, por ne nuk duhet domosdoshmërisht të pajtohemi se duhet domosdo të përqafohet paqja liberale dhe atë në tërësi. Ajo duhet të zbatohet në mënyrë graduale dhe, çka është më e rëndësishmja, duhet të marrë parasysh kontekstet dhe vlerat lokale. Në mjediset menjëherë pas konfliktit, dhe në rastet kur disa elemente të paqes liberale janë në kundërshtim me vlerat dhe kulturën lokale, duhet dhënë prioritet këtyre të fundit. Kjo është edhe më me rëndësi meqë pronësia lokale pasqyron të drejtën “që të thonë fjalën e tyre” njerëzit e synuar para se të fillojnë të aplikohen vlerat e jashtme. Në vend të shijes lokale, ndërtimi i paqes liberale do të bëhet, siç e ka ilustruar Richmond, “si verë e vjetër në shishe të reja” (Richmond, 2009b, f. 330).

Për këtë qëllim, vlefshmëria e paqes liberale dhe shtendërtimit është vënë në pikëpyetje nga kritikët të cilët gjithnjë e më shumë argumentojnë se kjo qasje e standardizuar pasqyron vetëm preferencën normative të bashkësisë ndërkombëtare para atyre të shoqërive të prekura, vlerat dhe traditat e të cilëve marginalizohen gjatë procesit (Mayall dhe Soares de Oliveirs, 2011). Përkundër argumenteve se ndërtimi i paqes liberale është në vetvete promovues i paqes (Mac Ginty, 2010), megjithatë, siç u argumentua më herët, ekziston një kundërtënie ndërmjet promovimit të paqes dhe mjeteve joliberalë që zakonisht i aplikon bashkësia ndërkombëtare (Mac Ginty dhe Richmond, 2013). Kur promovohet liberalizmi dhe ndërtimi i paqes liberale, dhe ku bashkësia ndërkombëtare duhet të veprojë sipas parimeve të barazisë, ndërkombëtarët në fakt janë dëshmuar se e bëjnë të kundërtën, duke e mohuar legjitimitetin dhe të drejtat e njerëzve. Liberalizmi përfshin një varg normash dhe parimesh të cilat praktikisht, nuk janë aplikuar. Për këtë qëllim, Richmond thekson se bashkësia ndërkombëtare “është e prirë të bllokojë zgjedhjen dhe fleksibilitetin sipas udhëzimeve të tyre institucionale duke vepruar në mënyrë të papërgjegjshme pa i pranuar kufizimet e udhëzimeve të tyre në kontekste të ndryshme” (Richmond, 2012, f. 355). Ngjashëm, Mac Ginty shtoi se qëllimi i fundit i ndërtimit të paqes liberale nënkupton kombinimin e elementeve detyruese me stimuj më të butë, më bindës gjatë procesit të shtendërtimit (Mac Ginty, 2010). Prandaj, paqja liberale herë pas here përshkruhet si “intervencionizëm liberal” ose “internacionalizëm liberal” (Mac Ginty, 2010, f. 393), në të cilën intervenimi evropian “në

periferi është i pranishëm për aq sa është i orientuar kryesisht për të ofruar siguri dhe progres të civilizimit botëror, e jo të interesave të veçanta të vendit ndërhyrës” (Parisi, 2002, f. 651).

Intervenimet nga bashkësia ndërkombëtare janë zbërthyer mjaft mirë nga Fukuyama, i cili mendon se reformat ose programet e zhvillimit pasqyrojnë një qasje të standardizuar të bashkësisë ndërkombëtare, në të cilën “një ekip nga Uashingtoni ose Brukseli parashutohet në një vend në zhvillim, duke bërë së pari një ‘vlerësim të nevojave’, e pastaj duke u diktuar vendorëve procesin e nevojshëm që t’i ndihmojnë vetes” (Fukuyama, 2005, f. 85). Edward Said, në qasjen e tij kritike ndaj fuqive të mëdha, në mënyrë cinike e ka ilustruar qasjen e intelektualëve perëndimorë në të cilën sqarimi se si duhet të ndryshohen pjesët e tjera të botës jepet nga “një barkë në lumin Temzë” (Said, 1994). Kjo qasje kontribuon drejt institucionalizimit të një shteti të dobët, i cili (gjatë zhvillimit ose procesit të tij të reformës) ka pak marrëdhënie me shoqërinë e tyre, dhe si rezultat, i mungon autoriteti legjitim (Chandler, 2013). Chandler e ka ilustruar këtë si moment kur “një vend nikoqir” e rezervon një sallë takimesh, por “mysafirët” që vijnë sjellin me vete kornizat e politikave që tashmë veç i kanë hartuar (Chandler, 2013).

Mund të argumentohet se nuk duhet të nënçmohet kurrë kontributi dhe përkrahja e qytetarëve dhe popullsisë lokale. Bashkësia ndërkombëtare zakonisht përbëhet nga teknokratët, por i mungojnë ekspertët në vendin ku ata punojnë (Donais, 2012). Si rezultat, vendorët mund të japin përshkrimin e tyre për atë se çka e shkakton konfliktin dhe rekomandimet për politikën (Mac Ginty dhe Richmond, 2013). Në fakt, konteksti lokal dhe sqarimi mbi menaxhimin dhe ndërmjetësimin e konfliktit janë thelbësore për zhvillim të qëndrueshëm. Padyshim, njohuria lokale e kontekstit duhet të shihet si resurs e jo si pengesë (Lederach, 1998).

Për këtë qëllim, Oliver Richmond argumenton se ndërtimi i paqes liberale është manifestim i “shtetndërtimit bashkëkohor të karakterit liberal dhe neo-liberal (ndërkombëtar), i cili si instrument e shfrytëzon, koopton dhe refuzon kulturën lokale” (Richmond, 2009a, f. 159). Richmond ka deklaruar me të drejtë se ndërtimi i paqes në sho-

qëritë pas konfliktit duhet të jetë e bazuar në komunitet ose të ndjek qasjen nga poshtë-lart, megjithatë, dhe siç është treguar në shumicën e rasteve, është zbatuar përmes qasjes nga lart-poshtë. Kjo marrëdhënie e pabarabartë ndërmjet bashkësisë ndërkombëtare dhe vendorëve në fund të fundit çon drejt një kontestimi të hapur të kulturës (lokale) dhe të “të qenit i ndryshëm” (Richmond, 2009a). Përpjekjet për aplikimin e ndërtimit të paqes liberale dhe neo-liberale në procesin e shtetndërtimit synon të drejtojë me shpejtësi shoqërinë drejt një tregu të hapur dhe kornizes neo-liberale, duke mos marrë parasysh të kaluarën e kohëve të fundit, qoftë ajo autoritare ose e konfliktit. Roland Paris e ka përkufizuar këtë si “liberalizim para institucionalizimit” (Paris, 2004, f. 179).

Në të vërtetë, qëndrimi i Roland Paris kundër liberalizimit të shtyrë nga jashtë është shumë më kritike. Paris beson se praktika bashkëkohore e ndërtimit të paqes është përkthim modern i “misionit civilizues” (*civilisatrice*) - koncept që daton nga besimi i epokës kolonialiste i cili sqaron “detyrën” e fuqive evropiane për të “civilizuar” shoqëritë joperëndimore (Paris, 2002, f. 638). “Misioni civilizues”, ka shtuar ai, paraqet përgjegjësinë morale për të “civilizuar” shoqëritë vendase që ata i kanë kolonizuar (Paris, 2002). Për këtë qëllim, tendenca “për të futur frymën perëndimore” në shoqëritë joperëndimore nënkupton pasojat e paplanifikuara për zhvillimin e shoqërive të synuara. Edhe pse ideja është që të mbështetet, për shembull, procesi i RSS-së, projekti ndërkombëtar zakonisht përfundon duke qenë projekt kulturor (Richmond, 2009a). Procesi shndërrohet në një sipërmarrje gjithëpërfshirëse, i cili e ka si synim primar institucionet e sigurisë, por qëllimi i fundit synon të transmetojë konceptin mbizotërues të liberalizimit dhe neo-liberalizimit. Kjo gjerësisht shihet si “modernizim me nxitim”, me objektiv të qartë të synimit për transformimin e shpejtë të një vendi post-konfliktual ose të post-pavarësisë në vija krejtësisht liberal-demokratike (Donais, 2012, f. 23). Faza e Fukuyamas në vitin 2004 për “arritjen e (nivelit) të Danimarkës” i sqaron në mënyrë absolute format e ndërtimit ndërkombëtar të paqes dhe komunitetin e donatorëve (Fukuyama, 2004, f. 29), e cila në mënyrë ironike është jehonë e tendencës së “intervencionistëve ndërkombëtarë” për të transformuar me shpejtësi vendet e pazhvilluara në vende të zhvilluara - të barabartë me standardin jetësor dhe demokratizimin në Skandinavi.

Ngjashëm me këtë, dhe nga këndvështrimi i profesionistit, mënyrë e standardizuar e transmetimit të modeleve Perëndimore ose do të zvogëlohet ose përzihet me modelet e tjera lokale dhe rajonale (Ash-down, 2011).

Qasja ekzistuese e standardizuar nga bashkësia ndërkombëtare është formësuar në modelin linear, që aplikohet në të gjitha mjediset pas konfliktit. Kjo i ka shndërruar grupin e proceseve të shtetndërtimit, i parë kryesisht si teknik dhe i kuptuar në mënyrë të ngushtë, në një fushëveprim të gjerë për eksportimin e demokracisë dhe qeverisjes së mirë (Chandler, 2013). Qasjet lineare kanë qenë të menduara vetëm për komunikim me elitat sepse, siç është konstatuar në mjediset e pas konfliktit, këto elita mund të bllokojnë procesin e zhvillimit dhe reformës. Nga këndvështrimi i bashkësisë ndërkombëtare, kjo ishte ide racionale, sepse ajo e bëri më të lehtë arritjen e objektivave. Problemi qëndron në atë se bashkësia ndërkombëtare kurrë nuk i ka marrë parasysh këto shoqëri në mënyrë të plotë. Si rezultat, në mënyrë që të ruhen parimet e pronësisë lokale, ka nevojë të kalohet nga qasja lineare në jo-lineare e cila do t'i përfaqësojë interesat e shoqërive të synuara. Kjo është me rëndësi sepse një qasje jo-lineare do të synojë të punojë në nivel të shoqërisë, duke e adresuar transformimin e procesit shoqëror dhe të kuptuarit e formimit shoqëror të demokracisë dhe paqes, duke shënuar kështu një largim nga mosdija e atyre që kanë avokuar një qasje lineare (Chandler, 2013).

Procesi i RSS-së në vendet në zhvillim sjell me vete një prani të konsiderueshme të bashkësisë ndërkombëtare. Ka shumë pak dallime ndërmjet metodave me të cilat është zbatuar RSS-ja në Kosovë dhe atyre në Bosnjë. Ajo paraqet një “paketë” e cila përfshinë një interpretim specifik të qeverisjes së mirë dhe liberalizmit. Problemi qëndron në atë se kjo “paketë” nuk i përshtatet kontekstit lokal, duke shkaktuar probleme tepër të mëdha për strukturën institucionale. Kjo situatë përkufizohet në atë që disa e quajnë paradoksi i “një zgjidhjeje universale” në RSS (Jackson, 2011, Oosterveld dhe Galand, 2012). Mac Ginty e analizoi këtë standardizim duke tërhequr një paralele me ndërmarrjen IKEA - “një paqe e gatshme e paketuar dhe e bërë nga komponentë të standardizuar” (Mac Ginty, 2008, f. 145). Po ashtu, edhe Shmeidl e konsideroi këtë proces si “McDonaldizim” (Shmeidl, 2009), duke

dhënë një ilustrim tjetër të qasjes së standardizuar. Kjo qasje e standardizuar ndaj RSS-së dhe ndërtimit të paqes nënkupton disa elemente të kontrollit, ku aktorët ndërkombëtarë shërbejnë si gardianë të stilit “komando dhe kontrollo” dhe ku bashkësia ndërkombëtare menaxhon të dy këta faktorë.

Në të vërtetë, tendenca e transformimit të intervenimeve të jashtme nga “intervenimi i sigurisë” në “intervenim kulturor” i ka sfiduar argumentet e fuqishme kulturore që kanë të bëjnë me moralitetin. Është e qartë se bashkësia ndërkombëtare është e prirë të promovojë vlerat që nënkuptojnë moralitet edhe pse vepron në mënyrë krejt të kundërt. William Bain thekson se të gjithë njerëzit e dinë si të sillen si anëtarë të familjes ose si qytetarë (Bain, 2006). Bain ka shkruar më tej duke argumentuar se ky lloj qëndrimi nga bashkësia ndërkombëtare në fakt e korrupton shoqërinë në “ata” dhe “ne”. Ai shtoi se “ata (ndërkombëtarët) i korruptojnë ata të tjerët (vendorët) duke ua mohuar humanitetin e tyre si të menduar. . . dhe ata (vendorët) na korruptojnë “neve” (ndërkombëtarëve) në mohimin e vullnetit mbi të cilin varet njohja e vet humanitetit tonë” (Bain, 2006, f. 538).

Ngjashëm, Roger Mac Ginty mendon se procesi i transkulturimit të vazhdueshëm po i shpie shoqëritë jo-perëndimore në atë që ai e quan “hibridizim” (Mac Ginty, 2010). Hibridizimi nënkupton se ka një bashkëpunim të imponuar i cili çon drejt ndryshimeve kulturore në mjediset jo-perëndimore. Richmond e përforcon këtë koncept edhe më shumë duke theksuar se “forma e hibridizuar e shteteve liberale autoritare e cila ka dal si treguese e konfrontimit jo të lehtë dhe e marrëdhënies ndërmjet agjentëve të paqes liberale dhe shpesh, agjentëve të vet konfliktit” (Richmond, 2009b, f. 326). Eksponentët e teorisë së ndryshimit në kontekstin e procesit të ndërtimit të paqes liberale të shtyrë nga perëndimi gjithnjë e më shumë bëjnë thirrje për prioritizim të modeleve që kryesisht marrin parasysh specifikat e kontekstit lokal (de Coning, 2013).

Hughes dhe Pupavac kanë një qëndrim më radikal duke argumentuar se diskursi prapa intervenimeve ndërkombëtare bëhet me qëllim për të legjitimuar një prani ndërkombëtare të papërcaktuar. Veçanërisht, që nga periudha e dekolonizimit, ndërkombëtarët kanë dyshuar në

kapacitetin e shteteve dhe popullsive post-kolonialiste për vetëqeverisje (Hughes dhe Pupavac, 2005). Diskurset e “antologjizimit” shpesh përdoren për të de-legjitimuar politikat lokale, në mënyrë që të arsyetohet kujdestaria ose mbikëqyrja ndërkombëtare. Luftërat në ish-Jugosllavi, për shembull, shpesh modeloheshin nga diskursi i urrejtjes së qenësishme etnike, e cila vinte përgjegjësinë për konfliktet mbi vet popullsitë e jo mbi elitat politike (Hughes dhe Pupavac, 2005).

BESIMI

Besimi është një normë tjetër e cila është njëjtë e rëndësishme në teorinë e shtetndërtimit. Ai synon të adresojë dilemën e besimit në marrëdhëniet ndërkombëtare, e me këtë edhe në lidhjen ndërkombëtarë-vendorë. Me të drejtë mund të thuhet se besimi i ka rrënjët thellë në “marrëdhënien e pabarabartë” ndërmjet ndërkombëtarëve dhe vendorëve, e cila mund të përkufizohet lehtë si “dilemë e mosbesimit” (Hansen, 2008, f. 45). Kjo dilemë përforcon marrëdhënien ndërmjet kombeve dhe shteteve si dhe marrëdhënien e përditshme ndërmjet qenieve njerëzore. Ajo nuk është një nocion i ngurtësuar ontologjik ku nuk mund të arrihet niveli i dëshiruar i besimit në terma të “po, ka besim” dhe “jo, nuk ka besim”. Kjo është një trajektore e cila zhvillohet gradualisht.

Në mjediset e post konfliktit ose të post-pavarësisë, besimi shtjellohet gjerësisht nga shkencëtarët politikë dhe sociologët. Kjo ka kontribuar drejt zhvillimit të studimeve mbi nyjen ndërkombëtarë-vendorë në përgjithësi dhe mbi pronësinë lokale në veçanti. William Bain ka dhënë një kontribut të dalluar në zbërthimin e dilemës së besimit. Ai argumentoi se administrimi ndërkombëtar ka dështuar që të bëjë dallimin ndërmjet dy elementeve të marrëdhënies njerëzore: kontratës dhe besimit (Bain, 2006). Ai më tej e përforcoi argumentin e tij se ndërkombëtarët dhe vendorët duhet ta shikojnë marrëdhënien e tyre në formë të palëve kontraktuese që përfshinë përfitimin e përbashkët, shkëmbimin e premtimeve, njohjen e barazisë dhe obligimin e ndërsjellë lidhur zhvillimin e shoqërisë. Kjo nuk nënkupton shpërndarjen e përfitimeve të cilën nuk pritet që ta kenë si qëllim ndërkombëtarët. Argumentet e tij burojnë nga e Drejta Romake, e

cila kërkon marrëdhënie kontraktuese në rast se ka tendencë për të kërkuar partneritet (Bain, 2006).

Problemi me logjikën e marrëdhënies kontraktuese është se ajo mendohet që ta bëj palën kontraktuese (ofruesin) patron. Si pasojë, patroni e ka kapacitetin të vendos për shkallën e besimit që i jepet përfituesit. Kjo marrëdhënie kontraktuese mund të revokohet ose pezullohet lehtë në bazë të besimit. Pushteti i patronit mund të keqpërdoret shumë lehtë, jo vetëm për të detyruar vendorët të ndjekin disa udhëzime të caktuara, por edhe për të zhvilluar një proces eksperimental të të mësuarit në të mirë të patronit. Për këtë qëllim, Bain vazhdon të përdor cinizmin kur e quan bashkësinë ndërkombëtare “Princ” i cili nuk detyrohet nga ligjet për të dënuar pushtetin e tij absolut (Bain, 2009, f. 151). Për më tepër, “bashkësia ndërkombëtare dhe angazhimet e tjera të ndërlihdura do të jenë gjithmonë pre e kritikës së madhe për aq kohë sa ithtarëve të saj u mungon besimi për të përcaktuar diskursin e aftësisë kundër kësaj vërejtjeje në aso mënyre e cila haptazi dhe sigurt e shpall superioritetin e qartë të qëllimeve që ata duhet të arrijnë” (Bain, 2009, f. 151).

Richmond e përforcon argumentin se duhet të ketë njëloj marrëdhënieje kontraktuese ndërmjet ofruesve (ndërkombëtarëve) dhe pranuesve (vendorëve), bazuar në ofrimin objekteve ose kornizave të nevojshme ose të dëshirueshme nga ana e pranuesit (Richmond, 2012). Ai mendon se marrëdhënia kontraktuese ka për qëllim të zvogëlojë “marrëdhënien e pabarabartë” ekzistuese. Autorët e tjerë në përgjithësi pajtohen se sa më shumë që të përfshihen dhe të respektohen vendorët, aq më i madh do të jetë niveli i besimit. John Paul Lederach ka përmendur një problem në zhvillimin e nyjes ndërkombëtarë-vendorë dhe dilemën e besimit. Me një ekspertizë të madhe praktike dhe akademike gjatë viteve 1980-ta dhe 1990-ta, ai ndoshta konsiderohet ndër të parët që ka ngritur dilemën e përfshirjes së vendorëve në mjediset e post-konfliktit. Lederach mendon se bashkësia ndërkombëtare i sheh njerëzit si resurse dhe si pranues (Lederach, 1998). Ndërtimi i paqes i bazuar në qytetarë duhet të shikohet si instrument dhe si pjesë integrale, e jo periferike (Lederach, 1998). Kryevepra e Lederach kontribuon në kultivimin e besimit dhe legjitimitetit ndaj bashkësisë ndërkombëtare në mesin e popullsisë lokale. Në fakt, tendenca e bash-

kësisë ndërkombëtare për të parë vendorët si problem e jo si zgjidhje (Donais, 2009) pasqyron një qasje paternaliste, e cila e vë në dyshim besimin.

Dilema e besimit e vë në pah metaforën me prindërit, tinejxherët, dhe veturat, ku tinejxherëve nuk mund tu besohen çelësat e veturës derisa prindërit e tyre t'i kenë mësuar ata të vozisin në mënyrë të përgjegjshme (Donais, 2012a, 2012b; Mayall dhe Soares De Oliveira, 2011). Megjithatë, është me rëndësi të analizohet bashkëpunimi mes ndërkombëtarëve dhe vendorëve në mënyrë analogjike me dilemën prindër-fëmijë. Konteksti i shembullit të paraqitur është i rëndësishëm këtu. Në rastet kur shembulli nxirret në bazë të paaftësisë së vendorëve për të marrë përsipër detyrat, shembulli do të ishte i rëndësishëm nëse ka strategji të qartë dalëse (e paraqitur më poshtë). Nëse shembulli përfshin ndërkombëtarët e pjekur dhe vendorët e papjekur atëherë kjo mund të tregohet problematike, sepse ajo në thelb përfshin një “marrëdhënie të pabarabartë” dhe “dilemën e mosbesimit” në nryjen ndërkombëtarë-vendorë.

Ndjenja e mosbesimit ndaj mjediseve pas pavarësisë buron nga supozimi se shtetet më të forta janë thellësisht problematike. Si rezultat, këto shtete dhe shoqëri nuk duhet të përcaktojnë kursin e kufijve të tyre (Chandler, 2006). Kështu, Chandler vazhdon më tej duke thënë se “shtetet e dobëta nuk janë më të këqija se shtetet e forta - derisa shtetet e dobëta nuk mund të ushtrojnë autoritetin adekuat në arenën e brendshme, shtetet e forta ushtrojnë autoritet të tepërt dhe janë të prira të marginalizojnë zërat e tjerë nga shoqëria civile” (Chandler, 2006, f. 30). Kjo mund të interpretohet lehtë si përpjekje e bashkësisë ndërkombëtare për të ndarë vetëm pjesët e vlerave të saj që u përshtaten interesave të saj, jo domosdoshmërisht edhe interesit të vendorëve.

REFORMA E SEKTORIT TË SIGURISË

RSS paraqet njërin prej dimensioneve konceptuale që ndihmon në zbrërthimin e pronësisë lokale. RSS nënkupton dy baza që janë esenciale për pikëpamjen e hulumtimit: E para, pronësia lokale është derivat i kornizës së RSS-së dhe, e dyta, fokusimi i librit është në sektorin e sigurisë. Megjithatë, derisa kontributi në RSS dhe pronësisë

lokale është shumë i pranishëm në nivelin e politikave, kjo pjesë synon të përshkruaj kontributin e politikave dhe të sjell diskutimin në nivelin akademik. Kontributi i RSS-së do të zbërthehet në dy nivele: në marrëdhënien ndërmjet bashkësisë ndërkombëtare dhe vendorëve gjatë procesit të RSS-së, dhe zhvillimi i sektorit të sigurisë në mjediset që kërkojnë institucione të reja të sigurisë.

RSS ka dal si rezultat i përfundimit të Luftës së Ftohtë me qëllimin parësor të parandalimit të konfliktit dhe rindërtimit të aparatit të sigurisë në mjediset pas konfliktit dhe post-autoritare. Ka një varg sinonimesh me kuptim të njëjtë me RSS-në, siç janë Rindërtimi i Sektorit të Sigurisë dhe/ose Transformimi i Sektorit të Sigurisë. Parimet e RSS-së kanë rrjedh nga organizatat dhe shtetet perëndimore, të cilat kryesisht kishin për qëllim të kontribuonin drejt demokratizimit të përgjithshëm të shoqërisë, me fokus kryesor në institucionet që kanë fuqi detyruese siç janë forcat e armatosura, policia dhe shërbimet informative. Përderisa RSS sugjeron një term teknik, ajo megjithatë është proces politik që kërkon përfshirjen e aktorëve ndërkombëtarë, shtetëror dhe joshtetëror (OECD, 2008).

Është vështirë të përshkruhet prejardhja e saktë e diskursit mbi RSS-në: deklarata e aktorëve të politikave në Mbretërinë e Bashkuar është ndër të parat. Sekretarja e Shtetit e Mbretërisë së Bashkuar për Zhvillim Ndërkombëtar, Clare Short, për herë të parë, zbuloi se politikat e sigurisë duhet të zhvillohen dhe formulohen në bashkëpunim me Zyrën për Çështje të Jashtme dhe të Komonveltit (FCO) dhe me Ministrinë e Mbrotjes (MOD) (Short, 1998). Kjo ishte hera e parë që institucionet e sigurisë dhe politikat e sigurisë u panë në një perspektivë më të gjerë. Deklarata po ashtu nënkuptonte marrjen parasysh të “zërit” të qytetarëve, dhe bënte thirrje për një pjesëmarrje ma të madhe të publikut në zhvillimin e politikave të sigurisë (Caparini, 2010).

Agjenda e RSS-së u konsolidua përmes miratimit të plotë të saj nga OECD, e cila e theksoi nevojën që qeveritë donatore të ofrojnë mbështetjen e tyre në reformimin e sektorit të sigurisë në vendet pas konfliktit ose post-autoritare (OECD, 2007). Raporti ka shërbyer si udhëzues për profesionistët dhe qeveritë donatore gjatë ofrimit të mbështetjes për vendet në zhvillim. Prej këtui, RSS është pranuar

gjithnjë e më shumë nga të gjitha organizatat ndërkombëtare. Në vitin 2008, OKB, për herët të parë ju referua nocionit të RSS-së në të cilin ajo në mënyrë të qartë theksoi se “reforma e sektorit të sigurisë është një element thelbësor i çdo procesi të stabilizimit dhe rindërtimit në mjediset e post-konfliktit” (OKB, 2008). Si i tillë, koncepti është pranuar formalisht nga të gjitha organizatat ndërkombëtare që shprehin interes në stabilizim dhe investime pas konfliktit.

Ndonëse kontributi deri më sot nuk ka mund të përcaktojë RSS-në brenda një kategorie të veçantë, ekzistojnë komponentë të ndryshëm që e bëjnë RSS-në konceptualisht të qëndrueshme. Kjo lidhje me qëndrueshmërinë është e pranishme në teori. Për shembull, teoria e shtetndërtimit sugjeron se RSS është e dizajnuar të paraqes një prej elementeve bazike të shtetit Weberian - “monopolin mbi përdorimin e forcës detyruese” (Sedra, 2010, f. 16). RSS është përshtatur me studimet e sigurisë, që do të thotë se thelbi i saj synon stabilizimin në vendet e post-konfliktit (Williams, 2008). RSS po ashtu ka integruar elementet nga teoria e demokratizimit, në të cilën ideja mbizotëruese e RSS-së e mbështet pjesën e demokratizimit të sektorit publik. Ndërsa në studimet e zhvillimit RSS mishëron komponentin e zhvillimit në të cilin rreshtohen një numër i aktorëve të jashtëm për të ofruar përkrahje të fokusuar në mjediset e post-konfliktit dhe atyre post-autoritare.

Sipas Brzoskas, qëllimi primar i RSS-së është që të iniciojë ndryshimet në qeverisjen e institucioneve të sigurisë, veçanërisht lidhur me “çështjet e buta”, siç është mbikëqyrja civile demokratike dhe monitorimi i të drejtave të njeriut (Brzoska, 2006). Në këtë mënyrë, institucionet e sigurisë do të shndërrohen nga një formë autokratike drejt një forme demokratike të qeverisjes, në të cilën një përfaqësues civil legjitim ushtron qeverisjen dhe mbikëqyrjen. Synimi primar i RSS-së është të fokusohet në institucionet që i kanë mjetet detyruese siç janë forcat e armatosura, policia, shërbimet e inteligjencës, rojet e kufirit dhe të ngjashme, megjithatë koncepti i RSS-së ka edhe një synim më të gjerë. Ai ka për qëllim që të demokratizojë institucionet e sigurisë në kuptimin e gjerë, dhe nuk duhet të kufizohet vetëm në forcat e armatosura. Kështu, nocioni i sektorit “gjithëpërfshirës” të sigurisë përmendet gjerësisht kur analizohet RSS, në të cilën të gjithë aktorët janë sub-

jekt i reformës, përfshirë edhe ekzekutivin, organet monitoruese dhe ligjvënëse. Një qasje gjithëpërfshirëse ndaj sektorit të sigurisë tregon se, përveç policisë, ushtrisë, shërbimeve të inteligjencës, shërbimeve të emergjencës civile, përfshihen edhe institucionet mbikëqyrëse siç janë parlamenti, organet e pavarura mbikëqyrëse dhe shoqëria civile. Emërtimi “e tërë qeveria” mund të gjendet në një numër burimesh që e sqarojnë në mënyrë të ngjashme nocionin e sektorit gjithëpërfshirës të sigurisë (Albrecht, Stepputat dhe Andersen, 2010; OECD, 2007). Në fakt, qasja gjithëpërfshirëse nënkupton përfshirjen përtej “tërë qeverisë” sepse, bashkë me kërkesat për përfshirjen institucionale të të gjitha aktorëve qeveritarë - përveç aktorëve të sigurisë - ajo u bën thirrje aktorëve joqeveritarë që të jenë pjesë e proceseve.

Në fakt, dhe në frymën e kuptimit gjithëpërfshirës, institucionet që janë të obliguara të ushtrojnë mbikëqyrje të sektorit të sigurisë janë vendimtare në korpusin e gjerë të konceptit të RSS-së. Në kontributin e tij për RSS, për shembull, Sedra deklaroi se “profesionalizmi dhe efektiviteti i sektorit të sigurisë nuk matet vetëm me kapacitetin e forcave të sigurisë, por me atë se sa mirë menaxhohen, monitorohen dhe mbahen përgjegjëse ato” (Sedra, 2010, f. 16). Paul Jackson e mbështeti këtë argument duke e konsideruar çështjen brenda një përkufizimi më të ngushtë të sektorit të sigurisë. Për Jackson-in “përkufizimi i ngushtë fokusohet në shërbimet e uniformuara dhe mbikëqyrjen e tyre, në mënyrë specifike atyre shërbimeve që janë të autorizuara për përdorimin e forcës që përfshijnë ushtrinë dhe zakonisht (por jo gjithmonë) policinë” (Jackson, 2011, f. 1811). Në anën tjetër, qasja më e gjerë ndaj RSS-së përfshin shërbimin jo të uniformuar dhe tërë sistemin e drejtësisë (Jackson, 2011). Sidoqoftë, Jackson nuk u është referuar organeve të tjera esenciale në sektorin e sigurisë, veçanërisht atyre që kanë mandat për mbikëqyrje dhe kontroll. Winkler ofron një sqarim të shëndoshë për këtë çështje duke e ndarë sektorin e sigurisë (e me këtë edhe procesin e RSS-së) në vija horizontale dhe vertikale: vija vertikale nënkupton se të gjithë aktorët, duke filluar nga presidenti, kryeministri (varësisht prej sistemit politik) të pasuar nga ministrat/agjencitë e deri te ekzekutivi, duhet të përfshihen në përkufizimin e sektorit të sigurisë. Vija horizontale nënkupton se duhet të përfshihen aktorët që e kanë mandatin për të mbikëqyrur performancën e in-

stitucioneve të sigurisë siç është parlamenti, agjencitë e pavarura, shoqëria civile dhe akademia (Winkler, 2002).

Një sqarim i tërësishëm i sektorit të sigurisë, megjithatë, përfaqëson vetëm një dimension të RSS-së. Koncepti nënvizon një gamë të gjerë elementesh që janë vendimtare për zhvillimin e RSS-së. Për të theksuar këtë, ja vlen të merret parasysh përkufizimin e ofruar nga Timothy Edmunds. Sipas Edmunds, janë pesë elemente thelbësore në RSS: demokratizimi, qeverisja e mirë, zhvillimi ekonomik, profesionalizimi dhe parandalimi i konfliktit (Edmunds, 2002, f. 11). Së pari, RSS shihet në kontekstin e demokratizimit të përgjithshëm të shoqërisë si pjesë e procesit të post-konfliktit dhe kalimit nga sistemi autoritar/komunist në sistemin demokratik dhe neo-liberal. Ky dimension vlerëson reformën e “tërë qeverisë”, në të cilën sektori i sigurisë e përbën vetëm një pjesë të reformës më të madhe të sektorit publik. Kjo do të thotë të kuptuarit gjithëpërfshirës të RSS-së, përtej përfshirjes së qeverisë. Së dyti, ai tregon se RSS duhet të përfshijë parimet e qeverisjes së mirë që synojnë të sigurojnë një sektor publik transparent dhe llogaridhënës i cili është përgjegjës para qytetarëve. Sektori i sigurisë nuk bën përjashtim në përqafimin e këtyre kriterëve të qeverisjes së mirë (Klopfer, Cantwell, Hadžić, & Stojanović, 2012), megjithëse është sektor i mandatuar që të përdor mjetet detyruese dhe të mbajë informacione të klasifikuara. Së treti, RSS është e lidhur me zhvillimin ekonomik, e me këtë, me potencialin e përgjithshëm të një vendi të caktuar për të reformuar sektorin e vet të sigurisë. Sektori duhet të jetë i qëndrueshëm paralelisht me resurset financiare dhe ekonomike të një vendi, në të cilin investimet në sektorin e sigurisë nuk do të rrezikojnë mirëqenien dhe funksionimin e sektorëve të tjerë të rëndësishëm (OECD, 2008). Së katërti, procesi i RSS-së, në kuptimin më të ngushtë, synon të bëjë modernizimin e institucioneve të sigurisë në përputhje me sfidat e reja të sigurisë, ku ato do të jenë në gjendje të maksimizojnë resurset e tyre në adresimin e një game të gjerë të sfidave të sigurisë që shkojnë shumë përtej kërcënimeve klasike ushtarake (Buzan, Waever dhe De Wilde, 1997). Së pesti, RSS është një atribut për parandalimin e konfliktit në vendet ose territoret pas-konfliktit. Në fakt, thelbi i RSS-së në radhë të parë është në sigurimin e qetësisë dhe sigurisë së individëve (Bendix dhe Stanley, 2008) dhe paqësimin e vendeve post-konfliktuale (Law, 2006), që d.m.th., në rastin e Evropës Juglindore, është arrit-

ur përmes bashkëpunimit rajonal të sigurisë në format të komunitetit për siguri (Prezelj, 2013). Duke përmirësuar ofrimin e shërbimeve të sigurisë për shoqërinë, sektori i reformuar i sigurisë i shërben “një mjedisi pozitiv dhe të përshtatshëm për proceset dhe aktivitetet zhvillimore” (Schnabel dhe Farr, 2012) në të cilin ajo mund të përdoret si një aset, e jo si pengesë, për paqen dhe sigurinë (Schnabel dhe Born, 2011).

Në fakt, RSS avokon që institucionet e sigurisë në radhë të parë tu shërbejnë individëve në shoqëri, e pastaj shtetit. Qëllimi kryesor i RSS-së është liria nga frika, prandaj marrja parasysh e sigurisë individuale është qëllimi parësor i këtij koncepti. Siguria e individëve, përmbi të gjitha, shënon një korrelacion qëllimor ndërmjet konceptit të RSS-së dhe konceptit të sigurisë njerëzore, i cili fillimisht ka rrjedh nga diskursi i politikave të organizatave ndërkombëtare (UNDP, 1994). Ky ndryshim ishte në përputhje me natyrën e re të sfidave të sigurisë në të cilën rreziqet dhe kërcënimet janë bërë gjithnjë e më komplekse (Mitrevska, Grizold, Buckovski dhe Wanis, 2009). Si rezultat, siguria njerëzore synon të sjell interesin dhe sigurinë e individit para shtetit; e me këtë, të sfidojë konceptin e ngushtë të sigurisë kombëtare i cili në radhë të parë synon t’i shërbejë sigurisë së shtetit (UNDP, 1994). Ngjashëm me sigurinë njerëzore, RSS synon të ndikojë në dinamikën sociale, në të cilën respektohen normat dhe vlerat universale. Në të vërtetë, një proces i RSS-së pa vizion të qartë për ruajtjen e sigurisë së individëve mund të konsiderohet vetëm si investim simbolik, dhe siç kanë theksuar Oosterveld dhe Galand “gjykatat do të mbesin vetëm objekte, gjyqtarët do të mbesin burokratë dhe kushtetutat vetëm copëza letre” (Oosterveld dhe Galand, 2012, f. 194). Kjo mund të përfundojë kështu në rast se RSS zhvillohet vetëm nga burokratët e bashkësisë ndërkombëtare të cilët kryesisht kanë shqetësime teknike (Jackson, 2011). Kjo në mënyrë të veçantë e sjell në perspektivë dilemën se kush është pronar dhe kush e udhëheq procesin e RSS-së, të cilës duhet t’i kushtohet vëmendje e veçantë.

Krahas dikotomisë RSS—siguri njerëzore, ka një korrelacion të fortë ndërmjet RSS-së dhe sigurisë së komunitetit. Synimi i RSS-së që të vë në shënjestër individët si shqetësimi kryesor për sigurinë ndërlidhet ngushtë me qasjen e bazuar në komunitet, sepse pritet që të mer-

ren parasysh nevojat dhe shqetësimet e tyre. Kjo mund të sigurohet përmes pjesëmarrjes dhe konsultimit të komunitetit që do të sjell më shumë sukses në procesin e RSS-së. Sipas praktikave nga të cilat buron siguria e komunitetit, “siguria e komunitetit nënkupton parandalimin, zvogëlimin dhe përmbajtjen e faktorëve socialë, mjedisorë ose frikësues të cilët prekin të drejtën e njerëzve për të jetuar pa frikë nga krimi dhe që ndikojnë në cilësinë e jetës së tyre” (Këshilli, 2014). Në të vërtetë, një tipar i përbashkët i nismave të suksesshme të RSS-së është inkurajimi i sigurisë me bazë në komunitet, e cila është e lidhur ngushtë me pronësinë lokale. Përveç kontributit të studiuesve, harmonia ndërmjet pronësisë lokale dhe sigurisë në bashkësi është përshkruar në qarqet e politikave, përfshirë në OECD, e cila ka deklaruar se “vlerat thelbësore të RSS-së duhet të përqendrohen tek njerëzit, të jenë në pronësi lokale dhe të bazohen në normat demokratike dhe parimet e të drejtave të njeriut të pranuar ndërkombëtarisht dhe në sundimin e ligjit” (OECD, 2006). Shqetësimet e sigurisë në nivel komuniteti dallojnë nga nevojat e shteteve kombëtare dhe të aktorëve të jashtëm. Është me rëndësi jetike që RSS të marrë parasysh ato nevoja dhe shqetësime (Caparini, 2010).

RSS DHE PRONËSIA LOKALE: SI PËRPUTHEN KËTO DY KONCEPTE?

Këndi kryesor i ndërmarrjes së RSS-së ka të bëjë me dilemën se kush e udhëheq dhe e ka në pronësi procesin. Me fjalë të tjera, sfidat kryesore lidhur me kontributin e RSS-së deri më sot kanë të bëjnë me argumentet që ndërlidhen me shkallën në të cilën koncepti i RSS-së e respekton pronësinë lokale. Shkalla në të cilën miratohet dhe zhvillohet pronësia lokale është vendimtare derisa në të njëjtën kohë duhet të përkujtohet se koncepti ka rrjedh si rezultat i procesit të RSS-së. Sa për të rikujtuar, sektori i sigurisë nënkuptonte një rol gjithëpërfshirës të jashtëm në reformën/zhvillimin e sektorit të sigurisë ndërsa kuptimi i saj është përhapur në sektorët e tjerët të ndryshëm.

Vërtetë, ndërmarrja e RSS-së sfidohet në mënyrën se si ajo shërbehet, menaxhohet dhe kontrollon nga aktorët e jashtëm, në shumicën e mjediseve pas konfliktit ose post-autoritare që kanë pasur një RSS të drejtuar nga jashtë. Është e qartë se pasojat janë të pranishme për shkak të qasjes ndaj RSS-së “nga lart-poshtë”, ku arkitektura e saj është plan-

ifikuar dhe zbatuar nga “të jashtit”. Shqetësim i menjëhershëm është tendenca e bashkësisë ndërkombëtare, siç thekson Donais, “që të bëj institucionet vendore të sigurisë të duken më shumë si institucione të tyre të sigurisë” (Donais, 2008, f. 7). Kjo nënkupton qasje paternaliste të aktorëve të jashtëm, në të cilën nuk respektohet konteksti. Donais e përforcoi këtë argument duke sugjeruar se RSS pjesërisht paraqet “inxhinieri shoqërore në të cilin bashkësia ndërkombëtare i mëson homologët lokalë se si të ndërtojnë dhe menaxhojnë sektorin e sigurisë sipas stilit perëndimor” (Donais, 2008, f. 7).

Ky argument ndërlidhet me kontributin e teoricienëve të shtetndërtimit, në të cilin ata kritikojnë qasjen e përgjithshme të bashkësisë ndërkombëtare në imponimin e modeleve perëndimore në një shtet në krijim e sipër (Bain, 2006; Mac Ginty, 2010; Paris, 2002; Richmond, 2009b). Pjesa më komplekse e kësaj ka të bëjë me imponimin ndërkombëtar ndaj sektorit të sigurisë, i cili mund të jetë i qëllimshëm ose i paqëllimshëm. Një rast i qëllimshëm i referohet praktikës së shtetndërtimit ku një vend i caktuar donator ose bashkësia ndërkombëtare dëshiron të ketë kontrollin mbi fuqinë detyruese të një shteti duke qenë plotësisht e vetëdijshme se këto veprime janë kundër interesit të bashkësive vendase dhe shtetit. Në anën tjetër, RSS duket të jetë e paqëllimshme nga disa aktorë donatorë të cilët prapëseprapë i “transplantojnë” praktikat e tyre në një vend tjetër pa pasur ndonjë qëllim që të dëmtojnë interesat e vendorëve, qoftë përfaqësuesve të qeverisë ose shoqërisë civile.

Si rezultat, RSS e shtyrë nga jashtë sfidohet më tej nga kundërthëniet mbi interpretimin e asaj që e përbën “zërin” e vendorëve. Brzoska ka theksuar se “RSS do të zgjas vetëm nëse bazohet në rritjen e ndjenjës së kontrollit nga vendimmarrësit lokalë dhe shoqëria civile ose grupet shoqërore” (Brzoska, 2006, f. 11). Nathan e përforcon këtë problem përmes rekomandimit për qeveritë donatore se ata nuk duhet të ndërmarrin RSS-në në vendet partnere, por në vend të kësaj duhet të fokusohen në mbështetjen e aktorëve lokalë që duan të ndërmarrin RSS-në (Nathan, 2008). Nathan me të drejtë nënvizon rastin e suksesshëm të Afrikës së Jugut gjatë viteve 1990-ta, që dëshmon përfshirjen efektive të vendorëve në procesin e RSS-së në periudhën pas aparteidit (Nathan, 2007). Ai pohon se RSS e shtyrë nga jashtë pasqyron një përzi-

erje të arrogancës, ankthit, dhe superioritetit në të cilin shihet qartë mungesa e rrespektit për vendorët (Nathan, 2008).

Dilema e Nathan-it e përshkruan edhe tendencën e agjendës ndërkombëtare që të mbizotërojë për shkak të aplikimit të trysnisë nga ta. Derisa kjo agjendë i paraprinë interesave të aktorëve, është thelbësore që të harmonizohen sa më shumë që të jetë e mundur interesat e “vendorëve” dhe “ndërkombëtarëve” (Bain, 2006; Nathan, 2008). Në të kundërtën, ka pak gjasa që RSS të jetë e suksesshme nëse nuk e merr parasysh ambientin historik, politik dhe shoqëror, i cili kërkon strategji të fokusuar në nivelin lokal dhe të jetë specifike për kontekstin (Edmunds, 2002). Disa madje kanë shkuar aq larg sa të paraqesin një proces të RSS-së të shtyrë nga ndërkombëtarët si një vegël “neo-koloniale” (Richmond, 2012, f. 355), duke trajtuar “natyrën haptazi të jashtme dhe detyruesë” të bashkësisë ndërkombëtare (Chandler, 2006, f. 29).

Dilemat e qasjes së bashkësisë ndërkombëtare ndaj RSS-së mund të zvogëlohen vetëm përmes një strategjie të qartë ku vendorët mund të udhëheqin procesin. Në një numër vendesh të post-konfliktit është dëshmuar se një proces i RSS-së që synon të rregullojë gjërat me shpejtësi dhe të aplikojë parimet kryesore të RSS-së ka gjasa të dështojë (Paris dhe Sisk, 2009). Po ashtu është argumentuar se kapaciteti ndërkombëtar nuk mund të zëvendësojë kapacitetet lokale përgjithmonë (Donis, 2012b). Si rezultat, ndërtimi i kapaciteteve kombëtare për të menaxhuar dhe mbikëqyrur sigurinë paraqet një hap të madh sa i përket sigurimit të pronësisë lokale. Qëndrueshmëria e institucioneve lokale mund të sigurohet përmes varësisë më të vogël nga jashtë. Në fakt, dilema e varësisë është mirë e njohur në ambientet e pas konfliktit. Sa më gjatë që të qëndrojnë bashkësia ndërkombëtare, aq më të mëdha janë gjasat që të krijohet varësia e institucioneve lokale (Wilén & Chapaux, 2011). Këtu mund të bëhet një lidhje ndërmjet dilemës së varësisë në procesin e RSS-së dhe mungesës së një strategjie dalëse nga bashkësia ndërkombëtare.

RSS DHE ZHVILLIMI

Debati mbi RSS-në kryesisht ka përfshirë rastet në të cilat sektori ekzistues i sigurisë – si në kontekst të post-konfliktit ashtu edhe në atë post-autoritar - i nënshtrohet procesit të reformës. Në vendet e

post-konfliktit, duhet pasur parasysh se institucionet e sigurisë - siç janë forcat e armatosura - kanë histori të ndryshme të zhvillimit. Zakonisht, palët e përfshira në konflikt kanë kaluar nëpër një cikël tranzicioni në atë që njihet si procesi i Çmobilizimit, Çarmatimit dhe Ri-integrimit (ÇÇR). ÇÇR synon të çmobilizojë ish luftëtarët, duke krijuar hapësirë për integrimin e ish luftëtarëve në jetën civile (Dudouet, Giessmann dhe Planta, 2012). Përfundimi i procesit të ÇÇR-së do të krijojë kushte të përshtatshme për të filluar procesin e reformës (Bryden, 2012). Në vendet post-autoritare, ndërmarrja e RSS-së ka synuar të reformojë forcat e armatosura duke i larguar nga mentaliteti i mëhershëm dhe nga sistemi qoftë me prerogativa komuniste ose të natyrës autokratike. Këtu, RSS ka më shumë gjasa të “inicohet nga regjimi” ndërsa, duke e krahasuar RSS-në në vendet pas konfliktit, vet shteti ka “më shumë kapacitet si për të parashikuar ashtu edhe për të menaxhuar proceset afatgjate të reformës” (Donais, 2009, f. 124).

Janë disa raste në të cilat interpretimi i ngushtë i RSS-së nuk i paraqet rrethanat në terren. Prandaj me të drejtë sugjerohet që RSS të dallohet si funksion dhe kuptim në vendet në zhvillim, në tranzicion dhe ato të zhvilluara (Ligji, 2006). Veçanërisht, kjo pyetje shtrohet për vendet në të cilat nuk ka pasur institucionet të sigurisë, ose ku sektori i përgjithshëm i sigurisë është dashur të ndërtohet nga zeroja. Sidoqoftë, edhe prerogativat e pas konfliktit edhe ato post-autoritare janë të pranishme. Si do të definoheshin këto rrethana? Debati ekzistues zakonisht i është referuar RSS-së kur i referohej vendeve që nuk kanë pasur institucione të sigurisë ose që për ndonjë arsye të caktuar, këto vende duket se qëllimisht i kanë ikur ndonjë ndërlidhjeje institucionale me të kaluarën - qoftë ajo e konfliktit ose autoritare. Këto raste më shumë nënkuptojnë kontekste formuese. Nga këndvështrimi konceptual, rasti i studiuar në këtë libër - rasti i Kosovës - ka prerogativa formuese. Ai tregon se, për shembull, nuk kishte lidhje të drejtpërdrejte ndërmjet ish institucioneve socialiste të sigurisë së ish-Jugosllavisë dhe përpjekjeve pas konfliktit për ndërtimin e institucioneve (Qehaja dhe Vrajolli, 2011). Këto raste me të drejtë mund të përkufizohen si *zhvillim i sektorit të sigurisë* që nënkupton se sektori i sigurisë fillimisht është zhvilluar (nga zeroja) para se të reformohej. Ka pasur referenca të rralla në këto kontekste, derisa *zhvillimi i sektorit të sigurisë* nuk është përmendur në mënyrë eksplicite në kontributin ekzistues të RSS-së. Referenca më e përafërt

me *zhvillimin e sektorit të sigurisë* është bërë nga Bryden dhe Hanggi, sipas të cilëve *zhvillimi i sektorit të sigurisë* “nënkuptonte trashëgiminë e konfliktit të armatosur, përfshirë shpërbërjen e formacioneve ushtarake dhe integrimin në strukturat e reja të sigurisë dhe/ose në jetën civile, përveç pastrimit të minave, bombave dhe raketave të pushpërthyerë” (Bryden dhe Hanggi, 2004, f. 14). Megjithatë, kontributi nuk mundi të zërthente mjaftueshëm RSS-në në mjediset ku e tërë infrastruktura zhvillohet nga niveli bazik. Ky zhvillim po ashtu përfshin burimet njerëzore dhe infrastrukturën. Si rezultat, përkufizimi i duhur i *zhvillimit të sektorit të sigurisë* do të mund të nxirrej nga mësimet e Kosovës dhe të silltet në diskutimin akademik (Qehaja dhe Vrajolli, 2012).

Në fakt, ka një numër argumentesh që e mbështesin përkufizimin e zhvillimit të sektorit të sigurisë që nuk largohen nga parimet kryesore të RSS-së. Dallimi parësor ndërmjet RSS-së dhe zhvillimit të sektorit të sigurisë ka të bëjë me mjediset specifike dhe me theksin që vihet në zhvillim e jo në dimensionin e reformës. Në kuptimin më të gjerë, ky përkufizim vërtet i përfshin karakteristikat e asaj që disa autorë e paraqesin si - “zhvillimizim i sigurisë” (Schnabel dhe Farr, 2012). Në të vërtetë, përputhja ndërmjet sigurisë dhe zhvillimit rrjedh kryesisht nga akademikët evropianë, të cilët pandehnin se ka një ndërlidhje ndërmjet sigurisë dhe zhvillimit (Fitz-Gerald, 2012). Si rezultat, duhet të bëhet ndarja në mes të rindërtimit të sektorit të sigurisë (Brzoska, 2006) dhe zhvillimit të sektorit të sigurisë. Zhvillimizimi i sektorit të sigurisë është shumë me kompleks, dhe përfshin edhe prerogativa të tjerë - përtej demokratizimit. Edmunds me të drejtë thekson se reformës i duhen “reformues” (Edmunds, 2002, f. 11). Në anën tjetër, zhvillimi kërkon “zhvillues”. Në mënyrë ilustruese, kjo mund të sqarohet përmes harmonisë së “vesë dhe pulës” (Brzoska, 2006, f. 5).

Për më tepër, *zhvillimi i sektorit të sigurisë* kërkon nevojën për të mishëruar parimet e RSS-së që në fillim, çka në parim, pasqyron një detyrë më të lehtë. Ndonëse problemi duket të jetë me përmasën në të cilën cikli i zhvillimit e njeh kontekstin lokal. Është kusht që ndërveprimi ndërmjet gjendjes së sigurisë dhe rezultateve zhvillimore, dhe ndërmjet performancës së shtyrë nga jashtë dhe kulturës lokale, duhet të përshtatet me kujdes (Schnabel, 2012). Procesi i zhvillimit të sektorit të sigurisë e pasqyron dilemën e Caplan-it për një strategji

dalëse, e cila kritikon aftësinë e proceseve të shtetndërtimit që përdoren me qëllim të mbajtjes së bashkësisë ndërkombëtare dhe ndikimit të saj sa më gjatë që të jetë e mundur (Caplan, 2012).

Zhvillimi i institucioneve të sigurisë nga zeroja duhet të pasqyrojë me kujdes interesin dhe përfitimet e popullatës lokale dhe të qeverisë. Është me rëndësi jetike që krijimi i institucioneve të sigurisë të pasqyrojë shprehjen e vullnetit kombëtar, dhe të mos jetë diçka e imponuar nga dikush nga jashtë, në të cilën sektori i sigurisë do të jetë drejtohet nga kërkesa në kontekstin e mjedisit lokal socio-ekonomik (Brzoska, 2006). Bashkësia ndërkombëtare përpiket të bind vendorët për “atë që është e mirë për ta” (Mobekk, 2010, f. 231) nuk është zgjidhje e qëndrueshme. Qëndrueshmëria mund të arrihet më mirë nëse ka garanci për qasjen e bazuar në nevoja e cila iniciohet nga vendorët (Oosterveld dhe Galand, 2012).

Megjithatë, nyja e sigurisë me zhvillim ka qenë objekt i kritikës nga disa autorë. Everett kritikon se tendenca e bashkësisë ndërkombëtare është që të fokusohet në diskursin zhvillimor jo vetëm pse ato fshehin marrëdhëniet e fuqive globale, por edhe sepse studimet e tilla janë të prira të portretizojnë vendorët si të pafuqishëm (Everett, 1997). Ajo argumenton se fokusi gjithnjë e më i madh në bashkësinë ndërkombëtare i ka larguar analizat nga vendorët dhe nga roli i tyre në projektet zhvillimore, pikërisht për shkak se diskurset zyrtare i portretizojnë vendorët si të pazhvilluar dhe të pa zë. Në fakt, argumenton ajo, studimet e tilla janë të prira të nënvlerësojnë kapacitetet e vendorëve, dhe se si rezistenca e tyre ndaj projekteve ndërkombëtare mund të formësojë rezultatin e një aktiviteti të caktuar. Kështu, përmes analizës së zhvillimit si diskurs që u imponohet vendorëve, “kritikët kanë paraqitur pikëpamjen e njëanshme të fuqisë dhe hegjemonisë” (Everett, 1997, f. 140) dhe kanë nënvlerësuar veprimin e aktorëve lokalë. Ndonëse veprimi lokal, dhe me këtë autoriteti lokal, është padyshim një aspekt i rëndësishëm i projekteve zhvillimore, situatat e ndryshme siç janë ato të shteteve pas konfliktit, mund të mos lënë aq shumë hapësirë për zërin e vendorëve. Përveç kësaj, Everett tregon se marrëdhënia ndërmjet “ndërkombëtarëve” dhe “vendorëve” mund të zërthehet më tutje për të analizuar hierarkitë brenda këtyre dy kategorive.

KAPITULLI II

KONTEKSTI I ZHVILLIMIT TË SEKTORIT TË SIGURISË NË KOSOVË

Ky kapitull paraqet një pasqyrë të përgjithshme të zhvillimit të sektorit të sigurisë në Kosovë. Ai shërben si pikë hyrëse në komponentin empirik të këtij libri duke e bërë tranzicionin nga analiza teorike në atë empirike. Analiza e kontekstit i mbështet përpjekjet hulumtuese në zbërthimin e tipareve kyçe historike sa i përket zhvillimit të sektorit të sigurisë, në përgjithësi, dhe komunikimit brenda nyjës ndërkombëtarë-vendorë, në veçanti. Për më tepër, ky kapitull u kushton rëndësi aspekteve kryesore të librit duke paraqitur bazat kyçe mbështetëse të sigurisë, politike dhe shoqërore. Megjithatë, për të shqyrtuar në mënyrë sistematike proceset kyçe, ky libër do të aplikojë një kornizë periodike në të cilën sqarohen transformimet e përgjithshme socio-politike dhe të sigurisë.

Cikli periodik do të ndahet në dy pjesë: periudha prej vitit 1999 deri në 2004 dhe periudha prej 2004 deri në 2008. Në këtë mënyrë, analiza e kontekstit shërben si prapaskenë e përpjekjes hulumtuese për shqyrtimin e nyjës ndërkombëtarë-vendorë në një fazë të mëvonshme. Konteksti do të shtjellojë edhe periudhën para vitit 1999 duke pasur parasysh se fokusi im është në vështrimin e marrëdhënies ndërmjet bashkësisë ndërkombëtare dhe vendorëve në mjediset pas konfliktit dhe pas pavarësisë. Megjithatë, në këtë kapitull unë synoj të paraqes elementet kryesore historike vetëm si informata të përgjithshme hyrëse për audiencat të cilave u mungojnë informacionet themelore të këtij konteksti.⁴

4 Sidoqoftë për informacione të tjera rreth kontekstit të Kosovës që nga periudhat parahistorike, ju rekomandoj fuqishëm librin e Noel Malcom (1999) "Kosova - një histori e shkurtër". New York: Harper Perennial.

KARAKTERISTIKAT KYÇE POLITIKE DHE TË SIGURISË

Në fund të Luftës së Ftohtë, në vendet e Evropës Lindore ndodhën ndryshime të mëdha politike dhe shoqërore. Në Jugosllavi, tranzicioni shkatërrues nga sistemi socialist dhe autoritar në sistem politik pluralist u manifestua me luftë dhe konflikt ndëretnik (Dyker dhe Vejvoda, 1996; Jovic, 2008; Mazower, 2000). Kjo e bëri tranzicionin shumë më të dhimbshëm se sa në pjesët e tjera të ish bllokut socialist. Si rezultat, qeveria demokratike u bë subjekt i transformimit të pas konfliktit, përveç tranzicioneve post-autoritare dhe post-socialiste që ndodhën në pjesët e tjera të bllokut.

Shpërbërja e dhunshme e Jugosllavisë filloi dhe përfundoi me Kosovën. Masat represive të udhëhequra nga kryetari i Republikës Federative të Jugosllavisë (së atëhershme), Slobodan Millosheviq, ndaj popullsisë shumicë shqiptare në Kosovë nën flamurin etno-nacionalist krijoi një precedent të ri në këtë pjesë të Evropës. Pika e kthesës ishte suprimimi i autonomisë së Kosovës në vitin 1989. Autonomia e Kosovës në kuadër të Jugosllavisë filloi të zbatohet në fund të viteve 1960-ta dhe u konsolidua me të drejtat pothuaj të barabarta të Kosovës (dhe Vojvodinës) me gjashtë republikat e Jugosllavisë në Kushtetutën Jugosllave të vitit 1974 (shih Rastin e GJND-së, 2009a, 2009b). Si pasojë, periudha prej vitit 1989 deri në 1998 u shënuar me një numër të madh të shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut, represionit, dëbimit dhe spastrimit etnik sistematik. Në këtë periudhë, nëpunësit shtetërorë të komunitetit shqiptar u përjashtuan në mënyrë sistematike nga vendet e tyre të punës; të gjitha mediat në gjuhën shqipe u ndaluan; kishte represion të përditshëm ndaj shumicës shqiptare në të gjitha format e dhunës dhe në këtë periudhë organizatat ndërkombëtare regjistruan një numër të madh të lëndimeve dhe vrasjeve (Pllana, 2013). Në udhëheqjen e Ibrahim Rugovës, lëvizja paqësore shqiptare ia doli të mbaj të gjallë një sistem paralel në arsim dhe shëndetësi pa kurrfarë synimi që t'i kundërvihet në mënyrë të dhunshme regjimit të Millosheviqit. Megjithatë, një dinamikë e re u krijua me përfundimin zyrtar të luftës në Bosnjë dhe Kroaci pas Marrëveshjes Paqësore të Dejtonit në vitin 1995 - marrëveshje e cila në parim solli paqen në Kroaci dhe Bosnjë, pa e marrë parasysh fare shtimin e represionit dhe viktimat në Kosovë. Si rezultat, ndjenja e shqiptarëve për rezistencë

paqësore filloi gradualisht të transformohet në ndjenjë të konfrontimit të dhunshëm, me krijimin e forcave kryesisht guerile, nën emrin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) (Pettifer, 2014). Lufta në mes të UÇK-së dhe forcave ushtarake, paraushtarake dhe policore jugosllave, në njërën anë, dhe viktimat civile në anën tjetër, alarmuan bashkësinë ndërkombëtare e cila vazhdimisht bënte thirrje për zgjidhje paqësore.

Në fillim të vitit 1999, bashkësia ndërkombëtare organizoi negociata ndërmjet përfaqësuesve të shqiptarëve të Kosovës dhe përfaqësuesve të qeverisë së Serbisë, të cilat u mbajtën në Rambuje të Francës. Qëllimi i marrëveshjes ishte që t'i jepte fund përhapjes së konfliktit, duke vepruar në bazë të mësimave të nxjerra nga BeH ku bashkësia ndërkombëtare ishte e fragmentuar dhe reagoi shumë dobët dhe shumë vonë. Për më tepër, marrëveshja ishte e hartuar në aso mënyre që do t'i jepte një autonomi substanciale Kosovës, në të cilën do të ruhej statusi juridik i territorit, do të ishte i pranishëm një mision paqeruajtës ndërkombëtar dhe do të mundësohej mbajtja e një referendumi për ndryshimin potencial të statusit në 3 vitet e ardhshme (Rambuje, 1999).

Kjo marrëveshje, e cila nuk i kënaqte krejtësisht të dy palët, u nënshkrua vetëm nga përfaqësuesit shqiptarë të Kosovës, ndërsa përfaqësuesit serbë i refuzuan kushtet e ofruara. Për shkak të vazhimit të operacioneve ushtarake në Kosovë dhe spastrimit etnik në terren, bashkësia ndërkombëtare u bashkua nën një zë të vetëm i cili çoi në vendimin për fillimin e sulmeve ajrore kundër Republikës Federative të Jugosllavisë. Si pasojë, ndodhën sulmet ajrore të NATO-s në një operacion 78 ditor, i cili filloi me 24 mars 1999 (NATO, 1999). Pavarësisht debeteve në disa qarqe politike dhe akademike mbi ligjshmërinë e vendimit për fillimin e sulmeve ajrore - për shkak të mosmiratimit nga anëtarët e KS të OKB-së (Simma, 1999) - ky vendim është konsideruar si pikë kthese në rendin botëror në të cilin shkeljet masive të të drejtave të njeriut nuk duhet më të konsiderohen si çështje e brendshme e një shteti sovran (Cassese, 1999). Sulmet ajrore shpejt u arsyetuan nën paradigmen e përgjegjësisë për të mbrojtur (ICISS, 2001).

Fundi i luftës u shënua me dorëzimin e forcave serbe të cilin e nënshkruan përmes marrëveshjes tekniko-ushtarake në Kumanovë, të

njohur si “Marrëveshja e Kumanovës”. Kjo Marrëveshje u nënshkrua ndërmjet NATO-s dhe Republikës Federative të Jugosllavisë. Ajo parashikonte tërheqjen e armatës, policisë dhe mekanizmave të tjerë jugosllav të sigurisë nga territori i Kosovës (NATO, 1999). Kjo marrëveshje po ashtu shërbeu si bazë për përpjekjet diplomatike brenda OKB-së që të nxirret një rezolutë të re në KS të OKB-së - Rezoluta 1244. Suksesi primar i rezolutës ishte që t’i jap fund konfliktit dhe ciklit të dhunshëm të shpërbërjes së Jugosllavisë. Rezoluta në mënyrë të qartë bënte thirrje për tërheqje të menjëhershme të forcave ushtarake dhe paraushtarake të regjimit të Millosheviqit si dhe çmilitarizimin e lëvizjes ushtarake të shqiptarëve të njohur si Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK) (OKB, 1999). Këta hapa themelorë u zbatuan me shpejtësi në muajt e parë të periudhës pas konfliktit të cilët me sukses filluan kultivimin e paqes dhe stabilitetit në këtë pjesë të Ballkanit.

MUNGESA E PRONËSISË LOKALE DHE AUTORITETI I KOMPETENCAVE TË REZERVUARA (1999-2004)

Përveç qëllimit parësor për arritjen e paqes dhe sigurisë, Rezoluta e KS të OKB-së 1244 shërbeu edhe si bazë për vendosjen e misioneve ndërkombëtare civile dhe ushtarake në Kosovë nën ombrellën e OKB-së (1999). Ajo po ashtu parashikonte vendosjen e një pranije ndërkombëtare ushtarake nën ombrellën e NATO-s. Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) dhe forca e NATO-s në Kosovë (KFOR) kishin detyrë parësore të zbatojnë rendin dhe ligjin në kontekstin e brishtë pas konfliktit në Kosovë. Rezoluta e bëri të qartë se autoriteti primar i qeverisjes mbi komponentët civilë dhe ushtarakë të pranisë ndërkombëtare ishte Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP). Po ashtu, PSSP ishte autoriteti kryesor për të siguruar zbatimin e rezolutës së OKB-së sa i përket punëve të rindërtimit dhe ndërtimit të institucioneve.

PSSP mbajti kompetenca të pakushtëzuara të qeverisjes ndaj institucioneve të reja të krijuara, në përgjithësi, dhe mbi institucionet e sigurisë, në veçanti. Terminologjia e aplikuar nga PSSP ishte “kompetencat e rezervuara”: kjo nënkuptonte një dimension të panegociueshëm me përfaqësuesit vendorë. Prandaj, OKB-së i ishte dhënë një mandat shumë kompleks mbi qeverisjen e territorit. Strukturat e

saj ndaheshin në katër shtylla: Shtylla I: Ndihma humanitare, e udhëhequr nga Zyra e Komisarit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (Kjo shtyllë në vitin 2000 u riemërtua Shtylla për Drejtësi dhe Siguri); Shtylla II: Administrata Civile, nën Kombet e Bashkuara; Shtylla III: Demokratizimi dhe Ndërtimi i Institucioneve, e udhëhequr nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), dhe Shtylla IV: Rindërtimi dhe Zhvillimi Ekonomik, e drejtuar nga Bashkimi Evropian (BE) (UNMIK).

Prej vitit 2000 Shtylla I e UNMIK-ut ka pasur mandatin që të forcojë kontrollin dhe qeverisjen e institucioneve të reja lokale të sigurisë. Në të vërtetë, përqendrimi i kompetencave në praninë ndërkombëtare e ka bërë Kosovën një rast unik në kuadër të administrimit ndërkombëtar të territoreve. Bashkësisë ndërkombëtare i ishte dhënë mandati që të ketë kompetenca ekskluzive në qeverisjen dhe kontrollin e institucioneve lokale të sigurisë pa i konsultuar përfaqësuesit lokalë. Në fakt, nëse shikohet marrëveshja, procesi i vendosjes për Rezolutën 1244 nuk ishte përcjell me asnjë konsultim me faktorët lokalë - duke përjashtuar përfaqësuesit e komunitetit shumicë në Kosovë. Po ashtu, Rezoluta 1244 e OKB-së i referohet marrëveshjes ushtarake teknike të arritur në Kumanovë e cila po ashtu nuk kishte përfshirë mekanizmin e konsultimit me përfaqësuesit e shumicës shqiptare. Si pasojë, UNMIK-u u vendos pas marrëveshjes diplomatike ndërmjet NATO-s, Rusisë dhe ish-Jugosllavisë, e cila përjashtoi pjesëmarrjen e faktorit vendas.

Pas luftës, kapacitetet politike specifike dhe “kompetencat e rezervuara” për bashkësinë ndërkombëtare e pasqyronin procesin unik të ndërtimit të institucioneve në sektorin e sigurisë. Kjo çoi në themelimin e të gjitha institucioneve të sigurisë nga zeroja (Qehaja dhe Vrajolli, 2011). Prandaj, krahasuar me njësitë e tjera të federatës jugosllave, rasti i Kosovës bënte përjashtim në atë se nuk kishte lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet ish-institucioneve socialiste të sigurisë dhe përpjekjeve pas konfliktit për ndërtimin e institucioneve. Për shembull, policia, strukturat e mbrojtjes dhe strukturat e sigurisë që të gjitha u formuan të reja në periudhën menjëherë pas konfliktit. Po ashtu, fakti se periudha nga 1989 deri në 1999 shënoi pastrimin e institucioneve lokale të sigurisë nga komuniteti shqiptar, vazhdimi koherent të strukturave

të sigurisë dhe praktikat institucionale nga periudha e paraluftës, të bartura në periudhën e pasluftës, është një kriter që nuk mund të mbështetet (M. Vrajolli, intervistë personale, 2 qershor 2014). Për më tepër, një argument i pashmangshëm lidhur me mungesën e memories institucionale është represioni i zbatuar nga institucionet ish-jugosllave nën përgjegjësinë dhe komandën e drejtpërdrejtë të regjimit të Millosheviqit.

Si rezultat, e vetmja ndërlidhje me luftën ose me periudhën socialiste gjendet ekskluzivisht tek personat që ju bashkuan institucioneve të reja të sigurisë por që kishin shërbyer ose në ish-forcat jugosllave ose në UÇK. Në të vërtetë, institucionet e reja nuk sjellin domosdoshmëri mentalitet të ri në kulturën organizative, dhe përkundër ndërlidhjes në mes të kulturës së mëparshme organizative dhe skenarit të pas konfliktit, kjo më shumë ishte në bazë individuale se sa sistematike. Sidoqoftë, të gjithë individët është dashur të vijojnë trajnimin bazik dhe të respektojnë metodologjinë e miratuar ndërkombëtarisht në mënyrë të barabartë, përkundër faktit se disave prej tyre u ishin dhënë grada më të larta ose në periudhën e socializmit ose gjatë periudhës së luftës (N. Ibishi, intervistë personale, 23 maj 2014).

Nëse kjo çështje analizohet në një perspektivë konceptuale, rasti i Kosovës ka më shumë kriterin e *zhvillimit të sektorit të sigurisë* se sa të RSS-së. Përderisa bazat e RSS-së mund të gjenden gjatë procesit të ndërtimit të institucioneve, megjithatë, ka pasur një lidhje të qartë ndërmjet komponentëve të zhvillimit dhe atyre të sigurisë. Si rezultat, *zhvillimi i sektorit të sigurisë* nënkupton një kontekst formues më shumë se sa kontekst të reformës në të cilën do të kërkohej një qasje tjetër. Sa për të përkujtuar mbështetjen konceptuale, procesi i zhvillimit kërkon “zhvillues” ashtu siç kërkon procesi i reformës “reformues” (Brzoska, 2006, f. 5; Edmunds, 2002, f. 11). Rrjedhimisht, *zhvillimi i sektorit të sigurisë* me një rol ekzekutiv të luajtur nga bashkësia ndërkombëtare nënkupton më shumë një ndikim në procesin e planifikimit se sa në kontekstin kur ndërmerret një proces i pastër i RSS-së. Ky argument ishte i vlefshëm për atë kohë procesi i përgjithshëm i planifikimit, menaxhimit dhe kontrollit zhvillohej nga prania ndërkombëtare.

Nëse kthehemi te konteksti i Kosovës, ka një numër institucioneesh të sigurisë që janë zhvilluar nga zeroja. Periudha e pasluftës u shënuar me themelimin e: Shërbimit Policor të Kosovës (SHPK) - të cilit i ishte dhënë mandati që të kryejë detyrat bazike në fushën e rendit dhe sigurisë publike – Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK) - të cilat u krijuan si rezultat i çmilitarizimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe kishin mandatin të ushtrojnë vetëm detyra të mbrojtjes civile, dhe strukturat e shërbimit të emergjencave civile të cilat u formuan veçanërisht në nivel të komunave. Megjithatë, nuk janë krijuar dy komponentë të sektorit të sigurisë (në perspektivë të ngushtë): mbrojtja dhe shërbimi i inteligjencës. Ato mbetën vetëm nën përgjegjësinë e PSSP-së. Në fakt, çdo përpjekje për zhvillimin e tyre nënkuptonte krijimin e institucioneve me mandat shtetëror, që potencialisht mund të kërkonte masa detyruese (R.Qehaja, 2004).

Rrjedhimisht, prej vitit 1999 deri me 2004 roli i aktorëve lokalë në sektorin e sigurisë ishte pothuaj i paimagjinueshëm, ku autoritetet e UNMIK-ut nuk ishin të gatshme që gradualisht të bartnin përgjegjësitë në këtë fushë. Nëse e huazojmë dilemën e Caplan mbi nevojën për të planifikuar si duhet “strategjinë dalëse” për misionet ndërkombëtare (Caplan, 2012, f. 4), qasja e UNMIK-ut gjatë 5 viteve të para duket se është rast që e pasqyron këtë. Për shembull, UNMIK-u hezitonte që të bart përgjegjësitë te vendorët për shkak të interpretimit të ngurtë të Rezolutës 1244 dhe autoritetit të bashkësisë ndërkombëtare. UNMIK-u kishte shprehur interesim që të mbaj *status quon* duke mos marr asnjë hap konkret në hartimin e një strategjie dalëse në sektorin e sigurisë.

Janë dhënë argumente të ndryshme kur analizohej ngurtësia e bartjes së përgjegjësisë tek autoritetet kosovare. Grupi i parë i kishte në shënjestër argumentet që kishin të bënin me politikën të cilët identifikonin statusin e pazgjidhur politik të Kosovës. Sipas këtyre argumenteve, Kosova ishte nën administrim ndërkombëtar, dhe kështu nuk mund të fillonte bartja e përgjegjësisë në një sektor me institucione që kishin kompetenca detyruese, dhe të krijohej shtylla e shtetit siç përkufizohet me konceptin tradicional (Westfalian) të shtetit. Këtu, argumentet përforcoheshin nga hezitimi i disa vendeve që shprehnin kundërshtimin ndaj shtetësisë së mundshme të Kosovës (F. Harris, intervistë

personale, 2 maj 2014). Grupi i dytë kishte më shumë parasysh marrëdhëniet shoqërore në njënë ndërkombëtarë-vendorë. Argumentet këtu kishin të bënin me hezitimin e bashkësisë ndërkombëtare që të bart përgjegjësitë te vendorët për shkak të mosbesimit (R. Qehaja, 2004; B. Selimi, intervistë personale, 20 tetor 2014; R. Marmullaku, intervistë personale, 17 korrik 2014). Ky argument thuhej se mbështetej duke iu referuar kontekstit politik, në të cilin dhënia e më shumë kompetencave kosovarëve mund të dëmtonte sigurinë dhe stabilitetin e rajonit të brishtë të Ballkanit Perëndimor (B. Selimi, intervistë personale, 20 tetor 2014). Grupi i tretë dominohej nga argumentet që lidheshin me RSS-në në të cilën mungesa e kapaciteteve të autoriteteve dhe popullsia lokale e shkaktonte dilemën mbi kohën kur duhet bartur përgjegjësitë. Këto argumente përputhen me konceptet e zhvillimit të cekura në literaturën mbi ndërtimin e institucioneve, të cilat tregojnë se qasjet nga poshtë - lart janë të parakohshme.

Në një numër vendesh të pas konfliktit, për shembull, ndërkombëtarët janë vendosur për të zëvendësuar administratat lokale për shkak se “vendorët nuk konsideroheshin se e përmbushnin detyrën e tyre në mënyrë adekuate” (Wilde, 2008, f. 18). Megjithatë, peshorja e përdorur për të gjykuar vendorët po ashtu është krijuar nga bashkësia ndërkombëtare, dhe, siç përcaktohet me të drejtë në nivelin konceptual, shpesh bazohet në perspektivën dhe standardet perëndimore. Në Timorin Lindor, për shembull, “arsyeja fillestare për administrimin e OKB-së nuk kishte të bënte asgjë me konfliktin; por kishte të bënte me pamundësinë e perceptuar të banorëve të Timorit Lindor që të qeverisin veten në periudhën afatshkurtër po të tërhiqej Indonezia” (Wilde, 2008, f. 18). Edhe rasti i Kosovës ishte i ngjashëm: edhe pse UNMIK-u u paraqit si përgjigje ndaj vakumi administrativ, qëllimi parësor i administratës së OKB-së ishte në fakt që të sigurojë ndryshimin e qeverisjes (Wilde, 2008). Si pasojë, edhe pse tërheqja e zyrtarëve serbë dhe jugosllavë krijojë nevojën për administratorë të rinj, tërheqja e tyre ishte pjesë e planit të krijuar për t’i hapur rrugën UNMIK-ut (Wilde, 2008). Kështu, nëse e zbërthejmë më tej analizën e Wilde dhe mbështetjen e saj konceptuale kur aplikohet një strategji dalëse, strategjia ndërkombëtare duket shumë më kalkuluese, duke vënë në radhë të parë interesat e tyre e jo ato të vendorëve. Si pasojë e kësaj, zyrtarët lokalë duket se kanë pak fuqi dhe mundësi veprimi,

veçanërisht në rastet si ai i Kosovës. Në të vërtetë, Kosova ishte subjekt i më shumë prerogativave specifike të një administrate të fuqishme ndërkombëtare nën flamurin e “kompetencave të rezervuara”. Fakti se kompetencat ishin përqendruar në një person – në PSSP-në - ekspozoi mënyrën në të cilën do të mund të bëhej mbikëqyrja dhe kontrolli demokratik i institucioneve të sigurisë. PSSP siguronte që organet qeveritare të Kosovës të cilat krijoheshin të mos kishin përgjegjësi ekzekutive ose mbikëqyrëse lidhur me sektorin e sigurisë dhe të drejtësisë për shkak të “kompetencave të rezervuara” të UNMIK-ut (Qehaja, 2004; N. Rashiti, intervistë personale, 5 qershor 2014). Po ashtu as legjislatura e parë e Kuvendit të Kosovës në vitin 2002 nuk krijoi asnjë komision mbikëqyrës ose nuk mbajti asnjë diskutim për sektorin e sigurisë për shkak të pengesës nga “kompetencat e rezervuara” të PSSP-së. Si rezultat, u bë evidente një kundërthënie e vërtetë në lidhjen mes sigurisë dhe zhvillimit meqë argumentet për zbatimin e parimeve të RSS-së u kontestuan në mënyrë serioze që në fillim të *zhvillimit të sektorit të sigurisë*, të paktën sa i përket mbikëqyrjes parlamentare.

Në aspektin social, misioni i UNMIK-ut kontribuoi me atë që disa autorë me të drejtë e kanë përkufizuar si “kontrast ndërmjet mënyrës së jetës së ndërkombëtarëve dhe vendorëve” (Lemay-Hebert, 2011). Dallimet në pagesën e stafit lokal dhe atij ndërkombëtar dhe akomodimi i zyrtarëve të UNMIK-ut në hotele lundruese krijoi perceptimin e një bote të elitës së privilegjuar që kontrollonte procesin e shtetndërtimit duke i përjashtuar aktorët lokalë. Lemay-Hebert (2001) e ka përshkruar praninë e UNMIK-ut si “dhunë simbolike” i cili e ndërtoi kritikën në bazë të përkufizimit të Pierre Bourdieu-s për format e fuqishme të dominimit social dhe kulturor që ndodhin në jetën e përditshme. Edhe pse shprehja “dhunë simbolike” mund të tingëllojë si kritikë e fortë konceptuale në kontekstin e Kosovës, ky argument mbizotëron gjatë procesit të rindërtimit pas konfliktit, duke pasur parasysh se dinamika e fuqisë së intervenimit ndërkombëtar e ka krijuar nocionin “ne” i cili zakonisht përfaqëson ndërkombëtarët më të fortë, dhe “ata” që përfaqëson vendorët më të dobët. Një varg shembujsh të marrë nga periudha pas pavarësisë e përforcon këtë pikë.

MBËSHTETJA KOMPLEKSE DHE IMPLIKIMET PËR ZHVILLIMIN E SEKTORIT TË SIGURISË

Roli i donatorëve ndërkombëtarë në Kosovën e pas konfliktit ka qenë vendimtar për ekonominë. Ekonomia e Kosovës është bazuar në tri shtylla: një ekonomi shumë e kufizuar e bazuar në prodhim që përbehej kryesisht nga ndërmarrjet e vogla, remitencat nga diaspora e Kosovës që jeton në vendet perëndimore, dhe mbështetja e bashkësisë ndërkombëtare përmes një numri programesh për ndihmë në zhvillim. Kjo e fundit është më e rëndësishmja në kontekstin e zhvillimit të sektorit të sigurisë sepse ajo ishte fokusi kyç i mbështetjes së bashkësisë ndërkombëtare, krahas sektorëve të tjerë. Në të vërtetë, edhe me zvogëlimin e vazhdueshëm të ndihmës, Kosova mbeti ndër ato pak vende në botë që morrën më së shumti ndihmë për zhvillim për kokë banori për shkak të numrit të madh të donatorëve. Problemi me këtë mbështetje të jashtme ekonomike qëndron në faktin se shumë kontribuues financiarë nuk ia dalin të vijnë në vend për arsye komplekse politike dhe korrupsionit të përhapur. Bashkë me remitencat nga diaspora, “ndihma për zhvillim nga donatorët ndërkombëtarë dhe fondet bilaterale përbën mesatarisht 50% të Bruto Prodhimit Vendor (BPV) të vendit (ASK, 2013). Projektet zhvillimore dhe bashkëpunimi ndërmjet bashkësisë ndërkombëtare dhe vendorëve ka ndryshuar dukshëm prej vitit 1999 deri më tani. Fillimisht, qeveritë perëndimore ishin shumë më të fokusuara në numrin e madh të refugjatëve që largoheshin nga Kosova, ose që ishin përndjekur nga vendi, derisa organizatat humanitare fokusoheshin në ofrimin e ndihmës humanitare si ushqim, veshmbathje dhe strehim për viktimat, para se të fokusohen në situatën politike në Kosovë (Luxemburg, 2014).

Nga perspektiva kontekstuale, prania e donatorëve dhe aktorëve ndërkombëtarë është konsideruar e dobishme për mbajtjen dhe stabilizimin, të paktën të përkohshëm, të ekonomisë në Kosovë. Megjithatë, duhet vlerësuar në mënyrë kritike shkalla në të cilën ndihma e jashtme ka pasur ndikim mbi zhvillimin e sektorit të sigurisë në Kosovë. Bashkëveprimi ndërmjet bashkësisë ndërkombëtare dhe vendorëve fillimisht ishte proces i njëanshëm i cili mori formën e intervenimit të drejtpërdrejtë nga qeveritë dhe organizatat perëndimore, e jo formën e bashkëpunimit. Si i tillë, projektet zhvillimore dhe

bashkëpunimi i mirëfilltë duket se fillojnë në një fazë të mëvonshme, dhe pasi institucionet kombëtare krijuan kapacitetet e mjaftueshme. Sidoqoftë, një numër i madh i projekteve të realizuara nga aktorët ndërkombëtarë si BE, NATO dhe vendet kryesore duket se janë planifikuar kryesisht nga bashkësia ndërkombëtare (Grupi i Fokusit, 2015).

Për më tepër, sfidat lidhur me intervenimin e jashtëm mund të zërthehen në përputhje me teorinë e Mac Ginty për “qasjen e standardizuar të bashkësisë ndërkombëtare në një mision paqeruajtës” (Mac Ginty, 2010, f. 399). Në Kosovë, situata u komplikua edhe më shumë për shkak të interesave të përfaqësuesve të caktuar të bashkësisë ndërkombëtare, e cila dukej se zbulonte një synim të përqendruar në një agjendë të drejtuar nga jashtë, qoftë ajo e individëve, shteteve të huaja ose organizatave ndërkombëtare.

SHPK paraqet një shembull që thekson modelet e imponuara nga jashtë në kontekst të ndihmës për zhvillim. Sa për ilustrim, SHPK është udhëhequr nga një Komisar ndërkombëtar i policisë me teknika dhe metodologji të policimit të cilat transformoheshin sa herë që ndryshonte komisari, gjë që ndodhte çdo vit (N. Rashiti, intervistë personale, 5 qershor 2014). Kompleksiteti i kësaj situatë u rëndua edhe më shumë nga rastet kur teknikat e ushtrimit të detyrës policore nga SHPK në një rajon dallonin shumë nga ato në rajonet e tjera. Në procesin e ndërtimit të kapaciteteve, ekspertët nga vendet e ndryshme i sillnin teknikat e vendeve të tyre të cilat shpesh ishin krejtësisht në mospërputhje me njëra tjetrën (N. Rashiti, intervistë personale, 5 qershor 2014; F. Harris, intervistë personale, 2 maj 2014). Modifikimi i shpeshtë i teknikave policore kishte implikime në sjelljen e zyrtarëve policorë të Kosovës deri në atë masë sa ata nuk mund të shprehnin pakënaqësi ndaj një teknike të caktuar policore të shtyrë nga ndërkombëtarët. Për shembull, zyrtarët policorë në rajonin e Mitrovicës kishin preferencë për teknikat policore britanike, duke reaguar negativisht ndaj teknikave policore franceze, thjeshtë sepse atyre ju dukej teknika britanike më miqësore (N. Rashiti, intervistë personale, 5 qershor 2014). Mos harmonizimi i teknikave policore në këtë periudhë ngriti disa dilema të tjera mbi kontekstin në të cilin zbatoheshin ato teknika policore. Në periudhën menjëherë pas konfliktit, me një shkallë të lartë vrasjesh prej mbi 240 në vit (shih Kapitullin V), dhe një numër

shumë të madh të krimeve të tjera, ishte shumë me rëndësi që të kishte një forcë policore më efikase dhe me reaguese.

Si pjesë e idesë për të mbajtur autoritetet lokale “sa më të çarmatosura që të jetë e mundur”, zyrtarët e lartë ndërkombëtarë propozuan një model të policimit në të cilin policia e Kosovës nuk do të posedonte armë të shkurtra gjatë patrullimit. Ky argument bazohej në supozimin se posedimi i armëve në një ambient të pas konfliktit “nxit dhunën”. Sugjerimi bazohej në modelin danez në të cilin zyrtarët policorë nuk posedojnë armë gjatë patrullimit (R. Marmullaku, intervistë personale, 17 korrik 2014; N. Ibishi, intervistë personale, 23 maj 2014). Megjithatë, një sugjerim i tillë është në kundërshtim të plotë me strukturën institucionale dhe me aplikimin e teknikave në pajtim me rrethanat lokale. Është dështim të krijohet sektori i sigurisë përmes një qasjeje paqeruajtëse të standardizuar, dhe kjo ndërlidhet fuqishëm me dilemën pesimiste të Fukuyama-s për “arritjen e (nivelit) të Danimarkës” në të cilën ai ka sqaruar tendencën e bashkësisë ndërkombëtare që të përpiqet shpejt t’i jap frymë perëndimore shoqërive jo-perëndimore (Fukuyama, 2004, f. 29).

Në një mjedis menjëherë pas konfliktit, një forcë policore e sapokrijuar dhe e përgatitur dobët e barti një barrë të rëndë. Gjatë muajve kur u prezantua ky “model danez”, efektiviteti i zyrtarëve policorë ishte i vogël. Një ish-zyrtar policor i SHPK-së e sqaroi skenarin në të cilin, në vend të armëve dhe mjeteve të tjera detyruese, mënyra e vetme e suksesshme për kapjen e një kriminelit ishte përmes ndërmjetësimit. Sipas këtij oficeri, në raste të caktuara, një kriminel mund të kapej “si rezultat i reputacionit që unë kisha tek popullata si ish zyrtar i lartë policor dhe komandant gjatë luftës” (N. Ibishi, intervistë personale, 23 maj 2014). Kjo ndodhte për arsye të thjeshtë se deri në vitin 2001 nuk ekzistonin mjetet detyruese për të sjell një kryes të një vepre para autoriteteve. Ky shembull e demonstroi mjaftueshëm dështimin e bashkësisë ndërkombëtare për të imponuar modelet e jashtme pa i marrë në konsideratë rrethanat lokale. Modelet e imponuara mbi SHPK-në ishin në mospërputhje aq të madhe sa që më vonë doli në shesh edhe pakënaqësia e zyrtarëve të OKB-së për këtë çështje. Një raport i OKB-së në vitin 2004 theksonte se “ndërtimi i kapaciteteve (të SHPK-së) ishte i prirë të jetë sporadik, i pakoordinuar dhe me kohëzgjatje të ku-

fizuar, i zhvilluar nga një numër aktorësh” dhe se “në rrethana të tilla ndikimi domosdo që do të jetë i kufizuar” (OKB Kosovë, 2005, f. 15).

Dështimi i UNMIK-ut të aplikojë qasjen e vet në përputhje me kontekstin lokal si dhe një dobësi e përgjithshme në përcaktimin e agjendës për një “strategji dalëse” u sfiduan seriozisht nga shpërthimi i trazirave të dhunshme që ndodhën në Kosovë në mars të vitit 2004. Trazirat filluan kur mediat lokale në mënyrë të përsëritur publikuan në titujt e lajmeve se tre fëmijë shqiptarë ishin sulmuar nga fshatarët serbë në pjesën veriore të Kosovës. Raportimet e shumta të mediave nxitën trazira gjithandej Kosovës në të cilat grupet radikale nxitën dhe shkaktuan një dhunë dhe pakënaqësi të shfrenuar ndaj bashkësisë ndërkombëtare, përfshirë edhe ndaj bashkësisë pakicë serbe. Sipas burimeve, rreth 30 trazira shpërthyen gjithandej Kosovës ku u përfshinë më shumë se 50,000 demonstrues të dhunshëm (Human Rights Watch [HRW], 2004). Këto trazira rezultuan me vdekjen e 19 civilëve - 11 shqiptarëve dhe 8 serbëve. Këto ngjarje, për herë të parë, nënvizuan nevojën për të ndërmarë hapa lidhur me bartjen e përgjegjësisë në fushën e sigurisë nga bashkësia ndërkombëtare drejt institucioneve lokale të sigurisë. Si pasojë e teknikave e pa harmonizuara policore të imponuara nga preferencat e aktorëve individualë ndërkombëtarë, dhe mungesës së gatishmërisë për të forcuar si duhet forcën policore lokale, trazirat e marsit 2004 paraqitën një dështim të dyfishtë të bashkësisë ndërkombëtare: ajo nuk e kishte marrë parasysh nevojën për ndërtimin e kapaciteteve lokale në mënyrë koherente dhe të bazuar në kontekst, dhe sinjalizoi dështimin në menaxhimin e krizës përkundër pranisë së madhe të forcave policore të udhëhequra nga ndërkombëtarët në terren.

Në përgjithësi gjatë kësaj periudhe, disa shembuj tregojnë gatishmërinë e bashkësisë ndërkombëtare për ndryshimin e metodologjisë së vet. Si rezultat, përpjekjet e kufizuara të bashkësisë ndërkombëtare për të përfshirë vendorët ishin shikuar nga perspektiva e “plotësimit të kushteve burokratike” (ticking the box). Kjo ishte për shkak se bashkësia ndërkombëtare komunikoi vetëm me elitat para se të komunikonte me përfaqësuesit e shumtë lokalë. Nëse na kujtohet mbështetja konceptuale e Hansen (2008) dhe dilemat empirike të Narten (2009), fokusi elitist ishte problem i veçantë dhe manifestohej

në një marrëdhënie të pabarabartë ndërmjet bashkësisë kosovare dhe asaj ndërkombëtare. Kjo qasje e udhëhequr nga jashtë bëri përpjekje të inkorporojë në mënyrë sipërfaqësore (ndonëse në mënyrë selektive) elitat lokale, duke marginalizuar kështu shumicën e popullsisë. Kjo qasje prodhoi elita të udhëhequra nga shteti, që mbetnin të zbrazëta për shkak të implikimeve negative mbi legjitimitet përtej sundimit të OKB-së (Jackson, 2011). Për më tepër, kjo qasje ishte “e pavarur nga vullneti i popullit të cilin ajo e qeveriste” (Bain, 2006, f. 533).

Në veçanti, ky problem u theksua nga kapja morale e elitës, e cila vuri në shënjestër faktorët e saj më të fortë, kryesisht politikanët e fuqishëm që ishin të lidhur me konfliktin, në një formë të “elitës së UÇK-së”. Këto zhvillime ishin të qëllimshme dhe kishin të bënin me dilemën parësore lidhur me ruajtjen e stabilitetit. Bisedimet me elitat e lidhura me luftën para ndonjë marrëveshjeje me pjesët e tjera të komunitetit lokal siguron se mund të bëhen koncesione pa pasur ndonjë kërcënim të paparashikuar për stabilitetin dhe sigurinë (M. Vrajolli, intervistë personale, 2 qershor 2014). Kjo dilemë ndërlidhet ngushtë me atë që mund të përkufizohet si paradigma e stabilitetit të ekzagjeruar - koncept i cili shtjellohet në kapitujt e ardhshëm.

PIKA E KTHESËS: FILLIMI I DORËZIMIT TË PËRGJEGJËSIVE (2004 - 2008)

Fundi i dhunës në vitin 2004 stimuloi një momenti të ri në rikonfigurimin e mandatit të UNMIK-ut. Kjo u shoqërua me kërkesa më specifike që haptazi bënin thirrje për më shumë kontroll lokal në sektorin e sigurisë. Ky proces u rregullua përmes dorëzimit gradual të përgjegjësive tek autoritetet lokale. Kjo bartje e përgjegjësive mund të ndodhte vetëm pas një analize të hollësishme të kapaciteteve të institucioneve ndërkombëtare dhe lokale dhe rekomandimeve për përmirësimin e tyre. Në vitin 2005, administrata e UNMIK-ut e nisi procesin e Rishikimit të Sektorit të Sigurisë së Brendshme (RSSB). RSSB e shqyrtoi performancën e institucioneve të sigurisë dhe rekomandoi disa hapa të ardhshëm të mundshëm për të mbështetur “strategjinë dalëse”. Rekomandimet e RSSB-së u bazuan në një vlerësim të gjerë të bërë me përfaqësuesit e të gjitha komuniteteve në Kosovë. Përkundër kësaj, edhe kjo iniciativë paraqiste një proces të udhëhequr nga jashtë. RSSB

më në fund e konfirmoi nevojën për më shumë pronësi lokale në sektorin e sigurisë, dhe shërbeu si një fakt i rëndësishëm që arsyetonte dhe theksonte trysinë për ndryshimin e qëndrimit të ngurtë të zyrtarëve të UNMIK-ut (UNDP, 2006).

Rekomandimet e RSSB-së rezultuan në lëvizjen e parë për bartjen e përgjegjësi. Në vitin 2005, Departamenti për Siguri Civile i UNMIK-ut u bart në Ministrinë e Shërbimeve Publike, duke lidhur shërbimet e emergjencave civile me kompetencat lokale në nivelin komunal. Po ashtu, në vitin 2006, UNMIK-u lejoi themelimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) dhe Ministrinë e Drejtësisë (MD) të Kosovës, të cilat duhej të qeveriseshin dhe menaxhoheshin nga kosovarët. Këta ishin hapat e parë, ndonëse të pjesshëm, drejt marrjes së përgjegjësisë në sektorin e sigurisë nga vendorët. Me ndryshimin e rolit të PSSP-së filloi bartja e disa “kompetencave të rezervuara” në sferën e policisë dhe drejtësisë, duke e reduktuar në të njëjtën kohë burokracinë e UNMIK-ut (Narten, 2009, f. 266). Për më tepër, ka pasur një ndryshim të rëndësishëm sa i përket mbikëqyrjes: Kuvendi i Kosovës kishte themeluar Komisionin Parlamentar për Siguri duke ushtruar mbikëqyrjen mbi shërbimet e emergjencës civile, ndërsa mbikëqyrja mbi forcën policore dhe TMK-në mbeti vetëm nën përgjegjësinë e PSSP-së (Qehaja dhe Vrajolli, 2011).

Trazirat e vitit 2004, siç u sqarua më lartë shërbyen si forcë shtytëse politike dhe diplomatike për të përshpejtuar zgjidhjen përfundimtare politike për statusin e Kosovës. Derisa RSSB preku dimensionin institucional të sektorit të sigurisë, procesi politik ishte qasje “nga lart - poshtë” në të cilën bashkësia ndërkombëtare do të gjente mënyrën për t’i ikur bllokimit politik drejt një zgjidhjeje përfundimtare për statusin. Procesi politik kishte për qëllim që së pari të mat shkallën në të cilën autoritetet e Kosovës, megjithëse me mandat të kufizuar, ia dilnin të zbatonin parakushtet kyçe të cilat OKB-ja i kishte emërtuar si “Standardet para Statusit” (OKB, 2003). Si rezultat, në vitin 2005 raporti vlerësues i të dërguarit special të OKB-së, Z. Kai Aide, kishte konstatuar se “edhe pse standardet e zbatuara në Kosovë ishin të pabarabarta, ka ardhur të kalohet në fazën tjetër të procesit politik” (OKB, 2005). Ky raport u hapi derën negociatave për statusin përfundimtar të Kosovës të cilat u zhvilluan në Vjenë ndërmjet delegacioneve

kosovare dhe serbe në periudhën prej vitit 2007 deri në 2008. Negociatat u lehtësuan nga i dërguari special i OKB-së për Kosovën, Marti Ahtisaari. Ndonëse dialogu ndërmjet dy delegacioneve u fokusua në nivelin politik me diskutime të veçanta mbi disa çështje kyçe siç ishin decentralizimi, trashëgimia kulturore dhe kthimi i refugjatëve, kjo dinamikë e re politike po ashtu shërbeu drejt përpjekjeve në propozimin dhe dizajnimin e arkitekturës së re të sektorit të sigurisë. Sektori i ri i sigurisë do të menaxhohej, qeverisej dhe kontrollohej nga vendorët.

Në vitin 2007, në mungesë të një zgjidhjeje të përbashkët dhe pas shterimit të të gjitha mundësive të negociimit, i dërguari i OKB-së doli me një propozim i cili sugjeronte që Kosovës t'i jepej një pavarësi e mbikëqyrur. Kjo e krijoi mundësinë për një status përfundimtar që nënkuptonte një Republikë të pavarur dhe sovranë të Kosovës (OKB, 2007). Ky propozim përfshinte edhe një kapitull që i dedikohej sektorit të sigurisë (OKB, 2007, f. 49).

Me shpalljen e pavarësisë së Kosovës në vitin 2008, propozimi lidhur me sektorin e sigurisë u mishërua në Kushtetutën e Republikës së Kosovës (Kushtetuta, 2008). Sipas Kushtetutës, “Republika e Kosovës ka pushtet mbi zbatimin e ligjit, sigurinë, drejtësinë, sigurinë publike, inteligjencën, organet civile emergjente dhe mbi kontrollin e kufijve në territorin e vet” (Kushtetuta, 2008, neni 125).

Shpallja e pavarësisë së Kosovës krijoi një periudhë të re politike në të cilën kosovarët do të merrnin përgjegjësinë pothuaj të plotë mbi shtyllën kryesore të shtetit - sektorin e sigurisë. Megjithatë, marrja gjithnjë e më e madhe e përgjegjësisë në këtë sektor nuk e dobësoi rolin e bashkësisë ndërkombëtare, i cili në vitin 2008, mbeti i fuqishëm. Themelimi i Zyrës Civile Ndërkombëtare (ICO), në kapacitetin e “ku-jdestarit” (*watchdog*) për zbatimin e zgjidhjes së përkohshme të Ahtisaarit, e mbajti autoritetin për të intervenuar në rast të ndryshimeve ose mospërputhjeve në zhvillimin e sektorit të sigurisë. Përveç ICO-s, ishin edhe dy misione të tjera që vazhduan të luajnë rol vendimtar në mbikëqyrjen e zhvillimit të institucioneve lokale siç ishin misioni i EULEX-it i BE-së dhe misioni i KFOR-it i NATO-s.

Periudha pas pavarësisë përfshinte vendosjen e EULEX-it, që konsiderohej si operacioni më i madh civil i BE-së për menaxhimin e krizës. Ky mision kishte për qëllim të monitorojë, mentorojë dhe këshillojë (MMA) policinë, gjyqësorin dhe doganën, dhe kryesisht ka për qëllim të arrihen standardet evropiane dhe integrimi në BE (BE, 2008). Gjatë periudhës nga 2008 deri 2012, EULEX mbajti disa kompetenca ekzekutive lidhur me krimin e organizuar dhe krimet e luftës për t'i përdorur në rrethana të jashtëzakonshme. Përveç ofrimit të ndihmës, ai kishte për qëllim të vlerësonte sistemet dhe strukturat ekzistuese dhe të identifikonte fushat ku nevojitej zhvillim dhe reforma në të ardhmen. Lidhur me këtë, detyrë fillestare e EULEX-it ishte që të ndihmojë në luftimin e problemeve që kishin të bënin me korrupsionin dhe krimin e organizuar.

KFOR-i, në anën tjetër, e vazhdoi mandatin e vet të paraparë që nga fillimi. Prania e tij u zvogëlua në mënyrë drastike (nga 50,000 sa kishte në vitin 1999 në 8,000 në vitin 2008) me përqendrimin e tij kryesor në pjesën veriore të vendit. Gjatë kësaj periudhe, KFOR-i filloi procesin e bartjes së përgjegjësive drejt PK-së sa i përket mbrojtjes së kufirit. Një detyrë shtesë që e mori kishte të bënte me procesin e krijimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) duke i mbajtur përgjegjësitë kyçe në mbikëqyrjen e këtij institucioni.

KAPITULLI III

SEKTORI I SIGURISË NËN OMBRELLËN E BASHKËSISË NDËRKOMBËTARE

Ky kapitull paraqet dhe analizon gjetjet kryesore cilësore dhe sasiore të librit. Gjetjet janë të organizuara dhe grupuara përreth dilemave kryesore që kanë të bëjnë me pronësinë lokale në rastin e Kosovës. Këto gjetje bazohen në një grup mënyrash për mbledhjen e të dhënave, përfshirë intervistat, vëzhgimin me pjesëmarrje, analizën e përmbajtjes dhe matjet sasiore. Krahas dilemave të përgjithshme lidhur me varësinë dhe mosbesimin, një referencë e konsiderueshme do tu bëhet nocioneve të stabilitetit obsesiv dhe të ekzagjeruar dhe implikimeve të tij për pronësinë lokale. Pjesa e dytë e kapitullit paraqet një interpretim të perceptimit publik mbi lidhjen mes ndërkombëtarëve dhe vendorëve dhe për pronësinë lokale në përgjithësi.

DILEMAT E MËDHA

Gjetjet empirike paraqesin marrëdhënien komplekse ndërmjet bashkësisë ndërkombëtare dhe aktorëve lokalë në zhvillimin e sektorit të sigurisë në Kosovën e pas pavarësisë. Nuk është rastësi që në sektorin e sigurisë janë dëshmuar këto marrëdhënie komplekse: Kosova nuk bën përjashtim në argumentimin se sektori i sigurisë është një ndër shtyllat më të rëndësishme të shtetësisë. Siç është thënë nga teoricienët kryesorë, forcat e armatosura vazhdojnë të jenë mjeti detyrues i shtetit (Buzan, 1991; Weber, 1958). Derisa hapat e parë të shtetndërtimit në mënyrë logjike kërkojnë mbështetjen e bashkësisë ndërkombëtar, përfshirja e saj, megjithatë, mund të jetë kundërthënëse, veçanërisht nëse ka dëshmi të ndërhyrjes së tepruar dhe të pakontestuar. Në Kosovë, ka dëshmi të mjaftueshme për të provuar këtë: veprimet e bashkësisë ndërkombëtare kanë sfiduar seriozisht pronësinë lokale. Në fakt, ndë-

rhyrja e tepruar e bashkësisë ndërkombëtare jo vetëm që duket të jetë problem gjatë administrimit të UNMIK-ut (shih Kapitullin III) por po ashtu paraqet pengesë të vazhdueshme edhe në periudhën menjëherë pas pavarësisë.

Është e vërtetë se dispozitat për shpalljen e shtetësisë së Kosovës janë bazuar në mbikëqyrjen e përkohshme të shtetësisë, kryesisht përmes Zyrës Civile Ndërkombëtare (ICO) por edhe përmes EULEX-it dhe KFOR-it (Kushtetuta, 2008). Megjithatë, siç do ta tregojnë gjetjet më poshtë, roli mbikëqyrës ose ishte keqpërdorur ose keqinterpretuar për shkak të ndërhyrjes së tepruar dhe, deri diku, imponimit të modeleve të jashtme. Kjo shpiti jo vetëm në shkeljen e të drejtës për vetëvendosje por edhe të parimeve bazë të pronësisë lokale. Në të vërtetë, e drejta e aktorëve lokalë që të kenë rolin primar në qeverisjen e një shteti dhe territori është e mishëruar në dispozitat legjislative ndërkombëtare. Dokumenti i parë që e njohu këtë të drejtë ishte Karta e Kombeve të Bashkuara (OKB, 1948), e pasuar nga një numër rezolutash detyruese ligjore të OKB-së (OKB, 1960, 1961) dhe rastesh të vendosura nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (GJND, 1971, 1975, 1995). Vërtetë, këto dokumente ligjore përcaktojnë të drejtën e popujve vendas - “të jenë të lirë nga kontrolli i huaj sipas të drejtës së tyre në autonomi” (Wilde, 2012, f.261). Autonomia këtu nuk është vetëm çështje politike por edhe çështje e brendshme në të cilën njerëzit dhe përfaqësuesit e tyre, pavarësisht konstelacioneve politike, e gëzojnë të drejtën të “thonë fjalën e tyre” në procesin e shtetndërtimit. Nga perspektiva ligjore, kjo përkufizohet si vetëvendosje e brendshme (Thürer & Burri, 2008; Weller, 2008).

Vetëvendosja e brendshme është e drejta e njerëzve të vendosin për proceset e zhvillimit dhe shtetndërtimit të tyre. Kështu veçanërisht ndodh në mjediset e post-konfliktit ose post-pavarësisë, ku bashkësia ndërkombëtare ushtron një mandat të tepruar në administrimin e një territori ose vendi. Marc Weller zbërthen kuptimin e vetëvendosjes nga një e drejtë individuale, drejt të drejtës së pjesëtarëve të grupeve ose popullsisë të caktuara, në të cilën ata mund të pretendojnë të qeverisin në një territor të caktuar (Weller, 2008). Ky përkufizim ofron një sqarim mbi të drejtën që ngrihet në argumentet politike dhe sociale.

Në kontekstin kosovar, e drejta në vetëvendosje dhe pronësi lokale jo vetëm që rrjedh nga dokumentet juridike ndërkombëtare të cekura më lartë, por ajo gjendet edhe në dokumentet e tjera juridike dhe politike (shih më poshtë). Këto dokumente e arsyejnë mjaftueshëm të drejtën e kosovarëve që të kenë rolin parësor në procesin e vendimmarrjes. Së pari, dispozitat e Zgjidhjes së Statusit të Kosovës parashihnin një rol parësor për kosovarët në procesin e shtetndërtimit, përkundër një pavarësie të përkohshme dhe të mbikëqyrur (OKB, 2007). Së dyti, vendimet individuale të shteteve sovraane për të njohur pavarësinë e Kosovës paraqesin një referencë në të drejtën e Kosovës dhe aktorëve lokalë që të vendosin për proceset e shtetndërtimit.⁵ Së treti, identifikohet opinioni i GJND-së që e vërtetoi statusin politik të Kosovës duke theksuar se e drejta për vetëvendosje të brendshme “i takon territoreve vetëqeverisëse dhe jo-vetëqeverisëse” dhe se “si rezultat i ushtrimit të kësaj të drejte janë krijuar një numër i madh shtetesh të reja” (GJND, 2010). Së katërti, rezoluta e Parlamentit Evropian - të cilën Kosova këshillohet ta respektojë - thekson se “pronësia lokale mbi procesit të shtetndërtimit është thelbësore për të siguruar stabilitet afatgjatë” (BE, 2008, neni 31). Po ashtu është e vërtetë se këto dokumente juridike e vërtetuan pavarësinë e mbikëqyrur për një periudhë 5 vjeçare. Shkalla në të cilën është ushtruar kjo mbikëqyrje, dhe çka është më e rëndësishme, si është ushtruar kjo mbikëqyrje paraqet këndin e vështruar në këtë libër përmes shembujve empirik në vijim.

Problemi i parë i misionëve ndërkombëtare ishte mungesa e një strategjie dalëse. Asnjë prej misionëve në Kosovë nuk duket të kenë pasur strategji dalëse e cila sinjalizonte një tërheqje të mundshme dhe datën që vendorët të marrin përgjegjësinë e plotë mbi proceset shtetërore. Sipas një bashkëbiseduesi kosovar, “nuk ka ndonjë vegël matëse në bazë të së cilës misionet ndërkombëtare duhet të tërhiqen...në vend të kësaj tërheqje është bërë në bazë të vendimeve politike” (L. Fushtica, intervistë personale, 21 korrik 2014). Në Kosovën e pas pavarësisë, vetëm ICO-ja u tërhoq në vitin 2012 pasi erdhi në përfundim se periudha e pavarësisë së mbikëqyrur kishte përfunduar, duke paraqitur

5 Për më shumë informacione, shih letrat e njohjes nga shtetet që e kanë njohur pavarësinë e Kosovës. Deri në mars 2018, Kosova është njohur nga 116 shtete anëtare të OKB-së.

kështu edhe vullnetin politik të sponsorëve të ICO-s (Gazeta Zyrtare, 2012). Kështu nuk ishte rasti me EULEX-in, OSBE-në, KFOR-in dhe një numër të madh organizatash ndërkombëtare të cilat nuk kishin strategji dalëse. Mungesa e orientimeve politike i përshtatet kontributit konceptual të Caplan-it në arsyetimin e strategjive dalëse të misioneve ndërkombëtare (Caplan, 2012). Mungesa e strategjive dalëse, dhe në zhargonin politik “shuarjes graduale”, duket të jetë një ndër problemet kryesore për misionet ndërkombëtare në të gjitha mjediset. Si rrjedhojë, mungesa e orientimeve të qarta të politikave - siç është rasti i Kosovës - mund të vonojë edhe më shumë të drejtën në vetëvendosje dhe pronësinë lokale (Caplan, 2012). Në këtë rast ajo jo vetëm që vonoi por edhe pezulloi pronësinë lokale (M. Vrajolli, intervistë personale, 2 qershor 2014).

Problemi i dytë i krijuar nga bashkësia ndërkombëtare ka të bëjë me mos-marrjen në konsideratë të kontekstit, ku Kosova në mënyrë të standardizuar portretizohet ngjashëm me vendet e tjera të pas konfliktit ose pas pavarësisë. Kjo situatë është krijuar përmes perceptimit linear të kontekstit të pas konfliktit, pavarësisht se për cilin rajon është fjala. Ishte mjaft paradoksale të dëgjosh bashkësinë ndërkombëtare të tërheq paralele ndërmjet Kosovës dhe Afganistanit (Kurti, 2011) (L. Fushtica, intervistë personale, 21 korrik 2014) në vend të krahasimit më logjik, për shembull, të kataklizmave të pas konfliktit në mes të B e H dhe Kosovës duke ju referuar kontekstit të ngjashëm dhe të kaluarës së përbashkët. Përderisa kjo kritikë ndaj analogjive të gabueshme ndërmjet Kosovës dhe rajoneve të tjera në asnjë mënyrë nuk nënkupton perceptim negativ për rajonet e tjera, është me rëndësi të bëhet dallimi ndërmjet konteksteve dhe kulturave të vendeve të synuara. Përveç kontekstit, edhe situata e sigurisë dhe niveli i zhvillimit ekonomik kanë një ndikim të rëndësishëm. Veprimet e standardizuara të bashkësisë ndërkombëtare ofrojnë ide të gatshme dhe që janë bërë mostër e të cilat ofrohen gjithandej në të gjitha vendet e pas konfliktit. Në vitin 2010, për shembull, unë personalisht kam punuar me një grup të konsulentëve ndërkombëtarë të cilët kishin për qëllim të identifikonin fushat për t'i përkrahur në sundimin e ligjit. Shpërndarja e ekspertëve ndërkombëtarë është përcjellë me udhëzime të rrepta të sigurisë, në përputhje me ato të aplikuar nga organizatat në Afganistan (Vëzhgimi me pjesëmarrje, 2010). Ekipi me siguri ishte i vetëdijshëm se situa-

ta e sigurisë në Kosovë ishte shumë më e favorshme se në Afganistan, megjithatë, logjika e përgatitjes “së përgjithshme dhe sipas kornizës logjike” u inkorporua në punën e përditshme: siç është pasqyruar nga Mac Ginty dhe ideja e “IKEA-izimit” (Mac Ginty, 2011).

Një problem i tretë i referohet implantimit të modeleve të bazuara të jashtme në sektorin e sigurisë së Kosovës. Disa prej veprimeve të ndërmarra nga bashkësia ndërkombëtare kanë ndodhur nën flamurin e “Praktikave më të Mira Perëndimore”. Për më tepër, këto praktika i kanë lidhur në mënyrë artificiale zyrtarët e Kosovës me paradigmën e kushtëzimit. Ky kushtëzim i referohet kushteve që një vend duhet të përmbush për të ecur drejt BE-së, NATO-s dhe organizatave të tjera ndërkombëtare, kusht që Kosova synon ta arrijë. Si pasojë, referimi i shpesh të “Praktikat më të Mira Perëndimore” në mënyrë artificiale e ka arsyetuar ndërhyrjen e bashkësisë ndërkombëtare në sektorin e sigurisë. Për shembull, kur analizohen modelet e ndryshme të punës policore nëpër vendet perëndimore, mund të thuhet se nuk ka një model të vetëm të punës policore që aplikohet në Evropë. Në të vërtetë, modelet perëndimore të qeverisjes së fushës së sigurisë janë të llojllojshme, secila prej tyre produkt i zhvillimeve historike dhe kushtetuese (Donais, 2012a). Modeli skandinav i sundimit të ligjit mund të paraqes qasjen më të mirë teorike për kontekstin skandinav: por ky kontekst dallon shumë nga konteksti i Kosovës dhe Ballkanit Perëndimor (Bleas dhe Qehaja, 2013). Si rezultat, referimet që i bëhen standardizimit universal të praktikës policore në Kosovë kontestohen lehtë.

Ky problem komplikohet edhe më shumë nga mospërputhja që hetohet ndërmjet shenjës së “Praktikave më të Mira Perëndimore” dhe nevojave lokale (Bleas dhe Qehaja, 2013), edhe kur përdoren si mjet për të matur kushtëzimin e Kosovës për avancimin ndërkombëtar. Është e qartë se “Praktikat më të Mira Perëndimore” jo vetëm që ishin “këshilluar” por edhe ishin “zbatuar”, me të paktën një ndërkombëtar të përfshirë, nëse jo duke e udhëhequr procesin e hartimit të ligjeve dhe politikave (B. Selimi, intervistë personale, 20 tetor 2014). Kjo situatë iu dha ekspertëve ndërkombëtarë hapësirë të përfshijnë praktikën nga vendet e tyre. Herë pas here, intervenimi përdorej për të arsyetuar përfshirjen e mëtejshme të ekspertëve të tjerë ndërkombëtarë, përmes roleve këshillimore dhe konsultuese. Këto zhvillime kanë

ndodhur si kosto e kushtëzimit ndërkombëtar të Kosovës (B. Selimi, intervistë personale, 20 tetor 2014; L. Fushtica, intervistë personale, 21 korrik 2014). Për më tepër, referencat e bëra në “Praktikat më të Mira Ndërkombëtare” jo vetëm që kanë pasur implikime negative për teknikat e policisë, por kanë pasur edhe pasoja në menaxhimin teknik të policisë, e ilustruar me ofrimin e një numri automjeteve të panevojshme që e kanë dëmtuar menaxhimin e flotës [së automjeteve] (R. Marmullaku, intervistë personale, 17 korrik 2014).

Problemi i katërt ka të bëjë me formën e ekspertizës ndërkombëtare. Edhe pse ekspertët e jashtëm mund të kenë ekspertizë në vendet prej nga vijnë, ata jo domosdoshmërisht kanë ekspertizë në vendin përfitues. Ky problem u konstatua jo vetëm në proceset e hartimit të politikave por edhe në mandatin ekzekutiv të bashkësisë ndërkombëtare. Për shembull, përfshirja e ekspertëve ndërkombëtarë për tu marrë me rastet më të ndjeshme të krimeve konsiderohet problematike sepse ndërkombëtarët nuk mund të kenë më shumë “njohuri operationale se sa vendorët” (F. Harris, intervistë personale, 2 maj 2014; B. Selimi, intervistë personale, 20 tetor 2014; R. Marmullaku, intervistë personale, 17 korrik 2014). Nuk mund të pritët nga ekspertët ndërkombëtarë të sjellin rezultate në një fushë, siç është p.sh., ajo e krimeve të rënda, pa e njohur kulturën dhe gjuhën lokale, dhe kur rrinë në vend jo më shumë se 6-12 muaj (F. Harris, intervistë personale, 2 maj 2014). Kjo pikë nuk e konteston nevojën për fushëveprimin dhe praninë e zyrtarëve policorë të EUELX-it prej vitit 2008 deri në 2012, e as nuk konsideron se ata ishin të panevojshëm (F. Harris, intervistë personale, 2 maj 2014). Në vend të kësaj, ajo identifikon se zyrtarët e EULEX-it nuk ishin vendosur në mënyrë efektive pasi që nuk kishte detyra që kërkonin një numër aq të lartë. Kështu që, situata pasqyron vetëm një komoditet të mjaftueshme për misionet ndërkombëtare.

Problemi i pestë kishte të bënte me arsyetimin rreth mbështetjes zhvillimore që i jepet Kosovës. Është e qartë se Kosova ka marrë më shumë ndihmë zhvillimore për kokë banori se sa vendet e tjera në rajon (shih Kapitullin III). Megjithatë, shumica e fondeve ishin të dedikuara për asistencë teknike, duke siguruar që përfitimet e tjera përveç marrjes së këshillave dhe mbështetjes në hartimin e ligjeve dhe politikave (e cila mund të vihet në dyshim), shumica e financimit faktikisht ju kthye BE-

së dhe vendeve të tjera. Në fakt, financimet e mëdha në formë të asistencës teknike e kanë bërë vendin një treg atraktiv për konsulencë nga kompanitë dhe individët nga Evropa dhe SHBA-ja. Përmes logjikës së donatorëve, ekspertiza teknike dhe fondet e mjaftueshme për ndihmë zhvillimore janë përdorur si mjete për të kontestuar pronësinë lokale, duke inkurajuar pronësinë ndërkombëtare mbi proceset shtetërore. Kuptohet, kështu ndodhi në periudhën e hershme pas konfliktit në të cilën buxheti i Kosovës u mbush dhe u plotësua nga ndihma e jashtme. Si rezultat, financat u përdoren si vegël për promovimin e politikave të caktuara të fuqive kryesore ndërkombëtare dhe të disa agjencive zhvillimore (B. Selimi, intervistë personale, 20 tetor 2014). Në sqarimin e tij rreth sfidave të Rishikimit të Sektorit të Sigurisë së Brendshme (RSSB), Antony Welch, koordinator i këtij proces në vitin 2005, theksoi se financimi mund të sigurohej lehtë për të siguruar një proces efikas të RSSB-së (Welch, 2014a). Ndërkohë, gjatë procesit të RSSB-së dhe derisa Kosova po shkonte drejt përfundimit të bisedave për statusin përfundimtar dhe pavarësisë, disa donatorë i tërhoqën fondet nga RSSB-ja për arsye të cilin (Welch, 2014). Ky është një shembull që tregon ndikimin e tepruar të bashkësisë ndërkombëtare deri në nivelin e rrezikimit të procesit të shtetndërtimit përmes tërheqjes së fondeve.

Arsyetimi i ndikimit të tepërt ndërkombëtar në bazë të ndihmës zhvillimore është kundër-produktiv dhe e konteston pronësinë lokale. Ky është veçanërisht rasti kur ndihma zhvillimore është vetëm plotësuese ose i mbështet resurset ekzistuese. Duke filluar nga viti 2002, për shembull, institucionet e sigurisë të Kosovës, siç është policia, u financuan nga tatimpaguesit kosovarë. Në mënyrë paradoksale, nga viti 2002 deri në fillim të 2009 kishte një prani të vazhdueshme të një komisarit ndërkombëtar të policisë i cili e drejtonte institucionin dhe financohej nga buxheti i Kosovës (N. Rashiti, intervistë personale, 5 qershor 2014). Prandaj, çdo argument që arsyeton një ndërhyrje të tepruar, dobësohet kur pjesa kryesore e buxhetit përkrahet nga tatimpaguesit lokalë. Me fjalë të tjera, edhe nëse miratohet logjika e donatorëve për financim të jashtëm në raport me pronësinë e kufizuar lokale, ajo nuk mund të aplikohet në rastin e Kosovës. Në të vërtetë, derisa financat e bashkësisë ndërkombëtare janë më të ulëta dhe të

dedikuara vetëm për asistencë teknike, aq më e lartë është mundësia për të sfiduar autoritetin ndërkombëtar (EPLO, 2014).

DILEMA E VARËSISË

Rezultatet tregojnë se varësia është produkt i pranisë së gjatë dhe rolit tepër të madh të bashkësisë ndërkombëtare e cila krijoi një rehati të caktuar në mesin e aktorëve lokalë, se “ndërkombëtarët do të bëjnë punën dhe ata (ndërkombëtarët) janë drejtuesit përfundimtarë” (Grupi i fokusit, 2015). Është e vërtetë se kjo varësi mund të ketë implikime afatgjate në mënyrën se si kosovarët e ndërtojnë shtetin: disa kanë ardhur në përfundim se pasojat tashmë janë evidente që në vitet e para të shtetësisë (Surroi, 2014). Megjithatë nuk mund të arrihet në përfundim se kjo varësi është produkt vetëm i veprimit ndërkombëtar: ajo paraqet vizionin e qartë dhe mungesën e të kuptuarit prej disa elitave lokale gjatë administrimit ndërkombëtar të Kosovës (B. Selimi, intervistë personale, 20 tetor 2014; R. Marmullaku, intervistë personale, 17 korrik 2014; L. Fushtica, intervistë personale, 21 korrik 2014).

Në veçanti, kjo varësi zbërthehet përmes perceptimeve të disa profesioneve të caktuara. Profesionin këtu përmendet gjatë tërë hulumtimit: qofshin ata zyrtarë të policisë, oficerë të FSK-së ose të tjerë. Sipas të intervistuarit, “oficerët e lartë të policisë së Kosovës kanë qenë më të preokupuar që t’i raportojnë EULEX-it se sa që të merren me sfidat e rëndomta të qetësisë dhe sigurisë” (R. Marmullaku, intervistë personale, 17 korrik 2014). Ndjenja e të pasurit të bashkësisë ndërkombëtare si drejtues kryesor vetëm se krijoi vështirësi të mëdha në konsekuencën e këtij institucioni. Në anën tjetër, për shembull, në MPB, roli tepër i madh i bashkësisë ndërkombëtare gjatë administrimit ndërkombëtar rezultoi (në Kosovën e pas pavarësisë) me një perceptim të inferioritetit të vendorëve ndaj bashkësisë ndërkombëtare (R. Marmullaku, intervistë personale, 17 korrik 2014). Si rezultat, MPB si organ politikbërës ka pasur vështirësi në hartimin dhe koordinimin e politikave e vetme sepse “fara e mbjell gabimisht, do të rritet gabimisht” (L. Fushtica, intervistë personale, 21 korrik 2014).

Çka është edhe më shqetësuese, niveli tepër i madh i varësisë ndaj bashkësisë ndërkombëtare duket se është keqpërdorur. Kjo kulturë

është kultivuar gjatë gjithë administrimit të UNMIK-ut dhe është mishëruar në periudhën pas pavarësisë (B. Selimi, intervistë personale, 20 tetor 2014; N. Rashiti, intervistë personale, 5 qershor 2014). Keqpërdorimi i varësisë mund të vërehet përkundrejt “sjelljeve të guximshme” të disa individëve nga bashkësia ndërkombëtare të cilët nuk guxonin të sfidonin asnjë vendim të zyrtarëve lokalë të policisë. Si rezultat, ka pasur raste në të cilat, për shembull, një zyrtar policor ndërkombëtar, pavarësisht gradës më të ulët policore, nuk mund të përmbahej nga dhënia e urdhrave homologut të tij lokal. Në vendet perëndimore zyrtarët me gradë më të ulët nuk kanë mundësi të urdhërojnë zyrtarët me grada më të larta sepse ata duhet t’i binden hierarkisë (B. Selimi, intervistë personale, 20 tetor 2014).

Natyrisht, këta shembuj paraqesin vetëm një pjesë të arsyetimit që ka të bëjë me varësinë. Dëshmitë cilësore konfirmojnë këtë varësi në të gjitha profesioneve e sektorit të sigurisë. Në pjesën e dytë të këtij kapitulli, është përshkruar varësia edhe në nivelin e perceptimeve të qytetarëve. Mungesa e “tërheqjes graduale” të bashkësisë ndërkombëtare dhe roli i saj tepër i madh ka çuar drejt një varësie të përgjithshme tek vendorët, veçanërisht kur flitet për misionet me të respektuara ndërkombëtare siç është KFOR-i.

Në anën tjetër, varësia nuk duhet të konsiderohet vetëm si shkak i veprimeve të bashkësisë ndërkombëtare. Sigurisht se është dobësi e vendorëve, e përfaqësuesve qeveritarë ose bashkësive lokale. Ishin vendorët ata që nuk shprehnin gatishmërinë për të marrë më shumë pronësi. Sjellja e profesionistëve lokalë mund të pasqyrohet në përkufizimin e William Bain lidhur me “mungesën e autoritetit për të rezistuar” (Bain, 2006, f. 537). Të pasurit e “autoritetit për të rezistuar” vërehet më së miri kur vendorët janë në pozitë tu thonë “jo” veprimeve ndërkombëtare. Si pasojë, autoriteti për të rezistuar ndërlidhet me varësinë: ku autoriteti për të rezistuar mungon për shkak të krijimit të varësisë.

Në një përpjekje ironike për të përkufizuar këtë nivel të varësisë, një opinionist kosovar theksoi se “është zhgënjyese të shohësh ndjenjën e të qenit i vogël, i parëndësishëm dhe i pafuqishëm...tek kosovarët mbretëron mentaliteti i servilit” (F.Surroi, 2012). Në fakt, Edward Said ka bërë një vrotim të thellë mbi sunduesit dhe servilitetin. Natyra

afatgjate dhe e rrënjësuar thellë e këtij perceptimi ka kontribuar idenë se “perëndimorët” janë kulturalisht, ekonomikisht dhe politikisht më të fortë se sa vendorët (Said, 1994). Në rastin e Kosovës natyrisht se është vështirë të testohet nëse supremacia kulturore është produkt i varësisë, megjithatë, nga hulumtimi mund të nënvizohen elemente të formave të caktuara të servilitetit dhe lojalitetit të tepruar.

BASHKËPUNIMI I PABARABARTË DHE DILEMA E BESIMIT

Dilema e mosbesimit analizohet hollësisht në kuadër të një “marrëdhënieje të pabarabartë” ndërmjet bashkësisë ndërkombëtare dhe përfaqësuesve lokalë (Hansen, 2008, f. 45). Si dilema e mosbesimit ashtu edhe marrëdhënia e pabarabartë përcaktojnë shkallën e partneritetit ndërmjet aktorëve ndërkombëtarë, qeveritarë dhe jo-qeveritarë. Partneriteti i pabarabartë dhe dilema e mosbesimit janë inkorporuar në literaturën e ndërtimit të paqes liberale dhe në teorinë e shtetndërtimit në të cilën shumica e aktorëve i qasen në mënyrë kritike rolit të vendeve kryesore ndaj shteteve të reja dhe atyre në zhvillim (Chandler, 2006; Fukuyama, 2004; Richmond, 2009). Të dy bazat konceptuale, përtej kritikës së përgjithshme në boshtin e “vendeve perëndimore që përpiqen të patronizojnë vendet lindore”, përcaktojnë në mënyrë të detajuar shkaqet e mosbesimit dhe partneritetit të pabarabartë në një ndërkombëtarë-vendorë.

Në të vërtetë, çështja e mosbesimit paraqet një ndër dilemat kryesore në procesin e shtetndërtimit në Kosovë, e veçanërisht në zhvillimin e sektorit të sigurisë. Dilema e besimit, megjithatë, nuk ishte e njëanshme dhe përfaqësonte një mungesë të besimit të vendorëve ndaj ndërkombëtarëve krahas mungesës së besimit të ndërkombëtarëve ndaj vendorëve (B. Rexhepi, intervistë personale, 25 gusht 2014). Është me rëndësi të theksohet mosbesimi i publikut meqë ai sqaron shkallën e kufizuar në të cilën qytetarët e kanë miratuar autoritetin e bashkësisë ndërkombëtare. Për zbatimin e këtij argumenti, Lederach ka të drejtë kur thekson se bashkësia ndërkombëtare i sheh njerëzit si resurse e jo si pranues (Lederach, 1998), duke siguruar rëndësinë që besimi i publikut të shikohet përmes perspektivës së resurseve.

VENDORËT NUK U BESOJNË NDËRKOMBËTARËVE

Një sqarim i dilemës së mosbesimit përcaktohet më së miri nga atëbotë Ministri i Punëve të Brendshme, i ndjeri Bajram Rexhepi, në përshkrimin që i bëri ai marrëdhënies me EULEX-in: “Nuk është se ne nuk u besojmë atyre (EULEX-it dhe KFOR-it)...shumica e pjesëtarëve të tyre kanë qasje pozitive ndaj zhvillimeve në Kosovë. Problemi qëndron me disa individë nga shtete të caktuara që kanë agjendë e cila jo gjithmonë është në përputhje me agjendën e shtetndërtimit të Kosovës. Prandaj, ne (MPB) shprehim rezerva në ndarjen e disa informatave me misionet ndërkombëtare” (B. Rexhepi, intervistë personale, 25 gusht 2014).⁶ Ministri shtoi se ky qëndrim ka ndodhur për shkak të rrjedhjes së informatave, që në disa operacione të veçanta e kanë dëmtuar shumë rezultatin (B. Rexhepi, intervistë personale, 25 gusht 2014). Për shembull, në vitin 2014 një bastisje për arrestimin e disa personave të dyshuar për terrorizëm e kishte zënë plotësisht në befasi praninë ndërkombëtare në Kosovë pasi ajo kishte dëgjuar për operacionin vetëm përmes mediave. Arsyeja e vendimit për të ndal ndarjen e informatave me bashkësinë ndërkombëtare ishte që operacioni të mbahet sa më konfidencial që të jetë e mundur, nën rregulla të rrepta të operacionit të klasifikuar, në mënyrë që të sigurohet përfundimi i suksesshëm i aksionit të policisë (B. Rexhepi, intervistë personale, 25 gusht 2014). Në fakt, trajektorja e ruajtjes së besimit mund të ngrihet vetëm përmes përvojave pozitive të bashkëpunimi në lidhjen ndërkombëtarë-vendorë. Ndoshta është vështirë të ketë përvoja të tilla duke e parë dilemën e mosbesimit të vazhdueshëm. Problemi me besimin në kontekstin e lidhjes ndërkombëtarë-vendorë krijohet në vend të një strategjie të duhur dalëse nga misionet ndërkombëtare. Prania ndërkombëtare afatgjate, veçanërisht një misioni që ka qëndrim që nuk i përgjigjet ndryshimit, do të tjetërsojë popullatën vendore dhe zyrtarët qeveritarë (Caplan, 2012).

Unë kam identifikuar një numër rastesh që manifestojnë mungesën e besimit. Qëllimi im është që të analizoj vetëm një numër rastesh, por të cilat janë të mjaftueshme për zbërthimin e këtij fenomeni. Në përgjithësi, kur zbërthehen shkaqet e vërteta të mosbesimit, zbulohen dy

6 Ministri Rexhepi ka shërbyer në MPB nga viti 2010 deri në 2015. Ai vdiq në vitin 2017.


arsye kryesore që e sqarojnë dilemën nga perspektiva e politikbërësve kosovarë: e para është mungesa e besimit ndaj punonjësve të caktuar ndërkombëtarë që kanë një ndjenjë kundër interesave të Kosovës; e dyta është mungesa e besimit si rezultat i shtetit të prejardhjes, që përfshin individët që vijnë nga shtetet me reputacion të dyshimit ndaj shtetndërtimit në Kosovë. Po ashtu brenda këtij grupi përfshihen individë që i përkasin vendeve të cilat, deri në ditën e sotme, nuk e kanë njohur shtetësinë e Kosovës (B. Selimi, intervistë personale, 20 tetor 2014).

Këto sqarime janë dhënë nga politikbërës kosovarë me përvojë, të cilët theksojnë se për shkak të vendimeve ose sjelljeve të individëve të caktuar në mënyrë të natyrshme u krijua ky nivel i mosbesimit i cili më vonë u bë normë (B. Selimi, intervistë personale, 20 tetor 2014). Derisa subjektivizmi është i arsyetueshëm, unë argumentoj se niveli i mosbesimit ishte krijuar nga moskujdesi ndaj individëve që vijnë nga shtete të caktuara. Megjithatë ky argument është shkencërisht jobindës, sepse gjykimi i dikujt tjetër sipas origjinës kombëtare është stereotip i rrënjosur në memorien historike të qytetarëve kosovarë, që shpesh përdoret për tu shfajësuar për mosbashkëpunim. Vërtetë, një perceptim i tillë jo vetëm që buron nga përfaqësuesit e institucioneve por edhe nga qytetarët e zakonshëm. Për të ilustruar këtë, perceptimi i opinionit publik tregon se besimi i njerëzve ndaj KFOR-it është më i lartë në rajonin e Gjilanit (në pjesën lindore të Kosovës) për shkak të përbërjes kryesisht nga njësitë amerikane, besim që mbështetet edhe nga një nivel i përgjithshëm i lartë i besimit ndaj SHBA-së. Në anën tjetër, perceptimi i publikut për KFOR-in ishte më i ulët në rajonin e Mitrovicës (në pjesën veriore të Kosovës), ku njësitë kryesisht përbëheshin nga pjesëtarë francez (Grupi i fokusit, 2014). Në këtë shembull, ka më pak besim ndaj Francës se sa ndaj SHBA-së, që është si rezultat i memories historike dhe së fundmi pjesëmarrjes së ushtarëve francez në mundësimin e ndarjes së Mitrovicës (Hougar, 2014).

Është me rëndësi të zërthehet besimi që kanë qytetarët ndaj misioneve ndërkombëtare, veçanërisht EULEX-it dhe KFOR-it. Së pari, dhe lidhur me EULEX-in, besimi ndaj misionit të tyre është jo i kënaqshëm. Nga paraqitja grafike mund të vërehet se besimi ndaj misionit të BE-së për sundimin e ligjit në Kosovë është 21%, ku 25 % janë

neutral dhe 42% shprehin mosbesim. Përveç kësaj, 42% pasqyrojnë qëndrimin që konteston autoritetin dhe besueshmërinë e misionit që ka mandatin të monitorojë dhe këshillojë si dhe të ushtrojë disa detyra ekzekutive në fushën më të gjerë të sundimit të ligjit. Interpretimi cilësor i të dhënave dhe reagimi individual i njerëzve ndaj EULEX-it e interpreton misionin si një mision që nuk dallon aq shumë nga misioni i mëhershëm i UNMIK-ut (Grupi i fokusit, 2014), ku në një numër rastesh ishte zbuluar se ai mbante një qëndrim që nuk ishte në harmoni me interesat publike. Për më tepër, ky perceptim krijohet si rezultat i sjelljes së përgjithshme të misioneve ndërkombëtare në Kosovë, të cilat janë dëshmuar se nuk janë në gjendje të bëjnë ndryshim substancial në mandatin e tyre ndërmjet periudhës menjëherë pas konfliktit (1999-2002) dhe periudhës së pas pavarësisë.

Figura 1. Sa i besoni EULEX-it? (n=1,100)




Perceptimi i njerëzve ishte në përputhje me pikëpamjet e të intervistuarve që mendonin se një dobësi e EULEX-it ishte dështimi për të bërë dallimin si duhet ndërmjet mandatit të tij për shtetndërtim dhe mandatit të mëhershëm të UNMIK-ut i cili ishte ekzekutiv dhe vepronte me logjikën e protektoratit (L. Greiçevci, intervistë personale, 25 korrik 2014); L. Neziri, intervistë personale, 1 shtator 2014; B.

Selimi, intervistë personale, 20 tetor 2014). Për më tepër, ky perceptim sinjalizoi një vlerësim publik të performancës së EULEX-it, i cili ishte nën atë që pritej (Grupi i fokusit, 2014). Si rezultat, ky perceptim është krijuar në bazë të sjelljes së misioneve ndërkombëtare.

Në fakt, edhe në vitet e mëhershme besimi i të anketuarve ndaj EULEX-it ishte problem. Unë e kam analizuar besimin ndaj EULEX-it në vitin 2012 dhe 2013 dhe kam nxjerr një trend në bazë të një ankete të zhvilluar në vitet përkatëse (Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë [QKSS] 2012, 2013). Nga paraqitja grafike më poshtë duket se vazhdimisht ka mbizotëruar mosbesimi ndaj institucionit e që tani ishte më i theksuar se në vitet e mëhershme. Kriza e legjitimitetit të EULEX-it vazhdimisht është injoruar në nivelin e politikave (Kursani, 2013).


Figura 2. Trendet e besimit ndaj EULEX-it 2012-2014 (n=1,054)



Gjendja duket më ndryshe me KFOR-in, ku shifrat e besimit të publikut janë dukshëm më të larta. Deri në 63% e të anketuarve i besojnë KFOR-it, 20% kanë mendim neutral ndërsa të tjerët (16%) kanë shprehur pakënaqësi. Sqarimi për këtë qëndrim është shumëdimensional. Së pari, njerëzit shprehin kënaqshmëri të përgjithshme ndaj

institucioneve të uniformuara, siç është rasti me FSK-në dhe ka një perceptim në përgjithësi pozitiv ndaj institucioneve të mbrojtjes në Ballkanin Perëndimor (shih pjesën në vazhdim). Së dyti, njerëzit janë të prirë ta shohin KFOR-in si çlirimtar të vendit, dhe besimi përcaktohet në bazë të kontributit përmes intervenimit humanitar në vitin 1999 (Grupi i fokusit, 2014). Së treti, KFOR-i ofron rehati psikologjike për njerëzit, në vend të forcave të armatosura lokale (Grupi i fokusit, 2015). Këtu, perceptimi i njerëzve po ashtu ndërlidhet me përvojën e të intervistuarve, megjithatë disa ndanin përvoja të mosbesimit në bazë të rasteve të dhëna në këtë libër.

Figura 3. Sa i besoni KFOR-it? (n=1,100)



BASHKËSIA NDËRKOMBËTARE NUK U BESON VENDORËVE

Ka një numër rastesh që e paraqesin dilemën e mosbesimit të bashkësisë ndërkombëtare ndaj vendorëve. Në të vërtetë, mosbesimi ndaj vendorëve është njëtrajtshmërisht problematik sikurse mosbesimi i vendorëve ndaj ndërkombëtarëve. Të dyja kanë implikime në mbizotërimin e përgjithshëm të pronësisë lokale dhe në nyjën ndërkombëtarë-vendorë. Sipas të intervistuarve, besimi ishte aq i lartë sa që “ndërkombëtarët gjithmonë punësonin shtetas jo-kosovarë për

përktim në gjuhën shqipe në gjyqësor” (A. Koci, intervistë personale, 28 maj 2014). Si rezultat, ata mund të kishin besim se të gjitha dokumentet gjatë procedurës gjyqësore përktheheshin si duhet. Ngjajshëm, në vitin 2005, Shtylla I-rë e UNMIK-ut (Siguria dhe Drejtësia) punësoi kosovarë përmes një arsyetimi artificial të pronësisë lokale, megjithatë pjesëtarët e stafit shpejt u marginalizuan pasi që ju ndalua qasja në intranet, sepse ekzistonte frika se do të rridhnin informacionet e klasifikuara (N. Rashiti, intervistë personale, 5 qershor 2014). Natyrisht nuk është qëllimi këtu që të nxirren shembuj të mosbesimit gjatë administrimit të UNMIK-ut gjatë të cilit në një numër rastesh kishte një mosbesim pothuaj paranoik ndaj vendorëve. Në të vërtetë, ka një numër shembujsh empirik që shtjellojnë hollësisht shkallën në të cilën bashkësia ndërkombëtare shprehte mosbesimin ndaj institucioneve kosovare edhe në Kosovën e pas pavarësisë.

Për shembull, në vitin 2011, njësitë speciale të EULEX-it, në kuadër të mandatit të tyre ekzekutiv për arrestime për krime të luftës, organizuan një bastisje cila kishte për qëllim të arrestonte kriminelë të dyshuar të luftës në rajonin e Prizrenit. Një prej personave të dyshuar ishte Drejtori i Komandës Rajonale të Policisë së Kosovës në Prizren. Gjatë vitit 2011, EULEX-i pati një prani të konsiderueshme në të gjitha stacionet policore - përfshirë edhe atë në Prizren - dhe pritej që një aksion që kishte në shënjestër drejtorin e komandës së dytë më të madhe rajonale të policisë të ishte i koordinuar me MPB-në e Kosovës. Problem në këtë rast, sipas atëbotë Ministrit të Punëve të Brendshme, ishte “mënyra spektakulare e arrestimit të drejtorit të policisë para kolegëve të tij” (B. Rexhepi, intervistë personale, 25 gusht 2014). Për më tepër, ky aksion i njëanshëm i EULEX-it që kishte në shënjestër në mënyrë specifike drejtorin, e ekspozoi mungesën e besimit të ndërkombëtarëve ndaj PK-së. Sipas Ministrit të Punëve të Brendshme, ky vlerësim ishte i gabuar pasi që drejtorit është dashur t’i dërgohet ftesa për të shkuar vullnetarisht, meqë “ai pa asnjë dyshim do ta bënte këtë gjë” (B. Rexhepi, intervistë personale, 25 gusht 2014). Bashkë me mosbesimin, ky rast nënkuptonte edhe situatën në të cilën pjesëtarët lokalë të policisë nuk mund të kryenin një aksion të organizuar nga kolegët e tyre ndërkombëtarë. Kjo situatë lehtë ka mundur të përfundoi me konfrontim të armatosur ndërmjet EULEX-it dhe Forcave Speciale të PK-së - incident që u shmang në momentin e fun-

dit me intervenimin e politikës dhe MPB-së (B. Rexhepi, intervistë personale, 25 gusht 2014).

Janë edhe dy raste të tjera empirike që pasqyrojnë mungesën e besimit ndaj PK-së. Rasti i parë ka të bëjë me protestat në qytetin e ndarë të Mitrovicës. Sipas përgjegjësive të përbashkëta të ndara ndërmjet mekanizmave ndërkombëtarë dhe vendorë të sigurisë, deri në vitin 2014 PK përfaqësonte vijën e parë të reagimit, dhe EULEX-i përfaqësonte vijën e dytë të reagimit, ndërsa KFOR-i përfaqësonte vijën e tretë të reagimit (F. Harris, intervistë personale, 2 maj 2014). Në bazë të kësaj logjike dhe marrëveshjeje, njësitë speciale të PK-së e rritën praninë e tyre në Urën e Mitrovicës për të mbajtur nën kontroll çdo përkeqësim të situatës si rezultat i protestave, ndonëse paqësore, në njërën anë. Edhe pse situata ishte nën kontroll, paraqitja e papritur e forcave speciale të EULEX-it pa kurrfarë koordinimi paraprak dhe pëlqimi nga PK nxiti reagimin e Komandantit të PK-së për Rajonin e Mitrovicës. Komandanti është cituar nga mediat të jetë grindur me komandantin e forcave speciale të EULEX-it duke e pyetur atë “kush të ka ftuar” (Telegrafi, 2012a). Gjatë bisedës ndërmjet dy komandantëve, Komandanti i PK-së e ka përfunduar argumentimin e tij duke theksuar se “...prania juaj (e EULEX-it) vetëm se ka kontribuar në tensionim, sepse prania juaj vetëm po tërheq vëmendjen dhe po sjell më shumë njerëz afër urës” (Telegrafi, 2012). Këtu, mosbesimi është i pranishëm përmes frikës së EULEX-it se PK nuk do të jetë në gjendje të merret me situatën, pavarësisht marrëveshjes paraprake për atë se kush e ka përgjegjësinë në secilin nivel. Mosbesimi po ashtu sqarohet edhe përmes dilemës mbizotëruese të disa përfaqësuesve të EULEX-it të cilët frikësohen se një pjesë e PK-së në nivel të lartë mund të mos i bindet zinxhirit komandues, prandaj nuk janë në gjendje që të parandalojnë dhunën e mundshme të bashkëqytetarëve të tyre kundër komunitetit serb (I intervistuari A., intervistë personale, 10 korrik 2014).

Situata ishte e ngjashme edhe në vitin 2013, kur kishte tensione rreth vendimit të Qeverisë së Kosovës për të ndaluar hyrjen e ministrit kontrovers serb pa portofol, Aleksander Vulin. Pas intervenimit të bashkësisë ndërkombëtare, ministri i Qeverisë së Serbisë u lejua që të hyjë në Kosovë; por ishte bashkësia ndërkombëtare, duke dashur të mbajë situatën nën kontroll, që njëanshëm filloi të kontrollojë sjelljen e zyr-

tarëve të Policisë së Kosovës në vendkalimet kufitare me Serbinë. Kjo ishte përtej mandatit të EULEX-it (Telegrafi, 2013).

Në fakt, nëse e zbërthejmë diskursin e EULEX-it në kohën e vendosjes së tij, veprimet që pasqyrojnë mosbesimin e EULEX-it ishin në mospërputhje të madhe me deklaratat e EULEX-it në fillim të misionit. Në vitin 2009, pas një sesioni të përbashkët të trajnimit, EULEX-i mbajti një konferencë për shtyp me PK-në ku e theksoi rolin e ardhshëm të misionit dhe rolin e tij në PK. Marrëdhënia ndërmjet PK-së dhe EULEX-it është ilustruar nga një zyrtar i lartë i EULEX-it në këtë mënyrë:

“...PK ishte si një ekip futbollit, përpiqej të fitonte ligën e kampionëve. EULEX-i ishte si trajneri: ai ofronte strategjinë, e monitoronte performancën për përmirësimin e kapaciteteve operative dhe menaxheriale. EULEX-i do t’iu ndihmojë por vetëm ju do të shënoni gola. Ideja është që ju dhe vetëm ju të jeni në fushën e lojës” (Harris, 2009).

Një ilustrim i ngjashëm ishte bërë 5 vite më vonë (2014) nga Shefi i EULEX-it, i cili deklaroi se:

“EULEX-i ishte në ulësen e pasagjerit, e jo në atë të shoferit” (Meucci, 2014 dhe Bashkimi Evropian, 2014).

Këto dy raste kishin ndodhur në periudhën në mes të këtyre dy deklaratave. Për ironi, diskursi dhe mesazhi kryesor i EULEX-it duket të jetë në kundërshtim të madhe me veprimet e EULEX-it. Në fakt, këta shembuj janë vetëm disa që janë bërë publik, dhe janë në vargun e madh të shembujve alternativë që e theksojnë mungesën e besimit në baza ditore (B. Rexhepi, intervistë personale, 25 gusht 2014). Mesazhi në vitin 2009 i ish zyrtarit të lartë të EULEX-it përgjegjës për mentorim, monitorim dhe këshillim të Policisë së Kosovës ishte konfirmuar të jetë në kundërshtim me veprimet e EULEX-it. Kjo u përforcua nga një i intervistuar, i cili theksoi se derisa “dokumentet e EULEX-it përmbajnë elemente për të ‘ndihmuar vendorët’ po ashtu mund të gjeni edhe folje si ‘ndërmarrja e veprimeve’, që nënkuptojnë kompetenca ekzekutive” (F. Harris, intervistë personale, 2 maj 2014).

Kjo gjë tregon se edhe publikut u ishin komunikuar mesazhe të tilla që nuk ishin në përputhje me njëra tjetrën.

Mosbesimi ndërmjet vendorëve dhe EULEX-it nuk ishte i vetmi problem. Përveç kësaj, ka raste që tregojnë një mosbesim edhe në lidhjen mes Kosovës dhe KFOR-it, edhe pse në shkallë më të vogël. Sa për të rikujtuar mandatin e KFOR-it në Kosovë menjëherë pas pavarësisë: fushëveprimi i tij u ndikua nga struktura e re institucionale dhe mandati i tij tradicional për ruajtjen e paqes dhe sigurisë, siç është përcaktuar nga Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Ndryshimi i këtij mandati u vërejt në rolin e ri të KFOR-it në ngritjen e FSK-së dhe strukturës së saj për mbikëqyrje civile (OKB, 2007). Kushtet e reja të krijuara në terren ngritën një numër pyetjesh për atë se në çka duhet të fokusohet misioni i KFOR-it. “Elefanti në dhomë” ishte pjesa veriore e Kosovës ku pati tensione të konsiderueshme dhe një numër protestash, dhe ku KFOR-i ishte i vetmi aktor i ligjshëm për të vepruar në atë rajon. Duke marrë parasysh këtë zhvillim, Qeveria e Kosovës e kritikoi mosveprimin e KFOR-it dhe “mosdijen” e tij ndaj përkeqësimit të situatës së sigurisë duke kërkuar një “përditësim” të misionit të KFOR-it sipas rrethanave të reja politike dhe shoqërore në Kosovë (Bota Sot, 2012). Përgjigja e Komandantit të KFOR-it ishte i rreptë duke theksuar se “për KFOR-in është me rëndësi që shefat e vet në NATO të jenë të kënaqur, nuk është me rëndësi se çka bën qeveria Kosovës dhe çka thotë populli i saj” (Bota Sot, 2012). Kjo deklaratë paraqet shkëputjen e misionit të KFOR-it nga realiteti në terren dhe, sipas analistëve kosovarë: kjo nuk është në përputhje me konstelacionin e ri politik dhe shoqëror në Kosovë (R.Qehaja, 2013). Pozicionimi i pandryshuar i KFOR-it ndaj zhvillimeve të reja në terren është ilustruar në mënyrë cinike nga një i intervistuar i cili theksoi se qasja e ngurtë e KFOR-it krijohet për shkak të përqendrimit të zyrtarëve dhe ushtarëve të vet vetëm brenda perimetrit të kazermave (I intervistuari B., intervistë personale, 22 korrik 2014). Kjo ide tregon se afërsia e madhe e ushtarëve të KFOR-it me kazermat siguron që ata të mos kenë aq shumë lidhje dhe as të mos mbajnë kontakte me faktorët lokalë. Kjo ka shpjer drejt një shkëputjeje dhe përshtypje të vjetruar të disa zyrtarëve të lartë të KFOR-it për rrethanat në terren.

Në fakt, mungesa e llogaridhënies së misioneve ndërkombëtare duket të jetë shqetësim i madh për partnerët e tyre kosovarë (B. Selimi, intervistë personale, 20 tetor 2014) për shkak të imunitetit tepër të madh dhe mbikëqyrjes së kufizuar nga përfaqësuesit e komuniteteve lokale, të cilët nuk mund të vlerësonin efikasitetin dhe aftësinë reaguese të misionit. Kështu, deklarata e Komandantit të KFOR-it paraqet nivelin e lartë në të cilën misioni ndërkombëtar u përgjigjet atyre që përfitojnë nga përkrahja ndërkombëtare.

Për më tepër, shembuj që sqarojnë dilemën e mosbesimit të KFOR-it mund të përshkruhen në kontekstin e paradigmës së ekzagjruar të stabilitetit (shih pjesën e ardhshme). Ky rast tregon se niveli më i lartë i mosbesimit është shënuar gjatë vitit 2011, kur KFOR-i është parë duke e vëzhguar në mënyrë të fshehtë bazën e Forcave Speciale të Policisë së Kosovës në Mitrovicë. Njësia e inteligjencës e KFOR-it kishte pranuar disa informata të pakonfirmuara se Qeveria e Kosovës ka mundësi të intervenojë në pjesën veriore të Kosovës për të rivendosur sundimin e ligjit (Telegrafi, 2012). Në këtë mënyrë, KFOR-i synonte të mbante situatën nën kontroll dhe që eventualisht të ndalonte lëvizjen e PK-së në pjesën veriore të Kosovës - sjellje kjo që nuk është në përputhje me partneritetin ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe KFOR-it (B. Rexhepi, intervistë personale, 25 gusht 2014).

STABILITETI I EKZAGJERUAR

Përpjekjet e Kosovës që të marr sovranitetin e plotë dhe të krijojë aparatit shtetëror është shikuar nga një perspektivë mjaft komplekse. Bashkësia ndërkombëtare ka bërë kalkulime të tepruara për çdo zhvillim institucional duke i analizuar implikimet e mundshme për stabilitetin. Vlerësimi i sigurisë për implikimet në stabilitet nuk kanë evoluar përkundër përmirësimeve substanciale të gjendjes gjatë këtyre periudhave (R. Marmullaku, intervistë personale, 17 korrik 2014; N. Rashiti, intervistë personale, 5 qershor 2014; L. Neziri, intervistë personale, 1 shtator 2014). Si pasojë, vlerësimi i stabilitetit në periudhën pas pavarësisë nuk ka dalluar në thelb nga vlerësimi i bërë në periudhat e pas konfliktit. Si rezultat, hulumtimi nuk ka mundur të gjej ndonjë ndryshim të madh në diskursin dhe vlerësimet e misioneve ndërkombëtare, për shembull, në mes të viteve 2001 dhe 2013 (N. Ibi-

shi, intervistë personale, 23 maj 2014; B. Selimi, intervistë personale, 20 tetor 2014; L. Greiçevci, intervistë personale, 25 korrik 2014; B. Rexhepi, intervistë personale, 25 gusht 2014).

Në të vërtetë, kur shqyrtohen të dhënat empirike prapa rolit të bashkësisë ndërkombëtare në shumicën e rrethanave të pas konfliktit, stabiliteti duket të jetë një ndër fjalët të përdorura më së shpeshti. Meqë interesi më i madh i bashkësisë ndërkombëtare ishte ruajtja e stabilitetit, ky fokus shpesh ka shpër në drejtim të pasojave të paqëllimshme për proceset e zhvillimit. Kur mbizotërojnë argumentet për stabilitet, situata zakonisht përfundon në një kompromis tipik ndërmjet stabilitetit dhe, për shembull, zhvillimit në fushën e sundimit të ligjit. Për këtë arsye, Kosova jo vetëm që paraqet një rast të rëndësishëm por në mënyrë të veçantë i paraqet tiparet që e theksojnë këtë dilemë. Frustrimi kundër qasjes lineare të bashkësisë ndërkombëtare është distiluar në një koncept i cili i ngjan “sigurisë së militarizuar” (Kurti, 2011, f. 92). Kënaqshmëria tepër e madhe me mbajtjen e paqes dhe stabilitetit mund të përdorej si vegël për të shantazhuar zhvillimet, siç është manifestuar nga grupet ekstremiste gjatë gjithë kësaj periudhe.

Ish shefi i UNMIK-ut në vitin 2005 dhe 2006, Soren Jessen Petersen, e ka pranuar se disa zhvillime në sundimin e ligjit në Kosovë kanë ndodhur në momentet e fundit për të ndalur ndonjë aksion apo hetim policor duke u bazuar në stabilitetin e ekzagjeruar “...[disa pjesëtarë të bashkësisë ndërkombëtare] shprehën brengosjen e thellë për veprimet e UNMIK-ut dhe Policisë së Kosovës në zbatimin e sundimit të ligjit. Këto veprime, sipas tyre, do të prekin stabilitetin” (Petersen, 2014). Petersen kishte shtuar se ai kishte vlerësuar se stabiliteti do të prekej si rezultat i mosveprimit. Me fjalë të tjera, prania e kriminelëve të luftës ose grupeve të organizuara kriminale paraqisnin sfidën kryesore për sigurinë dhe stabilitetin nëse nuk ndërmerren veprime serioze për t’i sjell ata para drejtësisë.

Në të gjitha nivelet argumentet politike ushqenin nocionet e stabilitetit të ekzagjeruar dhe obsesiv. Nëse kthehemi te veprimet ose mosveprimi i EULEX-it, përpjekja primare e këtij misioni ishte që të arrihet konsensusi ndërmjet shteteve anëtare për shkak të pengesave që paraqisnin kryesisht pesë vendet që nuk e kishin njohur shtetësinë

e Kosovës. Në fakt, nuk ishte e mundur të tejkalohen argumentet e këtyre shteteve: ato duhet të merren në konsideratë. Mesazhet ishin të thjeshta dhe krejtësisht politike: duhet të dërgoni më shumë policë në terren për të siguruar parandalimin e çfarëdo përkallëzimi, pavarësisht nëse ato janë në kundërshtim me vlerësimin e rrezikut dhe kërcënimit (F. Harris, intervistë personale, 2 maj 2014). Stabiliteti i ekzagjeruar zakonisht është sqaruar me terma specifik në të cilën “Personi A nga ky komunitet mund të përdor dhunën kundër personit B të një komuniteti tjetër” kështu që duhet të bëhen të gjitha përpjekjet për të siguruar që të mos ndodh kjo (F. Harris, intervistë personale, 2 maj 2014).

Në fakt, stabiliteti i ekzagjeruar duket se nuk vlen vetëm për Kosovën. Ai është një normë e cila aplikohet nga bashkësia ndërkombëtare në shumicën e rrethanave të pas konfliktit. Për të demonstruar kënaqshmërinë e tepruar dhe ekzagjerimin e stabilitetit në vendet e tjera, një ish zyrtar i Zyrës së Përfaqësuesit të Lartë (OHR) në BeH, duke ju përgjigjur argumenteve të boshnjakëve se “bashkësia ndërkombëtare nuk ka sjell asgjë përveç paqes në Bosnjë e Hercegovinë” u përgjigj me një vetëbesim të lartë se “po, paqja është gjë e madhe dhe ne jemi të kënaqur ta ruajmë atë” (I intervistuari C., intervistë personale, 31 tetor 2014). Sigurisht se ka një çmim të lartë për paqen në të cilën bashkësia ndërkombëtare ka investuar me sukses. Në rastin e BeH dhe Kosovës ajo ka ndaluar një luftë të përgjakshme e cila shkaktonte masakra dhe dëme katastrofale në pronë. Sidoqoftë, dobësitë në procesin e zhvillimit dhe shtetndërtimit nuk duhet të arsyetohen me suksesin e arritur në fillim të periudhës së pas konfliktit në arritjen dhe ruajtjen e paqes.

Ka një numër rastesh që sqarojnë shkallën në të cilën ka ndërhyrë stabiliteti i ekzagjeruar. Është me rëndësi të ndahen implikimet e dilemës së stabilitetit të ekzagjeruar nga zhvillimi institucional, duke nënvizuar implikimet për ambientin e sigurisë.

STABILITETI I EKZAGJERUAR NË RAPORT ME ZHVILLIMIN INSTITUCIONAL

Dilema mbi komponentin e mbrojtjes të Kosovës paraqet një shembull intrigues për ekzaminimin e dilemës obsesive dhe të ekzagjeruar të

stabilitetit. Ajo paraqet një rast në të cilin modeli i drejtuar nga jashtë për FSK-në ishte më shumë i imponuar dhe nuk ishte i bazuar në nevojat dhe vlerësimin e kërcënimit. Argumentet për imponimin e FSK-së kanë qenë krejtësisht politike: jo politike në aspektin e politikës së brendshme por në atë të “politikës së lartë”. Kjo paraqet një prej shembujve empirik më gjithëpërfshirës i cili tregon një mungesë të plotë të respektit për përfshirjen e vendorëve, duke shkelur kështu thelbin e pronësisë lokale.

Në vitin 2007, i Dërguari Special i OKB-së për Zgjidhjen e Statusit Përfundimtar të Kosovës, Marti Ahtisaari, në raportin e tij përfundimtar erdhi në përfundim se shteti që po krijohet duhet të ketë një institucion – FSK-në - me kapacitet personeli prej 2,500 pjesëtarësh aktivë dhe 800 pjesëtarësh rezervë, të armatosur lehtë dhe me mandatat të qartë në detyrat lidhur me reagim në rast fatkeqësive dhe në mbrojtje civile (OKB, 2007). Po ashtu u krijua edhe momenti për të propozuar një institucion të ri si rezultat i kërkesave të bashkësisë ndërkombëtare për të shpërbërë Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK) - një organizatë e mbrojtjes civile e cila ka funksionuar nga viti 1999 deri në 2008 si pjesë e procesit të çmilitarizimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK, 1999). Ideja prapa “shpërbërjes me dinjitet” të TMK-së (OKB, 2007) kishte për qëllim të shkëpuste lidhjet ndërmjet institucioneve shtetërore të Kosovës dhe çfarëdo lidhjeje të mëtejshme të tyre me luftën, duke argumentuar se lidhjet e mëtejshme do të ishin të dëmshme për shoqërinë shumetnike në të cilën të gjitha bashkësitë (domethënë edhe bashkësitë e pakicave) përfaqësohen në mënyrë të barabartë në forcën e ardhshme. Vendimi për të shpërbërë TMK-në nxiti reagime nga pjesëtarët të cilët përgjithësisht nuk mund të pajtoheshin me arsyetimin, dhe me sfidat për karrierat e tyre të ardhshme. Shqetësimet kundër kësaj force të fundit ishin të qarta: jo më shumë se 50% e pjesëtarëve të TMK-së do të kenë mundësinë t'i bashkohen forcës së re, përderisa pjesa tjetër e mbetur, pavarësisht moshës dhe aftësive, do të duhet të hyjnë në një program të ri-integrimit. Kjo do të rezultonte në pensionim të parakohshëm ose marrjen e ndonjë pozite në punësim civil. Për më tepër, ky vendim ishte politik dhe ishte iniciuar vetëm nga bashkësia ndërkombëtare pa kurrfarë konsultimi praktik me përfaqësuesit e qeverisë së Kosovës dhe pjesëtarët e TMK-së. Megjithatë, përfaqësuesit e qeverisë u detyruan ta pranojnë këtë hap

duke pasur parasysh koncesionet e përgjithshme që kërkoheshin për të arritur qëllimin e tyre - mbështetjen ndërkombëtare për shtetësinë e Kosovës (Grupi i fokusit, 2015).

Qëllimi ishte që të mos fokusohesh në procesin e shpërbërjes së TMK-së, por të fokusohesh në zhvillimet e institucioneve shtetërore dhe në periudhën pas pavarësisë. TMK paraqiste një shembull që pasqyron një zgjidhje të përcaktuar nga jashtë për shpërbërjen e një institucioni (pra, në vend të pëlqimit vendor) për arsye politike dhe shoqërore (pra, e lirë nga mentaliteti që lidhet me luftën). Mirëpo, le të vlerësojmë pyetjen kryesore lidhur me FSK-në: çka e shtyri bashkësinë ndërkombëtare të propozojë një institucion të sigurisë i cili nuk do të dallojë aq shumë nga mandati i TMK-së së shpërbërë? Nëse do të fillohej rindërtimi i një institucioni nga zeroja, me një strukturë të re dhe në kontekst sovran, pse të mos i jepet mandati edhe lidhur me mbrojtjen? Hulumtimi ka eksploruar një numër faktorësh që kanë ndikuar në vendimin për të pasur një institucion që ka vetëm mandat për mbrojtje civile në Kosovën e pas pavarësisë. Vërtetë, argumentet politike në kuadër të kontekstit të stabilitetit duket se e lënë nën hije çdo arsyetim kundër strukturës së FSK-së. Prandaj, vendimi ishte çështje e cila nuk është diskutuar me autoritetet kosovare, e lëre më me qytetarët. Kjo përfaqësonte një institucion që ishte aplikuar në vend të konsultimeve me përfaqësuesit e qeverisë dhe faktorët e tjerë vendorë, duke ngritur një dilemë të madhe mbi shkallën në të cilën vendorët kanë të drejtën e “fjalës” në procesin e dizajnit të institucionit. Si rezultat, këto dispozita ishin të panegociueshme (I intervistuari D., intervistë personale, 30 shtator 2014). Arsyet pse ky kapitull është bërë i panegociueshëm kurrë nuk janë bërë publike, qoftë për kosovarët ose të huajt. Ekziston një supozim i përbashkët se, nëse do të publikoheshin dispozitat për sigurinë, ato nuk do të ishin sa duhet bindëse për audiencën lokale në mënyrë që të arsyetohet modeli i imponuar nga jashtë për FSK-në. Kjo dilemë ishte e pranishme edhe me imponimin e jashtëm të strategjisë së sigurisë nacionale (shih Kapitullin V).

Pjesa e parë e argumentit për dizajnimin e FSK-së ishte politik dhe krejtësisht në përputhje me stabilitetin e ekzagjeruar dhe obsesiv. Këtu, dizajnuesit pretendonin se meqë pavarësia e Kosovës kontestohet nga një pjesë e shteteve anëtare të OKB-së, kapacitetet e FSK-së

duhet të nënkuptonin një strukturë të balancuar e cila nuk do të reflektonte forcën e armatosur tradicionale por diçka në mes - që tingëllon më pak se ushtri e më shumë se polici (I intervistuari D., intervistë personale, 30 shtator 2014). Në fakt, të njëjtat argumente janë aplikuar për krijimin e Policisë së Kosovës në periudhën menjëherë pas konfliktit.⁷

Argumenti i dytë ishte ushtarak që theksonte se krijimi i një ushtrie tradicionale do të ishte kërcënim i drejtpërdrejtë për Serbinë; trashëgimtare e Jugosllavisë e cila nuk e njeht sovranitetin e Kosovës dhe çfarëdo ndërtimi të institucioneve shtetërore. Sipas këtyre argumenteve, krijimi i kapaciteteve kosovare të mbrojtjes do të paraqiste kërcënim ushtarak për Serbinë pasi që Kosova do të kishte mjete për të sulmuar asetet ushtarake në Serbinë Jugore (I intervistuari D., intervistë personale, 30 shtator 2014).

Argumenti i tretë mbulon dy argumentet paraprake nën ombrellën e tregjeve të hapura dhe neo-liberalizmit, duke sugjeruar që Kosova nuk ka nevojë për asnjë lloj kapaciteti ushtarak pasi që nuk ka ndonjë kërcënim ushtarak për Kosovën, si dhe se mbajtja e atyre kapaciteteve do të kushtonte shumë (I intervistuari D., intervistë personale, 30 shtator 2014).

Argumenti i parë dhe i dytë bien nën dilemën e stabilitetit të ekzagjeruar obsesiv dhe nuk mund të konsiderohen të qëndrueshëm: Së pari, vendimi për të mbështetur procesin e shtetndërtimit në Kosovë është dashur të pasohet me mbështetjen e ndërtimit të tërë aparatit shtetëror, përfshirë sektorin e mbrojtjes. Njohja e vendeve që janë pro pavarësisë - e cila paraqet qëndrimin e vendeve të caktuara ndaj shtetësisë - nuk nënkuptonte asnjë dilemë mbi të drejtën e kosovarëve për të marrë sovranitetin e plotë.⁸ Në këtë kontekst, argumentet e

7 Synimi i bashkësisë ndërkombëtare ishte që të rris kapacitetet e Policisë së Kosovës vetëm në fushën e rendit publik. Kjo ishte për shkak se synimi primar i bashkësisë ndërkombëtare ishte që të ndërtojë një forcë policore për sfidat menjëherë pas konfliktit, dhe të përmbush kërkesat për siguri bazike. Kjo e kategorizoi ndërtimin e forcës më shumë për nivel krahinor, se sa për nivel shtetëror (B. Selimi, intervistë personale, 20 tetor 2014). Prandaj janë bërë investime për tu siguruar se policia nuk do të përngjan si shërbimi policor që ekziston në shtete normale.

8 Shih letrat e njohjes së pavarësisë së Kosovës.

tjera shtesë që kanë të bëjnë me praninë e misionëve ndërkombëtare ushtarake siç është KFOR-i, e me këtë edhe përmbushjen e detyrave lidhur me mbrojtjen nga ky mision, janë shkurtpamëse dhe kundër thelbit të pronësisë lokale. Misionet ndërkombëtare, përfshirë KFOR-in, janë kalimtare sepse, siç me të drejtë ka theksuar Donais, “misionet ndërkombëtare nuk mund të zëvendësojnë përgjithmonë institucionet vendore” (Donais, 2012b, min. 48). Një analogji ka mundur të bëhet me BeH, e cila nuk ka pasur pengesë në krijimin e forcave të armatosura, por që në fillim ka pasur dy ushtri (njëra e Republikës Serbe dhe tjetra e Federatës së BeH) në një shoqëri thellësisht të ndarë. Fillimisht, kishte pasur edhe prani ushtarake të NATO-s e cila më vonë u zëvendësua nga një prani ushtarake e BE-së paralelisht me praninë e forcave të armatosura të BeH-së (NATO, 2004).

Përndryshe, argumenti ushtarak dobësohet më tej pasi që, supozohet FSK në mënyrë ideale do të pasqyrojë të njëjtën forcë të personelit (2,500 pjesëtarë aktivë) por me mandat që lidhet me mbrojtjen, atëherë nga këndvështrimi ushtarak tradicional, si mundet ky institucion të paraqes kërcënim ndaj një vendi që ka një forcë të armatosur të themeluar mirë e me numër të personelit, të paktën numerikisht, 12 herë më të madh se FSK? Argumentet që ishin paraqitur në qarqet të cilat ishin kundër shtetësisë - të cilave duket se bashkësia ndërkombëtare u jepte përparësi - kishin në mendje një kundërshtim të vazhdueshëm ndaj krijimit të mekanizmave shtetëror. Për shembull, strategjia e sigurisë nacionale e Serbisë e vitit 2009 i referohet kërcënimit rajonal që vjen si rezultat i krijimit të shtetit të Kosovës. Strategjia e bën të qartë se “krijimi i të ashtuquajturës FSK paraqet një kërcënim serioz ndaj regjimit ekzistues të kontrollit të armëve dhe e dëmton ekuilibrin e fuqive në rajon” (Qeveria e Serbisë, 2009, f. 8). Megjithatë, strategjia nuk sqaronte në aspektin ushtarak se si FSK (me mandat për mbrojtje civile) mund të jetë kërcënim për rajonin - e lëre më të marrë parasysh argumentet politike. Për më tepër, këto vlerësime politike nuk mundën të provoheshin kurrë sepse, përkundrazi, kishin mbizotëruar argumentet që sugjeronin se pavarësia e Kosovës është parakusht për stabilitetin dhe sigurinë. Është kështu sepse asnjë prej synimeve të Komandës së FSK-së ose pjesëtarëve të saj nuk nënkuptonin ndonjë tendencë të kërcënimit të sigurinë kombëtare të Serbisë në Kosovën e pas pavarësisë thjeshtë sepse, edhe nëse hipotetikusht do të ishte kështu,

FSK ishte nën mbikëqyrjen e rreptë dhe udhëheqjen e KFOR-it si dhe të Qeverisë së Kosovës.

Argumenti më i fundit se “nuk ka nevojë të ketë forcë të mbrojtjes” po ashtu ishte në kundërshtim me qasjen e standardizuar të dilemës së bashkësisë ndërkombëtare për stabilitet. Në njëren anë, bashkësia ndërkombëtare i përsëriste vazhdimisht argumentet për nevojën e ruajtjes së stabilitetit, derisa në anën tjetër, ajo i hidhte poshtë kërkesa tradicionale për të pasur forca të armatosura. Problemit të këtij argumenti mund t’i jepet një përgjigje e thjeshtë: Kosova nuk bën përjashtim nga vendet e tjera të rajonit të cilat i kanë mbajtur kapacitetet ushtarake, edhe pse të kufizuara dhe të reformuara në kontekstin e integritetit në NATO. Forcat e armatosura bashkëkohore pritet të mbrojnë sovranitetin dhe integritetin e shtetit; të ndihmojnë autoritetet e tjera të shtetit nëse kërkohet dhe të kontribuojnë në misionet paqeruajtëse ndërkombëtare. Perspektivat e forcave të armatosura bashkëkohore në kontekstin e Kosovës, janë plotësisht në përputhje me vizionin e qeverisë dhe të shoqërisë për tu anëtarësuar në NATO.


Duke marrë parasysh zhvillimet e brendshme, rishikimi i diskursit të aktorëve politikë dhe shoqërisë civile në Kosovë zbulon kërkesat e vazhdueshme për nevojën e modifikimit të mandatit të FSK-së. Në fakt, periudha prej 5 vitesh pas pavarësisë dhe pothuaj 10 vitesh të administrimit ndërkombëtar kanë shërbyer si “tranzicion” për të diskutuar për krijimin e strukturës së mbrojtjes. Nga perspektiva institucionale, këto 5 vite kanë shërbyer për mbarëvajtjen e detyrave tashmë të vendosura të mbrojtjes civile në bazë të përvojës me FSK-në, konsolidimin e strukturës së re dhe ndërtimin e kapaciteteve. Të gjitha këto pika, megjithatë, synojnë të arsyetojnë përmbushjen e mandatit të FSK-së dhe forcojnë edhe më shumë argumentet për krijimin e një force me mandat ushtarak, sipas dispozitave të “plotësimi të kushteve burokratike”. Vlerësimi që është bërë nga prania e NATO-s, në të cilën ajo fillimisht verifikoi kapacitetet gjysmë-operacionale të FSK-së (2012) dhe kapacitetin e plotë operacional (NATO, 2013).

Si rezultat, në vitin 2012, Qeveria e Kosovës e filloi procesin e Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë (RSSS) (Qeveria e Kosovës, 2014), i ngjashëm me një rishikim normal të mbrojtjes në të gjitha

vendet sovrane. Synimi fillestar ishte që të bëhet një rishikim i plotë i sektorit të sigurisë; megjithatë, synimi primar ishte që të hapet diskutimi për modifikimin e mandatit të FSK-së drejt një mandati më tradicional të mbrojtjes. U zbatua një qasje mbarëqeveritare dhe konsultimi me shoqërinë civile për të siguruar qasje gjithëpërfshirëse në planifikimin e politikave. Po ashtu, procesi u zhvillua në konsultim me partnerët e NATO-s për tu siguruar se forca e ardhshme të jetë në pajtim me standardet e NATO-s (I intervistuari E., intervistë personale, 2 nëntor 2014). Pas dy vitesh të procesit, në mars 2014, Qeveria e Kosovës lansoi vendimin për të krijuar Forcat e Armatosura të Kosovës (FAK) të cilat do të përbëheshin nga 5,000 pjesëtarë aktivë dhe 3,000 pjesëtarë rezervë (Qeveria e Kosovës, 2014).

Procesi u duk se po merrte mbështetje të gjerë nga i tërë spektri politik dhe shoqëror. Për këtë qëllim, është shumë me rëndësi që të matet përkrahja e njerëzve për këtë vendim kur të zbërthehet legjitimiteti dhe gjithëpërfshirja e një vendimi të tillë. Anketa e mati perceptimin publik mbi vendimin e Qeverisë së Kosovës për krijimin e FAK-ut. Perceptimi i njerëzve u mat duke i pyetur qytetarët se a: (a) pajtohen me mandatin ekzistues të FSK-së, ose (b) e miratojnë vendimin për themelimin e FAK-ut. Në një hulumtim të opinionit publik, 87% e kosovarëve i kanë dhënë përkrahje të pa rezervë transformimit të FSK-së në FAK, përderisa vetëm 6% deklaruan se ata e mbështesin mandatin e FSK-së - mandat ky vetëm me detyra të mbrojtjes civile. Në fakt, nga pikëpamja numerike, është e sigurt se 87% e qytetarëve e mbështetën dizajnin institucional të drejtuar nga vendorët, derisa vetëm 6% do të ishin të kënaqur me një dizajn të drejtuar nga jashtë. Vetëm 7% e të anketuarve nuk mundën të japin mendim për këtë çështje. Kjo tregon se tema e reformës së mbrojtjes jo vetëm që është lart në agjendën e qytetarëve të zakonshëm të Kosovës por ata po ashtu nuk pranojnë kurrfarë opsioni tjetër përveç krijimit të një celule mbrojtës.

**Figura 4. Cili është mendimi juaj për të ardhmen e FSK-së?
(n=1,101)**



Është e vërtetë se mbështetja më e madhe e publikut për forcat e armatosura ose personelin e uniformuar nuk është trend vetëm në Kosovë por është qëndrim tradicional i njerëzve në Ballkanin Perëndimor (Çelik, 2012). Ajo përfaqëson një trend historik që tregon bazën sociologjike që qëndron prapa mbështetjes publike për forcat e armatosura. Megjithatë, nuk është rastësi që informacionet kthyesë të qytetarëve në çështjet që kanë të bëjnë me FAK-un tregojnë respektin për uniformën nga një perspektivë tradicionale (Grupi i fokusit, 2014). Perceptimi publik në rastin e përpjekjeve të Kosovës për themelimin e institucioneve të mbrojtjes shërben si një argument tradicional në shqyrtimin e opinionëve të banorëve vendas në procesin e dizajnit institucional. Përveç kësaj, është me rëndësi të mbahet në mend se mbështetja dhe pëlqimi i publikut analizohet gjerësisht në dimensionin konceptual. Duhet të ri-konsiderohet argumenti i Dominik Zaum se legjitimiteti është element vendimtar në vendet e post-konfliktit. Zaum me të drejtë e merr parasysh rëndësinë e legjitimitetit mbi autoritetin e bashkësisë ndërkombëtare, kur thotë se ky autoritet nuk mund të jetë absolut dhe duhet të mbahet përgjegjës (Zaum, 2006). Autoriteti ndërkombëtar nuk duhet të lë në hije autoritetin lokal nëse ai është i dobët (Hopgood, 2009) pavarësisht arsyeve e problemeve të tij të brendshme (Di Lellio, 2009).

Prandaj, sa i përket modelit të imponuar të FSK-së, autoriteti i bashkësisë ndërkombëtare ishte absolut në rastet kur përfaqësuesit vendorë nuk e jepnin pëlqimin. Pëlqimi në përgjithësi paraqet një burim dhe vegël të fuqishme për përcaktimin e obligimeve politike në kohën kur ai duhet të ofrohet në mënyrë të plotë, nga të gjithë faktorët (Zaum, 2006). Mungesa e pëlqimit mund të interpretohet si pozicionim i dobët i vendorëve, ose çka William Bain e ka përkufizuar si “mungesë e autoritetit për të rezistuar” (Bain, 2006, f. 537). Autoriteti për të rezistuar është i pranishëm në rastet kur faktorët lokalë janë në gjendje t’i thonë “Jo” veprimeve të caktuara të bashkësisë ndërkombëtare. Në të vërtetë, përkundër argumenteve të forta politike, të sigurisë, institucionale dhe shoqërore, kosovarët kanë pasur një pozicionim të dobët për të rezistuar kornizave institucionale të imponuara nga jashtë në frymën e negociatave të fuqishme dhe dilemave politike në rrugën drejt shtetësisë.

Në përgjithësi, dilema mbi dikotominë FSK (mbrojtje civile) - FAK (mbrojtje) - paraqet një varg pasojash që do të konsiderohen si mësimet të nxjerra për veprimet e më pastajme nga bashkësia ndërkombëtare në një ambient të ngjashëm. Së pari, vlerësimi i stabilitetit, rreziqeve dhe kërcënimeve duhet të evoluojë në përputhje me ndryshimet e rrethanave në terren. Vlerësimi i politizuar i sigurisë përmban kundërthënie që ndikojnë në dizajnin e mirëfilltë institucional. Së dyti, rasti tregon se mos marrja parasysh e qasjes nga “nga poshtë-lart” është e paqëndrueshme pasi që ose mund të kthehet në mospërkrahje të publikut ndaj bashkësisë ndërkombëtare ose në rritje të diskursit në favor të ndonjë modeli tjetër. Së treti, dhe nga perspektiva institucionale, tranzicionet e krijuara në mënyrë artificiale e ndjekin modelin “shpërbëj-krijoh-shpërbëj-krijoh” (UÇK-TMK-TMK-FSK), duke çuar kështu në implikime të mëdha financiare dhe institucionale dhe dobësi për memorien institucionale.

STABILITETI I EKZAGJERUAR NË RAPORT ME KËRCËNIMET E SIGURISË

Referenca e tepruar e stabilitetit ka qenë e pranishme në çdo kontekst zhvillimor të rendit publik dhe detyrave të sigurisë. Ato argumente janë kryesisht dhe thëllësisht të lidhura me “politikën e lartë”. Këtu është me rëndësi të citohet një përkufizim cinik i preokupimit me stabilitetin e tepruar dhe “reagimin e Serbisë” të komunikuar nga një ish

zyrtar i lartë i bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë, që thotë se “...nëse Ministri i Punëve të Jashtme të Serbisë thotë se ‘do të shembet qielli ‘ në Kosovë’, i tërë diskursi dhe veprimi [i bashkësisë ndërkombëtare] do të bazohet në atë deklaratë” (F. Harris, intervistë personale, 2 maj 2014). Kjo bëhet e qartë edhe nga përvoja e ish zyrtarëve policorë që kanë konfirmuar se, për shembull, edhe intervenimi i policisë në zonat e banuara me serbë në përpjekje për të kapur ndonjë grup hajdutësh konsiderohej me rrezik politik (B. Selimi, intervistë personale, 20 tetor 2014). Prandaj, nuk ishte rastësi që pothuaj 6 vjet pas pavarësisë dhe 15 vjet pas luftës, KFOR-i i mbante disa detyra që tejkalonin mandatin e tyre fillestar të ruajtjes së kufijve dhe mjedisit të sigurisë. Ish ministri i FSK-së e ka pranuar se detyrat e KFOR-it kryesisht koordinoheshin nga komanda e tyre në NATO e rrallë në konsultim me Qeverinë e Kosovës. Ai shtoi se në disa faza, detyrat e misionit të KFOR-it kanë mund të ri-dizajnoheshin në frymën e rritjes së kapaciteteve ku, për shembull, ruajtja statike e objekteve të trashëgimisë kulturore që e bënte KFOR-i ka mundur lehtë të bëhet nga Policia (A. Çeku, intervistë personale, 24 tetor 2014). I intervistuari e ka pranuar se ata (Qeveria e Kosovës) rregullisht ka kërkuar nga KFOR-i një përcaktim të përbashkët të hapave që duhet të ndërmerren për të eliminuar argumentet potenciale që në mënyrë lineare e konsideronin vendin jostabil (A. Çeku, intervistë personale, 24 tetor 2014).

Në fakt, kjo vijë e pandryshuar e KFOR-it – sipas qasjes së standardizuar të Kapllanit - u përshtatet argumenteve që janë të prira të shmangin çfarëdo lidhje në mes të institucioneve ushtarake dhe atyre të sigurisë. Ky qëndrim nuk ka dalluar në periudhat e ndryshme (Shih Kapitullin III). Në shkurt 2012, Kosova shënoi 4 vjetorin e pavarësisë në të cilin tradicionalisht prania e gardës së FSK-së përbënte një pjesë zyrtare e ceremonisë. Kjo zakonisht është një gjysmë-paradë në të cilën FSK “i nxjerr” njësitë më të mira të saj në sheshin kryesor të Prishtinës. Njësitë dukej se këndonin një këngë që shprehte motive të luftës. Kjo situatë e detyroi KFOR-in, në cilësinë e mbikëqyrësit të FSK-së, të rishikojë bashkëpunimin dhe të vlerësojë shkaqet dhe pasojat e këngës. Si rezultat, nevoja për të ruajtur stabilitetin “me çdo kusht” i detyroi përfaqësuesit e KFOR-it të kërkojnë nga mediat që të mos transmetojnë pjesën e paradës në të cilën këndonin njësitë e FSK-së (KTV, 2012). Argumentet ishin të shkruara dhe të qarta: në këngë kishte përmbajtje

ushtarake dhe motive që lidheshin me luftën. Reagimi ndaj kësaj qasjeje të KFOR-it erdhi nga organizata më e pavarur mediatike në Kosovë - Kohavisioni (KTV), e cila kritikoi haptazi qëndrimin dhe ndërhyrjen e KFOR-it në media (KTV, 2012). Ky rast nuk përfaqëson sjelljen e përgjithshme të KFOR-it, por tregon se qasja e standardizuar e misioneve ndërkombëtare është e prirë të shkel rregullat themelore të kontrollit demokratik dhe llogaridhënies së forcave të armatosura. Për më tepër, ai paraqet shkelje të lirisë së mediave dhe lirisë së shprehjes. Në këtë rast, tendenca e misionit ushtarak që të përpiket të ndikoj në politikat redaktuese cenon parimet themelore të mbikëqyrjes demokratike të sektorit të sigurisë. Nëse bashkësia ndërkombëtare përfaqëson elementet morale të rrënjosura thellë, elemente këto që duhet të zbatohen për hir të “qëllimeve të mira” (Bain, 2006, f. 528).

Një rast i ngjashëm ndodhi në vitin 2010 në të cilin prania e Gardës së Nderit të FSK-së gjatë “Epopëjës së UÇK-së” e nxiti KFOR-in që të “ngrij” marrëdhëniet me FSK-në (Kosovalive, 2010). Ndonëse vendimi nuk zgjati shumë, mesazhi që ai përcolli ishte politik dhe mjaft patronizues, duke paraqitur autoritetin e fortë të misionit ndërkombëtar mbi autoritetin e kufizuar të sektorit evolues kosovar të sigurisë. Në të vërtetë, janë dy argumente që mund të sqarojnë mjaftueshëm këtë situatë: I pari, prania e FSK-së në një ceremoni që ka të bëjë me luftën dhe prania e armëve të lehta në këtë ceremoni. Si rezultat, janë krijuar dy paradokse: paradoksi i parë që reflekton përdorimin e sjelljes shtrënguese me qëllim që të zhvesh njerëzit dhe pjesëtarët e FSK-së nga besimi i tyre për atë që ka ndodhur në të kaluarën, dhe i dyti, qëllimi për tua ndaluar pjesëtarëve të FSK-së të mbajnë armë të lehta pa varësisht dispozitave ligjore që i lejojnë FSK-së të mbaj armë të lehta.

Për ironi, në fillim të 2015 Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s vizitoi Kosovën. Gjatë takimit me Presidentin e Kosovës, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s u prit me gardën ceremoniale (Koha, 2015). Pjesëtarët e gardës, ndoshta pjesërisht të përbërë nga të njëjtit oficerë si në vitin 2010, i mbajtën armët e tyre të lehta: po të njëjtat armë për të cilat misioni i KFOR-it kishte pezulluar përkohësisht bashkëpunimin me FSK-në disa vite më herët. Është vështirë të thuhet se a ka qenë ky ndryshim në qëndrimin e NATO-s për shkak të ndryshimit gradual të qëndrimit të tyre politik apo se NATO-ja kishte reflektuar për sjelljen

e saj në të kaluarën. Sido që të jetë, në të dy opsionet kishin mbizotëruar argumentet në favor të respektimit të institucioneve lokale e me ketë të pronësisë lokale.

Nëse u kthehemi dy rasteve të vitit 2010 dhe 2012, ato duken se e vënë FSK-në në pozitë më të dobët, ku “autoriteti më i fortë ndërkombëtar” e udhëzoi FSK-në se si të sillet, si në aspektin institucional ashtu edhe atë shoqëror. Po ashtu ka një lloj konfuzioni se deri ku mund të ushtrohet një kompetencë e tillë. Ky autoritet, siç argumenton Hanah Reich, mund të (keq)përdoret lehtë, jo vetëm për të siguruar që vendorët të ndjekin disa rrethana të caktuara, por edhe për të nxitur një proces eksperimental të të mësuarit (Reich, 2006). Për shembull, prania ushtarake ushtroi disa funksione që asnjë prej organizatave ndërkombëtare perëndimore nuk i kishte aplikuar që nga përfundimi i Luftës së Ftohtë. Për të ilustruar këtë sjellje, një zyrtar i lartë i KFOR-it ngriti shqetësimin e tij të thellë për një fotografi që e kishte gjetur në kazermën e FSK-së të një ish udhëheqësi të UÇK-së (I intervistuari F, intervistë personale, 4 mars 2014). Ky është padyshim një shembull obsesiv i paradigmes së stabilitetit që një zyrtar i KFOR-it të merret me një fotografi me vlerë simbolike që e mban një individ i FSK-së. Një filozof shqiptar, në sqarimin e tij për simbolizmin dhe misionet ndërkombëtare, kishte theksuar me cinizëm se përshkrimi simbolik nga burokratët ndërkombëtarë nuk ka të bëjë asgjë me sqarimet e simbolikës nga filozofët evropianë (Hoxha, 2014). Simboli që shërben si mit personal për një zyrtar të FSK-së është më pak problematik se sa fushata e zhvilluar në mënyrë artificiale e burokratëve evropianë kundër simboleve: Veçanërisht, nëse simbolet janë të ngulitura thellë në mentalitetin e njerëzve në Ballkan. Ideja e Fukuyamas në sqarimin e tendencës së intervenuesve ndërkombëtarë që shpejt të transformojnë vendet e pazhvilluara në vende që janë më të zhvilluara është në përputhje me këtë shembull të sjelljes ndaj FSK-së.

Kuptohet, askush nuk mund të transformojë besimet e njerëzve me mjete detyruese - madje edhe duke i larguar simbolet e tyre. Njerëzit, e veçanërisht pjesëtarët e uniformuar, janë të lidhur me krenarinë për sakrificën e gjeneratave të përparshme, e cila arriti kulminacionin me UÇK-në. Në të vërtetë, stagnimi shoqëror është i papranueshëm derisa zhvillimi shoqëror mbetet në hije të së kaluarës. Sidoqoftë, ndryshimi i mënyrës së të menduarit është proces që kërkon dekada. Si

rezultat, “de-UÇK-izimi” i mentalitetit të njerëzve do të ndodh shpejt vetëm aq sa ndërlihet me transformimin shoqëror nga sistemi socialist dhe autoritar në sistemin kapitalist. Përndryshe, rastet që e sqarrojnë tendencën për të “perëndimizuar” shoqëritë jo-perëndimore do të tregohen të pasuksesshme.

PERCEPTIMI PUBLIK PËR PRONËSINË LOKALE

Perceptimi i kosovarëve për dilemën e pronësisë lokale i shërben më së miri qëllimit të këtij hulumtimi. Faktorët lokalë janë kryesorët në arsyetimin e pronësisë lokale (Martin dhe Wilson, 2008). Diskutimi dhe avokimi në emër të faktorëve lokalë pa e matur perceptimin e tyre paraqet sfida për analizë cilësore. Bashkë me përgjigjet sasiore të të anketuarve janë dhënë edhe informacione cilësore përmes pyetjeve të hapura. Në këtë mënyrë, të anketuarit kishin mundësi të shprehen edhe më shumë për një çështje. Mendime më të thella nga të anketuarit mund të merreshin vetëm nga komunikimi që e pata me hulumtuesit në terren dhe nga grupet e fokusit, të cilat ishin organizuar vetëm për këtë qëllim. Hulumtuesit në terren ishin trajnuar se si të thjeshtësojnë pyetjet kur bëhen me gojë, për t’i bërë të kuptueshme për të anketuarit pavarësisht përgatitjes së tyre shkollore ose profesionale.

Në pjesën e parë, krahas matjes së përgjithshme të perceptimit, unë i kam interpretuar të dhënat lidhur me perceptimin sipas moshës dhe përkatësisë etnike. Këto janë dy kategoritë që pasqyrojnë dallimet në perceptime. Në pjesën e dytë, kam shkuar edhe më thellë duke e bërë tabelimin e tërthortë të të dhënave nga njëra pyetje tek tjetra. Këtu, kam dashur të identifikoj dallimet në opinionet e të anketuarve të njëjtë nga një pyetje në tjetrën. Që tabelimi i tërthortë të jetë i saktë dhe i interpretueshëm, fokusi vihet në dy ndryshore të krahasueshme.


PERCEPTIMI PËR ROLIN E PËRGJITHSHËM TË BASHKËSISË NDËRKOMBËTARE

Një prej fushave të para të ekzaminuara e trajton perceptimin e përgjithshëm të kosovarëve mbi rolin e bashkësisë ndërkombëtare në zhvillimin e sektorit të sigurisë. Shumica dërrmuese (61.9%) e vlerësojnë të rëndësishëm rolin e bashkësisë ndërkombëtare në ndërtimin e institucioneve

të sigurisë. Ky rezultat paraqet qëndrimin e shumicës së kosovarëve, qofshin shqiptarë apo serbë të Kosovës, që e kuptojnë njëjtë rëndësinë e bashkësisë ndërkombëtare gjatë këtyre periudhave. Të anketuarit, megjithatë, e bënë një dallim ndërmjet rolit të bashkësisë ndërkombëtare në periudhën menjëherë pas konfliktit dhe në Kosovën e sotme të parvarur (Grupi i fokusit, 2014). Me fjalë të tjera, shumica e të anketuarve nuk e kontestojnë rolin strategjik të bashkësisë ndërkombëtare; megjithatë, roli i saj matet sipas periudhës dhe duke marrë parasysh rritjen e pjekurisë.

Në anën tjetër, deri në 30% e të anketuarve janë neutral rreth rolit të përgjithshëm të bashkësisë ndërkombëtare, duke mos qenë kundër rolit të tyre si të tillë por duke shprehur disa rezerva. Një përqindje e parëndësishme (5.5%) kanë deklaruar se roli i përgjithshëm i bashkësisë ndërkombëtare nuk ka qenë i rëndësishëm, derisa vetëm 2.2% nuk kanë pasur mendim për këtë çështje.


Figura 5. Sa e konsideroni të rëndësishëm kontributin e bashkësisë ndërkombëtare në zhvillimin e sektorit të sigurisë në Kosovë? (n=1,098)



Duket se nuk ka ndonjë dallim të madh në perceptim në mes të gjeneratave. Roli i përgjithshëm i bashkësisë ndërkombëtare në zhvillimin e sektorit të sigurisë perceptohet të jetë i rëndësishëm nga të gjitha gjeneratat. Si rezultat, roli i saj nga pikëpamja strategjike, nuk kontestohet dhe çmohet. Megjithatë, gjenerata e re (18-35 vjeç) e kanë


vlerësuar rolin e bashkësisë ndërkombëtare më pak të rëndësishëm me një dallim prej 6% me gjeneratën e moshës së mesme (36-60 vjeçe) dhe 4% me gjeneratën më të vjetër. Në anën tjetër, ka një dallim prej 1% ndërmjet gjeneratës më të re dhe gjeneratave të tjera, ku gjenerata më e re duket se e vlerësojnë rëndësinë e bashkësinë ndërkombëtare 1% më pak. Kur këto rezultate sipas moshës i interpretojmë më tej, janë dy shpjegime për këtë ndryshim të vogël në opinionin e gjeneratës më të re dhe gjeneratave të tjera. Së pari, gjenerata e re është e prirë ta mbaj mend më pak rolin e bashkësisë ndërkombëtare në periudhën menjëherë pas konfliktit. Kjo është periudha në të cilën të gjithë të anketuarit janë të prirë të bazojnë perceptimin e tyre (Grupi i fokusit, 2014). Në rastin e gjeneratës më të re, një grup i tyre, veçanërisht ata nga mosha 18 deri në 25 vjeç, nuk janë në gjendje të krijojnë mendimin e tyre një bazë të përvojës së tyre. Së dyti, arsyeja për dallimin në opinionin e gjeneratës së re mund të shpjegohet duke e krahasuar me natyrën e gjeneratës së re dhe studentëve që kërkojnë pavarësi në të gjitha fushat e shoqërisë, përfshirë edhe të qenit të lirë nga sundimi i aktorëve të jashtëm në kontekstin e shtet-ndërtimit.

Figura 6. Perceptimi sipas moshës për kontributin e përgjithshëm të bashkësisë ndërkombëtare (n=1,098)



Qëndrimi i përgjithshëm i kosovarëve, megjithatë, ndryshon kur pyeten për mendimin e tyre nëse bashkësia ndërkombëtare i ka marrë parasysh rrethanat në Kosovë gjatë zhvillimit të institucioneve të sigurisë. Deri në 38.3% e të anketuarve mendonin se bashkësia ndërkombëtare i ka marrë parasysh rrethanat dhe kulturën lokale krahasuar me 12.7% që e thoshin të kundërtën. Megjithatë, shumica e të anketuarve (44.4%) u përcaktuan për opsionin e mesëm, duke theksuar se bashkësia ndërkombëtare i ka marrë parasysh rrethanat lokale vetëm deri diku. Kur interpretohet më tej ky opsion i mesëm, njerëzit në përgjithësi e çmojnë rolin e bashkësisë ndërkombëtare, por prapë shprehin disa rezerva rreth nivelit në të cilin janë marrë parasysh rrethanat dhe kultura lokale. Ky mendim mund të zërthehet përmes mendimeve individuale të të anketuarve të cilët i bazonin rezervat e tyre në mungesën e vullnetit të bashkësisë ndërkombëtare që të marrë parasysh me kujdes kërkesat lokale (Grupi i fokusit, 2014).

Figura 7. A mendoni se bashkësia ndërkombëtare i ka marrë parasysh rrethanat në Kosovë gjatë zhvillimit të institucioneve të sigurisë? (n=1,101)




Rreth 40% e të anketuarve kanë deklaruar se specifikat lokale nuk janë marrë parasysh dhe më shumë se 15% e atyre që u përcaktuan për opsionin “deri diku” dhanë sqarime të mëtejshme, duke thënë se nuk kishte synim që të merreshin parasysh kërkesat lokale sepse qëllimi primar i bashkësisë ndërkombëtare ishte që të ruajnë interesin e tyre në

Kosovë, dhe në kurriz të vendorëve. Ky supozim na përkujton dilemën e ngritur nga Reich në të cilën autoriteti i bashkësisë ndërkombëtare mund të (keq)përdoret lehtë, jo vetëm për t'i bërë vendorët që të ndjekin disa udhëzime të caktuara, por edhe që të zhvillohet një proces eksperimental i të mësuarit (Reich, 2006). Në të vërtetë, deklaratat e të anketuarve i referohen procesit eksperimental (Grupi i fokusit, 2014), duke ju referuar pjesërisht diskursit në mesin e popullsisë në Kosovë. Sigurisht, kjo është vetëm njëra nga shqetësimet e paraqitura nga të anketuarit. Një numër i të anketuarve ju referuan në mënyrë të veçantë asaj që ata e quanin si “mostra” të modeleve të transmetuara në Kosovë gjatë zhvillimit të sektorit të sigurisë. Kjo është në përputhje edhe me argumentet e Mac Ginty, në të cilët ai i kategorizon modelet e ofruara nga bashkësia ndërkombëtare të përkufizuara si standardizim duke tërhequr paralele me ndërmarrjen IKEA ose të ngjashme (Mac Ginty, 2008, f. 145).


Kur bëhet ekzaminimi në bazë të perceptimit etnik, duket se ka disa dallime, edhe pse jo aq të mëdha, ndërmjet mendimit të shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve të Kosovës. Në fakt, dallimi ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve pothuaj arrin në 30% ku serbët në masë të madhe mendojnë se rrethanat lokale nuk janë marrë parasysh në procesin e zhvillimit të sektorit të sigurisë. Mendimi i serbëve mbetet i njëjtë, si në pjesën veriore të vendit ashtu edhe në pjesët e tjera të Kosovës. I interpretuar përmes perspektivës etnike, perceptimi i mos marrjes parasysh ose marrjes së pjesshme parasysh të rrethanave lokale nuk është perceptim në nivel shteti, por më shumë është perceptim i komunitetit. Ky mendim drejt modeleve të shtyra nga jashtë pasqyrohet tek komunitetet dhe paraqet perspektivën nga poshtë - lart.

Figura 8. Perceptimi për rrethanat lokale sipas përkatësisë etnike (n=1,101)



Ndonëse ka disa dallime në perceptimet sipas përkatësisë etnike, duket se ka dallim shumë të vogël nga një gjeneratë në tjetrën. Dallimi kryesor mund të gjendet në opsionin e mesëm. Gjenerata më e re dhe më e vjetër kanë shprehur dyshime për atë se a janë marrë parasysh rrethanat lokale, ndërsa ata të moshës së mesme duket se janë më kritikë, duke shënuar një dallim prej 4% nga gjeneratat e tjera në deklarimin se rrethanat nuk janë marrë parasysh. Interpretimi i menjëhershëm i këtij dallimi të vogël paraqet përvojat që ka pasur kjo gjeneratë në ndërveprimin ose ndoshta në punën me bashkësinë ndërkombëtare.

Figura 9. Perceptimi për rrethanat lokale sipas gjinisë (n=1,101)




PERCEPTIMI PËR KAPACITETET LOKALE DHE TËRHEQJEN E MISIONEVE NDËRKOMBËTARE

Perceptimi i përgjithshëm pozitiv për rolin e bashkësisë ndërkombëtare dhe dilemat e pjeshme për shkallën në të cilën bashkësia ndërkombëtare i ka marrë parasysh rrethanat lokale në zhvillimin e sektorit të sigurisë, na sjellin te çështja e kapaciteteve të institucioneve të sigurisë së Kosovës në ofrimin e qetësisë dhe sigurisë. Sipas rezultateve, 57.4% e të anketuarve mendonin se institucionet kosovare të sigurisë nuk janë në gjendje të kryejnë detyrat lidhur me sigurinë dhe ende kanë nevojë për mbështetje nga bashkësia ndërkombëtare. Sipas hulumtuesve në terren, të anketuarit preferonin më shumë mbështetjen nga NATO, në këtë rast nga KFOR-i, duke e përshkruar nevojën për më shumë mbështetje lidhur me mbrojtjen (Grupi i fokusit, 2014). Mbi 30% theksuan se institucionet e sigurisë janë krejtësisht të paafta të ofrojnë siguri, krahasuar me 11.2% që mendonin të kundërtën. Në përgjithësi, shumica e të anketuarve besojnë se institucionet e sigurisë janë plotësisht ose pjesërisht të afta, duke treguar një rritje të pjekurisë dhe besimit në mesin e qytetarëve për institucionet shtetërore. Ky perceptim është në përputhje me argumentet për të drejtën e vetëvendosjes dhe dilemën e strategjisë dalëse (Wilde, 2012). Ai ndërlidhet me


argumentet në favor të strategjive dalëse (Caplan, 2012) të cilat duhet të sigurohen në pajtim me pjekurinë dhe me parashikimin e vetë-qëndrueshmërisë së institucioneve shtetërore “që mund të mbijetojnë pas tërheqjes së intervenimit të jashtëm” (Fukuyama, 2004, f. 136).

Figura 10. A mendoni se institucionet lokale të sigurisë janë në gjendje të ofrojnë siguri? (n=1,101)




Megjithatë, nuk duket se ky është rasti me serbët e Kosovës, e veçanërisht me të anketuarit nga katër komunat veriore. Deri në 51% të të anketuarve nga komuniteti serb kanë shprehur dyshime për kapacitetet e sektorit të sigurisë. Si pjesë e këtij interpretimi, janë dy argumente që sqarojnë këtë qëndrim: Së pari, pasi që institucionet kosovare të sigurisë në pjesën veriore janë në fazën fillestare të tyre, besimi në kapacitetet e tyre nuk ka qenë e mundur të arrihet për një periudhë kaq të shkurtër kohore. Integrimi i rajonit verior në sistemin e Kosovës ka filluar vetëm në vitin 2013 pas marrëveshjeve për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Së dyti, institucionet e sigurisë shikohen si element i fortë i shtetit të Kosovës, kështu që perceptimi më shumë pasqyron refuzimin e përgjithshëm nga pjesa e popullsisë serbe, veçanërisht në pjesën veriore të Kosovës, ndaj këtyre institucioneve (Grupi i fokusit, 2014).

Figura 11. Perceptimi për kapacitetet e institucioneve sipas përkatësisë etnike (n=1,1010)




Kapacitetet e institucioneve të sigurisë së Kosovës trajtohen dhe ndërlihen me mendimin e njerëzve për tërheqjen ose vazhdimin e dy misioneve më të rëndësishme ndërkombëtare në vitin 2014: KFOR-it dhe EULEX-it. Këtu janë ofruar katër shkallë të Likertit në të cilat të anketuarve u është kërkuar të vendosin ndërmjet opsioneve të EULEX/KFOR: (a) Ata tashmë është dashur të ishin tërhequr; (b) Vitin tjetër (2015); (c) Në 3-5 vitet e ardhshme; (d) Kurrë. Mendimet dallojnë për njërin dhe tjetrin mision. Vetëm deri në 15% e të anketuarve mendonin se KFOR-i është dashur të tërhiqej tashmë, krahasuar me një përqindje të konsiderueshme të atyre që mendonin se EULEX-i është dashur të ishte tërhequr (37%). Ky rezultat mund të matet në kontekstin e qëndrimit të përgjithshëm pozitiv të njerëzve ndaj KFOR-it për shkak të trashëgimisë së tyre të rëndësishme historike, dhe lidhjes sociologjike ndaj uniformës ushtarake (Celik, 2012).

Figura 12. Kur duhet të tërhiqet KFOR-i nga Kosova? (n=1,097)



Në anën tjetër, rezultatet për EULEX-in ilustrojnë një krizë gjithnjë e më të madhe të legjitimitetit të tyre operativ, në të cilën perceptimi i njerëzve nuk është i bazuar vetëm në performancën e kufizuar, por edhe në ndërlidhjen e perceptuar ndërmjet misionit të mëhershëm të OKB-së, UNMIK, dhe misionit të fundit të BE-së, EULEX. Kriza me të cilën përballlet EULEX-i përforcohet nga 17% e të anketuarve të tjerë të cilët deklaruan se EULEX-i duhet të largohet vitin tjetër (2015), ku shumica e të anketuarve nuk e mbështesin praninë e EULEX-it (54%). Në anën tjetër, vetëm 8% e të anketuarve mendonin se KFOR-i duhet të largohet vitin tjetër.

Figura 13. Kur duhet të tërhiqet EULEX-i nga Kosova? (n=1,096)


Përqendrimi dominues i të anketuarve ka rënë në kategorinë e optionit që kërkon që misionet ndërkombëtare të rrinë edhe 3-5 vitet e ardhshme. 46% e të anketuarve mendonin se KFOR-i duhet të rrijë edhe në 3-5 vitet e ardhshme krahasuar me 33% të atyre që e kishin këtë mendim për EULEX-in. Perceptimi i të anketuarve të komunitetit serb është pak më i lartë në këtë kategori, megjithatë mbetet në përputhje me mendimet e bashkëqytetarëve të tyre shqiptarë.

Në anën tjetër, 13% e të anketuarve mendojnë se EULEX-i nuk duhet të largohet kurrë, ndërsa 31% mendojnë të njëjtën, por për KFOR-in. Këto shifra paraqesin një pakicë të të anketuarve që shprehin dëshirën për prani më afatgjate të EULEX-it, e cila ndoshta sqarohet me pesimizmin e përgjithshëm rreth performancës së institucioneve lokale (Grupi i fokusit, 2015). Perceptimi për KFOR-in mund të interpretohet ndryshe: Ky grup i të anketuarve i mbështet vlerësimet cilësore sipas të cilit prania e vazhdueshme e bashkësisë ndërkombëtare ka çuar në varësi të vendorëve. Disa të intervistuar shkuan më tej duke theksuar se varësia e vazhdueshme ka çuar në një situatë në të cilën udhëheqësit politikë dhe qytetarët nuk janë në gjendje të mendojnë dhe funksionojnë vet (Surroi, 2012). Perceptimi i këtyre të anketuarve nuk është në përputhje me argumentet konceptuale të cilat sqarojnë

se misionet ndërkombëtare nga jashtë nuk mund të zëvendësojnë institucionet lokale (Donais, 2012b).

Në të vërtetë, ekziston një dallim sipas moshës ndërmjet atyre që mendojnë se KFOR-i nuk duhet të largohet kurrë: nga 31% e të anketuarve të moshës prej 18 deri 35 vjeçe, deri në 29.2% e tyre mendojnë se KFOR-i nuk duhet të largohet kurrë nga Kosova, krahasuar me 37.4% e të anketuarve të moshës 65 vjeçe. Kjo shifër mund të interpretohet në kontekstin e gjeneratave të reja që kanë aspirata më të mëdha për të përmbushur kapacitetin e sovranitetit dhe përgjegjësisë së plotë. Ajo po ashtu manifeston logjikën e krijuar të dilemës së sigurisë, e cila është më e pranishme tek gjenerata më e vjetër se sa tek gjenerata më e re për shkak të lidhjes me të kaluarën.

Figura 14. Perceptimi për tërheqjen e EULEX-it sipas moshës së të anketuarve (n=1,097)



ANALIZA MULTIVARIATE E PERCEPTIMEVE

Perceptimi i njerëzve mund të zërthehet më tej duke aplikuar vegla të ndryshme statistikore. Në të vërtetë, analiza multivariate (tabelimi i tërthortë) mundëson të kuptuarit e perceptimit dhe verifikon dallimet nga dy ndryshore. Në shkencat shoqërore kjo ndihmon në nxjerrjen e


probabilitetit përmes një funksioni kumulativ të shpërndarjes. Është e mundur të verifikohen ndryshimet ndërmjet dy ndryshoreve, dhe unë isha në gjendje të interpretoj dallimet në perceptimin e të anketuarve nga një ndryshore në tjetrën. Unë i kam sintetizuar dy ndryshoret më të krahasueshme dhe kam krijuar në tabelë të kontingjencës. Për të paraqitur këto rezultate në formë më të lehtë për lexuesin, unë nuk e kam ekspozuar tabelën e kontingjencës, por vetëm diagramet.

Tabelimin e parë të tërthortë që e kam bërë ishte për besimin e të anketuarit ndaj pranisë ndërkombëtare në Kosovë dhe mendimin e tij/saj për praninë ose tërheqjen e këtyre misionëve. Përmes analizimit të variacioneve ndërmjet besimit/mosbesimit dhe pranisë/tërheqjes, unë kam dashur të identifikoj konsekuencën e secilit mendim të të anketuarit nga një variabël në tjetrën. Si rezultat, qëllimi i kësaj ishte që të bëhet ndërlidhja, për shembull, nëse njerëzit që shprehin pak ose nuk shprehin fare besim ndaj EULEX-it po ashtu mendojnë se EULEX duhet të tërhiqet ose tashmë është dashur të jetë tërhequr. Në Figurën 15, unë i kam bashkuar të dy ndryshimet në këtë perceptim: duke e ndërlidhur besimin/mosbesimin me variacionet për praninë/tërheqjen. Për të mbajtur variacionet e krahasueshme, nga 6 shkallët e Likertit, unë kam vendosur të heq rezultatet e opsionit të mesëm (“deri diku”) dhe të mbaj vetëm opsionet i besueshëm dhe shumë i besueshëm, në njërin anë, dhe aspak besim dhe pak besim, në anën tjetër. Unë po ashtu i kam hequr rezultatet e atyre që nuk shprehin opinion për çështjen sepse as kjo nuk mund të krahasohet. Me këtë qasje unë kam mundur të bëj tabelën e tërthortë ndërmjet dy variacioneve krahasuese.

Të anketuarit që kanë shprehur pak ose aspak besim ndaj EULEX-it janë në përputhje me dëshirat e tyre për tërheqjen e EULEX-it. Nga 42% e të anketuarve që kanë shprehur mosbesim ndaj EULEX-it, 54.9% mendojnë se EULEX-i është dashur të ishte tërhequr deri më tani, pasuar nga 20.3% që mendojnë se EULEX-i duhet të largohet vitin tjetër, d.m.th, në 2015 (pasi që anketa është zhvilluar në tetor 2014). Kjo tregon se, pavarësisht se të anketuarit kishin mendim neutral ose pozitiv për EULEX-in, ata mendojnë se misioni duhet të tërhiqet. Në anën tjetër, gjysma e të anketuarve që kanë shprehur shkallë të

mjaftueshme të besimit ndaj EULEX-it deklaruan se EULEX-i duhet të qëndrojë edhe 3-5 vjet ku pothuaj 23% e tyre deklaruan se EULEX-i


Figura 15. Tabelimi i tërthortë mbi besimin dhe praninë/tërheqjen për EULEX-in (n=764)



Nga interpretimi sasior, rezultatet tregojnë se ka një krizë të legjitimitetit pasi që shumica nuk i beson misionit dhe performancës së tij. Nëse analizojmë komunikimin formal ndërmjet EULEX-it dhe Qeverisë së Kosovës, ftesa zyrtare të kësaj të fundit dërguar BE-së për vazhdimin e misionit pasqyron një mospërputhje me vullnetin e njerëzve. Si rezultat, dhe duke marrë parasysh dilemën e Zaum-it, pëlqimi paraqet vegël të rëndësishme të autoritetit për administrimin ndërkombëtar. Sidoqoftë, mbështetja vetëm në pëlqimin e shtetit pa pëlqimin e tërë publikut (Zaum, 2006) është manifestim i krizës së legjitimitetit. Ajo po ashtu paraqet një rast tipik ku autoriteti ndërkombëtar e lë në hije autoritetin lokal të vendorëve (Hopgood, 2009). Pëlqimi i qytetarëve mund të plotësohet pjesërisht po që se EULEX-i do t'u përgjigjej pyetjeve të Kuvendit të Kosovës. Në këtë mënyrë, formalisht mund të mbahet mbikëqyrja përmes përfaqësuesve të faktorëve lokalë (Kursani, 2013). Nëse misioni do të ishte subjekt i monitorimit nga Avokati i Popullit të Kosovës, mbikëqyrja do të mbahej përmes përfaqësuesve të komuniteteve lokale të zgjedhura nga Parlamenti.

Në anën tjetër, të anketuarit duket se janë më të kujdesshëm me KFOR-in. Vetëm 31.8% e të anketuarve që kishin pak ose aspak besim ndaj KFOR-it deklaruan se misioni është dashur të ishte tërhequr tashmë. Ky numër pasohet nga 14.5% që deklaruan se KFOR-i duhet të largohet vitin tjetër (2015). Në shumëzimin e ndryshimeve në mes të “KFOR-i duhet të rrijë në 3-5 vitet e ardhshme” dhe “KFOR-i nuk duhet të largohet kurrë”, duket se 53.8% janë ata që shprehin mosbesim ndaj KFOR-it. Kjo tregon se KFOR-i, krahasuar me EULEX-in, perceptohet të jetë mision i domosdoshëm dhe garantues i stabilitetit. Natyrisht, në zbërthimin e këtyre ndryshimeve, KFOR-i perceptohet nga dimensiononi psikologjik që e merr parasysh dilemën e sigurisë që e kanë të anketuarit (M. Vrajolli, intervistë personale, 2 qershor 2014).


Figura 16. Tabelimi i tërthortë mbi besimin dhe praninë e KFOR-it (n=765)



Po ashtu e kam konsideruar si shkencërisht të rëndësishme që të aplikohen ndryshimet në perceptimet për rolin e bashkësisë ndërkombëtare në zhvillimin e sektorit të sigurisë kundrejt shkallës në të cilën bashkësia ndërkombëtare ka marrë parasysh rrethanat lokale në proceset e zhvillimit të sektorit të sigurisë. Të anketuarit që e vlerësuan rolin e bashkësisë ndërkombëtare si të parëndësishëm janë ata që më së shumti mendojnë se shumica e rrethanave lokale nuk janë marrë parasysh (44.3%) në zhvillimin e sektorit të sigurisë. Grupi kryesor i këtyre tri ndryshimeve janë të anketuarit që mendojnë se rrethanat

lokale janë marrë deri diku parasysh nga bashkësia ndërkombëtare: ky perceptim ndryshon nga 42% deri në 52.7%. Të anketuarit që vlerësojnë rolin e përgjithshëm të bashkësisë ndërkombëtare si të rëndësishëm janë ata që besojnë më së shumti se bashkësia ndërkombëtare i ka marrë parasysh rrethanat lokale në procesin e zhvillimit të sektorit të sigurisë (47.6%)

Figura 17. Tabelimi i tërthortë mbi rëndësinë e rolit të bashkësisë ndërkombëtare kundrejt kontekstit (n=1 077)



Në interpretimin e mëtejshëm të dy ndryshimeve, pavarësisht perceptimit të përgjithshëm pozitiv të njerëzve për rolin e përgjithshëm të bashkësisë ndërkombëtare, është qëndrim i përgjithshëm i të anketuarve se kushtet dhe vlerat lokale nuk janë marrë parasysh gjatë zhvillimit të sektorit të sigurisë. Kjo mund të krahasohet edhe me komentet individuale të bëra nga të anketuarit për këtë çështje si dhe për pyetjet e hapura (Grupi i fokusit, 2014).

KAPITULLI IV

PROBLEMET E ZHVILLIMIT TË SEKTORIT TË SIGURISË NË TRE SHEMBUJ

Roli i bashkësisë ndërkombëtare mund të përshkruhet në mënyrë të saktë nga shembujt e përfshirjes në zhvillimin e sektorit të sigurisë. Këta shembuj manifestojnë një pasqyrë të përgjithshme të bashkëpunimit në lidhjen ndërkombëtarë-vendorë. Rastet e analizuara më poshtë konsiderohen të jenë më të rëndësishmet për të sqaruar komplikimet e pronësisë lokale në Kosovën e pas pavarësisë. Kjo nuk nënkupton se këta janë shembujt e vetëm që arsyetojnë sfidat e pronësisë lokale: numri i madh i rasteve të ofruara në kapitujt e mëhershëm ka ndihmuar në sqarimin e komplikimeve lidhur me sektorin e sigurisë të drejtuar nga jashtë. Çka trajton ky kapitull janë tri raste studimore që sqarojnë në hollësi ndërhyrjen e bashkësisë ndërkombëtare në zhvillimin e sektorit të sigurisë. Këto ilustrjnë se si rezultatet e shtyra nga jashtë janë të shkëputura nga realiteti lokal. Shembujt ndahen në tre raste të përzgjedhura studimore: procesi i hartimit të strategjisë së sigurisë; zhvillimi “nga lart-poshtë” i këshillave për siguri në bashkësi dhe prioritetizimi i tepruar i incidenteve ndëretnike.

HARTIMI I STRATEGJISË SË SIGURISË SË KOSOVËS (2009-2011)

Korniza strategjike dhe doktrinare e sektorit të sigurisë manifeston vizionin udhëzues mbi të cilin do të bazohet reforma dhe procesi i përgjithshëm zhvillimor. Ky vizion në mënyrë tipike është i ndërtuar brenda SSK-së dhe roli primar i të cilës është që të përshkruajë se si një vend u ofron siguri qytetarëve dhe shtetit, që shpesh prezantohet si një dokument i integruar (Kontrolli Demokratik i Forcave të Armatosura [DCAF], 2005). Për më tepër, hartimi i SSK-së duhet të

pasqyrojë dimensionet kryesore në fushën e sigurisë në mënyrë që strategjitë sektoriale të harmonizohen me SSK-në. Ekziston një numër dokumentesh që sugjerojnë një cikël të përgjithshëm të bërjes së politikave në sektorin e sigurisë. Për shembull, një prej dokumenteve udhëzuese kyçe është raporti DAC i OECD-së i cili sqaron ciklin e hartimit të kornizës strategjike në përputhje me parimet e RSS-së (OECD, 2007).

SSK-ja e parë e Kosovës pritej të hartohej paralelisht me konsolidimin e arkitekturës së sektorit të sigurisë pas pavarësimit të vendit. Në të vërtetë, kërkesat për miratimin e SSK-së të elaboruara gjatë procesit të negociatave lidhur me statusin politik të Kosovës u përmblohdën në një dispozitë përfundimtare e cila kërkonte që “Kosova të hartojë një strategji të sigurisë” (OKB, 2007, f. 49). Kjo dispozitë shërbeu si referencë për futjen e parimeve që kanë të bëjnë me sigurinë në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Si rezultat, Kushtetuta e thekson qartë se “Këshilli i Sigurisë i Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me Presidentin e Republikës së Kosovës dhe Qeverinë, harton strategjinë e sigurisë për Republikën e Kosovës” (Kushtetuta, 2008, neni 125). Çështjet rreth rregullimit të procesit të SSK-së rregullohen më tej me Ligjin për Themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës (KSK) (Kuvendi i Kosovës, 2008). Në këtë mënyrë, korniza ligjore e njeh mjaftueshëm autoritetin e institucioneve lokale të sigurisë për menaxhimin, koordinimin dhe zbatimin e këtij procesi.

Hartimi i SSK-së filloi në vjeshtën e vitit 2009. Procesi u koordinua nga MPB për shkak të kapaciteteve jo të mjaftueshme të KSK-së - i krijuar vetëm në vitin 2008.⁹ Në atë kohë, MPB ishte institucioni më i konsoliduar i sigurisë, dhe kishte mandatin që të koordinojë përpjekjet institucionale për hartimin e SSK-së. MPB krijoi një grup punues teknik i cili përfshinte përfaqësuesit e institucioneve dhe ministrive përkatëse të sigurisë si dhe agjencive të tjera që tërthorazi preken nga SSK-ja e ardhshme. Për të siguruar qasje gjithëpërfshirëse, MPB kishte ftuar edhe përfaqësuesit e shoqërisë civile (Vrojtimi me pjesëmarr-

9 Në shumicën e vendeve, koordinimi i procesit të hartimit të SSK-së zakonisht bëhet ose nga Ministria e Mbrojtjes ose nga Ministria e Punëve të Brendshme. Në atë kohë, në Kosovë, Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës ishte në fazën e hershme të zhvillimit; kështu që Ministria e Punëve të Brendshme ishte i vetmi aktor i konsoliduar për të marrë përsipër udhëheqjen e procesit.

je, 2009-2010)¹⁰ si dhe kishte kontraktuar një ekspert ndërkombëtar që kishte përvojë me kontekstin e procesit të rishikimit të sektorit të sigurisë pas përfundimit të RSSB-së në vitin 2006. Qasja fillestare e MPB-së disi përputhej me argumentin e Dominik Zaum-it se çdo proces duhet të përfshijë pëlqimin i cili nuk kufizohet vetëm në elitat shtetërore por duhet të përfshijnë edhe qytetarët (Zaum, 2006). Pëlqimi gjithëpërfshirëse formalisht e paraqet autoritetin lokal, edhe pse i dobët në mjedisin e pas-konfliktit (Hopgood, 2009). Nuk ishte e sigurt se a ishte ky veprim i qëllimshëm apo i paqëllimshëm; megjithatë, ai nisi bazuar në qëllimet e mira dhe duke aplikuar logjikën gjithëpërfshirëse. Qëllimi i arritjes së një qasjeje gjithëpërfshirëse solide paraqet manifestimin e një prej kriterëve të pakta të mira të qeverisjes së RSS-së me të gjerë. Kjo po ashtu është siguruar përmes një numri anketash të zhvilluara nga një kompani e kontraktuar e cila ka matur perceptimin publik ndaj rreziqeve dhe kërcënimeve të sigurisë (Vrojtimi me pjesëmarrje, 2009-2010).

Një grupi punues i ishte dhënë mandati për të analizuar bazën ligjore të SSK-së, duke shmangur kështu kundërthëniet potenciale ndërmjet SSK-së së ardhshme dhe kornizave ligjore. Grupet e tjera punuese u fokusuan në përcaktimin e vizionit si dhe matjen e rreziqeve dhe kërcënimeve, bazuar në kontributin e institucionit të sigurisë (Vrojtimi me pjesëmarrje, 2009-2010). Rrjedhimisht, u garantua se procesi do të shikohet nga një perspektivë më e gjerë (Schnabel, 2012), duke siguruar që politikat e sigurisë të mos jenë të shkëputura nga sfera e politikave publike. Për këtë qëllim, grupet punuese kishin marrë parasysh një përbërje gjithëpërfshirëse të KSK-së, në të cilin përveç ministrive dhe agjencive që kishin të bënin me sigurinë, ishin përfaqësuar edhe aktorë të tjerë si Ministria e Financave, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Drejtësisë, madje edhe Ministria e Kthimit për të siguruar përfaqësimin e pakicave në KSK (Kuvendi i Kosovës, 2008).

Fillimisht, anëtarët e grupeve punuese nuk kërkuan asnjë asistencë nga prania ndërkombëtare në Kosovë. Megjithatë, procesi u monitorua nga afër deri aty sa zyrtarët për çështje të sigurisë të Zyrës Civile Ndërkombëtare (ICO) morën pjesë rregullisht në takime. Siç u sqarua

10 Autori i këtij libri ishte njëri nga personat e përfshirë në cilësinë e përfaqësuesit të shoqërisë civile.

në kontekstin e zhvillimit të sektorit të sigurisë, ICO ishte një organ ndërqeveritar i shteteve kryesore ndërkombëtare që e kishin njohur pavarësinë e Kosovës (shih Kapitullin III). Asaj i ishte dhënë mandati të mbikëqyrë zbatimin e dispozitave të marrëveshjes së Ahtisaarit, dhe përputhjen e saj me kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë brenda Kosovës. Zyra ishte autorizuar që të përdor kompetencat ekzekutive vetëm në rast se vendimet nuk ishin në përputhje me marrëveshjen e Ahtisaarit. Asaj nuk i ishte dhënë ndonjë autorizim tjetër (OKB, 2007). Ishte procesi i SSK-së i cili shënoi ndërhyrjen e paprecedente të zyrtarëve të ICO-s duke e kontestuar tërësisht procesin e udhëhequr nga vendorët dhe në fund, duke sjell një produkt të ri që nuk i përshatej procesit, e as ambientit të sigurisë në Kosovë. Kjo ndërhyrje ishte në kundërshtim me mandatin që ICO e kishte pasur në periudhën menjëherë pas pavarësisë. Në fakt, kur rishikohet roli i përgjithshëm i ICO-s në Kosovë gjatë pranisë së saj nga viti 2008 deri në 2012, kjo zyrë nuk kishte përdorur kompetencat e saj ekzekutive në shfuqizimin e vendimeve të Kosovës në fushat e tjera. Roli i saj ishte bukur minimal krahasuar me, për shembull, rastin e BeH në të cilën Zyra e Përfaqësuesit të Lartë vazhdimisht kishte përdorur të drejtën e saj të vetos për disa vendime të Federatës së Bosnjës e Hercegovinës si dhe të Republikës Serbe (Chandler, 2006; Perdan 2008). Në vend të kësaj, ICO në Kosovë aplikoi një qasje tjetër e cila do të shënonte intervenimin e tyre “nën tepih”. Prandaj, ndërhyrja e ICO-s - zyrës për çështje të sigurisë - në procesin e SSK-së shënoi një shembull të rëndësishëm në kontekstin e lidhjes ndërkombëtarë-vendorë. Ky shembull empirik nuk mund të përshkruajë se a pasqyronin sqarimet më poshtë politiken e ICO-s; megjithatë, mund të përfundohet se disa zyrtarë të saj, qoftë për ICO ose për qëllime personale, intervenuan deri në atë masë sa këto veprime u bënë të dëmshme për procesin e politikëbërjes.

Fillimi i intervenimit të ICO-s u shënuar me insistimin e ekipit të tyre që të ndikojnë në dizajnin e konceptit dhe vizionit të SSK-së. Përfaqësuesit e grupit punues dizajnuan një vizion dhe koncept në përputhje me ambiciet e shoqërisë kosovare për integrimin euro-atlantik - një qasje e cila u manifestua në mënyrë të njëjtë edhe në vendet fqinje. Ky vizion korrespondonte me kornizën ligjore, si dhe me të gjitha dokumentet strategjike të Kosovës. Argumentet e zyrtarëve të ICO-s nuk ishin sqaruar fillimisht, por indikacionet e tyre pasqyronin syn-

imin që të mos bëhet strategji analoge me kornizat e tjera të SSK-së në Ballkanin Perëndimor (Vrojtimi me pjesëmarrje 2009-2010).

Presionet ishin gjithnjë e më të pranishme kur zyrtarët e ICO-s haptazi kërkonin të përjashtohen rreziqet dhe kërcënimet kryesore që ishin identifikuar paraprakisht në analizën e rreziqeve institucionale dhe në perceptimin publik për kërcënimet (Vrojtimi me pjesëmarrje, 2009-2010). Argumentet për këtë bazoheshin në retorikën e cila aplikohesh shpesh për paradigmen e stabilitetit në të cilën, siç u sqarua më herët, theksimi i rreziqeve reale do të ishte “e dëmshme për sigurinë dhe stabilitetin” sepse do të nxiste një reagim nga palët ose aktorët shqetësimit e të cilëve ndërlihdeshin (Vrojtimi me pjesëmarrje, 2009-2010). Në mënyrë të veçantë, miqtë ndërkombëtar insistonin se strategjia nuk duhej të theksonte problemet reale që ishin të pranishme, si sfidat në pjesën veriore të Kosovës, kontestet me Serbinë dhe përpjekjet e Kosovës për njohje dhe shtimin e lëvizjeve fetare ekstremiste dhe të dhunshme sepse çdo përmendje e këtyre do të nxiste ndonjë reagim. Qëllimi i zyrtarëve të ICO-s ishte që të mbulonin këtë argument me një referencë të mjegullt për konceptin e sigurisë njerëzore në të cilin rreziqet dhe kërcënimet duhet të maten vetëm përmes disa treguesve të pasigurisë ekonomike dhe shoqërore, duke anashkaluar kështu rreziqet dhe kërcënimet e tjera si ato që kishin të bënin me pasigurinë ushtarake dhe politike. Të paktën gjatë shqyrtimit të SSK-ve të vendeve të tjera ishin përmendur pesë lloje të kërcënimeve: ushtarak, politik, ekonomik, mjedisor dhe shoqëror - ndarje kjo e bërë nga Buzan dhe Weaver, duke pasur parasysh kërcënimet dhe sfidat e reja të sigurisë në periudhën pas Luftës së Ftohtë, e cila në aspektin akademik ishte quajtur Shkolla e Mendimit e Kopenhagës (Buzan et al., 1997).

Nga një ambient kritik i ndërtimit të paqes, veprimet e zyrtarëve të ICO-s arsyetoheshin në bazë të demokracisë dhe vlerave evropiane - diçka që Kosova synon ta arrijë. Megjithatë, këto aspirata duhet të marrin parasysh vlerat dhe rrethanat lokale. Nëse shikohet motoja e famshme e BE-së: “Të bashkuar në diversitet”, atëherë shihet sqarimi i Evropës së përbërë nga kultura, tradita, praktika dhe natyrisht rrethana të ndryshme (BE, 2000). Në përsëritjen e dilemës së Fukuyamas për “të arritur (nivele) e Danimarkës”, motoja sfidon këtë dilemë dhe qëllimet e ICO-s (Fukuyama, 2004). Kjo veçanërisht është e vërtetë në

rastin e SSK-së në të cilën bashkësia ndërkombëtare duket se ushtron një ndikim të fuqishëm. Në këtë frymë, Donais e paraqiti një argument, duke theksuar se RSS është “inxhinierim shoqëror në të cilin ndërkombëtarët i mësojnë homologët lokalë se si të ndërtojnë dhe menaxhojnë sektorin e sigurisë” (Donais, 2008, f. 7). Vërtetë, qëndrimi i ICO-s në këtë rast ishte shumë më i fortë se sa qëndrimi i komunitetit të donatorëve. Ajo i kishte mbajtur disa kompetenca ekzekutive, kështu që mund t’i aplikonte këto kompetenca po të kishte “nevojë”. Këtu, dy dilemat korrespondojnë: Së pari, me monopolin e autoritetit ndërkombëtar në shtetet në krijim e sipër, dhe së dyti, me pozicionimin e dobët të aktorëve lokalë për t’iu kundërvënë veprimeve të autoritetit ndërkombëtar. Veprimet më tej korrespondojnë me supozimet e Mac Ginty dhe Richmond për keqpërdorimin e kompetencave në emër të demokracisë dhe vlerave evropiane.

Në sqarimin e këtyre pasojave të fundit të veprimeve të ICO-s, ndërhyrja e përditshme e zyrtarëve të ICO-s në modifikimin e vizionit të SSK-së sipas sugjerimeve të tyre çoi në dorëheqjen e anëtarëve kyç të grupit punues teknik përgjegjës për procesin e hartimit. Kjo ndodhi sepse organi institucional udhëheqës - MPB - u ballafaqua me presion të vazhdueshëm politik për të respektuar sugjerimet që jepeshin nga bashkësia ndërkombëtare, edhe pse nuk u kuptua kurrë se a paraqisnin këto sugjerime qëndrimet e tërë bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë. “Rezistenca” e kufizuar ndaj ndërhyrjes së ICO-s nuk zgjati shumë. Kjo, veçanërisht nga koha kur drafti (nga grupi punues teknik) u vlerësua nga përfaqësuesit e ICO-s për komente dhe vlerësim. Ky draft i dokumentit u rishkrua i tëri nga ICO-ja deri në atë masë sa pothuaj u bë dokument krejtësisht tjetër nga drafti që ishte hartuar fillimisht nga vendorët (Blease dhe Qehaja, 2013).

Rrjedhimisht, drafti i ofruar nga ICO-ja krejtësisht anashkaloi procesin, përderisa vizioni, bashkë me rreziqet dhe kërcënimet, nuk bazoheshin në analizë paraprake. Si për ironi, dokumenti përfundimtar i ICO-s kishte logon dhe vulën e Qeverisë së Kosovës, edhe pse materia e shkruar nuk e merrte parasysh kontributin e grupeve punuese lokale (Qeveria e Kosovës, 2010). Ky paradoks arriti e kulmin kur zyrtarët e ICO-s ua dorëzuan draftin anëtarëve kryesorë të grupit punues, në të cilën shënimi në fund theksonte se “[ekipi i ICO-s]...dëshiron t’ju

falënderojë të gjithëve për bashkëpunimin e shkëlqyeshëm dhe shërbimin e madh që e keni bërë për Republikën e Kosovës. Është nder të punohet me ju” (Korrespondencë e ICO-s përmes emailit, 21 janar 2010). Në këtë mënyrë, u sfidua seriozisht pronësia lokale deri në atë masë sa veprimet e bashkësisë ndërkombëtare kërkonin arsyetim përmes duke e quajtur procesin në pronësi lokale. Ky veprim i përdor fjalët pronësi lokale të përdorura shpesh në sytë e donatorëve dhe vendeve kryesore pa e zbatuar atë në praktikë. Kjo e paraqet qartë dilemën e Laurie Nathan-it mbi “hartimin e SSK-së në një vend të caktuar” në vend se, siç me të drejtë sugjeron ai, “mbështetjen e aktorëve lokalë (nëse e kërkojnë) në hartimin e SSK-së” (Nathan, 2007). Kjo po ashtu disi e ndjek një qasje të standardizuar të “shënjimimit të rubrikës” (ticking the box) në të cilën bashkësia ndërkombëtare ishte e interesuar të sigurojë pronësinë lokale pa e sqaruar se çka në fakt nënkupton pronësia lokale.

Drafti përfundimtar i ICO-s doli të jetë dokument krejtësisht i shkruar nga ndërkombëtarët dhe i cili nuk i referohej fare kontekstit, kulturës dhe rrethanave lokale. Si për ironi, në faqen e parë të dokumentit ishte paraqitur motoja “duke punuar së bashku - duke siguruar të ardhmen” (Qeveria e Kosovës, 2010), moto kjo e pavend për një dokument të tillë të imponuar nga njëra palë. Për më tepër, pikat kryesore të strategjisë kërkojnë që Qeveria e Kosovës të mbajë tërë përgjegjësinë për çështjet e sigurisë dhe stabilitetit në Kosovë – çka ishte në kundërshtim të plotë me procesin në realitet (Qeveria e Kosovës, 2010, f. 3) Për të plotësuar kërkesat ligjore, faqja e parë e strategjisë “tregonte” se dokumenti ishte hartuar nga KSK në bashkëpunim me Presidentin e Kosovës. Terminologjia e dokumentit ishte lustruar deri në atë masë sa që pjesët e saj kyçe nuk e pasqyronin vizionin shtetëror por një vizion joshtetëror. Gjatë zbërthimit të diskutit të shkruar, dokumenti i referohet vetëm tri herë nocionit të shtetit përderisa pjesa tjetër tregon një kuptim më të butë (N. Ibishi, intervistë personale, 23 maj 2014).

Duke e kuptuar se ky veprim do të nxiste kritika të mëdha dhe reagim publik, ICO e mbajti strategjinë larg nga publiku dhe vazhdimisht i bllokoi kërkesat për më shumë informata. Megjithatë, dokumenti nuk ishte klasifikuar asnjëherë pasi që ICO e kishte kuptuar se dokumenti

i SSK-së duhet të jetë i hapur për audiencën e gjerë. Sidoqoftë, SSK qëllimisht u mbajt larg nga sytë e publikut e veçanërisht nga mediat. Rrjedhimisht, ai kurrë nuk u bë temë e debatit apo konsultimit publik – gjë që kërkohet në ciklin bashkëkohor të politikëbërjes – i cili do të përfshinte një gamë të gjerë të përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe partive politike. Po të sillej dokumenti në vëmendjen e publikut, dilema e zyrtarëve të ICO-s do të ishte se “rezistenca” e publikut do të ishte më e fortë dhe më e madhe se sa ajo e bërë nga Qeveria. Në këtë mënyrë, kishte “rrezik” se produkti final do të kundërshtohej. Frika e ICO-s nga “rezistenca e vendorëve” i detyroi ata ta anashkalojnë Kuvendin e Kosovës për shqyrtim parlamentar, madje edhe komisionin parlamentar për siguri ose seancën plenare. Produkti përfundimtar i ICO-s u miratua nga Kuvendi i Kosovës, edhe pse ati i ishte dhënë pëlqimi vetëm në Kryesinë e Kuvendit. Ndikimi i tyre i madh po ashtu thekson shkallën në të cilën ICO-ja i anashkalonte procedurat e përgjithshme parlamentare. Si të tilla, këto veprime tregojnë shkëlqje të përbashkët të procedurave në parlament.

Në fund të procesit, mund të thuhet shkurtimisht se “Kosova kishte ushtruar kontroll mbi fillimin e SSK-së, njëfarë ndikimi mbi dizajnin, dhe një ndikim gjithnjë e më të vogël mbi produktin final, deri në atë shkallë sa që në fund të procesit vendorët nuk e kishin në pronësi SSK-në që kishte rezultuar nga ai proces” (Blease dhe Qehaja, 2013, f. 15). Siç kanë treguar përvojat e tjera empirike, roli i ndërkombëtarëve qëndron në dhënien e kohës dhe hapësirës që pozitat lokale që të hartojnë SSK-në, dhe nëse kërkohet, të ndihmojnë procesin përmes kultivimit të transparencës (Hansen, 2008). Me fjalë të tjera, pozita e dobët e autoriteteve lokale për t’i rezistuar strategjive të imponuara nga jashtë u kthye në mosnjohje të plotë të dispozitave të SSK-së që kurrë nuk shërbyen për të udhëzuar dokumentin doktrinar në fushën e sigurisë. Mosnjohja e qëllimshme e SSK-së e shtoi nevojën për një kornizë plotësisht të re strategjike dhe të politikave për Kosovën e cila do të bazohej në “zërin” e vendorëve. Si rezultat, në vitin 2012 Kosova filloi procesin e RSSB-së - të udhëhequr nga qeveria dhe me një rezultat në fillim të vitit 2014 që paraqet një theksim të madh të kontekstit dhe kulturës lokale (shih Kapitullin IV). Kjo ishte strategjia e parë e sigurisë së Kosovës e hartuar nga vendorët (Welch, 2014).

Në të vërtetë, duke marrë parasysh praktikën e padëshiruar historike në Kosovën e pas pavarësisë, është shumë me rëndësi që vendorët të iniciojnë procesin dhe të hartojnë strategjinë dhe legjislacionin, edhe pse nuk duhet të përjashtohen ndihma dhe sugjerimet e bashkësisë ndërkombëtare. Ekspertiza e nevojshme e bashkësisë ndërkombëtare ende është e mirëseardhur, veçanërisht në procesin fillestar të shtetndërtimit, por ajo duhet t'i përshtatet kontekstit të paraqitur në propozimet e kornizës lokale. Procedimi në mënyrë tjetër përmes miratimit të ideve të imponuara nga jashtë nuk është zgjidhje e qëndrueshme dhe mund të jetë e dëmshme. Bashkësia ndërkombëtare duhet të pajis aktorët vendorë me aftësi për të shkruar legjislacionin ose dokumentet strategjike që ata i konsiderojnë të duhura për situatën e tyre. Në këtë kuptim, investimet e jashtme duhet të synojnë ndërtimin e kapaciteteve, veçanërisht ato me perspektivë afatgjate.

SIGURIA NË BASHKËSI NGA LARTË - POSHTË

Siguria në bashkësi është koncept që aplikohet me të madhe në vendet anglo-saksone. Ky koncept ka të bëjë me përfshirjen e drejtpërdrejtë të bashkësive lokale në diskutimin dhe tejkalimin e sfidave të qetësisë dhe sigurisë në lagjen e tyre (Këshilli i Bristolit, 2014). Për shkak të sfidave komplekse me të cilat përballen komunitetet, siguria në bashkësi në radhë të parë synon të adresojë brengat e qytetarëve përmes mekanizmave në të cilët komunitetet dhe përfaqësuesit e institucioneve do të merrnin pjesë në mënyrë aktive (Caparini, 2012; Haxholli, Përteshi dhe Vrajolli, 2010). Si rezultat, përpjekjet e përbashkëta të komuniteteve dhe të zyrtarëve për siguri lokale shërbejnë për parandalimin e krimit në nivelin lokal. Për më tepër, dhe siç është sqaruar në kapitujt teorik, qëllimi i përgjithshëm i këtij koncepti është që të sigurojë lirinë nga frika. Vërtetë, liria nga frika është e mishëruar në parimet e SSK-së dhe në konceptin e sigurisë njerëzore (UNDP, 1994) si dhe në teorinë e re të sigurisë (Buzan et al. (1997).

Derisa koncepti i sigurisë së komunitetit rrjedh nga vendet anglo-saksone, ai nuk e përjashton mundësinë e aplikimit të konceptit, të paktën në parim, në rrethanat e tjera në botë. Ky është rasti me praktikat e tjera të sigurisë të cilat janë dëshmuar të suksesshme. Sidoqoftë, në mënyrë që iniciativat e sigurisë në komunitet të jenë të qëndrueshme

dhe të bazuara në kontekst, janë dy prerogativa kyç që duhet të zbatohen. Së pari, nevoja për të aplikuar sigurinë në komunitet duhet të rrjedh nga kërkesat e aktorëve lokalë. Në të vërtetë, arsyetimi i qasjes së bazuar në kërkesa (Reich, 2006) pasqyron një ndër parimet gjithëpërfshirëse të pronësisë lokale. Ngjashëm me rastin e hartimit të SSK-së, siguria në komunitet duhet të aplikohet dhe strukturohet në pajtim me kushtet dhe kulturën lokale. Në të kundërtën, ndarja e modelit të sigurisë në bashkësi nga kushtet e faktorëve lokalë paraqet një sfidë shumë paradoksale të pronësisë lokale. Së dyti, pjesëmarrja në mekanizmat e sigurisë në bashkësi duhet të pasqyrojë një përbërje që rrjedh nga bashkësia vendase. Kjo do të sigurojë që mekanizmat e sigurisë në bashkësi do të përbëhen nga përfaqësues të mirëfilltë të shoqërisë civile, e jo vetëm nga OJQ-të (Richmond, 2009).

Është e qartë se ka gjetje të mjaftueshme empirike që theksojnë natyrën e drejtuar nga jashtë të mekanizmave për siguri në bashkësi në Kosovë. Krijimi i këtyre mekanizmave ka rrjedhë në mënyrë artificiale nga politikat e bashkësisë ndërkombëtare, ose nga administrata ndërkombëtare ose nga donatorët, pa konsultim me bashkësitë lokale dhe palët e interesit. Rregullimi i sigurisë në bashkësi nga lart-poshtë ka shkaktuar implikime jo vetëm për qëndrueshmërinë e këtyre mekanizmave, por edhe për qëndrueshmërinë e kornizës ligjore.

Në fakt, iniciativat e para për krijimin e mekanizmave për siguri në bashkësi ishin në vitin 2002 gjatë kohës kur Kosova administrohej nga UNMIK-u. Këta mekanizma kishin për qëllim të krijonin një forum për përfaqësuesit e policisë, komunave dhe shoqërisë civile, për të diskutuar problemet lidhur me qetësinë dhe sigurinë dhe gjetjen e zgjidhjeve të mundshme (Haxholli et al., 2010). Ideja fillestare ishte që të krijohen këshillat e sigurisë në zonat e përziera etnike për shkak të numrit të incidenteve me motive etnike. Kjo do të siguronte jo vetëm përfshirjen e bashkësisë në parandalimin e krimeve por edhe do tu shërbente përpjekjeve për pajtim të komuniteteve. Këshillat për siguri në bashkësi paraqisnin vetëm një prej përpjekjeve të bashkësisë ndërkombëtare në përkrahjen e procesit të pajtimit.

Për më tepër, duke krijuar këshillat për siguri në bashkësi, bashkësia ndërkombëtare synonte të zhvillonte paralelisht konceptin e policimit

në bashkësi (R. Marmullaku, intervistë personale, 17 korrik 2014). Dikotomia siguria në bashkësi - policimi në bashkësi mund të konsiderohet si një prej politikave më të promovuara të pranisë ndërkombëtare në Kosovën e pas konfliktit (R. Marmullaku, intervistë personale, 17 korrik 2014). Policimi në bashkësi, ndonëse në aspektin institucional fokusohet në polici, synonte të rriste besimin ndërmjet bashkësive dhe të nxiste bashkëveprimin në mes të qytetarëve dhe zyrtarëve të policisë duke përdorur moton “policia janë populli dhe populli janë policia” (Bajraktari et al., 2006).

Në të vërtetë, veprimet e para në zbatimin e sigurisë në bashkësi janë ndërmarrë përmes mekanizmit të Ekipeve Vepruese për Siguri në Bashkësi (EVSU). EVSU fillimisht operonin në baza *ad hoc* me qëllim të adresimit efektiv të brengave të sigurisë së bashkësive lokale në Kosovë (L. Fushtica, intervistë personale, 21 korrik 2014). Derisa dispozitat e EVSU-së formalisht i referoheshin kërkesave nga poshtë-lartë në aplikimin e mekanizmave të sigurisë, modeli u soll nga jashtë pa iu referuar kushteve lokale. Zyrtarët e pranuan se modeli i EVSU-ve ishte sjellë nga modeli anglo-sakson me idenë që të mishërohet dhe përshtatet në kushtet lokale (L. Fushtica, intervistë personale, 21 korrik 2014). Si rezultat, modeli i zbatuar nga jashtë do të “stimulonte në mënyrë artificiale” kërkesat lokale. Në përpjekjen për të zbërthyer ambicien për “stimulim artificial”, duket se kishte edhe një qëllim që të arrihej një formë e hibriditetit: jo hibriditeti i përkufizuar nga Mac Ginty si përzierje e vlerave dhe kulturës në kontekstin e pas konfliktit (Mac Ginty, 2010), por bashkimi gradual i kërkesave lokale me modelin e sjell nga jashtë. Në mënyrë ilustruese, kjo do të kthente trajektorën e iniciuar nga lart-poshtë drejt asaj nga poshtë-lart, dhe si pasojë legjitimimin e nevojës për siguri në bashkësi të drejtuar nga jashtë në një fazë afatgjate.

Pas shpalljes së pavarësisë në vitin 2008, arkitektura e re e sektorit të sigurisë që u krijua iu referua autoritetit dhe pronësisë së Qeverisë së Kosovës në menaxhimin, kontrollin dhe mbikëqyrjen e sektorit të sigurisë (Kushtetura, 2008). Arkitektura e re e sigurisë ka krijuar kushtet për përmbrendësimin e këshillave të sigurisë në bashkësi, por si rezultat i kërkesave të krijuara në mënyrë artificiale. Hapi i parë ishte që të njihej dhe rregullohej mandati i këshillave për siguri në

bashkësi. Si rezultat, në vitin 2009 u nxor udhëzimi i parë administrativ me qëllim të krijimit të Këshillave Komunale për Sigurinë në Bashkësi (KKSBB) (MPB, 2009). KKSBB kishte për qëllim të instalojë një “brend kosovar” të mekanizmit të sigurisë në bashkësi i cili do të përfshinte një spektër të gjerë të bashkësive dhe zyrtarëve lokalë me qëllim të parandalimit të krimit në lagje. Për më tepër, synimi ishte që të ndërtohej një mekanizëm i vetëm për sigurinë në bashkësi i cili duhej të krijohej në të gjitha komunat e Kosovës. Kjo krijoi kushtin e një mekanizmi jo vetëm të udhëhequr në nivel lokal por i cili është financiarisht i vet-qëndrueshëm (Haxholli et al., 2010), pa pasur nevojë për mbështetje të plotë të donatorëve. Kjo ka hapur mundësinë për konsekuencë në sigurinë në bashkësi pavarësisht nevojës së vazhdueshme për ndërtim të kapaciteteve nga aktorët ndërkombëtarë dhe lokalë.

Themelimi i KKSBB-së nuk rezultoi në shpërbërjen e mekanizmave të tjerë që kishin funksionuar gjatë administrimit të UNMIK-ut, d.m.th. EVSB. Krahas KKSBB-së si model i udhëhequr vendor dhe EVSB-së si model i shtyrë nga jashtë, ishte edhe një mekanizëm i tretë i bashkësisë lokale: Komitetet Lokale për Siguri në Bashkësi (KLSB), të cilët sipas ligjit, mund të themeloheshin nga Policia në zonat specifike nëse ka nevojë të shtohet angazhimi me bashkësinë (Qeveria e Kosovës, 2008, neni 7.5). Si pasojë, Kosova e kishte një mekanizëm i cili njihet me ligj (KKSBB); një mekanizëm *ad hoc* i cili mund të krijohej nga Policia sipas nevojës (KLSB) dhe një mekanizëm të shtyrë nga jashtë mandati i të cilit nuk ishte i përcaktuar me asnjë ligj (EVSB). Ekzistimi paralel i tre mekanizmave për siguri në bashkësi kishte krijuar një varg sfidash për koordinim dhe pronësi.

Problemi i parë i referohet përfshirjes së tepërt të bashkësisë ndërkombëtare në “përkrahjen” e mekanizmave të sigurisë në bashkësi, në mënyrë specifike EVSB-të. Fakti se EVSB nuk ishte rregulluar me ligj siguronte se ai nuk mund të paraqiste “probleme” për komunitetin e donatorëve në mbështetjen e ndonjë iniciative e cila funksiononte paralelisht me KKSBB (R. Marmullaku, intervistë personale, 17 korrik 2014). Në të vërtetë, interesimi i komunitetit të donatorëve për sigurinë në bashkësi ishte aq i lartë, sa që sipas të intervistuarve, situata pasqyronte një imazh të “klientëve lokalë” dhe “furnizuesve ndërkom-

bëtarë” (Haxholli et al., 2010; M. Vrajolli, intervistë personale, 2 qershor 2014). Kjo ka krijuar një ndarje artificiale të rolit të organizatave ndërkombëtare në mbështetjen e secilit prej këtyre mekanizmave. Për më tepër, kjo ndërlidhet me dilemën e Reich për “marrëdhënien patron-klient” (Reich, 2006, f. 22). Si rrjedhojë, për shembull, EVSB-të vazhduan të mbështeten dhe mbahen përmes projektit amerikan Programi Ndërkombëtar i Asistencës për Trajnime në Hetime Penale (ICITAP) dhe KLSB përmes Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE). Në anën tjetër, nuk ka pasur ndonjë iniciativë të rëndësishme për të mbështetur përpjekjen e KKSB-ve të udhëhequra nga vendorët (Haxholli et al., 2010). Mbështetja e donatorëve ishte e çorganizuar dhe jotransparente, duke shkaktuar vështirësi në llogaritjen e vlerës së përgjithshme të dhënë nga donatorët për iniciativat e sigurisë në bashkësi që nga viti 2002.

Problemi i dytë ka të bëjë me “marrëdhënien patron-klient”, që ndërlidhet me dobësimin e mekanizmave të udhëhequr nga vendorët (KKSB) për shkak të mbështetjes nga jashtë dhënë EVSB-ve. Sipas një të intervistuarit, të njëjtit njerëz që përfaqësonin të njëjtat OJQ “kërcejnë” nga një takim i njërës mekanizëm në tjetrin, sepse marrin honorar të mjaftueshëm sa për të ruajtur praninë e përfaqësuesve të shoqërisë civile në të gjitha takimet (R. Marmullaku, intervistë personale, 17 korrik 2014). Kjo situatë po ashtu pasqyron dilemën e Fukuyamas, në të cilën OJQ-të e krijuara nga jashtë me siguri kanë “degeneruar në grupe të interesit që përfitojnë mjete pa sjell asnjë të mirë” (Fukuyama, 2004, f. 41) për një varg iniciativash që kanë për qëllim të përkrahin tranzicionin e sigurisë në bashkësi. Përfaqësuesit e këtyre OJQ-ve shërbyen si urë lidhëse ndërmjet “klientëve dhe patronëve”.

Një problem i tretë nënvizon çështjet rreth pjesëmarrjes së faktorëve lokalë në të gjitha këto iniciativa. Problemi nuk mund të identifikohet vetëm me pjesëmarrjen e përfaqësuesve lokalë qeveritarë si të tillë, por ka të bëjë me dilemën se kush e përfaqëson shoqërinë civile. Nëse lexohet një udhëzim administrativ që shënon përbërjen e mekanizmave për siguri në bashkësi, shihet se vetëm një referencë i bëhet atyre që përfshijnë “përfaqësuesit e OJQ-ve, mediave lokale, bizneseve dhe njerëzve me aftësi të kufizuara” (MPB, 2012). Këtu duhet ngritur dilema për OJQ-të, të cilat në sytë e bashkësisë ndërkombëtare janë për-

faqësues të vërtetët të shoqërisë civile. Siç është sqaruar në kornizën teorike, vendet perëndimore e përkufizojnë shoqërinë civile kryesisht në bazë të OJQ-ve, shoqatave dhe qytetarëve (Mac Ginty, 2012; Reich, 2006; Richmond, 2009) ndërsa në Kosovë, për shembull, udhëheqësit e fshatrave mund të përfaqësojnë më shumë bashkësitë vendase se sa OJQ-të. Si rezultat, mbështetja vetëm në përfaqësuesit e OJQ-ve për parandalimin e krimit jo vetëm që ngrit dilemën e “OJQ-ve që marrin fonde e nuk bëjnë asgjë” (Fukuyama, 2004), por edhe e konteston qasjen thelbësore gjithëpërfshirëse ndaj RSS-së.

Problemi i katërt e merr parasysh natyrën e mbivendosjes së përkrahjes së donatorëve. Në vend të bashkimit të përpjekjeve dhe rritjes së kapaciteteve të KKSB-ve, komuniteti i donatorëve ka investuar në mekanizma që nuk sigurojnë rezultate cilësore. Kjo situatë jo vetëm që dëmton pronësinë lokale mbi sigurinë në komunitet por edhe shërben si platformë për konkurrencë dhe mungesë koordinimi ndërmjet donatorëve - një problem që është theksuar nga OECD në secilën RSS (OECD, 2007). Këta mekanizma po ashtu duket se përdoren si aktivitet i bashkësisë ndërkombëtare për të arsyetuar praninë e tyre. Në disa takime të KKSB-ve dhe të mekanizmave të tjerë, prania e zyrtarit të EULEX-it ishte e panevojshme (ndonëse nuk ishte në mandatin e tyre), pasi që me pjesëmarrje, zyrtarët mund të arsyetonin detyrën e tyre dhe të “shënonin se e kanë kryer detyrën” në raportet e tyre (R. Marmullaku, intervistë personale, 17 korrik 2014).

Një dilemë tjetër e trajton varësinë e mekanizmave të sigurisë në bashkësi nga përkrahja e huaj. Në të vërtetë, EVSB nuk ka ndonjë pronar që dihet dhe nuk ka garanci se investim tepër i madh i bërë në këtë mekanizëm do të tregohet i qëndrueshëm pas largimit të donatorëve nga Kosova. Kjo situatë është veçanërisht shqetësuese kur dihet se varësia financiare e sigurisë në komunitet po ashtu ka krijuar një varësi të përgjithshme që lë pak hapësirë për zbatimin e ndonjë strategjie dalëse. Ky është një problem që nuk ei bën përgjegjëse vetëm bashkësinë ndërkombëtare, por edhe institucionet lokale siç është MPB. Ajo më shumë paraqet mungesën e asaj që William Bain e ka përkufizuar si “autoritet për të rezistuar” (Bain, 2006, f. 537). Për të përkujtuar përkufizimin e Bain, “autoriteti për të rezistuar” mund të shihet lehtë në rastin kur vendorët janë në pozitë tu thonë “jo” disa


veprimeve të caktuara të ndërmarra nga ndërkombëtarët. Kështu sigurisht është rasti me sigurinë në bashkësi të drejtuar nga jashtë e cila nuk mund të shënojë kurrfarë rezistence nga institucionet kosovare në vend të autoritetit lokal. Rezistenca këtu nuk interpretohet në kuptimin tradicional të parandalimit të përfshirjes paralele të donatorëve, por e konsideron kanalizimin e përkrahjes potenciale në mekanizmat e udhëhequr nga vendorët dhe të njohur ligjërisht të KKSB-ve.

Modeli i sigurisë në bashkësi konsiderohet të jetë esencial në kuadër të pronësisë lokale përderisa rrjedh nga popullsia drejt së cilës është i orientuar ky parandalim dhe kjo siguri. Mungesa e ndërlidhjes me kontekstin lokal e bën projektin e papërshtatshëm, edhe nëse ai përmban disa elemente të nuancuara të pronësisë lokale. Në frymën e përfshirjes tepër të madhe të komunitetit të donatorëve, ishte me rëndësi të vlerësohet në mënyrë empirike shkalla në të cilën kjo përkrahje kishte ndikim te qytetarët. Meqë të gjitha këto “investime” të bëra nga jashtë filluan në vitin 2002, ndikimi i kësaj mbështetjeje mund të matet në zonat ku jetojnë bashkësitë. Natyrisht, unë kam aplikuar një metodë të vetme të perceptimit publik: duke i pyetur rreth pranisë së të tre mekanizmave. Kjo duket se e sqaronte mjaftueshëm njohjen e përfshirjes së bashkësive në të gjithë mekanizmat dhe iniciativat për siguri në bashkësi.

Pyetja që u shtrua ishte se a kishin dijeni të anketuarit për ekzistimin e mekanizmave të sigurisë në bashkësi, si KLSP, EVSB dhe KKSB. Mbi 80% e të anketuarve u shprehën se ata nuk kishin dijeni se ekzistonin këta mekanizma. Rezultatet ishin mjaft dekurajuese, pasi që 12 vitet e përkrahjes së donatorëve për sigurinë në bashkësi nuk kishin çuar në një vetëdijesim të publikut të gjerë për ekzistimin e institucioneve që synonin të përfaqësonin interesin e tyre në çështje të qetësisë dhe sigurisë në komunat e tyre. Kjo e ka vështirësuar matjen e mëtejshme të kënaqshmërisë së njerëzve me këshillat për siguri lokale për arsyen e thjeshtë se nuk mund të vlerësohen rezultatet e mekanizmave me bazë në bashkësi në vend të vetëdijesimit publik mbi ekzistimin e këtyre mekanizmave. Figura 18 tregon se vetëm 12-17% e të anketuarve kanë shprehur se kanë deri diku njohuri për ekzistimin e mekanizmave për siguri në bashkësi. Përveç kësaj, ekzistimi i EVSB-ve prej vitit 2002 nuk ka sjell ndonjë ndryshim të gjendjes së përgjithshme. Hulumtuesit në

terren, në sqarimet e tyre lidhur me reagimin e të anketuarve, theksuan se ata që thoshin se kanë njohuri për ekzistimin e mekanizmave të sigurisë nuk mund të identifikonin dallimin ndërmjet njërit apo tjetrit mekanizëm (Grupi i fokusit, 2014). Ky është tregues i mjaftueshëm për të sqaruar pasojat e përfshirjes së donatorëve të shumtë para një perspektive të komunitetit.

Figura 18. A keni njohuri për ekzistimin e mekanizmave të mëposhtëm të sigurisë? (n=1,099)



Rezultatet e matjes së perceptimit publik konfirmojnë investimin e pasuksesshëm të donatorëve në sigurimin e mekanizmave të qëndrueshëm për sigurinë në bashkësi që i shërbejnë interesit të qytetarëve. Këto veprime për sigurinë në bashkësi, ngjashëm me dy shembujt e shpjeguar më lartë, pasqyrojnë dilemën primare të theksuar nga Laurie Nathan i cili nxori mësimet nga donatorët në Afrikë (Nathan, 2007). Natyrisht, kontekstet janë të ndryshme por mjetet për zbatimin e këtyre veprimeve mbesin të njëjta. Kjo qasje dhe ky shembull nuk bëjnë përjashtim nga qasja e përgjithshme e standardizuar e bashkësisë ndërkombëtare për “shënimin si punë të kryer në matricë” në promovimin e pronësisë lokale në letër. Këto veprime shkojnë më larg, duke shkelur në fakt thelbin e pronësisë lokale.

TEJPRIORITIZIMI I INCIDENTEVE ME MOTIVE ETNIKE

Institucionet e sigurisë kanë mandatin të parandalojnë dhe luftojnë një numër të madh krimesh që paraqesin sfidë për rendin dhe sigurinë publike. Siç është sqaruar në Kapitullin III institucionet e sigurisë së Kosovës, në radhë të parë policia, u krijuan shumë shpejt në periudhën menjëherë pas konfliktit për të siguruar kontrollin dhe menaxhimin e rendit publik në një kontekst të brishtë. Në shqyrtimin e literaturës ndërkombëtare dhe mendimeve të të intervistuarve, shumica e burimeve i referohen qëllimit të bashkësisë ndërkombëtare për përgatitjen e policisë me bazë lokale për të trajtuar dhunën në baza etnike (R. Marmullaku, intervistë personale, 17 korrik 2014; L. Fushtica, intervistë personale, 21 korrik 2014; M. Vrajolli, intervistë personale, 2 korrik 2014). Së bashku me policinë lokale, prania e madhe e policisë dhe ushtrisë ndërkombëtare në terren nuk ishin në gjendje të parandalonin një numër krimesh që ose ishin me motive etnike ose të kryera ndaj viktimave që i takonin një bashkësie pakicë.

Derisa sasia e këtyre krimeve duket të ketë qenë shqetësimi primar në periudhën menjëherë pas konfliktit, numri i këtyre incidenteve në baza etnike kishte rënë gradualisht si rezultat i përmirësimit të ambientit të sigurisë në Kosovë. Kjo rënie mund të shihet në mënyrë statistikore çdo vit, si dhe të identifikohet në diskurs. Nga këndvështrimi kontekstual, ky trend i rënies ishte ndërprerë vetëm një herë në mars të vitit 2004, me shpërthimin e trazirave të cilat, sidoqoftë, nuk ishin vetëm tensione ndëretnike por edhe pakënaqësi ndaj pranisë ndërkombëtare (shih Kapitullin III).

Trendi i rënies së numrit të krimeve ndëretnike nuk rezultoi me ndryshimin e politikës nga bashkësia ndërkombëtare. Prandaj, të kuptuarit e prioriteteve të sigurisë mbeti i njëjtë me ato që kishin qenë në periudhën menjëherë pas konfliktit. Ky rast studimor paraqet një numër gjetjesh që tregojnë politikat e shkëputura të misioneve ndërkombëtare nga rrethanat lokale në Kosovë. Ai nuk paraqet vetëm shkëputjen e misioneve ndërkombëtare nga realitetet lokale në vetvete, por edhe pasqyron implikimet e këtyre misioneve në prioritizimin e politikave nga Policia e Kosovës. Këtu fokusi vendoset në prioritizimin e tepruar të gatishmërisë institucionale në parandalimin dhe luftimin e

incidenteve ndëretnike, përkundër krijimit të një mjedisi të ri të sigurisë në Kosovën e pas pavarësisë. Kjo situatë ilustron se si misionet ndërkombëtare pothuaj nuk shkojnë përtej qëllimeve të tyre të përcaktuara në fillim. Ky shembull ofron përgjigje empirike në dilemat konceptuale që njihen nga studiuesit ndërkombëtarë lidhur me qasjen e standardizuar të misioneve ndërkombëtare dhe mbizotërimin e “politikës së lartë” në dizajnimin e politikave.


Këtu është me rëndësi të zërthehen veprimet e misionit ndërkombëtar duke ju referuar prioritizimit të tepruar që i bëhet parandalimit të incidenteve ndëretnike. Sa për të përkujtuar, baza ligjore për vendosjen e misioneve ndërkombëtare në Kosovë ishte mbështetur në qëllimin e përgjithshëm të krijimit të një mjedisi të “qetë dhe të sigurt” (shih Kapitullin III). Ky vizion ishte përfshirë në vitin 1999 në Rezolutën 1244 të KSKB-së dhe gjendej në të gjitha dokumentet dhe raportet e tjera ndërkombëtare. Në të vërtetë, marrëdhëniet ndëretnike, si marrëdhënie mes shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës, ishin shkaktari kryesor i konfliktit, dhe sollën pasoja gjatë gjithë periudhës së pas konfliktit. Në vitin 2006, Bashkimi Evropian (BE) lansoi një mision planifikues - Ekipin Planifikues të Bashkimit Evropian (EUPT) - që kishte për qëllim të përgatiste terrenin për misionin e ardhshëm të EULEX-it. EUPT i përcaktoi detyrat dhe mandatin e misionit të ardhshëm të EULEX-it - në frymën e mjedisit të ri politik lidhur me statusin e Kosovës - i cili kryesisht duhej të bazohej në tre komponentë: mentorim, këshillim dhe monitorim, dhe duke mbajtur edhe disa kompetenca ekzekutive. Misioni planifikues e dizajnoi strukturën e EULEX-it në të cilën policia përfaqësonte autoritetin për të klasifikuar motivet e incidenteve. Ekipi e klasifikoi fokusin e misionit të BE-së, duke e paraparë përfshirjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit, si dhe arrestimin e kriminelëve të luftës si realiste.

Përveç kësaj, ekipi planifikues i kushtoi vëmendje të veçantë të ashtuquajturave Incidente Potenciale me Motive Etnike (IPME) - kategori kjo që mbulonte krimet ku viktimë ishin komunitetet pakicë. Sipas të intervistuarit përgjegjës për komunikim me EUPT, krahas mungesës e konsultimit me autoritetet policore lokale, problem ishte se planifikimi nuk pasqyronte problemet reale dhe rrethanat në terren në të cilat rritej numri i krimeve të tjera, përderisa ato që ishin në baza etnike po

binin në mënyrë drastike (R. Marmullaku, intervistë personale, 17 korrik 2014). Rrjedhimisht, veprimet e EUPT-së nuk e morën parasysh konsultimin me grupin e gjerë të aktorëve lokalë. Kjo çoi në dilemën mbizotëruese në emër të vendorëve e cila në mënyrë serioze e sfidoi legjitimitetin. Mungesa e konsultimit dhe pozita e dobët e autoriteteve lokale që të sfidojnë këto veprime janë pasqyrim i vrojtimeve të bëra nga Richmond dhe Said - marrëdhënia e pabarabartë ndërmjet ndërkombëtarëve dhe vendorëve (Richmond, 2009; Said, 1994).

Vërtetë, të intervistuarit deklaruan se një theksim i tepruar i një krimi të caktuar mund të konsiderohet si tendencë për të paragjykuar se krimet etnike po ndodhin shpesh pavarësisht trendeve në rënie (R. Marmullaku, intervistë personale, 17 korrik 2014). Ish zyrtari i lartë i Policisë elaboroi më tej duke shpjeguar kompleksitetin e IPME-ve; “regjistrimi i krimeve të këtij lloji do të bëhej në të gjitha rastet në të cilat komuniteti pakicë ishte viktimë, pa e identifikuar nëse kryesi ishte nga komuniteti shumicë ose, që ishte edhe më me rëndësi, se a ishte incidenti/krimi me motive etnike” (R. Marmullaku, intervistë personale, 17 korrik 2014). Si rezultat, duket se motivet pas vendimeve të gjykatave kohëve të fundit nuk bazoheshin në kriteret etnike por në baza personale dhe pronësore, gjë që, në disa raste identifikonte përfshirjen e individëve që ishin nga e njëjta bashkësi.

**Figura 19. Numri i përgjithshëm i vrasjeve në vit (1999-2012):
Statistikat e Policisë së Kosovës (2014)**



Siç ilustron në Figurën 19, ka një rënie të përgjithshme të numrit të vrasjeve në vit, e po ashtu edhe një rënie të numrit të krimeve me motive etnike. Nëse e krahasojmë vitin 2000 me 2013, ka një trajektore që tregon trendet e rënies së numrit të vrasjeve, nga 256 në vitin 2000 në 39 në vitin 2013. Kjo nuk do të thotë se situata e sigurisë në Kosovë është përmirësuar në atë masë sa duhet të ndihemi krejtësisht rehat. Në fakt, shifrat tregojnë një rritje të konsiderueshme të sigurisë dhe ambientit të sigurt. Kështu është rasti edhe me krimet me motive etnike të cilave u janë nënshtruar bashkësitë pakicë.

Klasifikimi i shkaqeve të krimit në nivelin e hetimit policor mund të jetë çorientues dhe joprofesional. Në një korrespondencë përmes emailit me zëdhënësin e Policisë së Kosovës, mua më janë dhënë statistikat për rastet e vrasjeve në vit, por duke përjashtuar klasifikimin e motiveve. Në sqarimin e përfaqësuesve të policisë, është thënë qartë se “motivet e rasteve zbulohen vetëm pas vendimit të gjykatës” (Korrespondencë e *Policisë së Kosovës* përmes emailit, 15 gusht 2014). Prandaj, dhe duke e tërhequr një vijë ndarëse me përpjekjet e mëhershme nga bashkësia ndërkombëtare, mund arrihet në përfundim se vendimet politike mbizotërojnë para vlerësimit profesional të motiveve që qëndrojnë prapa krimit. Për ta elaboruar me tej këtë dilemë, një supozim i përbashkët në mesin e të intervistuarve është se meqë misioni ndërkombëtar tregon një këmbëngulësi të vazhdueshme ndaj IPME, synimi shkon përtej qasjes së standardizuar të përpjekjeve neoliberales për ndërtimin e paqes. Përveç kësaj dileme ekziston një qëllim politik të cilin burokratët ndërkombëtarë e aplikojnë në mënyrë elegante për të arsyetuar praninë e tyre - qëndrimi që sfidon opinionin profesional në nivel të policimit. Ky arsyezim e merrte parasysh presionin e aplikuar në mënyrë të rreptë nga disa aktorë ndërkombëtarë duke marrë parasysh dispozitat e Rezolutës 1244 të KSKB-së të vitit 1999 dhe duke lënë nën hije argumentet e tjera profesionale që u zhvilluan në vitin 2007 dhe 2008. Si pasojë, nuk kishte dallime të mëdha në mënyrën se si, për shembull, ishte prezantuar misioni i mëhershëm i UNMIK-ut, nga misioni i EULEX-it që po krijohet. Kjo ishte arsyeja pse perceptimi i publikut ndaj këtij të fundit nuk e bënte dallimin ndërmjet UNMIK-ut dhe EULEX-it përkundër qëllimit (të paktën me fjalë) të këtij të dytit që të arsyetohet se ka një mandat krejtësisht ndryshe me fokus të veçantë në sundimin e ligjit (shih Kapitullin IV).

Argumenti politik është kompleks sepse ai paraqiste ndikimin e disa anëtarëve të BE-së dhe OKB-së, që duke theksuar dështimin në adresimin e krimeve në baza etnike, i përforconin argumentet kundër avancimit të statusit politik dhe shoqëror të shtetësisë së Kosovës. Rrjedhimisht, EUPT dhe EULEX konfirmuan argumentin mbizotërues të një qasjeje të standardizuar të misionëve ndërkombëtare në të cilën qëllimet fillestare rrallë modifikohen nga misionet pasardhëse. Për më tepër, u përforcuan dilemat mbi pandryshueshmërinë e dizajnit të strukturës, pasi që për këto veprime nuk kishte pasur konsultime me autoritetet lokale.

Në anën tjetër, planifikimi në bazë të “kontekstit menjëherë pas konfliktit” bëri që përfaqësuesit e policisë së Kosovës të shikojnë zyrtarët e ardhshëm policorë të EULEX-it si të njëjtë me ata të UNMIK-ut (B. Selimi, intervistë personale, 20 tetor 2014), edhe pse, në parim, zyrtarët policorë të EULEX-it nuk kishin mandat ekzekutiv (L. Fushtica, intervistë personale, 21 korrik 2014) përveç disa përjashtimeve, përfshirë edhe veprimet kundër krimit të organizuar dhe krimeve të luftës. Në parim, kjo i sfidoi dispozitat ligjore në Kosovën e pas pavarësisë në të cilën vendorët duhet të mbanin përgjegjësinë primare në çështjet e sigurisë. Ajo e rriti mospërputhjen ndërmjet politikave të shtyra nga jashtë dhe argumenteve profesionale në favor të hartimit të politikave me qëllim të parandalimit të shqetësimeve të sigurisë të kohës së (atëhershme) tashme.

Disa autorë janë të prirë të zërthejnë këto veprime përtej sjelljeve politike dhe të standardizuara. Ky veçanërisht është rasti kur ka arsyetim të vazhdueshëm të mbajtjes së një prioriteti të vjetër në agjendën politike në mënyrë që të ruhet “*status quo*”. Me fjalë të tjera, veprimet e zbatuara nga disa burokratë ndërkombëtarë kishin për qëllim të mundësojnë zgjatjen e punësimit të tyre në mision. Ky qëndrim mund të përshkruhet si “profesion i ndërkombëtarëve”. Argumenti për këtë bazohet në sugjerimin se shumica e “ndërkombëtarëve” kanë kaluar nga një mision në tjetrin, çka rrjedhimisht ka çuar në krijimin e një “profesioni” specifik (M. Vrajolli, intervistë personale, 2 qershor, 2014). Ky argument bazohet edhe në dilemën e Lemay-Hebert se bashkësia ndërkombëtare e ka një stil të privilegjuar të jetës (Lemay-Hebert, 2001) në dëm të njerëzve të varfër dhe politikave artificiale.

Vazhdimi i kësaj politike dhe prioritizimi i saj ishte vendim i njëanshëm i marrë nga bashkësia ndërkombëtare, i vlerësuar vetëm në bazë të përshkrimeve të vet atyre pa u konsultuar me përfaqësuesit legjitimë të aktorëve lokalë. Sërish, duke përdorur teorinë e Zaum-it për legjitimitetin e misioneve ndërkombëtare, duhet mbajtur mend se populli dhe përfaqësuesit e tij duhet të thonë fjalën e tyre për prioritetet dhe mandatin e bashkësisë ndërkombëtare. Kjo duhet të ndodhë pasi që autoriteti i bashkësisë ndërkombëtare, edhe pse mbështetet në bazën ligjore, nuk mund të jetë absolut, duhet të mbahet përgjegjës (Zaum, 2006) dhe nuk mund të marrë nëpër këmbë autoritetin lokal (Hopgood, 2009. Si rezultat, kritika se institucionet lokale nuk ishin konsultuar nga misionet ndërkombëtare për fushëveprimin dhe detyrat e misioneve ishte konsideruar shumë problematike nga palët e interesit (B. Rexhepi, intervistë personale, 25 gusht 2014; R. Marmullaku, intervistë personale, 17 korrik 2014; N. Rashiti, intervistë personale, 5 qershor 2014), duke ofruar kështu një shembull shtesë për mospërputhjen e modelit të shtyrë nga ndërkombëtarët brenda këtij konteksti.

Pasojat e politikave të standardizuara janë matur duke i krahasuar me paaftësinë e EULEX-it që të përmbush, të paktën pjesërisht, mandatin e vet. Mungesa e pëlqimit të dhënë nga autoritetet lokale, qeveritare ose të shoqërisë civile, e ka sjell në pikëpyetje kredibilitetin e EULEX-it që nga fillimi i vendosjes. Ka pasur një mospërputhje të madhe ndërmjet deklaratave fillestare të BE-së që vepron si aktor global, me misionin e EULEX-it që ishte më i madhi i këtij lloji në histori, dhe performancës së tij në terren. Perceptimi i ulët i publikut dhe kriza e legjitimitetit, të zbërthyer përmes kontekstit të perceptimit publik (shih Kapitullin IV), sqarojnë mjaftueshëm planifikimin e dobët dhe shkëputjen e rrethanave lokale nga politikat.

KAPITULLI V

PËRMBLEDHJE MBI PRONËSINË LOKALE NË MJEDISËT E PAS PAVARËSISË

Unë i kam demonstruar parimet e pronësisë lokale në tërë procesin e shtetndërtimit. Në të vërtetë, një prej hapave të parë të përpjekjeve humluese ishte zberthimi i kornizës konceptuale ekzistuese të pronësisë lokale. Kam pasur disa supozime të caktuara që në fillim të hulumtimit se a është pronësia lokale konceptualisht e qëndrueshme. Me kohë e kuptova se ky koncept nuk është i zhvilluar sa duhet. Kjo është dëshmuar në bazë të një ekzaminimi të thellë teorik. Si rezultat, një ndër kontributet shkencore kryesore ishte në pasurimin e mbështetjes konceptuale në mënyrë që testohet dhe kontekstualizohet ajo në rastin tonë studimor.

Kontributi teorik ka synuar të fus pronësinë lokale në kuadër të teorisë së shtetndërtimit. Kjo është e mundur sepse zberthimi i pronësisë lokale në kuadër të shtetndërtimit pasqyron dilemën parësore mbi shkallën në të cilën është marrë parasysh pronësia lokale. Natyrisht, pronësia lokale i është pranëvendë RSS-së sepse koncepti, ndonëse në nivel të politikave, ka rrjedhur nga RSS (Donais, 2008). Sidoqoftë, kufizimi i konceptit të RSS-së është i pamjaftueshëm për analizën shkencore të saj duke marrë parasysh teoritë e tjera relevante siç është teoria e shtetndërtimit. Prandaj, unë i kam dhënë prioritet teorisë së shtetndërtimit përmes testimit të pronësisë lokale në kuadër të normave siç janë besimi dhe legjitimiteti. Për më tepër, unë i kam dhënë një vend të caktuar ekzaminimit të pronësisë lokale në kontekstin e ligjshmërisë, ku vetëvendosja e paraqet një ndër parimet që aplikohet më së shumti. Veç kësaj, dhe duke pasur parasysh natyrën e fokusimit të pronësisë lokale në vendet me administrim ndërkombëtar ose gjysmë-ndërkombëtar, unë kam përfshirë edhe teorinë e ndërtimit të paqes në kornizën e përgjithshme të teorisë së shtetndërtimit.

Unë e kam kontekstualizuar pronësinë lokale brenda kornizës së marrëdhënieve ndërmjet bashkësisë ndërkombëtare dhe aktorëve lokalë në Kosovë duke përcaktuar këtë marrëdhënie në një lidhje ndërkombëtarë- vendorë. Prandaj, nuk kam mundur të ekzaminojë ndarazi rolin e aktorëve në procesin e zhvillimit të sektorit të sigurisë. Janë pikërisht këto marrëdhënie komplekse që pengojnë zbatimin e pronësisë lokale. Komponenti i përgjithshëm ishte kontekstualizimi i “politikës së lartë” dhe implikimet e saj në zbatueshmërinë dhe respektimin e pronësisë lokale. Prandaj, ishte e pashmangshme vënia e një fokusi të veçantë në “politikën e lartë” pasi që shumica e gjetjeve përshkruanin faktorët politikë që sfidonin pronësinë lokale. Në fakt, unë kam argumentuar se bashkësia ndërkombëtare është e obsesionuar me sigurinë, duke e futur atë brenda një stabiliteti të tepruar dhe duke e stërpërdorur atë si mjet. Kjo rrezikon përfshirjen e vendorëve në procesin e shtetndërtimit deri në atë pikë sa e tjetëron popullsinë dhe profesionistët lokalë.

Për më tepër, e kam vënë pronësinë lokale jo vetëm në kontekstin e Kosovës por në mënyrë specifike, edhe në kuadër të sektorit të sigurisë. Janë dy arsye kryesore që e arsyetojnë ekzaminimin e sektorit të sigurisë si vendimtar në përshkrimin e marrëdhënieve ndërmjet bashkësisë ndërkombëtare dhe aktorëve lokalë. Arsyeja e parë nënkupton se sektori i sigurisë mbetet pjesa më e fortë e aparatit shtetëror. Kjo është ajo njohja tradicionale e institucioneve të sigurisë që nënkupton elementin detyrues të shtetit (Buzan, 1991; Weber, 1958). Unë nuk i njoh institucionet e sigurisë vetëm nga kjo perspektivë tradicionale, vetëm si forca të armatosura, polici dhe inteligjencë. Unë më shumë e njoh dhe e kam ekzaminuar sektorin e sigurisë përmes qasjes gjithëpërfshirëse, e cila përfshin, bashkë me forcat e sigurisë dhe policisë, rolin e aktorëve mbikëqyrës siç janë qeveria, parlamenti, institucionet e pavarura dhe shoqëria civile (OECD, 2007). Arsyeja e dytë është më shumë e përqendruar në kontekst; meqë sektori i sigurisë është ndër-tuar nga zeroja (Qehaja dhe Vrajolli, 2011) në periudhën menjëherë pas konfliktit në Kosovë, është me rëndësi të shihet shkalla e ndikimit të bashkësisë ndërkombëtare në këtë sektor pas pavarësisë.

RISHIKIMI I PRONËSISË LOKALE

Kontributi më i madh për konceptin e pronësisë lokale buron nga qarqet e politikave (policy circles). Këtu unë e përfshij rëndësinë e një numri organizatash ndërkombëtare si dhe një numri autorësh individualë (Donais, 2008; Mac Ginty, 2010; Nathan, 2007; Reich, 2006; Richmond, 2009a). Ky kontribut, megjithatë, ka arritur të bëj vetëm zbërthimin teknik të konceptit të pronësisë lokale. Referenca në pronësinë lokale zakonisht është bërë në raport me RSS-në, duke e sjell konceptin në vijë me thirrjet për përfshirje më të gjerë të aktorëve lokalë në të gjitha fazat e RSS-së. Referencat në pronësinë lokale janë shtuar si rezultat i praktikës së keqe të shpeshtë nga bashkësia ndërkombëtare.

Sidoqoftë, puna kërkimore ekzistuese ka mbetur e kufizuar në disa “fjalë që ishin në modë”: pronësia lokale përdorej bashkë me fjalët “stabilitet”, “demokraci”, “ndërtim i paqes”, “pajtim” dhe shumë e shumë fjalë të tjera. Në fakt, duket se ka një ekzaminim të thellë shkencor të të gjitha “fjalëve më të shpeshta” të cekura më lartë, ndërsa shprehja pronësi lokale bën përjashtim. Përpyekjet e bashkësisë ndërkombëtare dhe disa studiuesve individualë e kanë mbështetur nevojën për pronësi lokale. Përderisa ka një qëllim përgjithësisht pozitiv prapa kësaj përfshirjeje, në anën tjetër, disa prej këtyre përpyekjeve ndihmojnë vetëm duke “shënuar plotësuar rubrikën” si kërkesë e disa donatorëve (Wilén & Chapaux, 2011) për të siguruar fonde dhe marrëdhënie të mira me qeveritë donatore (Richmond, 2012). Kjo është përkufizuar si marrëdhënie “patron-klient”, në të cilën bashkësia ndërkombëtare është patroni ndërsa vendorët janë klientë (Reich, 2006, f. 22).

Në anën tjetër, lehtë mund të thuhet se edhe përkufizimet e ofruara nga bashkësia ndërkombëtare mbi pronësinë lokale dallojnë nga një organizatë në tjetrën, janë teknike dhe mjaft të paqarta. Duhet të kujtojmë orvatjet e zyrtarëve të OKB-së që synonin të ofronin një përkufizim të pronësisë lokale (ose të asaj që ata i referoheshin si “pronësi kombëtare”, që nënkupton kulturën burokratike të angazhimit me elitat përmes vënies së shtetit në qendër (Richmond, 2012, f. 366). Përkufizimi jobindës i politikave kishte implikime edhe në përfshirjen e vendorëve në kuadër të konceptit të pronësisë lokale. Ai nuk

definonte mjaftueshëm se a nënkuptonte termi lokale përfshirjen e bashkësive vendase (autoktone) përveç elitave. Përkufizimi ekzistues më shumë nënkuptonte një qasje lineare në të cilën shoqëritë shikohen nga perspektiva e shoqërisë civile perëndimore. Përbërja sociale e shoqërisë civile duhet të shikohet përtej qasjes ekzistuese lineare (Chandler, 2013)

As përpjekjet e tanishme akademike nuk mundën të japin një kuptim konciz të pronësisë lokale. Timothy Donais e ka përkufizuar pronësinë lokale si “...procesin se sa aktorët lokalë ushtrojnë kontrollin ose ndikimin mbi fillimin, hartimin dhe zbatimin e procesit të reformës” (Donais, 2009, f. 118). Kontributi i tij bazohej në nevojën e përfshirjes së vendorëve në të gjitha proceset e RSS-së. Për më tepër, ai avokoi për nevojën e një përfshirjeje më të gjerë të faktorëve lokalë, duke përfshirë jo vetëm përfaqësuesit e qeverisë por edhe përfaqësuesit e shoqërisë së gjerë civile, domethënë, bashkësitë lokale. Në mënyrë të ngjashme, Laurie Nathan u përpoq të arsyetonte pronësinë lokale në bazë të orientimit të politikave duke e kritikuar bashkësinë ndërkombëtare e veçanërisht komunitetin donator që ishte i gatshëm të bënte RSS-në në vendet partnere. Në vend të kësaj ai kishte avokuar se ata (bashkësia ndërkombëtare) duhet të fokusohen në përkrahjen e aktorëve lokalë që duan të bëjnë RSS-në (Nathan, 2008).

Si përpjekjet e Donais ashtu edhe ato të Nathan (mes tjerash) kanë ndihmuar në promovimin e konceptit të pronësisë lokale larg qarqeve të politikave. Ata morën pjesë në misionet e ndryshme ndërkombëtare, duke siguruar që kontributi i tyre të rrjedh nga dobësitë e këtyre misionëve në përjashtimin e aktorëve lokalë nga proceset e RSS-së. Si rezultat, ata ja dolën të iniciojnë një debat për pronësinë lokale i cili shkonte përtej “fjalëve” të përgjithshme “që përdorshin shpesh”. Sidoqoftë, ky kontribut nuk mund të analizonte në mënyrë shkencore pronësinë lokale dhe raportin e saj me sjelljet shoqërore. Ai nuk mundi të ndihmojë as në identifikimin e implikimeve të mungesës së pronësisë lokale në procesin e shtetndërtimit. Në anën tjetër, Oliver Richmond e ka bërë një hap përpara duke zbërthyer marrëdhënien ndërmjet ndërkombëtarëve dhe vendorëve në kuadër të pronësisë lokale. Përpjekjet e tij synonin të thjeshtësojnë përkufizimin meqë “... marrëdhëniet ndërmjet aktorëve të jashtëm dhe të brendshëm mbi

institucionin politik, ligjor, social, zhvillimor dhe të sigurisë importohen ose ndërtohen dhe bazohen në nivelin lokal” (Richmond, 2012, f. 359). Richmond e shtjelloi arsyetimin socio-politik në bazë të të cilit ishte penguar pronësia lokale. Me këtë, ai ju referua qasjes patronizuese të bashkësisë ndërkombëtare ndaj vendorëve duke tërhequr paralele me epokën kolonialiste (Richmond, 2012), ngjashëm me argumentet e përcaktuara nga Said në dekadat e mëhershme (Said, 1994). Për më tepër, sjelljet e bashkësisë ndërkombëtare janë ekzaminuar nga Lemay-Hebert (2011), ndërsa Mac Ginty e ka konceptuar marrëdhënien e përgjithshme në atë që ai e ka definuar si “marrëdhënie hibride” (Mac Ginty, 2011).

Në anën tjetër, libri ka kontribuar në mënyrë konceptuale në këtë çështje duke e zbërthyer pronësinë lokale nga perspektiva të ndryshme: Implikimet e mosbesimit dhe legjitimitetit; shkalla në të cilën “politika e lartë” është aplikuar si vegël e shprehur përmes stabilitetit obsesiv (të ekzagjeruar); varësia e vendorëve nga bashkësia ndërkombëtare që rezultoi nga mungesa e një strategjie dalëse dhe një harmonie ndërmjet pronësisë lokale dhe vetëvendosjes. Libri identifikon së paku dy korniza konceptuale, të cilat kanë ndihmuar në testimin e vendorëve. Të dyja janë studiuar shumë pak dhe kërkojnë përdorimin e kornizave alternative teorike dhe konceptuale.

ANALOGJIA NDËRMJET PRONËSISË LOKALE DHE VETËVENDOSJES

Unë besoj shumë se një ndër kontributet kryesore shkencore në forcimin e konceptit të pronësisë lokale përfshinë identifikimin e argumenteve ligjore. Kjo e bën konceptin jo vetëm të rëndësishëm për studime të sigurisë dhe studime zhvillimore por edhe për të drejtën ndërkombëtare. Unë e kam identifikuar parimin ligjor të vetëvendosjes si parimin më të afërt me konceptin e pronësisë lokale. Këtu, nuk e nënkuptoj interpretimin e ngushtë të vetëvendosjes - i cili kryesisht argumenton rreth të drejtës së shkëputjes (secesionit) dhe ndryshimit të kufijve shtetërorë - dhe dizajnin fillestar të parimit (Weller, 2008). Unë i referohem elementit të parimit të vetëqeverisjes i cili argumenton për të drejtën e faktorëve lokalë që të qeverisin vet, të lirë nga ndikimi i tepruar i jashtëm i bashkësisë ndërkombëtare.

Karta e OKB-së, dhe disa rezoluta kyçe të OKB-së, janë miratuar pas Luftës së Dytë Botërore dhe gjatë Luftës së Ftohtë. Vetëvendosja buron nga Karta e OKB-së dhe është e mishëruar edhe në disa rezoluta (OKB, 1968). Sidoqoftë, këto prapëseprapë janë subjekt i interpretimit në ambientin ekzistues. Natyrisht, vendimet e GJND-së në dekadat e mëhershme dhe e drejta zakonore e kanë zhvilluar edhe më tej interpretimin e vetëqeverisjes. Në mënyrë ideale, Karta e OKB-së dhe disa rezoluta duhet të ishin modifikuar dhe t'i ishin përshtatur rendit të ri botëror; që do të thotë se në mënyrë që pronësia lokale të ketë bazë ligjore, një rezolutë e veçantë do të bënte ta detyrueshme një përfshirje të ardhshme të administratës ndërkombëtare dhe komunitetit të donatorëve. Sidoqoftë, është e vërtetë se është e vështirë të pritët miratimi i rezolutave të reja dhe ndryshimeve potenciale duke ditur raportet komplekse të fuqisë ndërmjet shteteve anëtare të përhershme. Megjithatë, unë argumentoj se korniza ekzistuese ligjore që është në dispozicion për vetëqeverisje është e mjaftueshme, nëse interpretohet në frymën e pronësisë lokale. Në të vërtetë, pronësia lokale argumentohet në rrethana në të cilat roli i vendorëve anashkalohet nga ndikimi i fuqive të mëdha, qoftë përmes administrimit ndërkombëtar ose komunitetit të donatorëve. Interpretimi i vetëvendosjes kundrejt pronësisë lokale duhet rrjedhimisht të nënkuptojë vetëvendosjen e brendshme (Thürer & Burri, 2014; Weller, 2008). Vetëvendosja e brendshme mund të futet brenda konceptit të pronësisë lokale si e drejtë e popullit që të vendos në mënyrë të pavarur për proceset e tij zhvillimore dhe të shtetndërtimit. Kjo nënkupton “të drejtën e popujve që të jenë të lirë nga kontrolli i huaj sipas të drejtës së tyre për autonomi” (Wilde, 2012, f.261).

Me pak më shumë përpjekje dedikuar ekzaminimit ligjor të pronësisë lokale në kuadër të vetëqeverisjes, shkenca do tu paraprijë iniciativave të ardhshme në njohjen e pronësisë lokale si të drejtë ligjore, e mishëruar në sistemin ligjor ndërkombëtar dhe të obligueshme për të gjitha palët. Si rezultat, koncepti i pronësisë lokale do të paraqes bazën ligjore për argumente të forta zhvillimore dhe politike. Ai do të ndërtojë më tej temën e konceptit shumë-disiplinor transcendental. Kjo do të bëjë që pronësia lokale të njihet si parim të domosdoshëm i administratës ndërkombëtare dhe komunitetit të donatorëve në proceset e pas konfliktit dhe shtetndërtimit.

RËNDËSIA E LEGJITIMITETIT NË PRONËSINË LOKALE

Ka një kontribut shumë të madh shkencor në fushën e legjitimitetit. Legjitimiteti zakonisht shikohet në kontekstin e teorisë së demokratizimit, kryesisht në sistemet politike, me qëllim që të shpjegohet se sa është qeveria legjitime. Natyrisht, legjitimiteti i qeverisë nuk është qëllim i këtij hulumtimi. Qëllimi këtu është që legjitimiteti të zërthehet në bazë të pronësisë lokale dhe të shikohet se a janë prania dhe ndikimi i tepruar i bashkësisë ndërkombëtare sa duhet legjitime, domethënë, se bashkësitë vendase i miratojnë veprimet e saj. Në fakt, Dominik Zaum dhe William Bain bënë një hap të madh në zërthimin e pronësisë lokale në kuadër të legjitimitetit. Derisa Dominik Zaum mendon se “bashkësia ndërkombëtare [në rrethanat e pas konfliktit] ua mohon [të dyjat] njerëzve të cilët ata i qeverisin” (Zaum, 2006, f. 456), William Bain e konsideron problematike mungesën e “autoritetit të vendorëve për të rezistuar” (Bain, 2006, f. 537). Bain dhe Zaum mendonin se legjitimiteti është element vendimtar në vendet e pas konfliktit, në të cilat njerëzit duhet të thonë fjalën e tyre dhe do të respektohen derisa autoriteti i bashkësisë ndërkombëtare nuk mund të jetë absolut dhe ajo duhet të mbahet përgjegjëse (Zaum, 2006). Ka bazë të mjaftueshme për funksionimin e bashkësisë ndërkombëtare në vend të autoritetit lokal. Autoriteti lokal zhvillohet gradualisht (Bain, 2009; Lincoln, 1995) derisa ai mund të aplikohet vetëm “kur të jetë në gjendje të imponojë obligime efektive” (Hopgood, 2009, f. 232). Me pozicionim të dobët të shteteve në krijim e sipër, është vështirë të pritet që autoriteti lokal është sa duhet i pranishëm dhe i pranuar që të prodhojë rezistencë ndaj autoritetit ndërkombëtar.

Përpyekjet e ardhshme të këtyre studiuesve duhet të fokusohen në shkallën në të cilën autoriteti lokal do të mund të vërtetohej dhe legjitimizohet. Përpyekjet e tilla shkencore duhet të promovojnë të kuptuarit e “zërit” të vendorëve në veprimet e bashkësisë ndërkombëtare. Kjo, natyrisht, duhet të plotësohet përtej bazës ligjore tradicionale, sepse misionet ndërkombëtare dhe veprimet e komunitetit të donatorëve kryesisht bazohen në vendime ligjore. Këtu, mendoj në përshkrimin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë të legjitimitetit të përfshirjes ndërkombëtare. Për shembull, është me rëndësi të zërthehet në mënyrë shkencore se a duhet t'i jepen përfshirjes ndërkombëtare kompetencat e

përfaqësuesve të qytetarëve, pra, të parlamentit, të gjyqësorit, të institucioneve të pavarura dhe të shoqërisë civile.

Në mënyrë të ngjashme, përpjekjet hulumtuese në dikotominë legjitimitet-pronësi lokale po ashtu u janë përshtatur parimeve të RSS-së. Në fakt, në aspektin konceptual kjo ndihmon në zbërthimin e mëtejshëm të legjitimitetit. Nëse e përsërisim përkufizimin e RSS-së siç është përcaktuar nga Brzoska, qëllimi primar i RSS-së është që të sigurohet mbikëqyrja civile demokratike (Brzoska, 2006). Kjo nënkupton nevojën për të mbajtur përgjegjësinë të gjithë aktorët e përfshirë në sektorin e sigurisë, qofshin ndërkombëtarë apo vendorë. Unë nuk pres që kontributi do të bazohet vetëm në dimensionin konceptual; është shumë me rëndësi që legjitimiteti i veprimeve dhe mosveprimeve të bashkësisë ndërkombëtare të testohet në rastet e tjera studimore në të cilat roli i saj në rrethanat e pas konfliktit dhe pas pavarësisë ishte tepër i madh.

ULJA E VARËSISË NDAJ BASHKËSIA NDERKOMBËTARE

Varësia paraqet një prej pasojave kryesore të mungesës së pronësisë lokale, të cilën e kam trajtuar gjatë hulumtimit. Në fakt, gjatë testimit të hipotezës unë kam nxjerr në dritë pasojat e përfshirjes afatgjate të bashkësisë ndërkombëtare, duke çuar në varësinë e aktorëve lokalë, veçanërisht të profesionistëve. Varësia e aktorëve lokalë nga bashkësia ndërkombëtare duket të jetë sfiduese për procesin e shtetndërtimit, ndërsa shkaqet e saj rrjedhin nga fakti se bashkësia ndërkombëtare nuk ka strategji dalëse. Ky konkluzion bazohet në përkufizimin e strategjive dalëse nga Richard Caplan dhe Relf de Wilde (Caplan, 2012; Wilde, 2012). Rrjedhimisht, një varësi e tillë e ka krijuar konceptin te vendorët se “ndërkombëtarët do të bëjnë punën dhe se ata [ndërkombëtarët] janë drejtuesit përfundimtar” (B. Selimi, intervistë personal, 20 tetor 2014). Në fakt, nëse e ri-ekzaminojmë rastin e Kosovës, këto pasoja ishin të qarta që në vitet e para të shtetësisë (Surroi, 2014).

Përderisa përfshirja e mundshme e bashkësisë ndërkombëtare në të gjitha mjediset e pas konfliktit dhe pas pavarësisë duhet të jetë e bazuar në kontekst, megjithatë ajo duhet të marr parasysh evitimin e shkaqeve që çojnë në varësi të aktorëve lokalë. Gjetjet e mija tregojnë

se janë dy shkaqe që duhet të merren parasysh në mënyrë që të ulët varësia: një strategji e qartë dalëse dhe aftësia për të rezistuar. E para i drejtohet bashkësisë ndërkombëtare dhe e dyta bashkësive lokale. Sidoqoftë, administrimi i mundshëm ndërkombëtar ose komuniteti i donatorëve duhet të marr parasysh të parën në mënyrë që të shmang implikimet e të dytës.

STRATEGJIA E QARTË DALËSE

Asnjë mision ndërkombëtar nuk duhet të vendoset, ose të ofrojë mbështetje, në bazë të një pranie afatgjatë, sepse ekspertiza ndërkombëtare nuk mund të zëvendësojë kapacitetet lokale përgjithmonë (Donais, 2009). Përkundrazi, çdo prani afatgjate do të krijojë një proces eksperimental të mësimin në kurriz të vendorëve (Reich, 2006), diçka që duket se ndodh në mjediset e pas konfliktit. Një strategji dalëse do të përgatiste profesionistët lokalë dhe bashkësitë që të marrin përsipër përgjegjësitë kur të jetë arritur një nivel i caktuar i pjekurisë dhe ekspertizës. Ky vendim duhet të rrjedh nga rezultatet konkrete. Për shembull, mbështetja e jashtme për zhvillimin e sektorit të sigurisë duhet të ketë një “fund të mirë”, që do të thotë, se mbështetja e frytshme duhet të përfundojë me dorëzim të plotë të përgjegjësive tek autoritetet lokale. Një problem paraqitet kur strategjitë dalëse i përshatën “politikës së lartë”, siç ishte rasti me Kosovën. Unë kam gjetur se asnjë prej misionëve ndërkombëtarë dhe donatorëve kryesorë nuk ka pasur synim të tërhiqet ose të propozojë “largimin gradual” nga Kosova pa një vendim paraprak politik ndërkombëtar.

Në anën tjetër, është e vërtetë se në rendin ekzistues ndërkombëtar një vendim politik pasqyron vetëm njërin anë të medaljes, sepse misionet ndërkombëtare vendosen në një vend në bazë të rezolutave ndërkombëtare dhe pëlqimit të anëtarëve të organizatave të caktuara. Megjithatë, marrja parasysh e vendimeve politike nuk duhet të lë në hije zhvillimet pozitive sa i përket rritjes së pjekurisë dhe kapacitetit të aktorëve lokalë. Përveç kësaj, vendimet politike nuk duhet të lënë në hije gatishmërinë e bashkësive lokale. Po ju referohem atyre pasi që, siç ka treguar për shembull rasti i Kosovës, përkundër vendimit të Kuvendit të Kosovës për të ftuar EULEX-in në vend, bashkësitë lokale vazhdimisht nuk e kanë aprovuar as mandatin e as praninë e tij. Sa

për të rikujtuar statistikat, 54% e të anketuarve (njëjtë si nga radhët e shqiptarëve ashtu edhe të serbëve të Kosovës) i kanë bërë thirrje misionit të EULEX-it që të tërhiqet ose kishin pritur që ai tashmë të ishte tërhequr. Prandaj, është mjaft problematike që të sigurohet legjitimiteti i misioneve ndërkombëtare vetëm përmes perspektivës së institucioneve, të paktën në vendet në zhvillim siç është Kosova.

Si pasojë, mungesa e një strategjie dalëse krijon një varësi artificiale të përfituesve, veçanërisht të profesionistëve, sepse ata mësohen të jenë të lidhur me bashkësinë ndërkombëtare. Kjo jo vetëm që krijon perceptimin se “këta të jashtëm gjithmonë do të zgjidhin problemet” (B. Selimi, intervistë personale, 20 tetor 2014; R. Marmullaku, intervistë personale, 17 korrik 2014) por edhe e pengon konsekuencën dhe qëndrueshmërinë kur këto misione të jenë larguar përfundimisht nga vendi. Nëse kthehemi te gjetjet në Kosovës ndërhyrja dhe mandati i bashkësisë ndërkombëtare janë veçanërisht të rrënjësura në sektorin e sigurisë.

Përfshirja e mundshme e bashkësisë ndërkombëtare duhet të bazohet në një mandat të qartë, të shtyrë nga kërkesa dhe që mbështet përpjekjet e profesionistëve lokalë dhe të shoqërisë për shtetndërtim. Para kësaj, ka nevojë për planifikim konsultues me përfshirje më të gjerë të vendorëve në mënyrë që të hartohet një strategji dalëse realiste (Donais, 2012). Kjo nënkupton planifikim në bazë të nevojave dhe kërkesave të bashkësive lokale dhe përfaqësuesve qeveritarë, e jo vetëm përmes një qasjeje të standardizuar. Në fakt, kjo qasje e standardizuar, ose analiza “universale”, krahasohet në mënyrë ironike me logjikën e “ushqimit të shpejtë” ose “kornizës logjike” (Reich, 2006; Schmeidl, 2009) dhe përfundimisht konsiderohet e pasuksesshme. Kjo mbështetje duhet të pasqyrojë modelet që janë në përputhje me mjedisin dhe specifikat e vendeve të synuara. Përfshirja e mundshme e bashkësisë ndërkombëtare sigurisht se kërkon një qasje të kundërt ndaj asaj të zbatuar në Kosovë, ku pasojat janë evidente, veçanërisht sa i përket qëndrueshmërisë dhe varësisë së sektorit të sigurisë.

AFTËSIA PËR TË REZISTUAR

Aftësia për të rezistuar është po aq e rëndësishme sa edhe strategjia e qartë dalëse. Në fakt, kjo është pasojë e dështimit që të zbatohet një

strategji dalëse. Dallimi këtu qëndron në atë se kjo ka të bëjë me sjelljen e përfaqësuesve të qeverisë dhe bashkësisë lokale, e jo të bashkësisë ndërkombëtare. Ajo më shumë nënkupton autoritetin lokal edhe pse të dobët në rrethanat e pas konfliktit (Bain, 2009; Di Lellio, 2009; Hopgood, 2009; Lincoln, 1995). Në fakt, po të ekzistonte aftësia për të rezistuar dhe po të forcohej autoriteti lokal, do të kishte më shumë gjasa që të sigurohet pronësia lokale dhe të miratohet një strategji dalëse për bashkësinë ndërkombëtare. Unë e kam demonstruar se “aftësia për të rezistuar” mund të dallohet lehtë në rastin e parë kur vendorët të jenë në pozitë tu thonë “jo” disa veprimeve të caktuara të ndërmarra nga bashkësia ndërkombëtare. Kjo është me rëndësi veçanërisht nëse këto veprime nuk janë paraparë të jenë në përputhje me vullnetin popullor të shumicës së qytetarëve dhe me interesat e shoqërisë. Megjithatë është e vërtetë se aftësia për t’i rezistuar bashkësisë ndërkombëtare është më e ndërlikuar se sa aftësia për t’i rezistuar, për shembull, qeverisë.

Në demokracitë normale, “jo”-ja për qeverinë mund të konvertohet në dështimin e partive në pushtet për të fituar zgjedhjet dhe për formuar qeverinë. Kjo nuk është metodë për të sfiduar praninë e ndërkombëtarëve pasi që ata nuk janë përfaqësues të popullit. Shkalla e mbështetjes publike dhe diskursit publik duhet të konsiderohet si vegël e mjaftueshme për të matur legjitimitetin e bashkësisë ndërkombëtare - diçka që kjo tezë e ka aplikuar për Kosovën.

Në Kosovë, nuk ka pasur kundërshtim të shumicës së zgjidhjeve të ofruara nga jashtë, pavarësisht se a ka qenë ky veprim i dëmshëm për RSS-në dhe shtetndërtimin. Ka pasur veprime për kundërshtimin e disa vendimeve nga jashtë (F. Harris, intervistë personale, 2 maj 2014; B. Selimi, intervistë personale, 20 tetor 2014); megjithatë, ato nuk mundën të parandalonin një pjesë të bashkësisë ndërkombëtare që të imponojë ose fus në zbatim këto politika. Këtu, mund të përmend tre raste: SSK, mekanizmat e sigurisë në bashkësi, dhe paradigma obsesive e motivuar në baza etnike. Këto pasqyrojnë shembujt më të rëndësishëm, ndonëse jo të vetmit, dhe sqarojnë mos aftësinë e aktorëve lokalë të rezistojnë ose të paktën të thonë fjalën e tyre në proces. Kjo pasqyrore pozicionimin dhe autoritetin e dobët të vendorëve në mënyrë që të forcojnë interesat e tyre kombëtare dhe publike.

Në fakt, kam ardhur në përfundim se mos aftësia për t'iu kundërvënë zgjidhjeve jo të kënaqshme nga jashtë është e lidhur ngushtë me dobësinë e shtetit. Natyrisht, të gjitha vendet e pas konfliktit dhe pas pavarësisë konsiderohen të jenë të dobëta në fillim - veçanërisht ato që janë në fazën më të hershme të shtetndërtimit. Nuk mund të krahasohet autoriteti i shteteve të vogla në krijim e sipër siç është Kosova, me autoritetin, për shembull, të Gjermanisë ose Japonisë pas Luftës së Dytë Botërore për tu rimëkëmbur aq shpejtë. Sa e kam kuptuar unë, sa më shumë që të krijohet shtetësia, krenaria e qytetarëve për shtetësinë është më e fortë. Në këtë aspekt, unë jam i prirë të krahasoj Kosovën me Nepalin, ku kisha mundësinë të merrja pjesë në një përvojë të shkurtër por domethënëse; edhe pse Kosova është më e zhvilluar dhe gjeografikisht në Evropë, aftësia e profesionistëve të saj t'i rezistojnë zgjidhjeve të imponuara nga jashtë është më e ulët se e profesionistëve të Nepalit. Në Nepal, komuniteti i donatorëve ndërkombëtarë është më i kujdesshëm në “sugjerimin” e “praktikave më të mira perëndimore” për shkak se rezistenca është më e theksuar. Prandaj, nuk është rastësi që disa prej aktorëve donatorë janë të prirë të sillen në përputhje me ambientin, që do të thotë se ata përbahen nga ofrimi i zgjidhjeve kur ka rezistencë.

Unë argumentoj se nuk është realiste të pritet që varësia të jetë më e ulët në shoqëritë që kanë prerogativa më të mëdha për të qenë të varura. Megjithatë, duhet të bëhen përpjekje nga bashkësia ndërkombëtare për të gjetur mënyra për uljen e varësisë, sepse ajo është e dëmshme për çdo proces të shtetndërtimit. Kjo ka qenë problematike jo vetëm në rastin e Kosovës, por edhe në BeH (Perdan, 2008), në Timorin Lindor (Lemay-Hebert, 2011) dhe në Palestinë.

IMPLIKIMET E EKZAGJERIMIT TË “POLITIKËS SË LARTË”

Dëshmitë tregojnë se “politika e lartë” mund të ketë ndikim të tepruar në veprimet, mosveprimet, vendimet dhe sugjerimet e bashkësisë ndërkombëtare në zhvillimin e sektorit të sigurisë. Ajo është shndërruar në instrument dhe është përdorur së tepërmi ose është keqpërdorur nga përfaqësuesit e bashkësisë ndërkombëtare (L. Greiçevci, intervistë personale, 25 korrik 2014). Unë po ashtu kam sjellë prova për të ekspozuar përmasën e “politikës së lartë” krahas mungesës

së strategjisë dalëse. Në fakt, një prej përfundimeve primare është se ndikimi i tepruar i një politike të tillë në RSS mund të konsiderohet e dëmshme. Në Kosovë, kanë mbizotëruar argumentet politike për të arsyetuar ndikimin e tepruar të bashkësisë ndërkombëtare. Në të vërtetë, rasti i Kosovës nuk është përjashtim kur argumentet politike mbizotërojnë mbi ato racionale. BeH paraqet një shembull tjetër ku, edhe pse nuk kishte problem me shtetësinë e saj - veprimet e bashkësisë ndërkombëtare ishin të motivuara politikisht (Caplan, 2006; Perdan, 2008).

Nëse hulumtojmë më thellë në shembullin e Kosovës (dhe BeH), bashkësia ndërkombëtare ishte aq e obsesionuar me ofrimin e sigurisë dhe ambientit të sigurt, që domethënë, çdo reformë ose zhvillim në sektorin e sigurisë shikohej vetëm nga kjo perspektivë. Duhet të përkujtojmë kënaqësinë e tepruar të zyrtarëve të lartë të BE-së me arritjen kryesore të tyre në Ballkan: “paqja është gjë e madhe kështu që ne jemi të kënaqur që ta ruajmë atë” (I intervistuari C, intervistë personale, 31 tetor 2014). Nuk ka asgjë të keqe në përpjekjet për ruajtjen e paqes - faktikisht kjo edhe është prerogativa kryesore - sepse vet BE është projekt i paqes dhe duhet ta mbrojë këtë vlerë. Megjithatë, kjo nuk duhet të bëhet në dëm të proceseve të tjera. Për më tepër, ajo nuk mund të aplikohet si vegël për të arsyetuar dobësitë në sektorin e sigurisë, veçanërisht kur ky sektor është përgjegjësi e përbashkët e bashkësisë ndërkombëtare dhe aktorëve lokalë. Referenca e tepruar në stabilitet krijon një argument politik që synon të lë nën hije argumentet e tjera teknike.

Si për ironi, argumentet politike zakonisht ndërtohen nga një distancë gjeografike; është kjo distancë që krijon argumente artificiale për “nevojën ekskluzive” të ruajtjes së paqes. Prandaj, nëse ne e paraqesim dilemën për transformimin e FSK-së në FAK, argumentet për stabilitetin e tepruar zakonisht bëhen në kryeqytetet perëndimore, përfshirën Brukselin. Në fakt, Brukseli është i prirë të shikoj të gjitha zhvillimet nga perspektiva e politikës (Palokaj, 2015). Si pasojë, tendenca për të vrojtuar procesin e shtetndërtimit vetëm mbi baza politike është në papajtueshmëri dhe kundërshtim me vet thelbin e pronësisë lokale. Pasojat janë të qarta: “politika e lartë mbizotëron mbi çdo argument tjetër që arsyeton mjaftueshëm; në këtë

rast, mbi nevojën për të krijuar një institucion që do tu shërbente interesave të shtetit. Tendenca që proceset të vlerësohen vetëm në bazë të “çmimit të paqes”, e me këtë të “politikës së lartë” pasqyron një analogji me shembullin ironik të paraqitur nga Edward Said (ndonëse i sqaruar në një kontekst tjetër), i cili e ka përshkruar profilizimin e Lindjes së Mesme nga autorët ndërkombëtarë si “një pamja magjepsëse në Champs-Élysées në Paris” (Said, 1994, f. 179).

Është edhe më problematike të bëhet përpjekje të imponohet ndryshimi i mentalitetit në terren të “politikës së lartë”. Ky proces nuk mund të adresohet përmes logjikës së “kornizës logjike”, kështu që nuk është përfundimtar. Shembulli që pasqyron ndëshkimet për përdorimin e simboleve të luftës nga forcat e sigurisë nënkupton qëllim të mirë strategjik: megjithatë, veprimet taktike nuk i shërbejnë kësaj strategjie. Mentaliteti që lidhet me luftën do të ulet me kalimin e gjeneratave dhe jo me mjete detyruese.

Përfshirja e mundshme e bashkësisë ndërkombëtare nuk duhet të mbështetet kryesisht në “politikën e lartë”. Ky mesazh duhet të merret parasysh në të gjitha ambientet, pavarësisht nivelit të kompleksitetit. Nuk po them se politika nuk duhet të merret parasysh fare, sepse thjeshtë kjo s’mund të bëhet. Sidoqoftë, bashkësia ndërkombëtare nuk duhet të jetë tepër e obsesionuar me stabilitetin dhe sigurinë, veçanërisht nëse ka argumente të mjaftueshme që demonstrojnë se procesi i përgjithshëm i paqes nuk mund të ndikojë në zhvillimin e sektorit të sigurisë - siç është rasti në Kosovë. Në përgjithësi, mbështetja për RSS-në duhet të bazohet vetëm në parimet e përbrendësimit të praktikave të mira bazuar në kontekstin në të cilin sektori i sigurisë do të jetë i qëndrueshëm.

PROMOVIMI I BESIMIT

Besimi duket të jetë një prej normave komplekse në marrëdhëniet ndërkombëtare. Ajo është një prej normave që mund të pengojnë pronësinë lokale. Sa i përket vendeve të pas konfliktit dhe pas pavarësisë, gjetjet tregojnë se mosbesimi është i rrënjosur thellë në “marrëdhënien e pabarabartë” ndërmjet ndërkombëtarëve dhe vendorëve, e cila mund të përkufizohet lehtë si “dilemë e mosbesimit” (Hansen,

2008, f. 45). Kjo është vërtetuar në rastin e Kosovës. Natyrisht, siç argumentohet në tërë kornizën teorike, “dilema e mosbesimit” nuk është nocion i fiksuar ontologjik; ajo nuk mund të arrihet deri në një pikë ku mund të thuhet “po, ka besim” ose “jo, nuk ka besim”. Kjo është një trajektore e cila zhvillohet gradualisht. Për më tepër, ky nuk është problem vetëm në Kosovë por mund të gjendet edhe në marrëdhëniet ndërmjet vendeve të zhvilluara; ai paraqet problemin kryesor në bashkëpunimin në fushën e sigurisë dhe në ndërtimin e komuniteteve të sigurisë në BE sepse ndarja e informatave, për shembull, ndërmjet forcave të sigurisë duket të jetë sfiduese (Malstrom, 2011).

Të rikujtojmë, William Bain ka dhënë një kontribut të dalluar në zbrërthimin e “dilemës së mosbesimit” në mjediset e pas konfliktit. Ai argumentoi se administrata ndërkombëtare ka dështuar që të bëj dallimin ndërmjet dy elementeve të marrëdhënies njerëzore: kontratës dhe besimit (Bain, 2006). Ai më tej e përforcoi argumentin e tij se ndërkombëtarët dhe vendorët duhet të konsiderojnë marrëdhënien e tyre në formë të palëve kontraktuese që kanë përfitim të përbashkët. Megjithatë, problemi me logjikën e marrëdhënies kontraktuese është se ajo konsiderohet se e bën palën kontraktuese (ofruesin) patron. Si pasojë, patroni e ka kapacitetin të vendos për shkallën e besimit që i jepet përfituesit. Për këtë qëllim, Bain shkon edhe më tej me cinizmin e tij kur e quan bashkësinë ndërkombëtare si “Princ”, i cili nuk detyrohet nga ligjet për të dënuar pushtetin e tij absolut (Bain, 2009, f. 151).

Nuk mund të argumentohet se ka një aspekt të “Princit” në kapacitetin e bashkësisë ndërkombëtare në këtë rast studimor. Megjithatë, gjetjet e tij kanë paraqitur një varg shembujsh që sqarojnë nivelin e lartë të mosbesimit ndërmjet profesionistëve lokalë dhe bashkësisë ndërkombëtare. Besimi nuk munda të rritej në përputhje me trajektoren e praktikës, gjetjet e tregojnë të kundërtën: sa më gjatë që të jetë e pranishme bashkësia ndërkombëtare, aq më shumë do të ketë raste të ndërhyrjes. Një ndërhyrje e tillë ka çuar në mungesë të besimit në radhët e profesionistëve lokalë. Kjo po ashtu është reflektuar edhe në mosbesimin e qytetarëve. Statistikat mbi perceptimin publik, për shembull, tregojnë se në periudhën 2012-2014 rreth 42% e të anketuarve nuk i besonin EULEX-it. Pakënaqësia në rritje me misionet ndërkombëtare mund të vërehet kudo në këtë libër. Megjithatë, ky trend nuk është

i kufizuar vetëm në Kosovë sepse duket se vlen edhe për vendet e tjera të pas konfliktit, ku mungesa e një strategjie dalëse të bashkësisë ndërkombëtare është kthyer në pakënaqësi të bashkësive lokale.

ZVOGËLIMI I MODELEVE TË IMPONUARA NGA JASHTË

Modelet e bazuara nga jashtë në zhvillimin e sektorit të sigurisë kanë dëshmuar të jenë një prej shqetësimeve kryesore të pronësisë lokale. Disa prej vendimeve dhe veprimeve të bashkësisë ndërkombëtare janë sugjeruar nën flamurin e “Praktikave më të Mira Perëndimore”. Ne e kemi zbërthyer projektin e FSK-së të shtyrë nga jashtë, i cili nuk bazohej në kërkesat lokale dhe ishte i imponuar politikisht - kjo ka çuar në përsëritjen e kërkesave për të pasur një forcë mbrojtëse. Unë kam argumentuar ngjashëm në lidhje me politikat e sigurisë kombëtare të drejtuara nga jashtë dhe sigurinë në komunitet “nga lart - poshtë”. Përveç kësaj, unë kam ofruar një numër shembujsh të tjerë kudo në libër që sqarojnë marrëdhënien komplekse në lidhjen ndërkombëtarë-vendorë. Referencat e shpeshta në “Praktikat më të Mira Perëndimore” e kanë arsyetuar në mënyrë artificiale ndërhyrjen e bashkësisë ndërkombëtare në sektorin e sigurisë. Kjo ndërhyrje ishte e pa justifikuar për shkak të logjikës së thjeshtë që lidhet me RSS-në, për shembull, se nuk ekziston një model i vetëm i sigurisë ose policimit që aplikohet në Evropë. Prandaj një universalitet i tillë nuk mund të ekzistojë në realitet. Realisht, modelet perëndimore të qeverisjes së sigurisë janë shumë të ndryshme, secila prej tyre produkt i zhvillimeve historike dhe kushtetuese (Donais, 2008). Rrjedhimisht, që në shikim të parë kontestohen referencat në një standardizim të unifikuar të praktikave të policimit.

Modelet e sigurisë dhe policimit të shtyra nga jashtë transmetohen në mënyrë lineare në tërë kontekstin e pas konfliktit, pavarësisht rajonit. Të intervistuarit dukej se transmetonin përvojën e tyre në të cilën bashkësia ndërkombëtare e tërhiqte një paralele, për shembull, ndërmjet Kosovës dhe Afganistanit (L. Fushtica, intervistë personale, 21 korrik 2014). Natyrisht, unë nuk e mbështes perceptimin e gabuar që profesionistët e Kosovës e kanë për rajonet e tjera. Po ashtu, unë nuk e mbështes as përpjekjen që të gjitha rastet e pas konfliktit të shihen brenda të njëjtës perspektivë të ngushtë, thjeshtë sepse konteksti

dhe mjedisi janë të ndryshëm. Megjithatë, është e vërtetë se veprimi i standardizuar nga bashkësia ndërkombëtare ka çuar në ide të gatshme dhe të bëra sipas mostrave që janë ofruar në të gjitha mjediset e pas konfliktit. Kështu është rasti me përpjekjet për shkëmbimin e përvojave nga rajonet e tjera, të cilat disa “profesionistë ndërkombëtarë” i kanë zbatuar lehtë.

Në anën tjetër, gabimet e bëra përmes konceptimit linear të të gjitha mjedisëve të pas konfliktit mund të shihen nga perspektiva e ekspertëve ndërkombëtarë. Është e vërtetë se të qenit ekspert ndërkombëtar në vendin tënd të origjinës nuk ta jep automatikisht atë ekspertizë në vendin përfitues. Ky problem nuk ishte i pranishëm vetëm në procesin e hartimit të politikave por edhe në mandatin ekzekutiv të bashkësisë ndërkombëtare. Përfshirja e ekspertëve ndërkombëtarë në detyra ekzekutive është edhe më problematike, siç e ka treguar rasti, sepse ekspertët ndërkombëtarë nuk mund të kenë më shumë “njohuri operacionale se sa vendorët” (F. Harris, intervistë personale, 2 maj 2014; B. Selimi, intervistë personale, 20 tetor 2014; R. Marmullaku, intervistë personale, 17 korrik 2014). Njohuria operacionale konsiderohet më e rëndësishme se sa çdo njohuri tjetër, veçanërisht në çështjet që kanë të bëjnë me sundimin e ligjit.

Është e qartë se këto modele nuk i kanë përfshirë kurrë në mënyrë gjithëpërfshirëse të gjithë aktorët për të fituar një legjitimitet më të gjerë. Komuniteti i donatorëve ndërkombëtar shpesh preferon të konsultohet vetëm me elitat lokale, të cilat kanë kredenciale specifike perëndimore (Caparini, 2010; Narten, 2009). Diskutimi kryesisht me elitat paraqet një prej dilemave kryesore në RSS (Brzoska, 2006). Në Kosovë, bashkësia ndërkombëtare e ka kërkuar pëlqimin për zgjidhjet dhe modelet e caktuara vetëm nga aktorët më të fortë (elitat). Si i tillë, zhvillimi i sektorit të sigurisë i drejtuar nga jashtë jo vetëm që nuk është bërë në konsultim me të gjithë përfaqësuesit lokalë, por edhe në mënyrë selektive vendosi për elitat me të cilat ajo do të punojë - duke injoruar ato që do paraqisnin sfidë dhe rezistencë kundër përfshirjes së bashkësisë ndërkombëtare.

Si rezultat, përfshirja e mundshme e administratës ndërkombëtare dhe komunitetit të donatorëve duhet të mendojnë me kujdes rolin

e tyre në një kontekst specifik krahas kërkesave të përfaqësuesve të qeverisë vendore. Në fakt, imponimi i modeleve që nuk janë në harmoni me rrethanat lokale jo vetëm që i tjetërson komunitetet lokale, por ofron zgjidhje që sipas të gjitha gjasave do të jenë të pasuksesshme dhe të paqëndrueshme. Dështimi i kësaj qasjeje do të testohet në rast të tërheqjes përfundimtare të përkrahjes nga komuniteti i donatorëve. Ky është shqetësim i veçantë i donatorëve kryesorë, të cilët janë të prirë për të ndarë ekspertizën në bazë të normave të tyre. Donatorët kryesorë duhet të përmbahen nga mbështetja e një modeli të standardizuar dhe të bazuar nga jashtë të sigurisë dhe policimit në vend të marrjes së pëlqimit vendor.

PËRFUNDIMET

Ky libër ka demonstruar rëndësinë e pjesëmarrjes së vendorëve për një paqe dhe shtetndërtim të qëndrueshëm. Përfshirja e vendorëve nuk e ka për qëllim të dëmtojë rëndësinë e politikës në shtetndërtim - që njihet gjerësisht si qasje “nga lartë-poshtë” - thjeshtë sepse ajo nuk mund të anashkalohet. Megjithatë, argumenti gjithëpërfshirës e ka prezantuar rëndësinë e veprimeve të shtyra vendore - dhe një qasjeje “nga poshtë - lartë”. Duke ditur rëndësinë, libri ka treguar se të dy qasjet janë njëjtë të rëndësishme - ku qasja “nga poshtë - lartë” është më e rëndësishme pasi që “shtetndërtimi nuk është i kufizuar në qasjen ‘nga lartë - poshtë’ ose vetëm në qasjen ‘nga poshtë - lartë’ (Paris dhe Sisk, 2007, f. 15). Si rezultat, gjetjet e sfiduan sistemin ekzistues të intervenimit ndërkombëtar në mjediset e pas konfliktit i cili vetëm teknikisht iu referua rolit të vendorëve pa e marrë parasysh përfshirjen e gjerë të tyre dhe duke e shpërfillur kulturën lokale. Komplexitetet nuk gjenden në tërë sektorin e sigurisë, shtyllë që përfaqëson themelin e shteteve bashkëkohore.

Rasti i Kosovës ka dëshmuar të jetë shumë i rëndësishëm në shqyrtimin e shkallës së përfshirjes ndërkombëtare. Roli i tepruar i bashkësisë ndërkombëtare, pa një strategji të qartë dalëse, ka çuar drejt reagimit të faktorëve lokalë në të cilat politikat e shtyra nga jashtë janë refuzuar në mënyrë të heshtur dhe nuk kanë gjetur zbatim në kontekstin e Kosovës. Referenca e tepruar në ruajtjen e stabilitetit dhe sigurisë si mjete për arsyetimin e veprimeve ndërkombëtare solli mungesën e besimit ndërmjet bashkësisë ndërkombëtare dhe vendorëve. Ky nivel i përfshirjes së bashkësisë ndërkombëtare e ka shkëputur politikën e sigurisë nga realiteti lokal, duke çuar në fragmentim dhe qëndrueshmëri të kufizuar. Si pasojë, pozicionimi i dobët i autoritetit vendor kundrejt pozicionimit më të fortë të agjendave të imponuar nga jashtë shkaktuan bashkëpunim të pabarabartë (Hansen, 2008; Reich, 2006) ndërmjet bashkësisë ndërkombëtare dhe qeverisë dhe faktorëve lokalë. Po

ashtu, dhe në kuptim më të gjerë, mospërfshirja e faktorëve lokalë në formë të përfaqësuesve të qeverisë ose të shoqërisë civile manifeston mungesën e prerogativave kyç për sigurimin e pronësisë lokale.

Në këtë kapitull përmbyllës, unë kam përmbledhur implikimet e kontributit teorik dhe gjetjeve empirike të trajtuara në të gjitha nivelet e librit. Në pjesën e parë, unë kam sintetizuar gjetjet kyçe ndër- sa në pjesën e dytë kam paraqitur drejtimit e ardhshme kërkimore që kanë për qëllim të zhvillojnë dhe teorizojnë konceptin e pronësisë lokale. Sinteza dhe drejtimit e ardhshme synojnë të orientohen drejt përfshirjes së mundshme të bashkësisë ndërkombëtare në përmirësimin e veprimeve të tyre në mjediset e pas konfliktit dhe pas pavarësisë.

SINTETIZIMI I SFIDAVE TË PRONËSISË LOKALE

Pronësia lokale është koncept i papërfunduar. Qëllimi i tij primar i respektimit të të drejtave të vendorëve është ndërtuar në mënyrë artificiale në qarqet e politikave të zhvillimit ndërkombëtar. Ai ia ka dalë të përmbush kushtet teknike të aplikimit të politikave ndërkombëtare, por ka dështuar të aplikojë konceptin në proceset kyçe të zhvillimit të sektorit të sigurisë. Gjetjet tregojnë se pronësia lokale ka mbetur në margjinat e “kornizës logjike” të donatorëve pa e synuar përbrendësimin e saj në normë të domosdoshme të bashkësisë ndërkombëtare. Ajo nuk është përfshirë në asnjërin prej parimeve ligjore - siç është vetëvendosja - e as në normat ekzistuese ndërkombëtare siç janë legjitimiteti dhe besimi. Kështu, pronësia lokale mbetet një kategori e pazhvilluar sa duhet e paqebërjes liberale. As kontributi shkencor nuk mundi të bënte ndonjë hap aq të madh. Ai nuk e ka ekzaminuar hollësisht pronësinë lokale në të gjitha rastet studimore, kryesisht në ato që kanë të bëjnë me asistencën ndërkombëtare në mjediset e pas konfliktit ose pas pavarësisë. Rasti i Kosovës ka rastisur të jetë ndër rastet më me vend ku është zbrëthyer pronësia lokale përtej asaj që është shërbyer në nivel të politikave dhe zhvilluar në kontributin e kufizuar konceptual. Gjetjet e librit konfirmojnë se bashkësia ndërkombëtare ka shpërfillur parimet thelbësore të pronësisë lokale në procesin e zhvillimit të sektorit të sigurisë në Kosovë. Ajo i ka sfiduar iniciativat kryesore të drejtuara në nivelin lokal në bazë të “politikës së lartë” dhe stabilitetit. Ndërhyrja e

ka tjetërsuar popullatën lokale deri në atë shkallë sa veprimet e bashkësisë ndërkombëtare janë deklaruar si jolegjitime, dhe kanë rezultuar me mungesë të besimit.

Gjetjet janë sintetizuar më tutje më poshtë:

Së pari, përkufizimi ekzistues i konceptit të pronësisë lokale është dëshmuar të jetë joadekuat dhe i zhvilluar vetëm mbi kornizën e politikave. Referenca në vendorët dhe pjesëmarrjen e tyre është përdorur nga donatorët dhe organizatat ndërkombëtare kryesisht për të siguruar fonde dhe marrëdhënie të mira me qeveritë donatore (Richmond, 2012) prandaj ka qenë e kufizuar vetëm në “plotësimin e rubrikës në matricën” e përfshirjes së komuniteteve lokale pa e pasur qëllimin për t’i përfshirë ato (Wilén & Chapaux, 2011). Organizatat ndërkombëtare e kishin përkufizuar konceptin në një mënyrë e cila pasqyrore kundërbënie. Për shembull, edhe brenda OKB-së përkufizimi i pronësisë lokale është dizajnuar dhe ri-dizajnuar në mënyrë që të arrihen qëllime të caktuara të politikave edhe pse secili prej këtyre koncepteve ishte në konflikt me njëri-tjetrin Përkufizimi akademik i pronësisë lokale ka dhënë vetëm një kontribut të kufizuar kur e sqaroi dilemën e lidhjes mes ndërkombëtarëve dhe vendorëve (Richmond, 2012) dhe përfshirjen e donatorëve (Nathan, 2007). Libri ka kontribuar duke krijuar harmoni ndërmjet pronësisë lokale dhe parimit juridik ndërkombëtar të vetëvendosjes. Ky kontribut e ngriti idenë e konsiderimit të pronësisë lokale si koncept ligjor përtej një koncepti ekzistues të politikave. Ai po ashtu ka ekzaminuar pronësinë lokale në kuadër të normave ndërkombëtare siç janë besimi dhe legjitimiteti duke e plotësuar bazën e tij morale. Edhe fuqia ligjore edhe ajo morale përfshijnë argumente gjithëpërfshirëse të konceptit të zhvilluar të pronësisë lokale.

Së dyti, dhe duke marrë parasysh kontekstin specifik të rastit të Kosovës, ndikimi tepër i madh i bashkësisë ndërkombëtare ka pasur implikime për zhvillimin e sektorit të sigurisë. Trajektorja e ndikimit ndërkombëtar në sektorin e sigurisë është modifikuar në mënyrë artificiale gjatë gjithë periudhës së pas pavarësisë, ndonëse ende bazohet në perceptimet e tepruara të stabilitetit dhe “politikës së lartë”. Dikotomia “politikë e lartë” - stabilitet nuk e ka pasqyruar kurrë gjendjen e

vërtetë në terren, megjithatë, pasojat e kësaj politike e kanë modeluar një sistem të sigurisë të drejtuar nga jashtë. Një prej rasteve, siç është krijimi i FSK-së në vend të konsultimeve me përfaqësuesit lokalë nën argumentet e stabilitetit të ekzagjruar, është dëshmuar të jetë e paarsyeshme dhe mjaft e paqëndrueshme. Kjo ndodhi sepse kërkesat e vendorëve ishin drejtuar rreth një shqetësimi të vetëm të krijimit të Forcave të Armatosura, duke shmangur kështu dedikimin ndaj një modeli të drejtuar nga të huajt. Ngjashëm, stabiliteti i ekzagjruar shënoi një intervenim klasik në politikat e sigurisë - kryesisht në SSK - duke treguar superioritetin e intervenimit të bashkësisë ndërkombëtare në dëm të kornizës kryesore doktrinare të politikës së sigurisë. Kjo thjeshtësohet më tej në rastin e këshillave të sigurisë në bashkësi, të cilat u financuan nga jashtë dhe pa strategji të qartë për dorëzimin e përgjegjësive tek vendorët.

Së treti, modelet e drejtuara nga jashtë në Kosovë janë dëshmuar se janë në mospërputhje me realitetin, dhe në fakt kanë treguar shpërfillje për këtë realitet. Modelet e paraqitura në Kapitujt IV dhe V e manifestuan mungesën e pronësisë lokale dhe implikimet e saj në qëndrueshmërinë e politikës së sigurisë. Kosova nuk bën përjashtim nga qasja “një zgjidhje universale për gjithçka” e aplikuar nga bashkësia ndërkombëtare, pasi që veprimet janë treguar se janë lineare. Ky linearitet është aplikuar në të gjitha mjediset e pas konfliktit pavarësisht rajonit, zhvillimit ekonomik ose rrethanave specifike të një vendi (L. Fushtica, intervistë personale, 21 korrik 2014). Në anën tjetër, këto modele kanë përjashtuar përfshirjen më të gjerë të të gjithë aktorëve, duke e vënë në pikëpyetje legjitimitetin e veprimeve ndërkombëtare. Në vend të kësaj, gjetjet e kanë treguar preferencën e bashkësisë ndërkombëtare që të konsultohet vetëm me elitat lokale, të cilat kanë kredenciale specifike perëndimore (Caparini, 2010; Narten, 2009). Një problem i ngjashëm është nënvizuar nga përfshirja e ekspertëve ndërkombëtarë, pasi që ekspertët ndërkombëtarë nuk mund të kishin më shumë “njohuri operationale se sa vendorët” (F. Harris, intervistë personale, 2 maj 2014); B. Selimi, intervistë personale, 20 tetor 2014; R. Marmullaku, intervistë personale, 17 korrik 2014). Kundër argumentet që sugjerojnë nevojën për një intervenim me kohë si mjet të krijimit të paqes liberale dhe “praktikave më të mira perëndimore”

nuk janë bindëse pasi që çdo synim për zgjidhje të shpejtë dhe aplikim të parimeve kryesore të RSS ka gjasa të dështojë (Paris dhe Sisk, 2009).

Së katërti, mungesa e besimit në lidhjen ndërkombëtarë-vendorë paraqet një prej dilemave më të mëdha për thelbin e pronësisë lokale. Shembujt që sqarojnë shkallën e besimit kanë treguar një rritje të nivelit të mosbesimit pavarësisht rezultateve në praktikë dhe bashkëpunimit ndërmjet bashkësisë ndërkombëtare dhe vendorëve. Problemi gjithëpërfshirës i mosbesimit është i dyfishtë: E para është se “vendorët nuk u besojnë ndërkombëtarëve” dhe e dyta “ndërkombëtarët nuk u besojnë vendorëve”. Mosbesimi nga të dy drejtimet është i rrënjosur qoftë në paragjykim ose në rezultatet në praktikë, duke pasqyruar një problem të thellë për zbatimin e pronësisë lokale. Rezultatet që tregojnë perceptimin publik ndaj misionëve ndërkombëtarë paraqesin më së miri mosbesimin e publikut ndaj bashkësisë ndërkombëtare dhe opinionin popullor që favorizon tërheqjen e misionit, veçanërisht të misionit më të madh të BE-së në terren - EULEX-it. Ky nivel i mosbesimit thellohet më tej kur ekspertët ndërkombëtarë shfaqin disa elemente të mosbesimit ndaj profesionistëve lokalë.

Së pesti, implikimi i mungesës së pronësisë lokale ka çuar drejt varësisë së aktorëve lokalë, veçanërisht profesionistëve. Varësia e aktorëve lokalë nga bashkësia ndërkombëtare duket të jetë sfiduese për procesin e shtetndërtimit, ndërsa shkak i saj është rezultat i mungesës së një strategjie dalëse për bashkësinë ndërkombëtare. Kjo gjetje i është e përshtatur përkufizimit të “strategjive dalëse” të Richard Caplan dhe Ralf de Wilde (Caplan, 2012; Wilde, 2012) bazuar në vlerësimin e përbashkët se kapaciteti ndërkombëtar nuk mund të zëvendësojë kapacitetet lokale përgjithmonë (Donais, 2012b). Rrjedhimisht, një varësi e tillë ka krijuar konceptin tek vendorët se “ndërkombëtarët do të bëjnë punën dhe se ata [ndërkombëtarët] janë drejtuesit përfundimtar” (B. Selimi, intervistë personal, 20 tetor 2014). Megjithatë, kjo varësi manifestohet si shkak dhe si pasojë. Derisa varësia është konstatuar se krijohet si rezultat i një pranie pothuaj të papërcaktuar të bashkësisë ndërkombëtare, po ashtu është konfirmuar të jetë edhe si rezultat i dobësisë së vendorëve, qoftë e përfaqësuesve qeveritarë ose e bashkësive vendase. Niveli i lartë i varësisë - siç identifikohet në tërë këtë libër - është bërë sistemik prandaj ajo është mishëruar në

